



CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS:

TËRHEQJA E MBRETËRISË SË BASHKUAR NGA ANËTARËSIA E UNIONIT EVROPIAN DHE IMPLIKIMET E KËTIJ PROCESI

Kandidatja:

MA. Viona RASHICA

Mentori:

Prof. Dr. Abdulla AZIZI

Tetovë, 2021

Titulli punues i temës:

“Tërheqja e Mbretërisë së Bashkuar nga anëtarësia e Unionit Evropian dhe implikimet e këtij procesi”

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

“Withdrawal of the United Kingdom from EU membership and the implications of this process”

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

“Повлекување на Велика Британија од членството во ЕУ и импликациите од овој процес”

ABSTRAKTI

Tërheqja e Mbretërisë së Bashkuar nga anëtarësia e Unionit Evropian, proces ky i njohur me termin Brexit, është një prej ngjarjeve ndërkombëtare kryesore të shekullit XXI. Rëndësia e Brexit-it mbështetet në faktin se kemi të bëjmë me daljen e Britanisë, një shteti që njihet për rolin e madh politik, ekonomik dhe ushtarak në botë, prej një organizate ndërkombëtare sui generis me rëndësi të jashtëzakonshme në arenën ndërkombëtare.

Qëllimi primar i hulumtimit është ofrimi i informacioneve gjithëpërfshirëse rreth procesit të Brexit-it, fillimisht duke shpjeguar përfundimin e anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare dhe duke vazhduar më pas me veçoritë e referendumit britanik të vitit 2016, karakteristikat e negociatave të Brexit-it, faktorët që kanë ndikuar në votimin e britanikëve për dalje nga UE-ja, si dhe me pasojat kryesore ekonomike dhe politike të Brexit-it.

Për realizimin e studimit është përdorur metodologjia e përzier, përkatësisht kombinimi i metodave kualitative dhe kuantitative. Rol të rëndësishëm në grumbullimin e të dhënave primare kanë intervistat gjysmë të strukturuar me ekspertë të shkencave politike dhe persona të angazhuar në institucione të MB-së dhe UE-së. Kurse, të dhënat sekondare janë mbledhur nga bibliografia e përbërë prej literaturës dhe raporteve hulumtuese në lidhje me Brexit-in, si dhe nga burimet e Internetit, përfshirë këtu dokumente zyrtare të institucioneve politike dhe ekonomike në Britani dhe UE, hulumtime të realizuara nga institute të ndryshme ndërkombëtare dhe lajme të medieve kryesore ndërkombëtare.

Rezultatet kërkimore kanë hedhur në pah implikime serioze të tërheqjes së MB-së nga anëtarësia e UE-së, duke e bërë kështu Brexit-in një prej rasteve më të komplikuar të përfundimit të anëtarësisë së shteteve në organizatat ndërkombëtare, me pasoja afatgjata dhe shtrirje përtej kontinentit evropian.

Konkluzionet e disertacionit synojnë të kontribuojnë në mënyrë modeste në zgjerimin e njohurive rreth procesit të Brexit-it, respektivisht në sqarimin lidhur me të.

Fjalët kyçe: *Mbretëria e Bashkuar, Unioni Evropian, Brexit, Neni 50, implikimet*

ABSTRACT

Withdrawal of the United Kingdom from membership of the European Union, a process known by the term Brexit, is one of the major international events of the twenty-first century. The importance of Brexit relies on the fact that we are dealing with the departure of Britain, a state which is known for its major political, economic and military role in the world, from an international sui generis organization with extraordinary importance in the international arena.

The primary purpose of the research is to provide comprehensive information about the Brexit process, initially explaining the termination of state membership from international organization, and then continuing with the specifics of the British referendum in 2016, the characteristics of Brexit negotiations, the factors that have influenced the British vote to leave the EU, as well as the main economic and political consequences of Brexit.

For the realization of the study was used the mixed methodology, respectively the combination of qualitative and quantitative methods. Semi-structured interviews with experts of political science and persons engaged in UK and EU institutions have an important role in primary data collection. Whereas secondary data is collected from a bibliography that contains literature and research reports related to Brexit, as well as from the Internet sources including here official documents of political and economic institutions in Britain and the EU, research conducted by various international institutes and major international media news.

Research results have highlighted serious implications of the withdrawal of the UK from EU membership, thus making Brexit as one of the most complicated cases of termination of membership of states from international organizations, with long-term consequences and extension beyond the European continent.

The conclusions of the dissertation aim to contribute modestly to the expansion of knowledge about the Brexit process, respectively clarification regarding it.

Key words: *United Kingdom, European Union, Brexit, Article 50, implications*

АПСТРАКТ

Повлекувањето на Велика Британија од членството во Европската унија, процес познат под терминот Брегзит, е еден од најголемите меѓународни настани на дваесет и првиот век. Важноста на Брегзит се потпира на фактот дека ние се занимаваме со заминување на Велика Британија, држава која е позната по својата голема политичка, економска и воена улога во светот, од меѓународна организација *sui generis* со извонредно значење на меѓународната сцена.

Примарната цел на истражувањето е да се обезбедат сеопфатни информации за процесот Брегзит, првично да се објасни престанокот на членството на државата од меѓународната организација, а потоа да се продолжи со спецификите на британскиот референдум во 2016 година, карактеристиките на преговорите за Брегзит, факторите што ги имаат влијаеше на гласањето на Британците за напуштање на ЕУ, како и на главните економски и политички последици од Брегзит.

За реализација на студијата се користеше мешаната методологија, соодветно комбинацијата на квалитативни и квантитативни методи. Полу структурирани интервјуа со експерти од политички науки и лица ангажирани во институциите на Велика Британија и ЕУ имаат важна улога во примарното собирање на податоци. Со оглед на тоа што секундарните податоци се собираат од библиографија која содржи литература и извештаи за истражување поврзани со Брегзит, како и од извори на Интернет, вклучително и официјални документи на политички и економски институции во Велика Британија и ЕУ, истражување спроведено од разни меѓународни институти и големи меѓународни медиуми Вести.

Резултатите од истражувањето истакнаа сериозни импликации од повлекувањето на Велика Британија од членството во ЕУ, со што Брегзит стана еден од најkomplицираните случаи на прекинување на членството на државите од меѓународните организации, со долгорочни последици и проширување надвор од европскиот континент.

Заклучоците на дисертацијата имаат за цел да придонесат скромно за проширување на знаењето за процесот Брезит, односно појаснување во врска со него.

Клучни зборови: Обединетото Кралство, Европската унија, Брезит, член 50, импликации

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	II
ABSTRACT	III
ΑΠΣΤΡΑΚΤ	IV
LISTA E TABELAVE	XII
LISTA E FIGURAVE	XIII
LISTA E SHKURTESAVE	XIV
KAPITULLI I	1
HYRJE	1
I.1 Konteksti dhe parashtrimi i problemit.....	1
I.2 Synimet dhe objektivat e hulumtimit	3
I.3 Rëndësia dhe kontributi i studimit	4
I.4 Plani i disertacionit	5
KAPITULLI II	9
SHQYRTIMI I LITERATURËS	9
II.1 Mënyrat e përfundimit të anëtarësisë së shteteve në organizatat ndërkombëtare	9
II.1.1 Shpërbërja e organizatës ndërkombëtare.....	9
II.1.1.1 Shpërbërja e Lidhjes së Kombeve	9
II.1.1.2 Dispozita e përcaktuar për shpërbërjen e Bankës Botërore	10
II.1.2 Zhdukja e shtetit.....	12
II.1.2.1 Format e zhdukjes së shtetit	12
II.1.2.2 Përfundimi i anëtarësisë së Jugosllavisë në OKB.....	13
II.1.3 Përfundimi i shtetit nga organizata ndërkombëtare	14
II.1.3.1 Dallimi ndërmjet pezullimit dhe përfundimit të shtetit nga organizata ndërkombëtare	14
II.1.3.2 Pezullimi i Ruisë nga Këshilli i Evropës	15
II.1.3.3 Rekomandimi ndaj Asamblesë së Përgjithshme për përfundimin e Afrikës së Jugut nga OKB-ja.....	17

II.1.4 Tërheqja e shtetit nga organizata ndërkombëtare	19
II.1.4.1 E drejta dhe kushtet e tërheqjes	19
II.1.4.2 Mungesa e klauzolës së tërheqjes	20
II.1.4.3 Shembuj të tërheqjeve të shteteve nga organizatat ndërkombëtare	21
II.1.4.3.1 Tërheqja e shteteve nga Lidhja e Kombeve	21
II.1.4.3.2 Tërheqja e Indonezisë nga OKB-ja.....	22
II.1.4.3.3 Tërheqja e shteteve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar	23
II.1.4.3.4 Tërheqja e Zanzibarit nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik	24
II.1.4.3.5 Tërheqja e Francës nga NATO	24
II.1.4.3.6 Tërheqja e Venezuelës nga Organizata e Shteteve Amerikane	26
II.1.4.4 Shkaku kryesor i tërheqjeve të shteteve nga organizatat ndërkombëtare	27
II.1.5 Konkluzionet	28
II.2 Vendimi i Mbretërisë së Bashkuar për t'u tërhequr nga anëtarësia e Unionit Evropian	29
II.2.1 Tërheqja e shtetit nga UE-ja	29
II.2.1.1 E drejta dhe rregullimi i tërheqjes së shtetit nga UE-ja	29
II.2.1.2 Përmbajtja e Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës	30
II.2.2 Referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në UE.....	31
II.2.2.1 Organizimi i referendumit	31
II.2.2.2 Rezultatet e përgjithshme të referendumit	35
II.2.2.2.1 Votimi i referendumit në Angli.....	36
II.2.2.2.2 Votimi i referendumit në Uells.....	38
II.2.2.2.3 Votimi i referendumit në Irlandën Veriore	38
II.2.2.2.4 Votimi i referendumit në Skoci	39
II.2.3 Aktivizimi i Nenit 50 nga MB-ja	39
II.2.3.1 Ligji i Unionit Evropian (Njoftimi i Tërheqjes) 2017	39
II.2.3.2 Kërkesa e MB-së për aktivizimin e Nenit 50.....	41
II.2.3.3 Miratimi i UE-së për hapjen e negociatave të Brexit-it.....	42
II.2.4 Negociatat e Brexit-it.....	43

II.2.4.1	Palët negociuese të UE-së dhe MB-së	43
II.2.4.1.1	Negociatorët e UE-së	43
II.2.4.1.2	Negociatorët e MB-së	46
II.2.4.2	Faza e parë e negociatave	49
II.2.4.2.1	Raundi i parë	51
II.2.4.2.2	Raundi i dytë	51
II.2.4.2.3	Raundi i tretë	52
II.2.4.2.4	Raundi i katërt	53
II.2.4.2.5	Raundi i pestë	53
II.2.4.2.6	Raundi i gjashtë	54
II.2.4.2.7	Përfundimi i fazës së parë të negociatave	55
II.2.4.3	Faza e dytë e negociatave	56
II.2.4.3.1	Draft-Marrëveshja e Tërheqjes	57
II.2.4.3.2	Bisedimet mars-qershor 2018	58
II.2.4.3.3	Propozimi i Marrëveshjes së Tërheqjes nga UE-ja dhe MB-ja	59
II.2.4.3.4	Mosratifikimi i Marrëveshjes së Tërheqjes nga Parlamenti i MB-së më 29 mars 2019	62
II.2.4.3.5	“Brexit Day”	63
II.2.4.4	Faza e tretë e negociatave	66
II.2.4.4.1	Raundet e bisedimeve mars-dhjetor	69
III.2.4.4.2	Takimet e Komitetit të Përbashkët	73
III.2.4.4.3	Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-UE	74
II.2.5	Konkluzionet	77
KAPITULLI III	79
QASJA METODOLOGJIKE	79
III.1	Analiza e faktorëve që i kontribuuan Brexit-it bazuar në qasjen teorike realiste.....	79
III.1.1	Niveli individual	79
III.1.1.1	Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitet e 70-ta.....	79

III.1.1.2 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitet 80-ta	82
III.1.1.3 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në vitet e 90-ta	83
III.1.1.4 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në dekadën e parë të këtij shekulli	84
III.1.1.5 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në dekadën e dytë të këtij shekulli	86
III.1.1.6 Reagimet e politikanëve botërorë lidhur me referendumin e vitit 2016 në MB	90
III.1.2 Niveli shtetëror	94
III.1.2.1 Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të MB-së në vitin 2015	94
III.1.2.2 Ngritja e UKIP-it	96
III.1.2.3 Ndikimi i gazetave britanike	102
III.1.2.4 Fushata “Vote Leave and Take Control”	103
III.1.3 Niveli sistematik	106
III.1.3.1 Referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitin 1975.....	106
III.1.3.2 Humbja e sovranitetit kombëtar	110
III.1.3.3 Eurozona.....	112
III.1.3.4 Emigracioni	114
III.1.3.4.1 Emigrantët e UE-së në MB	114
III.1.3.4.2 Kriza e refugjatëve në Evropë në vitin 2015	116
III.1.4 Niveli global.....	121
III.1.4.1 Prezenca e popullizmit në vende të ndryshme të botës.....	121
III.1.4.2 Rimarrja e “vendit të humbur” të MB-së në botë	123
III.1.5 Konkluzionet	125
III.2 Pasojat ekonomike të Brexit-it	127
III.2.1 Pasojat ekonomike të Brexit-it për Mbretërinë e Bashkuar.....	127
III.2.1.1 Detyrimet financiare të MB-së ndaj UE-së pas Brexit-it	127

III.2.1.2 Rritja e kostove tregtare.....	128
III.2.1.3 Devaluimi i monedhës paund	131
III.2.1.4 Rënia e investimeve të huaja direkte.....	133
III.2.1.5 Zhvendosja e firmave nga MB-ja	134
III.2.1.6 Ulja e migrimit neto	135
III.2.1.7 Rënia e GDP-së britanike.....	137
III.2.2 Pasojat ekonomike të Brexit-it për Unionin Evropian.....	139
III.2.2.1 Humbja e kontributit britanik në buxhetin e UE-së.....	139
III.2.2.2 Impakti i Brexit-it në marrëdhëniet ekonomike të UE-së me Japoninë	143
III.2.3 Pasojat ekonomike të Brexit-it në nivel global	145
III.2.3.1 Ndikimi i Brexit-it në marrëveshjet ekonomike ndërkombëtare të UE-së ...	145
III.2.3.2 Lidhja e marrëveshjeve të reja tregtare të MB-së.....	146
III.2.4 Konkluzionet	148
III.3 Pasojat politike të Brexit-it.....	149
III.3.1 Pasojat politike të Brexit-it për Mbretërinë e Bashkuar	149
III.3.1.1 Dorëheqja e David Cameron-it nga posti i kryeministrit britanik.....	149
III.3.1.2 Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017	151
III.3.1.3 Dorëheqja e Theresa May-it nga posti i kryeministres britanike	156
III.3.1.4 Prorogimi i Parlamentit të MB-së në vitin 2019	158
III.3.1.5 Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019	160
III.3.1.6 Pozicioni i Irlandës Veriore si rrjedhojë e Brexit-it	164
III.3.1.7 Rreziku i shkëputjes së Skocisë nga MB-ja	166
III.3.1.7.1 Referendumi i pavarësisë skoceze në vitin 2014	166
III.3.1.7.2 Mundësia e organizimit të referendumit të dytë të pavarësisë në Skoci	169
III.3.2 Pasojat politike të Brexit-it për Unionin Evropian	171
III.3.2.1 Rreziku i inkurajimit të shteteve të tjera për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së.....	171
III.3.2.2 Efektet negative të Brexit-it në politikat zgjeruese	175

III.3.2.3 Ndikimi i Brexit-it në procesin integrues të vendeve të Ballkanit Perëndimor në UE.....	175
III.3.2.4 Roli i UE-së në arenën ndërkombëtare pa MB-në.....	177
III.3.2.5 Impakti i Brexit-it në efikasitetin e diplomacisë digjitale të UE-së.....	179
III.3.3 Pasojat politike të Brexit-it në nivel global.....	180
III.3.3.1 Kontekstet gjeopolitike të Brexit-it.....	180
III.3.3.2 Marrëdhëniet diplomatike të ShBA-ve me MB-në dhe UE-në pas zgjedhjeve presidenciale amerikane të vitit 2020.....	182
III.3.4 Konkluzionet.....	184
KAPITULLI IV.....	186
ANALIZA SWOT.....	186
IV.1 Pikat e forta.....	186
IV.1.1 Pikat e forta për Mbretërinë e Bashkuar.....	186
IV.1.2 Pikat e forta për Unionin Evropian.....	186
IV.2 Dobësitë.....	187
IV.2.1 Dobësitë për Mbretërinë e Bashkuar.....	187
IV.2.2 Dobësitë për Unionin Evropian.....	188
IV.3 Mundësitë.....	188
IV.3.1 Mundësitë për Mbretërinë e Bashkuar.....	188
IV.3.2 Mundësitë për Unionin Evropian.....	189
IV.4 Kërcënimet.....	189
IV.4.1 Kërcënimet për Mbretërinë e Bashkuar.....	189
IV.4.2 Kërcënimet për Unionin Evropian.....	190
KAPITULLI V.....	191
PËRFUNDIMI.....	191
CHAPTER V.....	198
CONCLUSION.....	198
BIBLIOGRAFIA.....	205
BURIMET NGA INTERNETI.....	213

LISTA E TABELAVE

<i>Tabela 2.1</i>	Votimi i referendumit të Brexit-it sipas moshave të ndryshme	36
<i>Tabela 2.2</i>	Votimi i Brexit-it në tetë regjione të Anglisë	37
<i>Tabela 3.1</i>	Votimi i partive politike në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare britanike në vitin 2015	95
<i>Tabela 3.2</i>	Numri i votave të marra nga UKIP në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare britanike që nga viti 1997 deri më 2015	98
<i>Tabela 3.3</i>	Numri i votave të marra nga UKIP në zgjedhjet e PE-së nga viti 1999 deri më 2014	99
<i>Tabela 3.4</i>	Votimi i referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitin 1975 nga vendet britanike	109
<i>Tabela 3.5</i>	Numri i aplikimeve për azil në vitin 2015 në vendet anëtare të UE-së	118
<i>Tabela 4.1</i>	Tërësia e detyrimeve financiare të MB-së ndaj UE-së nga viti 2020 deri më 2064	128
<i>Tabela 4.2</i>	Eksportet dhe importet e MB-së me vendet anëtare dhe joanëtare të UE-së gjatë vitit 2019	129
<i>Tabela 4.3</i>	Ndryshimet në kurset e këmbimit për \$ dhe €, si dhe norma mesatare e tyre në vite dhe përqindja	131
<i>Tabela 4.4</i>	GDP-ja e Mbretërisë së Bashkuar sipas të dhënave të Bankës Botërore nga viti 2015 gjer në vitin 2019	138
<i>Tabela 4.5</i>	Kontributet e MB-së në UE që nga viti 2014 deri më 2019 në miliona £	142
<i>Tabela 4.6</i>	Lista e marrëveshjeve ndërkombëtare ku MB-ja ka qenë palë nëpërmes UE-së e që sipas qeverisë britanike duhet të zëvendësohen	147
<i>Tabela 5.1</i>	Votimi i partive politike në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të parakohshme të MB-së në vitin 2017	155
<i>Tabela 5.2</i>	Votimi i partive politike në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të parakohshme të MB-së në vitin 2019	163

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 2.1</i>	Fletëvotimi i Referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE	34
<i>Figura 3.1</i>	Përqindja e azilkërkuesve në shtetet anëtare të UE-së sipas vendeve të tyre në vitin 2015	119
<i>Figura 3.2</i>	Shtetet anëtare të UE-së që kishin aprovuar më së shumti aplikime për azil në vitin 2015	120
<i>Figura 3.3</i>	Pikëpamjet euroskeptike dhe eurofile në 10 shtete anëtare të UE-së në vitin 2016	120
<i>Figura 3.4</i>	Mospajtueshmëria mbi menaxhimin e krizës së refugjatëve në vitin 2015 në dhjetë shtete të UE-së	121
<i>Figura 3.5</i>	Pesë ekonomitë më të mëdha të botës dhe përqindja në GDP-në globale në vitin 2016	124
<i>Figura 3.6</i>	Pesë ekonomitë më të mëdha të UE-së dhe përqindja në GDP-në e UE-së në vitin 2016	124
<i>Figura 4.1</i>	Raporti i kursit të këmbimit paund vs euro nga viti 2015 deri më 2020	132
<i>Figura 4.2</i>	Raporti i kursit të këmbimit paund vs dollar nga viti 2015 deri më 2020	132
<i>Figura 4.3</i>	Investimet e huaja direkte në MB gjatë vitit 2018	134
<i>Figura 4.4</i>	Përqindja e punëve në MB nga shtetasit britanikë, migrantët nga UE-ja dhe migrantët nga pjesa tjetër e botës	136
<i>Figura 4.5</i>	Përqindja e punëve në Londër nga shtetasit britanikë, migrantët nga UE-ja dhe migrantët nga pjesa tjetër e botës	137
<i>Figura 4.6</i>	Ndryshimet aktuale në vlerën e ardhshme të GDP-së së MB-së	138
<i>Figura 4.7</i>	Kontributet e MB-së në buxhetin e UE-së dhe të ardhurat nga ky i fundit në miliarda £	141
<i>Figura 5.1</i>	Fletëvotimi i Referendumit mbi Pavarësinë e Skocisë nga MB-ja në vitin 2014	168

LISTA E SHKURTESAVE

ABE	Autoriteti Bankar Evropian
AEB	Agjencia Evropiane e Barnave
AP	Asambleja e Përgjithshme
APGj	Alternativa për Gjermaninë
DDUE	Departamenti i Daljes nga Unioni Evropian
DL	Demokratët Liberalë
Euroatom	(European Atomic Energy Community) Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike
GjDUE	Gjykata e Drejtësisë së Unionit Evropian
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDP	Gross Domestic Product (Prodhimi i Brendshëm Bruto)
GjDUE	Gjykata e Drejtësisë së Unionit Evropian
GNI	Gross National Income (Të Ardhurat Kombëtare Bruto)
GjSMB	Gjykata Supreme e Mbretërisë së Bashkuar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ISIS	Islamic State of Iraq and the Levant (Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit)
KE	Këshilli Evropian
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
KoE	Komisioni Evropian
KS	Këshilli i Sigurimit
KVDT	Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve
LDB	Lufta e Dytë Botërore
LKE	Ligji i Komuniteteve Evropiane 1972
LPB	Lufta e Parë Botërore
MB	Mbretëria e Bashkuar

MPE	Marrëveshja e Partneritetit Ekonomik
MPM	Marrëveshja e së Premtës së Mirë
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
NATO	North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
OBI	Organizata e Bashkëpunimit Islamik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSA	Organizata e Shteteve Amerikane
PB	Partia e Brexit-it
PE	Parlamenti Evropian
PK	Partia Konservatore
PL	Partia Laburiste
PNS	Partia Nacionaliste Skoceze
PPPJSUE	Politika e Përbashkët për Punë të Jashtme dhe e Sigurisë së Unionit Evropian
PR	Partia e Referendumit
PUD	Partia e Unioniste Demokratike
PUU	Partia Unioniste e Ulsterit
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TVSh	Taksa mbi Vlerën e Shtuar
UE	Unioni Evropian
UKIP	Partia e Pavarësisë së Mbretërisë së Bashkuar
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara)
UNICEF	United Nations International Children's Emergency Fund (Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)
ZBSMBQ	Zonat Bazë Sovrane të Mbretërisë së Bashkuar në Qipro
ZPBMB	Zyra për Përgjegjësinë e Buxhetit të Mbretërisë së Bashkuar
ZPU	Zona e Përbashkët e Udhëtimit

KAPITULLI I

HYRJE

I.1 Konteksti dhe parashtrimi i problemit

Një nga prioritetet kyçe të shteteve është anëtarësimi i tyre në organizatat ndërkombëtare, qofshin ato ndërqeveritare ose joqeveritare. Prej shekullit XX e tutje, roli i organizatave ndërkombëtare është rritur jashtëzakonisht shumë. Meqë bota përballet me probleme të shumta, të cilat nuk kursejnë asnjë shtet pavarësisht madhësisë territoriale, numrit të popullsisë, GDP-së dhe forcës ushtarake, shtetet domosdoshmërisht duhet zgjedhur bashkëpunimin multilateral. Procedurat e anëtarësimit të shtetit në një organizatë ndërkombëtare zënë një vend tejet të rëndësishëm në literaturën që shtjellon veçoritë e organizatave ndërkombëtare. Mirëpo, krahas anëtarësimit, çështje me rol po aq të rëndësishëm përbëjnë edhe rrethanat që shpiejnë drejt përfundimit të anëtarësisë së shtetit nga një organizatë ndërkombëtare. Ky i fundit përbën një proces rreth së cilit ka një sërë paqartësish që pamundësojnë kuptueshmërinë e tij. Prandaj për këtë arsye, gjatë trajtimit të temës së disertacionit fillimisht janë specifikuar mënyrat e përfundimit të anëtarësisë së shtetit në një organizatë ndërkombëtare. Mënyra e parë është shpërbërja e organizatës, e cila ndodh nëpërmes aktivizimit të një neni të caktuar të statutit të saj që rregullon shpërbërjen, apo me vendimin e organit kryesor të organizatës. Megjithëse rrallëherë diskutohet, por që assesi nuk duhet të lihet në harresë, një mënyrë tjetër e përfundimit të anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare është zhdukja e shtetit. Një shtet zhduket kur shpërbëhet dhe prej tij formohen shtete të reja, ose kur kemi bashkimin vullnetar të dy ose më shumë shteteve. Anëtarësimi i shtetit në organizatë ndërkombëtare mund të përfundojë edhe përmes përjashtimit. Mirëpo, jo rrallëherë përjashtimi ngatërrohet me pezullimin. Duhet theksuar se një shteti të pezulluar nga organizata ndërkombëtare i ndërpritet ushtrimi i të drejtave dhe obligimeve të caktuara nga statuti i organizatës për një periudhë të caktuar kohore, por nuk i përfundon anëtarësia. Ndërsa kur

një shtet me veprime të caktuara nuk i respekton dhe shkel parimet e organizatës, atëherë kjo e fundit ndaj tij ndërmerr sanksionin më të rëndë që është përjashtimi. Përgjatë ekzistencës së organizatave ndërkombëtare ka pasur disa raste kur ka përfunduar anëtarësia e shteteve sipas mënyrave të cekura. Mirëpo, raste më të shpeshta ka tek mënyra e katërt, e cila është tërheqja. Si një akt vullnetar i largimit të shtetit nga organizata ndërkombëtare, tërheqja përmendet brenda neneve të caktuara në statutet e shumë organizatave ndërkombëtare. Kryesisht drejt vendimit të shteteve për tërheqje ka pasur ndikim të madh rezistenca për të transferuar pjesë të sovranitetit brenda organizatave ndërkombëtare. Rrjedhshmëria e marrëdhënieve ndërkombëtare në vitin 2016 ka rënë nën ndikimin e një vendimi të një shteti me peshë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake për t'u tërhequr nga një organizatë ndërkombëtare. Brexit, respektivisht vendimi i Mbretërisë së Bashkuar për t'u tërhequr nga anëtarësia e Unionit Evropian, është një ngjarje ndërkombëtare që nuk ka ndikuar vetëm tek protagonistët e tij kryesorë, por ka shtrirë impaktin përtej Evropës. UE-ja për herë të parë është përballur me vendimin e një vendi anëtar për t'u tërhequr nga anëtarësimi, proces ky i rregulluar në Nenin 50 të Traktatit të Lisbonës. Aktivizimi i këtij neni erdhi si rrjedhojë e votimit të britanikëve për dalje nga UE-ja në referendumin e 23 qershorit 2016, votim ky që e orientoi Britaninë e Madhe drejt një të ardhmeje shumë të pasigurt. Negociatat ndërmjet MB-së dhe UE-së për Brexit dëshmuar mjaftueshëm se çfarë procesi të vështirë paraqiste ky i fundit. Problemet dhe mospajtimet e shumta i kanë përcjellë palët në tri fazat e bisedimeve, prandaj edhe "Brexit Day" nuk ndodhi më 29 mars 2019 siç e parashihte Neni 50. Faza e tretë e negociatave lidhur me marrëdhëniet e ardhshme të UE-së me Britaninë jashtë saj si vend i tretë e vulosi komplikueshmërinë e Brexit-it. Ky i fundit erdhi si rrjedhojë e ndikimit të një sërë faktorëve, rrënjët e së cilëve janë hedhur që nga filltet e anëtarësimin të MB-së në Komunitetin Ekonomik Evropian, pra që nga viti 1974 e gjer në vitin 2016. Shumë individë e dukuri nga brendësia e Britanisë, pastaj disa ngjarje dhe zhvillime brenda dhe jashtë kontinentit evropian kanë kontribuar në vendimin e britanikëve për tërheqjen e vendit të tyre nga anëtarësia. Brexit-i ka rezultuar me shumë pasoja, ndër të cilat ato më seriozet i përkasin aspektit ekonomik dhe atij politik. Arsyeja kryesore që Brexit-i nuk mund të cilësohet si një çështje e brendshme e MB-së ose e UE-së mbështetet në faktin se pasojat e Brexit-it janë shpërndarë jashtë kufijve të Evropës, prandaj me shumë të drejtë konsiderohet si një nga ngjarjet ndërkombëtare më të rëndësishme, jo vetëm të dekadës, por edhe të shekullit XXI.

I.2 Synimet dhe objektivat e hulumtimit

Nëpërmes këtij disertacioni janë bërë përpjekje maksimale që të ofrohen të dhëna të rëndësishme dhe gjithëpërfshirëse rreth procesit të Brexit-it. Puna kërkimore është mbështetur në realizimin e disa qëllimeve, të cilat janë:

- *Të shpjegohet se çfarë nënkupton tërheqja e shteteve nga anëtarësia e organizatave ndërkombëtare, duke marrë si shembuj disa organizata ndërkombëtare me rol të madh në arenën globale;*
- *Të ofrohen informacione lidhur me organizimin e referendumit të Brexit-it, për kampanjat kryesore rreth këtij të fundit në Britani, për rezultatet dhe pjesëmarrjen e përgjithshme të popullit britanik në këtë referendum, si dhe votimin e tij në katër vendet britanike;*
- *Të specifikohen karakteristikat kryesore të negociatave të Brexit-it brenda secilës fazë të bisedimeve;*
- *Të paraqitet një analizë e faktorëve që i kontribuuan Brexit-it, duke u mbështetur tërësisht në qasjen teorike realiste;*
- *Të theksohen pasojat ekonomike të Brexit-it për MB-në dhe UE-në, si dhe ato në nivel global;*
- *Të theksohen pasojat politike të Brexit-it për Britaninë dhe UE-në, si dhe ato në nivel global.*

Fokusi kryesor hulumtues i disertacionit është shtrirë në ofrimin e përgjigjeve sa më të sakta në këto gjashtë pyetje kërkimore:

- 1) *Çfarë nënkupton tërheqja e shteteve nga anëtarësia e organizatave ndërkombëtare?*
- 2) *Ç'veçori patën kampanjat në MB lidhur me referendumin e Brexit-it dhe si u votua ky i fundit në vendet britanike?*
- 3) *Cilat janë karakteristikat kryesore të negociatave të Brexit-it?*
- 4) *Cilët faktorë i kontribuuan vendimit të Britanisë për t'u tërhequr nga UE-ja?*
- 5) *Cilat janë pasojat kryesore ekonomike të Brexit-it për MB-në dhe UE-në, si dhe ato në nivel global?*
- 6) *Cilat janë pasojat kryesore politike të Brexit-it për Britaninë dhe UE-në, si dhe ato në nivel global?*

Pjesë e rëndësishme e studimit të disertacionit do të jetë edhe testimi i hipotezës kryesore, të shoqëruar nga katër hipoteza ndihmëse:

Dalja e Mbretërisë së Bashkuar nga Unioni Evropian do të njihet si procesi më i komplikuar në historikun e tërheqjes së shteteve nga anëtarësia e organizatave ndërkombëtare:

- 1) Brexit dëshmoi se fuqia e nacionalizmit nuk duhet nënvlerësuar dhe fuqia e organizatave ndërkombëtare nuk duhet mbivlerësuar;*
- 2) UKIP posedon meritat kryesore në votimin e popullit britanik për daljen e vendit të tyre nga UE-ja;*
- 3) Pakënaqësitë e Skocisë dhe Irlandës Veriore me vendimin e Brexit-it rrezikojnë shpërbërjen e Britanisë;*
- 4) Brexit vë në pikëpyetje aftësinë e UE-së për t'u shndërruar në aktor global me ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare.*

I.3 Rëndësia dhe kontributi i studimit

Votimi i popullit britanik në referendumin e anëtarësisë së MB-së në UE më 23 qershor 2016 për Brexit kishte qenë befasi për mbarë globin. Brexit po hap kapituj të rinj në historinë e Britanisë së Madhe, kurse UE-ja është përballur me largimin e një vendi anëtar, apo thënë më saktë me një proces rreth së cilit nuk ka pasur fare përvojë. MB-ja është shkëputur prej një organizate me rol ekonomik të jashtëzakonshëm në arenën ndërkombëtare, kurse nga UE-ja është tërhequr një prej shteteve anëtare të pakta që karakterizohet për peshën e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake në botë. Nevoja për ofrimin e informacioneve rreth procesit të Brexit-it nuk është prezente vetëm tek britanikët dhe shtetasit e vendeve anëtare të UE-së sepse njohuritë rreth tij janë të nevojshme për të gjitha vendet e botës, veçmas për ato shtete që kanë marrëdhënie bilaterale me Britaninë ose UE-në. Prandaj Brexit është bërë pjesë e hulumtimeve të shumë ekspertëve nga mbarë bota që nga prezantimi i planit të David Cameron për organizimin e referendumin në vitin 2015. Politikanë dhe studiues të nacionaliteteve të ndryshme kanë ofruar, ofrojnë dhe do të ofrojnë studime të shumta mbi aspekte specifike të Brexit-it. Çdo kontribut i tyre vlerësohet pavarësisht vëllimit, ngase nëpërmes tyre do të pasurohet bibliografia e Brexit-it në vazhdimësi. Brexit përbën një proces që kërkon studim thelbësor, i cili përpos që do të

ndikonte pozitivisht në zgjerimin e njohurive në lidhje me të, do të ndikonte pozitivisht edhe në shmangien e atyre hutive që mund të krijojnë paqartësi dhe të paraqesin një sërë vështirësish në kuptueshmërinë e tij. Ky disertacion ka natyrë shpjeguese, përshkruese, analitike dhe krahasuese. Rëndësia e tij bazohet në ofrimin e të dhënave gjithëpërfshirëse sa i përket tërheqjes së MB-së nga anëtarësia e UE-së, ashtu që të mund të cilësohet si një kontribut modest në zgjerimin e njohurive lidhur me të. Po ashtu, është përmbledhje e një sërë hulumtimesh individuale mbi pjesë të veçanta të procesit të Brexit-it të realizuara brenda periudhës 2016-2021.

I.4 Plani i disertacionit

Disertacioni përpos abstraktit të ofruar në gjuhën shqipe, angleze dhe maqedone, listës së tabelave, listës së figurave, listës së shkurtesave, bibliografisë dhe burimeve nga Interneti, është i përbërë nga pesë kapituj.

Kapitulli i parë është hyrja, ku shpalosen detaje rreth kontekstit dhe parashtrimit të problemit të studiuar, synimeve dhe objektivave hulumtuese, rëndësisë dhe kontributit të disertacionit, si dhe planit se si është realizuar ky i fundit.

Kapitulli i dytë ka të bëjë me shqyrtimin e literaturës dhe është i përbërë nga dy seksione. Në seksionin e parë shpjegohen mënyrat e përfundimit të anëtarësisë së shteteve nga organizatat ndërkombëtare. Ky seksion është i ndarë në pesë nënseksione. Nënseksioni i parë sqaron përfundimin e anëtarësisë së shtetit përmes shpërbërjes së organizatës ndërkombëtare, duke marrë shembull shpërbërjen e Lidhjes së Kombeve dhe duke përshkruar dispozitën e përcaktuar për rregullimin e shpërbërjes së Bankës Botërore. Më pas nënseksioni i dytë pasqyron të dhëna mbi mënyrën e dytë të përfundimit të anëtarësisë që është zhdukja e shtetit, ku specifikohen format e zhdukjes së shtetit dhe si shembull merret përfundimi i anëtarësisë së Jugosllavisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si pasojë e shpërbërjes së saj si federatë dhe krijimit të shteteve të reja. Nënseksioni i tretë ofron informacione për përjashtimin e shteteve nga organizatat ndërkombëtare. Meqë ndonjëherë pezullimi dhe përjashtimi i shteteve ngatërrohen dhe konsiderohet që kanë efekte të njëjta, ky nënseksion thekson dallimet mes tyre, duke ofruar edhe dy shembuj, pezullimin e Ruisë nga Këshilli i Evropës dhe rekomandimin ndaj Asamblesë së Përgjithshme për përjashtimin e Afrikës së Jugut nga OKB-ja. Nënseksion tejet i veçantë i

këtij seksioni është i katërti, në të cilin shtjellohet tërheqja e shtetit nga organizata ndërkombëtare. Krahas të dhënave mbi të drejtën dhe kushtet e tërheqjes, mungesën e klauzolës së tërheqjes, në këtë nënseksion janë bashkëngjitur edhe gjashtë shembuj të tërheqjeve të shteteve nga organizatat ndërkombëtare si Lidhja e Kombeve, OKB, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata e Bashkëpunimit Islamik, NATO dhe Organizata e Shteteve Amerikane. Po ashtu, pjesë e këtij nënseksioni është edhe shkaku që i shpien shtetet drejt vendimit për tërheqje nga anëtarësia e organizatës ndërkombëtare. Konkluzionet e seksionit të parë cekën në nënseksionin e pestë. Seksioni i dytë është një nga seksionet më të rëndësishëm të disertacionit sepse elaborohet vendimi i MB-së për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së. Po ashtu edhe ky seksion përbëhet prej pesë nënseksionesh. Nënseksioni i parë përshkruan tërheqjen e shtetit nga UE-ja, respektivisht të drejtën dhe mënyrën e rregullimit të tërheqjes, si dhe përmbajtjen e Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës. Pastaj, nënseksioni i dytë ka informacione mbi referendumin e anëtarësisë së MB-së në UE që prej vendimit të organizimit të tij e gjer tek mënyra se si ishte votuar, përfshirë këtu rezultatet e përgjithshme të tij në Britani, si dhe ato veçmas në Angli, Uells, Irlandën Veriore dhe Skoci. Nënseksioni i tretë ka të bëjë me aktivizimin e Nenit 50 nga MB-ja, përfshirë këtu Ligjin e Unionit Evropian (Njoftimi i Tërheqjes) së vitit 2017, kërkesën e qeverisë britanike për aktivizimin e Nenit 50 dhe miratimin e UE-së për hapjen e negociatave të Brexit-it. Nënseksioni i katërt është nënseksioni më i rëndësishëm i këtij seksioni dhe njëri prej nënseksioneve kryesore të disertacionit sepse brenda tij elaborohen negociatat e Brexit-it. Fillimisht ofrohen të dhëna për karakteristikat kryesore të negociatorëve të UE-së dhe atyre britanikë. Pastaj shtjellohet faza e parë e negociatave, duke specifikuar veçoritë e gjashtë raundeve të bisedimeve gjer tek përfundimi i saj. Faza e dytë e negociatave zë vend të posaçëm në këtë nënseksion ngase shpjegohen Draft-Marrëveshja e Tërheqjes, bisedimet e zhvilluara ndërmjet palëve në mars-qershor 2018, propozimi i Marrëveshjes së Tërheqjes nga UE-ja dhe Britania, mosratifikimi i saj nga Parlamenti i MB-së më 29 mars 2019, si dhe rrethanat gjer tek "Brexit Day". Nënseksioni i katërt përmbillet me fazën e tretë të negociatave, ku shpalosen informacione mbi raundet e bisedimeve mars-dhjetor 2020, takimet e Komitetit të Përbashkët dhe Marrëveshjen e Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-UE, e cila shënon fundin e bisedimeve intensive katërvjeçare të finalizimit të procesit të Brexit-it. Seksioni i dytë përfundon me konkluzionet e tij të paraqitura në nënseksionin e pestë.

Kapitulli i tretë i disertacionit i përket qasjes metodologjike dhe është e ndarë në tri seksione. Seksioni i parë cilësohet si seksioni më i rëndësishëm, jo vetëm i këtij kapitulli, por i disertacionit në përgjithësi sepse ofron një analizë të faktorëve që i kanë kontribuar Brexit-it, duke u mbështetur në qasjen teorike realiste. Si rrjedhojë e përpjekjeve për t'i identifikuar faktorët kryesorë që kanë ndikuar në vendimin e popullit britanik për tërheqjen e vendit të tyre nga UE-ja, analiza apo seksioni ndahet në katër nivele, gjegjësisht katër nënseksione. Në nënseksionin e parë paraqitet niveli individual i analizës, brenda së cilit theksohen të gjithë politikanët britanikë që nga vitet e 70-ta e gjer tek dekada e dytë e shekullit XXI, të cilët e kanë përkrahur idenë e referendimit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE/UE, përfshirë këtu edhe reagimet e politikanëve botërorë për referendumin e vitit 2016. Më pas, në nënseksionin e dytë ofrohet niveli shtetëror i analizës, respektivisht disa dukuri brenda Britanisë, të tilla si zgjedhjet parlamentare britanike të vitit 2015, ngritja e UKIP-it, ndikimi i gazetave britanike dhe fushata "Vote Leave and Take Control". Nënseksioni i tretë i përket nivelit sistematik të analizës, i cili ndërlidhet me disa ngjarje dhe procese që kanë prekur MB-në dhe UE-në, duke filluar që nga referendumi mbi anëtarësinë e Britanisë në KEE në vitin 1975, pastaj duke analizuar disa elemente që mund të kishin ndikuar në humbjen e sovranitetit kombëtar të MB-së si rrjedhojë e anëtarësisë në UE, për të vazhduar me eurozonën dhe emigracionin, gjegjësisht ndikimin e këtij të fundit nëpërmes emigrantëve të UE-së në Britani dhe krizës së refugjatëve të vitit 2015 në Evropë. Analiza përmbillet me nivelin global në nënseksionin e katërt, ku zërthehet ndikimi i disa rrethanave globale, të tilla si prezenca e popullizmit në vende të ndryshme të botës, si dhe dëshira e britanikëve për rimarrjen e "vendit të humbur" të MB-së në botë. Konkluzionet e këtij seksioni ofrohen në nënseksionin e pestë. Seksioni i dytë i kapitullit të tretë ofron të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar vështirësitë kryesore të Brexit-it sepse pasqyron pasojat ekonomike të tij. Ky seksion është i ndarë në katër nënseksione. Në nënseksionin e parë theksohen pasojat kryesore ekonomike të Brexit-it për Britaninë, si detyrimet e saj financiare ndaj UE-së pas Brexit-it, rritja e kostove tregtare, devaluimi i monedhës paund, rënia e investimeve të huaja direkte, zhvendosja e firmave, ulja e migrimit neto dhe rënia e GDP-së. Ndonëse jo e dëmtuar njësoj sikurse MB-ja, nuk duhet anashkaluar disa pasoja ekonomike të Brexit-it për UE-në si humbja e kontributeve britanike në buxhetin e saj dhe impakti i Brexit-it në marrëdhëniet ekonomike të UE-së me Japoninë, informacionet rreth së cilave janë të paraqitura brenda nënseksionit të dytë. Ndikimi i Brexit-it në marrëveshjet

ekonomike ndërkombëtare të UE-së dhe lidhja e marrëveshjeve të reja tregtare të Britanisë pas Brexit-it nuk janë pasoja ekonomike nga të cilat preken vetëm MB-ja dhe UE-ja, por prej tyre do të ndikohen edhe shumë vende të tjera të botës, me ç'rast cilësohen si pasojat ekonomike të Brexit-it në nivel global, e që janë të shpalosura në nënseksionin e tretë. Konkluzionet e këtij seksioni cekën në nënseksionin e katërt. Seksioni i tretë i kapitullit të tretë ka të bëjë me pasojat politike dhe është i përbërë prej tri nënseksionesh. Nënseksioni i parë specifikon disa prej pasojave kryesore politike të Brexit-it për Britaninë, duke përfshirë këtu dorëheqjen e David Cameron prej postit të kreut të qeverisë britanike, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017, dorëheqjen e Theresa May nga posti i kryeministres, prorogimin e Parlamentit të MB-së në vitin 2019, pozicionin e Irlandës Veriore si rrjedhojë e Brexit-it, dhe rrezikun e shkëputjes së Skocisë nga Britania. Më pas, nënseksioni i dytë cek disa nga pasojat politike të Brexit-it për UE-në, si rreziku i inkurajimit të shteteve të tjera për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së, efektet negative të Brexit-it në politikat zgjeruese, ndikimi i Brexit-it në procesin integruar të Ballkanit Perëndimor në UE, roli i UE-së në arenën ndërkombëtare pa MB-në dhe ndikimi i Brexit-it në efikasitetin e diplomacisë digjitale të UE-së. Nënseksioni i tretë thekson disa pasoja politike të Brexit-it në nivel global, siç janë kontekstet gjeopolitike të Brexit-it dhe marrëdhëniet diplomatike të ShBA-ve me Britaninë dhe UE-në pas zgjedhjeve presidenciale amerikane të vitit 2020. Në fund të këtij seksioni, konkluzionet paraqiten në nënseksionin e katërt.

Kapitulli i katërt përbëhet prej analizës SWOT, i cili është i ndarë në katër seksione ku theksohen pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e Brexit-it si për MB-në, ashtu edhe për UE-në.

Kapitulli i pestë i përket përfundimit, gjegjësisht përmbledhjes së veçorive kryesore të temës së hulumtuar brenda këtij disertacioni, i cili ofrohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

KAPITULLI II

SHQYRTIMI I LITERATURËS

II.1 Mënyrat e përfundimit të anëtarësisë së shteteve në organizatat ndërkombëtare

II.1.1 Shpërbërja e organizatës ndërkombëtare

II.1.1.1 Shpërbërja e Lidhjes së Kombeve

Përfundimi i anëtarësisë së shtetit në një organizatë ndërkombëtare mund të ndodhë kur kjo e fundit shpërbëhet dhe shuhet së ekzistuari. Një organizatë e themeluar për një periudhë të caktuar kohore përfundon së funksionuari pas mbarimit të asaj periudhe, sipas dispozitave të caktuara në statutin e saj. Mirëpo, në qoftë se mungon dispozita që rregullon shpërbërjen, atëherë organizata mund të shpërbëhet me vendimin e organit të saj më të lartë përfaqësues.

Rast i veçantë i shpërbërjes së organizatave ndërkombëtare është Lidhja e Kombeve, e cila u themelua më 10 janar 1920 për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe për të arritur paqen dhe sigurinë në botë, duke u bazuar në marrëdhënie të hapura dhe të respektuara ndërmjet kombeve (Herren, 2014, p. 16). Kjo organizatë ishte një risi absolute e marrëdhënieve ndërkombëtare të shekullit të kaluar, por hezitimi i shteteve anëtare për të transferuar pjesë të sovranitetit brenda saj dhe interesat e tyre specifike rezultuan me parandalimin e veprimeve adekuate të Lidhjes. Si rrjedhojë e qëndrimeve të shteteve që cilësoheshin fuqi të mëdha të asaj kohe, dështuan një sërë çështjesh të sigurisë dhe çarmatimit. Po ashtu edhe mungesa e ShBA-ve në kuadër të Lidhjes ndikoi në dobësimin e saj. Roli i Lidhjes si instrument i sigurisë kolektive filloi të dobësohej që nga viti 1930 e këndeje, ndërsa kulmi i dobësimit të saj ishte në vitin 1939 kur edhe shpërtheu Lufta e Dytë

Botërore, me ç'fakt operacionet e Lidhjes në Gjenevë u pezulluan dhe ngjarjet e kësaj lufte e përshpejtuan shkatërrimin e saj. Lidhja e Kombeve vazhdoi të ekzistonte, por nuk pati rol të rëndësishëm në rrjedhshmërinë e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Përfundimi i LDB-së hodhi në pah nevojën për krijimin e një organizate të re ndërkombëtare më të fuqishme që do ta zëvendësonte Lidhjen, e cila ishte Organizata e Kombeve të Bashkuara që u themelua më 24 tetor 1945 (Lamb & Robertson-Snape, 2017, p. 214). Procesi i likuidimit të aseteve dhe trajtimi i detyrimeve të organizatave të shpërbëra përcaktohet nga vetë organizata nëpërmes dokumenteve kushtetuese apo me masa speciale të miratuara për shpërbërje. Kur funksionet, të drejtat dhe obligimet transferohen nga një organizatë në tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me suksesim ndërmjet organizatave ndërkombëtare, i cili arrihet me marrëveshje dhe varet nga kompetencat kushtetuese të organizatës pasardhëse (Shaw, 2008, pp. 1329-1330). Më 18 prill 1946, Asambleja kishte vendosur për shpërbërjen e Lidhjes së Kombeve, pa pasur nevojë të pëlqimit individual të secilit shtet anëtar, si dhe ia transferoi OKB-së të gjitha funksionet, asetet dhe ndërtesat e Lidhjes. OKB-ja ndoqi strukturën e Lidhjes së Kombeve, me ç'rast Asambleja u bë Asamble e Përgjithshme, Këshilli u bë Këshill i Sigurimit, si dhe Gjykata e Përhershme e Drejtësisë u bë Gjykatë Ndërkombëtare e Drejtësisë. Seksionet dhe shërbimet teknike të Lidhjes u bënë agjenci të specializuara të OKB-së (Ginneken, 2006, p. 190).

II.1.1.2 Dispozita e përcaktuar për shpërbërjen e Bankës Botërore

Statutet e disa organizatave ndërkombëtare përmbajnë dispozita të veçanta që rregullojnë shpërbërjen e tyre. Shembull mund të merret Banka Botërore si një nga institucionet ndërkombëtare financiare më të rëndësishme në botë, e cila dispozitën lidhur me shpërbërjen e saj e ka të paraqitur në Nenet e Marrëveshjes për Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim,¹ gjegjësisht në *Nenin VI, Seksioni 5, për Pezullimin e Operacioneve dhe Shpërndarjen e Detyrimeve*. Neni në fjalë thekson:

- a) *Në raste urgjente, Drejtorët Ekzekutivë mund të pezullojnë operacionet përkohësisht në lidhje me kreditë e reja dhe garantojnë pritje të një mundësie për shqyrtim dhe veprime të mëtejshme nga Bordi i Guvernatorëve.*

¹Nenet e Marrëveshjes për Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim u hartuan në Konferencën Monetare dhe Financiare të Kombeve të Bashkuara në Bretton Woods, New Hampshire, nga 1 gjer më 22 korrik 1944. Ky dokument u bë efektiv më 27 dhjetor 1945 dhe është ndryshuar tri herë: më 17 dhjetor 1965, më 16 shkurt 1989 dhe më 27 qershor 2012.

- b) Banka mund të pezullojë përgjithmonë funksionet e saj lidhur me kreditë e reja dhe e garanton me votim të shumicës së Guvernatorëve, duke ushtruar shumicë të fuqisë totale të votimit. Pas një pezullimi të tillë të operacioneve, Banka pushon menjëherë të gjitha aktivitetet, përveç disa incidenteve deri te realizimi i duhur, ruajtjes dhe mbajtjes së aseteve të saj, si dhe përmbushjes së detyrimeve të saj.
- c) Përgjegjësia e të gjithë anëtarëve për abonimet pa leje në kapitalin e aksioneve të Bankës dhe sa i përket zhvlerësimit të monedhave të tyre do të vazhdojë derisa të gjitha kërkesat e kreditorëve, përfshirë edhe kërkesat e kushtëzuara, të jenë përmbushur.
- d) Të gjithë kreditorët që mbajnë kërkesa të drejtpërdrejta, do të paguhet nga asetet e Bankës dhe pastaj nga pagesa në Bankë në thirrjet për abonime të papaguara. Para bërjes së ndonjë pagese për kreditorët që mbajnë kërkesa të drejtpërdrejta, Drejtorët Ekzekutivë do të bëjnë rregullime siç është e nevojshme, sipas gjykimit të tyre, për të siguruar një shpërndarje për mbajtësit e kërkesave kontingjente në mënyrë të vlefshme me kreditorët që mbajnë kërkesa direkte.
- e) Asnjë shpërndarje nuk do të bëhet te anëtarët për shkak të kuotave të tyre në kapitalin e Bankës përderisa:
- I. Të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve të jenë përmbushur ose siguruar;
 - II. Shumica e Guvernatorëve duke ushtruar një shumicë të fuqisë totale të votimit të kenë vendosur të bëjnë një shpërndarje.
- f) Pasi të jetë marrë një vendim për të bërë shpërndarje të aseteve, Drejtorët Ekzekutivë me një shumicë prej 2/3 mund të bëjnë shpërndarje të njëpasnjëshme të aseteve të Bankës tek anëtarët derisa të shpërndahen të gjitha asetet. Kjo shpërndarje do t'i nënshtrohet zgjedhjes paraprake të të gjitha kërkesave të papaguara të Bankës ndaj secilit anëtar.
- g) Para se të bëhet ndonjë shpërndarje e aseteve, Drejtorët Ekzekutivë përcaktojnë proporcionalisht pjesën që i përket secilit shtet anëtar bazuar në raportin e aksionarit të tij ndaj totalit të aksioneve të papaguara të Bankës.
- h) Drejtorët Ekzekutivë vlerësojnë pasuritë që do të shpërndahen në datën e shpërndarjes dhe më pas do të vazhdojnë t'i shpërndajnë ato si vijon:
- I. Do të paguhet secili anëtar për detyrimet e tij apo ato të agjencive të tij zyrtare ose personave juridikë brenda territorit të tij, për aq sa ato janë në dispozicion

për shpërndarje, një shumë e barabartë në vlerë me pjesën e saj proporcionale të shumës totale që do të shpërndahet;

- II. Çdo balancë ndaj një anëtari, pasi të jetë bërë pagesa si më lart, do të paguhet në monedhën e tij, aq sa mbahet nga Banka, deri në një shumë të barabartë me vlerën e këtij bilanci;*
 - III. Çdo balancë ndaj një anëtari theksuar më lart, pasi të jetë bërë pagesa do të paguhet me ar ose monedhë të pranueshme për anëtarin, për aq sa ato mbahen nga Banka, deri në një shumë të barabartë me vlerën e këtij bilanci;*
 - IV. Çdo pasuri e mbetur, e mbajtur nga Banka, pasi të jenë bërë pagesat për anëtarët si më lart do të shpërndahet proporcionalisht ndërmjet anëtarëve.*
- i) Çdo anëtar që merr asete të shpërndara nga Banka, do të gëzojë të njëjtat të drejta në lidhje me ato asete siç Banka gëzonte para shpërndarjes së tyre (World Bank, 2012).*

II.1.2 Zhdukja e shtetit

II.1.2.1 Format e zhdukjes së shtetit

Mënyrë tjetër e përfundimit të anëtarësisë së shteteve në organizatat ndërkombëtare, e cila nuk përmendet aq shpesh, por nuk mund të anashkalohet është zhdukja e shtetit. Sikurse lindja e shtetit ashtu edhe zhdukja e tij paraqesin çështje faktike që shkaktojnë pasoja të shumëllojshme juridike. Në *Nenin I të Konventës së Montevideos për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve*² theksohet se shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet t'i ketë këto katër elemente:

- 1) Popullsinë e përhershme;*
- 2) Territorin e caktuar;*
- 3) Qeverisjen;*
- 4) Kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera (Crawford, 2012, p. 671).*

Humbja e ndonjërit prej këtyre elementeve qenësore për shtetin pason me zhdukjen e tij. Zhdukja e shteteve ka qenë më së shumti rezultat i pushtimit dhe nënshtrimit në luftë,

² Konventa e Montevideos për të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve është një traktat i nënshkruar në Montevideo, Uruguaj, më 26 dhjetor 1933 gjatë Konferencës së Shtatë Ndërkombëtare të Shteteve Amerikane dhe ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 1934. Konventa në fjalë kodifikon teorinë deklarative të shtetësisë, e pranuar si pjesë e së drejtës ndërkombëtare zakonore.

si dhe i shkatërrimit të pushtetit të shtetit që e ka humbur luftën (debellatio). Mirëpo, shteti zhduket edhe me ndarjen e territorit të tij në shtete të tjera apo me shkatërrimin e shtetit të mëparshëm. Po ashtu një shtet mund të zhduket edhe me bashkimin vullnetar të dy ose më shumë shteteve, pra përmes hyrjes në ndonjë bashkësi shtetërore si union real (sot nuk ka më shtete të këtilla) apo si federatë që është bashkësi e më shumë shteteve, vendeve, e krijuar me kushtetutë dhe si tërësi paraqet një subjekt ndërkombëtar, megjithëse anëtarëve të saj iu pranohet sovraniteti i veçantë (Gruda, 2013, ff. 74-77).

II.1.2.2 Përfundimi i anëtarësisë së Jugosllavisë në OKB

Shembull tipik i zhdukjes së një federate dhe ndarjes së territorit të saj në shtete të tjera është Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë,³ e cila ishte anëtare e OKB-së, Kartën e së cilës e kishte nënshkruar më 26 qershor 1945 dhe e kishte ratifikuar më 19 tetor 1945. Mirëpo, anëtarësimi i RSFJ-së në OKB përfundoi në vitin 1992, si rrjedhojë e shpërbërjes së saj pas themelimit dhe pranimit pasues të shteteve anëtare të reja në OKB, si Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës, Republika e Kroacisë, Republika e Sllovenisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika Federative e Jugosllavisë. Duhet cekur që RSFJ-ja nuk e vazhdoi anëtarësinë në OKB përmes pjesës së mbetur të republikave brenda saj, asaj të Serbisë dhe Malit të Zi, ndonëse këto dy të fundit e përshkruanin RFJ-në si vazhdimësi të RSFJ-së dhe kishin deklaruar se do t'iu përmbaheshin obligimeve që RSFJ-ja kishte marrë përsipër ndërkombëtarisht si anëtare e OKB-së (Duxbury, 2011, p. 21). Mirëpo, përmes *Rezolutës 777* të KS-së më 19 shtator 1992 (United Nations Security Council Resolutions, 1992) dhe *Rezolutës A/47/485* të AP-së më 30 shtator 1992 (United Nations, 1992) u përcaktua se RFJ-ja nuk mund të vazhdonte anëtarësinë në OKB si ish-RSFJ sepse kjo e fundit po shuhej së ekzistuar.

Republika e Sllovenisë ishte anëtarësuar në OKB përmes *Rezolutës A/RES/46/236*, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës me *Rezolutën A/RES/46/237*, ndërsa Republika e Kroacisë me *Rezolutën A/RES/46/238*, që të tri shtetet më 22 maj 1992. AP-ja me *Rezolutën A/RES/47/225* më 8 prill 1993 kishte vendosur të pranojë si anëtare të OKB-së ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Duhet cekur se më 14 shkurt 2019 nëpërmes Misionit

³ Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë përbëhej nga gjashtë republika: Serbia, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, si dhe në vitin 1946 brenda Serbisë u vendos të krijoheshin dy njësi nënfederale autonome, Kosova e Metohija (e riemëruar Kosovë në vitin 1963) dhe Vojvodina.

Diplomatik të Maqedonisë drejtuar Protokollit dhe Shërbimit Ndërlidhës të OKB-së emri i vendit u ndryshua në “Republikën e Maqedonisë së Veriut”⁴. RFJ-ja u anëtarësua në OKB me *Rezolutën A/RES/55/12* më 1 nëntor 2000. Pas miratimit dhe shpalljes së Kartës Kushtetuese të Serbisë dhe Malit të Zi më 4 shkurt 2003 emri zyrtar i “Republika Federative e Jugosllavisë” ishte ndryshuar në “Serbia dhe Mali i Zi”. Më 3 qershor 2006, Sekretari i shtatë i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan u njoftua nga Republika e Serbisë se anëtarësimi i Serbisë dhe Malit të Zi do të vazhdohej vetëm prej Republikës së Serbisë si rrjedhojë e shpalljes së pavarësisë së Malit të Zi, e cila rezultoi nga referendumi i pavarësisë së Malit të Zi prej Serbisë të mbajtur më 21 maj 2006. Mali i Zi u pranua si shtet anëtar i OKB-së më 28 qershor 2006 me *Rezolutën A/RES/60/264* (United Nations, n.d.).

II.1.3 Përjashtimi i shtetit nga organizata ndërkombëtare

II.1.3.1 Dallimi ndërmjet pezullimit dhe përjashtimit të shtetit nga organizata ndërkombëtare

Mënyrë tjetër e përfundimit të anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare është përjashtimi. Mirëpo, ka raste kur ky i fundit ngatërrohet me pezullimin, prandaj duhet qartësuar dallimi mes tyre.

Pezullimi i shteteve nga organizatat ndërkombëtare përbën një masë të ndërmarrë nga organizata nëpërmes së cilës shtetit të anëtarësuar i ndërpritet ushtrimi i të drejtave dhe privilegjeve të përcaktuara nga statuti i organizatës brenda një periudhe të caktuar kohore (Amerasinghe, 2015, p. 114). Një shtet i pezulluar nuk merr pjesë dhe nuk kontribuon në proceset e vendimmarrjes së organizatës për aq kohë sa pezullimi është aktiv. Pezullimi cilësohet edhe si mjet i duhur imponues për respektimin e normave të organizatës prej shteteve anëtare dhe shpesh përdoret si metodë sanksionuese për mospërbushjen e detyrimeve financiare të anëtarësisë (Duxbury, 2011, p. 22). Efektet e tij ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sepse në disa organizata pezullimi nënkupton humbjen e të drejtave dhe privilegjeve në një organ të organizatës, kurse në disa të tjera humbjen e të drejtave dhe privilegjeve në të gjitha organet. Edhe procedura e shqiptimit të pezullimit

⁴ Emri “Republika e Maqedonisë së Veriut” rezultoi nga Marrëveshja e Prespës e nënshkruar më 17 qershor 2018 mes Greqisë dhe Maqedonisë, si zgjedhje e një mosmarrëveshjeje të gjatë për emrin e kësaj të fundit. Marrëveshja ishte ratifikuar në parlamentet e të dy shteteve më 25 janar 2019 dhe hyri në fuqi më 12 shkurt 2019.

ndryshon, por në përgjithësi fuqinë për caktimin e tij e kanë organet kryesore plenare të organizatave. Duhet theksuar se pezullimi nuk i liron shtetet nga obligimet e anëtarësisë, posaçërisht prej atyre financiare, si dhe nuk e përfundon anëtarësinë në vetvete. Mirëpo, ai është i mbushur me pasoja shumë serioze aq sa në teori është e dyshimtë nëse mund të kuptohet fuqia e tij në mungesë të dispozitës së shprehur, përveç nëse ekziston dispozita që rregullon përjashtimin (Amerasinghe, 2015, p. 117).

Përjashtimi përbën metodën më të diskutueshme të përfundimit të anëtarësisë së shteteve në organizatat ndërkombëtare dhe njëkohësisht sanksionin më të rëndë që mund ta ndërmarrë organizata ndaj një shteti anëtar. Vendimi për përjashtimin e një shteti pason nga mosrespektimi ose shkeljet serioze të parimeve të organizatës. Ekzistojnë dispozita të caktuara në disa organizata ndërkombëtare, posaçërisht atyre me karakter financiar, të cilat e rregullojnë përjashtimin e shteteve, por vendimi për përjashtim mund të konsiderohet më tepër i përkohshëm sesa i përhershëm. Në mungesë të dispozitave për përjashtim është e dyshimtë nëse ekziston një parim i përgjithshëm apo supozim i interpretimit që do ta lejonte atë. Prandaj, ashtu siç janë të rregulluara kushtet për anëtarësimin e shteteve në organizata, duhet të rregullohet edhe mënyra e përjashtimit të tyre në qoftë se dështojnë të përmbushin obligimet e anëtarësisë (Amerasinghe, 2015, pp. 122-123). Shumë ekspertë të organizatave ndërkombëtare e mohojnë efektivitetin e përjashtimit si metodë sanksionuese ndaj sjelljeve të pabindura të shteteve anëtare. Disa e konsiderojnë atë si mjet të papërpunuar dhe të gjymtë për të arritur rezultate të qëndrueshme brenda një organizate, njësitë e së cilës janë shtete. Pastaj disa të tjerë shprehin dyshime mbi efikasitetin e përjashtimit sepse e shohin atë si mjet që më shumë e ç'ekuilibron organizatën se sa që e stabilizon atë, si dhe nxit pakënaqësi mes shteteve anëtare. Kryesisht në organizatat ndërkombëtare rajonale ka më shumë hapësira për përjashtimin e shteteve, si përpjekje e ruajtjes së standardeve të përbashkëta të anëtarëve të tjerë (Duxbury, 2011, p. 23).

II.1.3.2 Pezullimi i Ruisë nga Këshilli i Evropës

Për të shpjeguar më mirë pezullimin e shtetit nga organizata ndërkombëtare, shembull tipik mund të merret pezullimi i Ruisë nga Këshilli i Evropës. *Pezullimin e një shteti KiE-ja e ka të theksuar brenda Nenit 8 të statutit të saj që thotë: Çdo Anëtar i Këshillit të*

Evropës që ka shkelur seriozisht Nenin 3⁵ mund të pezullohet nga të drejtat e tij të përfaqësimit dhe i kërkohet nga Komiteti i Ministrave të tërhiqet sipas Nenit 7.⁶ Nëse një Anëtar i tillë nuk e respekton këtë kërkesë, Komiteti mund të vendosë që ai shtet të mos jetë Anëtar i Këshillit që nga data që Komiteti mund ta përcaktojë (Council of Europe, 1949).

Federata Ruse ishte anëtarësuar në KiE më 28 shkurt 1996, duke u bërë shteti i tridhjetë e nëntë anëtar i organizatës (Council of Europe, n.d.). Si pasojë e aneksimit të Krimesë nga Rusia më 18 mars 2014, ngjarje kjo e cila në Rusi tashmë njihet si “Dita e Ribashkimit të Rusisë me Krimenë”, Federata Ruse u përball me një sërë sanksionesh ndërkombëtare, në mesin e së cilave ishte edhe pezullimi i saj nga KiE-ja. Kjo e fundit paraqet një vlerë të rëndësishme gjeokulturore për Rusinë sepse anëtarësia në KiE i siguron përfitime të shumta në disa fusha, veçanërisht në ato që lidhen me të drejtat e minoriteteve ruse (Blum, 2008, p. 278). Asambleja Parlamentare e KiE-së, duke deklaruar se aneksimi i Krimesë nga Rusia ishte “në kundërshtim të qartë me Statutin e KiE-së” dhe me angazhimet e bëra nga Rusia që kur u bashkua me organizatën në vitin 1996, kishte vendosur të pezullojë të drejtat e votimit të delegacionit rus, të drejtën e tij për t’u përfaqësuar në organet drejtuese të Asamblesë, si dhe të drejtën e tij për të marrë pjesë në misionet e vëzhgimit zgjedhor. Në një rezolutë të miratuar me 145 vota pro, 21 kundër dhe 22 abstenime, Asambleja pohonte se okupimi ushtarak i territorit të Ukrainës, kërcënimi i forcës ushtarake, njohja e të ashtuquajturit “referendumi i paligjshëm” dhe aneksimi i Krimesë përbënin pa dyshim shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare. Ky pezullim ishte efektiv deri në fund të sesionit të vitit 2014, më saktësisht gjer më 26 janar 2015 (Council of Europe, 2014). Në janar të vitit 2015 Asambleja i kishte pezulluar sërish këto të drejta për një periudhë tremujore si përgjigje të aktiviteteve të Rusisë në Ukrainën Lindore. Kur çështja e pezullimit do të shqyrtohej në prill 2015, Rusia kishte bojkotuar Asamblenë dhe vazhdonte të ushtronte presion brenda organizatës. Në vitin 2016 kishte njoftuar se do të rikthehej në Asamble vetëm nëse kjo e fundit do të hiqte dorë nga fuqia e saj për të mohuar të drejtat e votimit dhe përfaqësimit të delegacionit rus, në vitin 2017 kishte ndërprerë kontributin e saj

⁵ Neni 3 i Statutit të Këshillit të Evropës thekson: Çdo Anëtar i Këshillit të Evropës duhet t’i pranojë parimet e sundimit të ligjit dhe gëzimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga të gjithë personat që janë në juridiksionin e tij, si dhe të bashkëpunojë sinqerisht dhe në mënyrë efektive për realizimin e qëllimeve të Këshillit.

⁶ Neni 7 i Statutit të Këshillit të Evropës thekson: Çdo anëtar i Këshillit të Evropës mund të tërhiqet duke njoftuar zyrtarisht Sekretarin e Përgjithshëm për këtë qëllim. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në fund të vitit financiar në të cilin njoftohet, në qoftë se njoftimi është dhënë gjatë nëntë muajve të parë të atij viti financiar. Nëse njoftimi është dhënë në tre muajt e fundit, ai do të hyjë në fuqi në fund të vitit të ardhshëm financiar.

financiar të anëtarësisë në vlerë prej 33 milionë € që përbënte 7% të buxhetit të KiE-së, si dhe në vitin 2018 Rusia kishte deklaruar se do të largohej nga organizata nëse nuk do të përmbusheshin kërkesat e saj. Ish-Sekretari i Përgjithshëm i KiE-së Thorbjørn Jagland, si dhe shtetet anëtare si Franca dhe Gjermania kërkonin mënyra efikase për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Në tetor 2018 këto shtete paraqitën një analizë ligjore, me disa defekte, e cila konfirmonte pretendimin e Ruisë se fuqitë e Asamblesë lidhur me pezullimin e të drejtave të votimit dhe përfaqësimit ishin në kundërshtim me Statutin e KiE-së. Gjithashtu pohonin se nëpërmes këtij sanksionimi të delegacionit rus, Krimea nuk ishte kthyer në Ukrainë dhe situata e të drejtave të njeriut në Federatën Ruse nuk ishte përmirësuar fare, si dhe gjithashtu ky vendim kishte krijuar kriza brenda KiE-së (Stiglmeier, 2019). Përfundimisht më 25 qershor 2019, me 118 vota pro, 62 kundër dhe 10 abstenime, Ruisë iu ndërpre masa e pezullimit. Shtetet që votuan pro këtij vendimi pranuan se rivendosja e të drejtave të plota të Ruisë në Asamble mbështetej në faktin se qytetarëve rusë nuk do t'iu mohohet e drejta për të ngritur raste përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kurse shtetet që votuan kundër theksonin se votat e tyre kishin ardhur si rrjedhojë ndaj mosdorëzimit të aneksimit ilegal të Krimesë dhe mosmbështetjes së Ruisë për luftë separatiste në lindje të Ukrainës (Erlanger, 2019).

II.1.3.3 Rekomandimi ndaj Asamblesë së Përgjithshme për përjashtimin e Afrikës së Jugut nga OKB-ja

Shembull që konfirmon dyshimet e ngritura për efikasitetin e përjashtimit si metodë sanksionuese e organizatës ndërkombëtare ndaj shkeljeve të rënda të një shteti është rekomandimi për përjashtimin e Afrikës së Jugut nga OKB-ja. Përjashtimi i shteteve nga OKB-ja është i rregulluar në *Nenin 6 të Kartës, i cili thekson: Asambleja e Përgjithshme, me rekomandimin e Këshillit të Sigurimit, mund të përjashtojë nga Organizata një Anëtar të saj që shkel vazhdimisht parimet e shpallura në këtë Kartë* (United Nations, n.d.). Mirëpo, Karta e OKB-së nuk përmban rregulla të sakta lidhur me atë se çka përfaqëson shkelje të Kartës dhe kjo çështje i mbetet për vlerësim AP-së dhe KS-së.

Afrika e Jugut ishte një nga 51 anëtarët themelues të OKB-së në vitin 1945 (Permanent Mission of South Africa to the United Nations, n.d.). Veçori negative e Afrikës së Jugut ishte politika e aparteidit, e cila ishte legalizuar në vitet dyzeta të shekullit të kaluar. Ajo karakterizohej nga ndarja racore mes pakicës së bardhë dhe shumicës jo të bardhë, si

dhe diskriminimi i ashpër politik dhe ekonomik i kësaj të fundit. Ndonëse çështja e aparteidit kishte hyrë brenda agjendës së AP-së në vitin 1952, politikat racore të qeverisë së Afrikës së Jugut ishin diskutuar që prej vitit 1946 nga India lidhur me trajtimin indianëve në Unionin e atëhershëm të Afrikës së Jugut, të cilët gjatë aparteidit kishin përjetuar pothuajse të njëjtin diskriminim sikurse zezakët dhe njerëzit e racave të tjera (Dakers, 2014, p. 45). Për Afrikën e Jugut aparteidi cilësohej si një çështje e brendshme shtetërore dhe si e tillë nuk mund të trajtohej nga OKB-ja. AP-ja më 1952 kishte hedhur ca hapa modestë sa i përket aparteidit, së pari duke studiuar situatën racore në Afrikën e Jugut dhe së dyti duke u siguruar nëse të gjitha shtetet anëtare të OKB-së i respektonin detyrimet e përcaktuara nga Karta për promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Çështja e aparteidit për diskutim nga AP-ja (A/PV.476) ishte mbështetur nga pjesa më e madhe e shteteve të Evropës Perëndimore, ShBA-të dhe Kanadaja. Miratimi i *Rezolutës 917 (X)* mbi aparteidin më 6 dhjetor 1955 rezultoi me tërheqjen e delegacionit të Afrikës së Jugut nga AP-ja, ndonëse tetëmbëdhjetë vite më vonë kjo tërheqje nuk cilësohej edhe aq vullnetare. Gjatë viteve të gjashtëdhjeta ishte rritur shumë presioni për pezullimin e Afrikës së Jugut nga AP-ja. Në vitin 1970 përmes *Rezolutës 2636 A (XXV)*, AP-ja aprovoi raportin e Komitetit të Kredencialeve me përjashtim të kredencialeve të përfaqësuesve të Afrikës së Jugut, formulë kjo e aplikuar edhe në sesionet e viteve 1971, 1972 dhe 1973. Në vitin 1974 AP-ja hodhi një hap përfundimtar përmes refuzimit vjetor të kredencialeve të Afrikës së Jugut, si formë e refuzimit të pjesëmarrjes së saj në aktivitetet e AP-së. Ndonëse nuk ishte përjashtim i plotë, kishte efekt pothuajse të njëjtë. Më 16 dhjetor 1974, AP-ja i kishte bërë thirrje KS-së për rishikim të marrëdhënieve mes OKB-së dhe Afrikës së Jugut. Një *Projekt-Rezolutë (S/11543)* e paraqitur më 24 tetor 1974 nga Kameruni, Kenia, Mauritania, pastaj edhe nga Iraku, i rekomandonte AP-së aktivizimin e Nenit 6 të Kartës ndaj Afrikës së Jugut, duke u mbështetur në tri fakte:

- 1) *Afrika e Jugut nuk pranoi ta braktiste politikën e aparteidit;*
- 2) *Afrika e Jugut refuzoi t'i tërhiqte forcat e saj nga Namibia;*
- 3) *Afrika e Jugut mbështeste regjimin ilegal në Rodezinë Jugore, duke dërguar forca ushtarake dhe policore, e që ishin në kundërshtim me rezolutat përkatëse të KS-së.*

Mirëpo, si pasojë e kundërshtimit të Francës, MB-së dhe ShBA-ve, kjo dispozitë nuk u aktivizua. Këto shtete u përballën me kritika të shumta sepse vetoja e trefishtë e tyre kishte ardhur si rezultat i bashkëpunimit që kishin me Afrikën e Jugut në fushën bërthamore, si dhe

në importet e kromit dhe nikelit nga Rodezia Jugore. Pas lirimt të Nelson Mandelës nga burgu më 11 shkurt 1990 dhe vendimeve të qeverisë së Afrikës së Jugut për shkatërrimin e regjimit të aparteidit në vitin 1991, pasuan ndryshime të jashtëzakonshme në Afrikën e Jugut (Bosch-Marín, 1998, pp. 43-45). Më 26, 27 dhe 28 prill 1994 në Afrikën e Jugut ishin organizuar zgjedhjet e para demokratike dhe më 10 maj të këtij viti Nelson Mandela ishte vendosur në krye të Presidencës së Republikës së Afrikës së Jugut (Woll, 2015, p. 42). Ndërkaq, më 23 qershor 1994 Afrika e Jugut e rifilloi pjesëmarrjen e saj në AP, gjegjësisht përmes *Rezolutës A/48/PV.95* (Bosch-Marín, 1998, p. 45).

II.1.4 Tërheqja e shtetit nga organizata ndërkombëtare

II.1.4.1 E drejta dhe kushtet e tërheqjes

Tërheqja përbën një akt vullnetar të një shteti për t'u larguar nga organizata, me ç'fakt paraqet një mënyrë tjetër të përfundimit të anëtarësisë së shteteve nga organizatat ndërkombëtare. *Neni 54 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve*⁷ thekson se *përfundimi i një traktati ose tërheqja e një pale mund të bëhet në dy mënyra:*

- 1) *Në përputhje me dispozitat e traktatit;*
- 2) *Në çdo kohë me pëlqimin e të gjitha palëve pas konsultimit me shtetet e tjera kontraktuese* (Dörr & Schmalenbach, 2018, p. 1015).

Tërheqja e shteteve mund të zbatohet vetëm në traktatet shumëpalëshe sepse traktatet dypalëshe përfundojnë së ekzistuari në qoftë se njëra nga palët tërhiqet. Kur një shtet shpreh vullnetin për t'u tërhequr prej një traktati shumëpalësh, ai heq dorë nga të drejtat dhe obligimet e përcaktuara nga traktati në fjalë, me ç'rast përfundon statusi i tij si palë përbërëse e këtij të fundit (Dörr & Schmalenbach, 2018, p. 1022).

E drejta e tërheqjes së shteteve nga anëtarësia përmendet shprehimisht në statutet e shumicës së organizatave ndërkombëtare, me përjashtim të OKB-së, në Kartën e së cilës nuk ka dispozitë që ndalon, lejon, apo rregullon tërheqjen. Në përgjithësi caktohet një periudhë kohore ndërmjet dhënies së njoftimit të shtetit për tërheqje dhe hyrjes së kësaj të

⁷Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve u miratua më 22 maj 1969 dhe u hap për nënshkrim më 23 maj të këtij viti nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Traktateve. Kjo e fundit zhvilloi dy sesione në Neue Hofburg në Vjenë, sesionin e parë nga 26 mars gjer më 24 maj 1968 dhe sesionin e dytë prej 9 prill deri më 22 maj 1969. Konventa hyri në fuqi më 27 janar 1980 dhe në janar të vitit 2018 është ratifikuar nga 116 shtete.

fundit në fuqi, e cila ndryshe njihet si periudhë ‘ftohjeje’ apo edhe si mënyrë rishqyrtuese e mundësive të tërheqjes nga organizata. Mirëpo, shtrohet pyetja, a mund të pezullojë një shtet njoftimin e tij për tërheqje pasi ta deklarojë atë? Përgjigja është se një njoftim i tillë nuk mund të pezullohet, përveç nëse pjesa tjetër e shteteve anëtare të organizatës bien dakord për pezullimin e njoftimit të tij. Tërheqja është relativisht e pakontestueshme (në kuptimin juridik) me kusht që të arrihet brenda parashikimeve të përcaktuara nga kushtetuta e organizatës (Duxbury, 2011, p. 20).

Kushtet e bashkangjitura për tërheqje ndryshojnë në varësi të organizatës, megjithatë në përgjithësi detyrimet që duhen përmbushur domosdoshmërisht para se tërheqja e shtetit nga organizata të bëhet efektive janë ato financiare. Prandaj organizatat ndërkombëtare me karakter financiar ndeshen me një sërë komplikimesh kur përballen me tërheqjen e ndonjë shteti anëtar, ngase rregullimi i llogarive me shtetin që tërhiqet përbën një proces tejmasë të ndërlikuar (Amerasinghe, 2005, pp. 117-118).

II.1.4.2 Mungesa e klauzolës së tërheqjes

E drejta e shteteve për t’u tërhequr nga anëtarësia e organizatave ndërkombëtare mund të jetë e diskutueshme nëse kushtetutës së organizatës i mungon dispozita që e lejon tërheqjen e shtetit. *Neni 56 i KVDT-së rregullon denoncimin e ose tërheqjen nga një traktat që nuk përmban asnjë dispozitë lidhur me përfundimin, denoncimin apo tërheqjen dhe thekson:*

- 1) *Një traktat, i cili nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me përfundimin e tij dhe që nuk parashikon denoncim apo tërheqje, nuk i nënshtrohet denoncimit ose tërheqjes përveç nëse:*
 - a) *është vërtetuar se palët synojnë të pranojnë mundësinë e denoncimit apo tërheqjes;*
 - b) *e drejta e denoncimit ose tërheqjes mund të nënkuptohet nga natyra e traktatit.*
- 2) *Një palë do të njoftojë jo më pak se dymbëdhjetë muaj lidhur me qëllimin e saj për të denoncuar apo për t’u tërhequr nga një traktat sipas paragrafit 1 (Dörr & Schmalenbach, 2018, p. 1039).*

Paragrafi i dytë i këtij neni, i cili vlen për traktatet bilaterale dhe multilaterale bën dallimin ndërmjet tri termave të lartpërmendur, përfundimit, denoncimit dhe tërheqjes.

Përfundimi i traktatit nënkupton se ky i fundit shuhet së ekzistuari, me ç'rast palët lirohen nga çdo obligim i mëtejshëm për të përmbushur traktatin.

Denoncimi i traktatit është një deklaratë e njëanshme përmes së cilës një palë përfundon pjesëmarrjen në traktat. Traktatet bilaterale përfundojnë me denoncimin e njëjës palë, përderisa traktatet multilaterale vazhdojnë funksionimin e tyre vetëm se pala e denoncuar tërhiqet dhe humb statusin e palës së këtij traktati.

Tërheqja nga traktati është një sinonim i denoncimit, mirëpo duhet cekur se KVDT-ja përdor dy termet këmblyshëm për veprimin e njëjtë të shtetit ngase terminologjia e praktikës së traktateve ndërkombëtare nuk është uniforme (Dörr & Schmalenbach, 2018, pp. 1045-1046). Politikat që favorizojnë pikëpamjen se tërheqja e shteteve nga anëtarësia lejohet edhe në mungesë të dispozitës në kushtetutën e organizatës, e cila do ta lejonte dhe rregullonte atë, kanë qenë të bazuara në koncepte të tilla si sovraniteti dhe vetëvendosja, barazia, si dhe përshtatshmëria dhe parimet e përgjithshme të së drejtës. Dy konceptet e para mund të konsiderohen si të kufizuara nga pjesëmarrja në instrumentin përbërës, përderisa barazia është si shpatë me dy teha. Përshtatshmëria mund të cilësohet si një argument më bindës sepse një shtet anëtar që është hezitues nuk mund të detyrohet për participim (Amerasinghe, 2005, pp. 118-120).

II.1.4.3 Shembuj të tërheqjeve të shteteve nga organizatat ndërkombëtare

II.1.4.3.1 Tërheqja e shteteve nga Lidhja e Kombeve

Statuti i Lidhjes së Kombeve e kishte të rregulluar tërheqjen vullnetare të shteteve në Nenin 1, i cili thekson: Çdo Anëtar i Lidhjes pas dy vitesh të bërjes së njoftimit, tërhiqet nga organizata në qoftë se detyrimet e tij ndërkombëtare, si dhe të gjitha detyrimet e tij të përcaktuara në Statut të përmbusheshin në kohën e tërheqjes së tij (Yale Law School, n.d.).

Përgjatë ekzistencës së saj njëzet e gjashtëvjeçare, Lidhja e Kombeve ishte përballur me tërheqje të shumta të shteteve të ndryshme. Shteti i parë që kishte shprehur vullnetin e tij për t'u tërhequr nga Lidhja ishte Kosta Rika më 24 dhjetor 1924, duke vazhduar pastaj me Brazilin më 14 qershor 1926, Japoninë më 27 mars 1933, Gjermaninë më 21 tetor 1933, Paraguain më 23 shkurt 1935, Guatemalën më 26 maj 1936, Nikaraguan më 27 qershor 1936, Hondurasin më 10 korrik 1936, El Salvadorin më 26 korrik 1937, Italinë më 11 dhjetor 1937, Kilin më 2 qershor 1938, Venezuelën më 12 korrik 1938, Perunë më 8 prill 1939,

Hungarinë më 11 prill 1939, Spanjën më 9 maj 1939, Rumaninë më 11 korrik 1940 dhe Haitin në prill të vitit 1942 (Ginneken, 2016, pp. 24-34). Tërheqjet e këtyre shteteve kishin qenë krejtësisht të ndikuara nga ngjarjet që kishin ndodhur para dhe gjatë LDB-së.

II.1.4.3.2 Tërheqja e Indonezisë nga OKB-ja

Ndonëse Karta e OKB-së nuk përmban asnjë dispozitë që rregullon tërheqjen vullnetare të shteteve megjithëkëtë, një raport i Këshillit të Konferencës së San Franciskos përjashtimisht lejon mundësinë që çdo shtet anëtar të tërhiqet nga organizata në raste të jashtëzakonshme dhe duhet t'i paraqesë arsyet e tërheqjes, të cilat duhet të jenë të atilla që e arsyetojnë vendimin. Sipas kësaj, e drejta e tërheqjes është e kufizuar me marrëveshje të përgjithshme (Gruda, 2013, pp. 377-378).

OKB-ja është përballur vetëm një herë me vendimin e një shteti anëtar për tërheqje, nga Indonezia, vendim ky që kishte pasuar nga kundërshtimi i zgjedhjes së Malajzisë si një anëtar jo i përhershëm i KS-së, e që Indonezia e konsideronte si rezultat të një manovre tjetër koloniale. Njoftimi për tërheqjen e Indonezisë më 20 janar 1965 iu dha nëpërmes një letre U Thant, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në atë kohë, me ç'rast ky i fundit e pranoi tërheqjen e Indonezisë pasi konstatoi se nuk kishte zgjidhje tjetër. Një vendim i tillë konsiderohej një goditje e rëndë për prestigjin e OKB-së, veçmas kur kjo e fundit po shënonte përvjetorin e njëzetë të themelimit, mirëpo tërheqja ishte pranuar pa njohje zyrtare nga KS-ja dhe AP-ja (Cordier & Harrelson, 1976, p. 24). Tërheqja e Indonezisë nga OKB-ja u përcaktua si “anëtarësi joaktive” që mund të nxirrej nga një sërë veprimesh të organizatës si pezullimi i Indonezisë nga lista e shteteve anëtare, largimi i flamurit dhe targës indoneziane nga OKB-ja, përjashtimi i saj nga dokumentet buxhetore, etj. (Conforti & Focarelli, 2016, p. 53). Mirëpo, më 19 shtator 1966 Indonezia kishte vendosur që të rifillonte bashkëpunimin e plotë me OKB-në pasi Sukarno, Presidenti i asaj kohe i Indonezisë, humbi pushtetin si rezultat i një grusht shteti ushtarak, si dhe të dy palët kishin rënë dakord që Indonezia të paguante 10% të kontributeve, të cilat do të arrinin të përmbushnin periudhën e mungesës së saj (Bedjaoui, 1991, p. 84).

II.1.4.3.3 Tërheqja e shteteve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar

Neni 26, Seksioni 1, i Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar⁸ rregullon të drejtën e tërheqjes së shteteve anëtare dhe thekson: Çdo Anëtar mund të tërhiqet nga Fondi në çdo kohë duke transmetuar një njoftim me shkrim tek Fondi në zyrën e tij kryesore. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së një njoftimi të tillë (International Monetary Fund, 2016).

Më 14 mars 1950, Drejtori Menaxhues i FMN-së kishte marrë një letër nga Ambasadori i Polonisë në ShBA, i cili në emër të qeverisë së Republikës së Polonisë njoftoi për vendimin e kësaj të fundit për tërheqje nga anëtarësia në FMN, pasi pretendohet se Fondi kishte dështuar në përmbushjen e detyrave të tij, kishte qenë instrument i nënshtruar i politikës së ShBA-ve dhe kishte bashkëpunuar me këto të fundit për të detyruar një numër anëtarësh që të zhvlerësojnë monedhat e tyre. Tërheqja e Polonisë u pranua nga FMN më 15 mars 1950 (International Monetary Fund, 1985), por Polonia iu bashkua Fondit sërish më 12 qershor 1986 (International Monetary Fund, 2019).

Kuba kishte marrë një letër nga Drejtori Menaxhues i FMN-së më 11 tetor 1963, nëpërmes së cilës i tërhiqeshin vërejtje për dështime sa i përket përmbushjes së detyrimeve financiare të anëtarësisë. Si pasojë e këtyre dështimeve, më 2 prill 1964 Fondi kishte marrë njoftim nga Kuba për tërheqjen e saj nga anëtarësia, e cila ishte bërë efektive menjëherë (International Monetary Fund, 1985).

Në vitin 1965, kur Indonezia kishte vendosur të tërhiqej nga OKB-ja kinse për shkak të ndikimit të lartë të fuqive neokoloniale brenda organizatës në fjalë, ky vend kishte vendosur të tërhiqej edhe nga FAO, UNESCO, UNICEF dhe FMN. Ministri i jashtëm indonezian i asaj kohe, Subandrio, më 3 gusht 1965 përmes një letre iu drejtua Drejtorit Menaxhues të Fondit duke e njoftuar atë për vendimin e Indonezisë për t'u tërhequr nga FMN, si dhe më 17 gusht 1965 për gatishmërinë e saj për të diskutuar rregullimin e llogarive me Fondin. Tërheqja e Indonezisë nga FMN nuk kishte pasur asnjë problem (International Monetary Fund, 1985), megjithëse Indonezia iu bashkua sërish Fondit më 21 shkurt 1967 (International Monetary Fund, 2019).

⁸Nenet e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar u miratuan në Konferencën Monetare dhe Financiare të Kombeve të Bashkuara, Bretton Woods, New Hampshire, më 22 korrik 1944 dhe hynë në fuqi më 27 dhjetor 1945, ndërsa u ndryshuan më 28 korrik 1969, më 1 prill 1978, më 11 nëntor 1992, më 10 gusht 2009, më 18 shkurt 2011, më 3 mars 2011, më 26 janar 2016.

II.1.4.3.4 Tërheqja e Zanzibarit nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik

Sipas Nenit 35 të Kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Islamik:⁹

- 1) Çdo Shtet Anëtar mund të tërhiqet nga Organizata duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm një vit para tërheqjes së tij. Një njoftim i tillë do t'iu komunikohet të gjitha Shteteve Anëtare;
- 2) Shteti që aplikon për tërheqje është i detyruar t'i përmbushë detyrimet e tij deri në fund të vitit fiskal gjatë së cilit paraqitet kërkesa për tërheqje. Ai gjithashtu do të rregullojë çdo obligim tjetër financiar që i detyrohet Organizatës (Organization of Islamic Cooperation, n.d.).

OBI është përballur me një rast të tërheqjes së një shteti anëtar, me Zanzibarin (rajon gjysmë-autonom i Tanzanisë) më 13 gusht 1993. Popullsia e Tanzanisë përbëhet nga 34% të krishterë, 33% myslimanë, dhe 33% religjione të tjera, përderisa popullsia e Zanzibarit i përkasin kryesisht fesë myslimane. Qeveria e Zanzibarit ishte anëtarësuar në OBI për të arritur përfitime më të mëdha ekonomike. Presidenti i Tanzanisë, Ali Hassan Mwinyi, e miratoi vendimin e Zanzibarit, mirëpo ky vendim rezultoi me zemërim të opozitës, me ç'rast u kërkua impeaçmenti i tij dhe si rrjedhojë e këtyre ngjarjeve Zanzibari vendosi të tërhiqej nga OBI-ja. Qeveria e Tanzanisë nuk e konsideronte të duhur anëtarësinë e Zanzibarit në OBI, pasi organizata në fjalë përfaqësonte vetëm njërin nga fetë e Tanzanisë (United Nations Refugee Agency, 2004).

II.1.4.3.5 Tërheqja e Francës nga NATO

Tërheqja e shteteve nga anëtarësia e NATO-s është e rregulluar në Nenin 13 të Traktatit të Atlantikut Verior, i cili thekson: Pasi Traktati të ketë hyrë në fuqi për njëzet vite, çdo Palë mund të pushojë së qenuri Palë e Traktatit një vit pas njoftimit të denoncimit, që i është dhënë Qeverisë së ShBA-ve, e cila duhet të informojë Qeveritë e Palëve të tjera për marrjen e çdo njoftimi për denoncim (North Atlantic Treaty Organization, 2019).

⁹ Karta e parë OBI-së u miratua më 4 mars 1972, ku u përcaktuan objektivat, parimet dhe qëllimet themelore të organizatës, me qëllim të forcimit të solidaritetit dhe bashkëpunimit mes shteteve anëtare. Gjatë 40 viteve të fundit anëtarësia e saj është rritur nga 30 në 57 shtete. Karta e OBI-së u ndryshua në mënyrë që të adaptohej me ritmin e zhvillimeve të reja në tërë botën. Karta e tanishme ishte miratuar nga Samiti i Njëmbëdhjetë Islamik, i mbajtur në Dakar më 13 dhe 14 mars 2008, për t'u përputhur me kërkesat e shekullit XXI.

Presidenti francez Charles de Gaulle më 21 qershor 1966 e kishte tërhequr Francën nga struktura e komandës ushtarake të integruar të NATO-s. Ai kishte dëshiruar një pavarësi më të madhe ushtarake, veçmas përballë ShBA-ve. Kjo u materializua me refuzimin e integritit të parandaluesit bërthamor të Francës ose pranimin e çdo forme kontrolli mbi forcat e saj të armatosura, si dhe me largimin e të gjitha forcave të huaja nga territori francez. Përderisa Franca mbeti anëtare e NATO-s dhe kishte marrë pjesë në instancat politike të Organizatës, ajo nuk ishte përfaqësuar në komitete të caktuara si Grupi i Planifikimit Bërthamor dhe Komiteti i Planifikimit të Mbrojtjes. Forcat e huaja u larguan nga territori francez dhe forcat franceze u tërhoqën përkohësisht nga komandat e NATO-s (L'Organisation du Traité de l'Atlantique Nord, p.d.).

Më 4 prill 2009 Franca vendosi të rikthehej në pjesëmarrje të plotë pas një kthimi të pjesshëm në strukturat ushtarake të NATO-s në vitin 1995. Që nga kjo datë, ministrat e mbrojtjes marrin pjesë në mbledhjet e ministrave, shefat e stafit të përbashkët të mbrojtjes marrin pjesë në takime me homologët e tyre nga vendet aleate dhe përfaqësuesit ushtarakë francezë në NATO ulen në Komitetin Ushtarak. Po ashtu, që atëherë oficerët francezë shërbejnë në selinë e Forcave Aleate në Evropë, në selinë e nivelit operacional dhe në disa organizata të Komandës për Transformim. Vendimin e Francës për pjesëmarrje të plotë në NATO e kishte njoftuar Presidenti francez, Nicolas Sarkozy, në qershor 2008, mirëpo duhet cekur se Franca kishte përcaktuar disa kushte për këtë rikthim në strukturat ushtarake:

- *Ruajtja e lirisë së plotë për gjykimin e kontributit francez në operacionet e NATO-s;*
- *Ruajtja e pavarësisë bërthamore (Franca vendosi të mos bashkohet me Grupin e Planifikimit Bërthamor të NATO-s);*
- *Mosvendosja e asnjë force franceze plotësisht nën komandën e NATO-s në kohë paqje;*
- *Mospjesëmarrja në financimin e përbashkët të shpenzimeve të caktuara.*

Qeveria franceze duke marrë përsipër përgjegjësinë e saj, në një deklaratë të politikës së jashtme sipas Nenit 49 (1) të Kushtetutës,¹⁰ vendimin për t'u rikthyer në NATO e kaloi për votim në Asamblenë Kombëtare, e cila e aprovoi atë në mars 2009. Franca njoftoi zyrtarisht pjesëmarrjen e saj të plotë në strukturat ushtarake të NATO-s në Samitin e

¹⁰ Neni 49, Paragrafi i parë, i Kushtetutës së Republikës së Pestë Franceze thekson: Kryeministri, pas diskutimit nga Këshilli i Ministrave, mund t'a bëjë programin e qeverisë ose ndoshta një deklaratë të politikave të përgjithshme në një çështje të një votëbesimi përpara Asamblesë Kombëtare.

Strasburgut-Kehl në prill 2009. Prej vitit 2009 Franca posedon afro 750 pozicione oficerësh shtesë brenda komandës së integruar të NATO-s, por me theks të veçantë edhe postin e Komandantit Suprem të Aleatëve për Transformim (Représentation permanente de la France auprès de l'OTAN, p.d.).

II.1.4.3.6 Tërheqja e Venezuelës nga Organizata e Shteteve Amerikane

Tërheqja e shteteve nga Organizata e Shteteve Amerikane është e rregulluar në Nenin 143 të Kartës¹¹ së saj, i cili thekson: Kjo Kartë do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar, por mund të denoncohet nga çdo Shtet Anëtar përmes një njoftimi me shkrim të Sekretariatit të Përgjithshëm, i cili do t'u komunikojë të gjithë të tjerëve çdo njoftim të marrë për denoncim. Pas dy vitesh që nga data në të cilën Sekretariati i Përgjithshëm merr një njoftim të denoncimit, kjo Kartë do të pushojë së qenuri në fuqi për shtetin që denoncon, i cili do të pushojë së takuari Organizatës pasi të ketë përmbushur detyrimet që burojnë nga Karta e tanishme (Organization of American States, n.d.).

Më 27 prill 2017, Republika Bolivariane e Venezuelës kishte filluar zyrtarisht procesin e tërheqjes prej OSA-së, përmes një vendimi të marrë nga Presidenti Nicolás Maduro. Ky i fundit pohonte se historia e kësaj organizate, më herët por edhe tani, është për keqardhje sepse që prej themelimit të saj e gjer tani ka qenë e rrëmbyer nga interesat që janë në kundërshtim të plotë me frymën e integritit dhe bashkimit. Ai pohonte se OSA kishte të meta të shumta, përfaqësonte interesat e imperializmit dhe mënyrën e të bërit politikë kriminale në rajon (Ministry of Popular Power for External Relations of the Venezuela, 2019). Para se të merrej vendimi për tërheqje, sektorët ekstremistë të opozitës lokale në Venezuelë inkurajuan një përshkallëzim të një dhune të paparë në vend. OSA intensifikoi ndërhyrjen në punët e brendshme të Venezuelës, një shkelje flagrante e Kartës së OSA-së, duke nxitur vendimin historik të ekzekutivit kombëtar. *Neni 19 i Kartës thekson: "Asnjë shtet apo grup shtetesh nuk ka/në të drejtë të ndërhyjë/jnë në mënyrë direkte ose indirekte, për çfarëdolloj arsyeje, në punët e brendshme apo të jashtme të ndonjë shteti tjetër. Parimi i mësipërm ndalon jo vetëm forcën e armatosur, por edhe çdo formë tjetër të ndërhyrjes ose kërcënimit në tentativë ndaj personalitetit të shtetit apo kundër elementeve të tij politike,*

¹¹ Karta e Organizatës së Shteteve Amerikane është një traktat Pan-Amerikan që vendosi krijimin e Organizatës së Shteteve Amerikane. Ajo u nënshkrua në Konferencën e Nëntë Ndërkombëtare të Shteteve Amerikane më 30 prill 1948, të mbajtur në Bogotá, Kolumbi, si dhe hyri në fuqi më 13 dhjetor 1951.

ekonomike dhe kulturore” (Organization of American States, n.d.). Sesionet dhe rezolutat e OSA-së inkurajuan demonstratat e dhunshme të periudhës prill-korrik 2017, kërkesa e së cilave ishte rrëzimi i qeverisë së Venezuelës, e që rezultuan me dhjetëra vdekje të njerëzve duke përfshirë edhe persona që ishin djegur për së gjalli, si dhe dëme materiale të shaktuara në institucionet publike dhe private. Bazuar në Kushtetutën e Republikës Bolivariante të Venezuelës, presidenti është i autorizuar për drejtimin e marrëdhënieve të jashtme të kombit dhe bazuar në këtë përfaqësuesit diplomatikë të Venezuelës të OSA-së i dorëzuan kësaj të fundit letrën e nënshkruar nga Presidenti Maduro, e cila zyrtarizonte tërheqjen e vendit nga kjo organizatë, e që hyri në fuqi më 29 prill 2019, datë me të cilën përfundoi anëtarësia e Venezuelës në OSA (Ministry of Popular Power for External Relations of the Venezuela, 2019). Në përgjigje të tërheqjes, Sekretari i Përgjithshëm i OSA-së Luis Almagro pohoi se kishte përdorur në mënyrë të përsëritur pozicionin e tij për të bërë thirrje për ndryshimin e regjimit në Venezuelë, madje duke arritur gjer në atë pikë sa të mbështeste edhe një ndërhyrje ushtarake për largimin e Presidentin Maduro dhe kishte bërë thirrje ndaj vendeve të Amerikës Latine për të vendosur sanksione kundrejt Karakasit (Dobson, 2019). Sanksione të ndërmarra ndaj Karakasit janë bërë edhe nga Uashingtoni, duke përfshirë këtu embargo të naftës, sanksione kundër sektorit bankar dhe të minierave, si dhe një numër masash kufizuese që kufizojnë qasjen e Venezuelës në infrastrukturën financiare globale (Dobson, 2019).

II.1.4.4 Shkaku kryesor i tërheqjeve të shteteve nga organizatat ndërkombëtare

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është i domosdoshëm për shtetet sovrane meqë ato janë të pafuqishme për t’iu përgjigjur problemeve dhe sfidave të shumta që nuk njohin kufij territorialë, e që për zgjidhjen e tyre kërkohet menaxhimi global apo bashkëpunimi multilateral. Organizatat ndërkombëtare pavarësisht kategorive që iu përkasin përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të përpjekjeve për të zgjidhur probleme të ndryshme globale dhe jo më kot konsiderohen si bartës të rinj të ngjarjeve botërore. Mirëpo, ato po e sfidojnë pozitën deri vonë të pakontestueshme të shteteve si subjekte primare të marrëdhënieve ndërkombëtare. Me anëtarësimin e një shteti në një organizatë ndërkombëtare bartet një pjesë e sovranitetit të shtetit brenda saj. Rezistenca e transferimit të sovranitetit në organizata ndërkombëtare është prezente tek të gjitha shtetet e botës, qofshin ato të mëdha, të mesme apo të vogla, si dhe kur ajo kalon në një nivel të lartë

rezultojn tërheqja e shteteve nga anëtarësimi në organizata. Dekada e dytë e shekullit XXI karakterizohet nga kërcënimet dhe vendimet e disa shteteve me peshë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake në botë për t'u tërhequr prej organizatave ndërkombëtare që kanë rëndësi dhe rol të madh në arenën globale, e që duhet trajtuar me shumë seriozitet sepse implikimet që pasojnë prej tyre janë shqetësuese. Shembull tipik është vendimi i MB-së për t'u tërhequr nga UE-ja, i njohur me termin 'Brexit', i cili do të njihet si rasti më i ndërlikuar sa iu përket tërheqjeve të shteteve prej organizatave ndërkombëtare.

II.1.5 Konkluzionet

Për të kuptuar përfundimin e anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare, duhet specifikuar mënyrat se si përfundon anëtarësia. Organizata ndërkombëtare mund të shpërbëhet në dy mënyra, me vendim të organit të saj kryesor siç ka ndodhur me Lidhjen e Kombeve, ose kur aktivizohet neni i caktuar të statutit të organizatës që rregullon shpërbërjen siç e ka Banka Botërore. Kur organizata shpërbëhet, përfundon edhe anëtarësia e shteteve. Mirëpo, edhe zhdukja e shtetit qoftë me ndarjen e territorit të tij në shtete të reja ose me bashkim vullnetar të dy apo më shumë shteteve, është mënyrë tjetër e përfundimit të anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare. Shembull tipik mund të merret përfundimi i anëtarësimit të RSFJ-së në OKB. Kur shteti pezullohet nga organizata ndërkombëtare për mospërbushjen e detyrimeve të caktuara nga statuti i organizatës, atij nuk i përfundohet anëtarësia por i ndërpritet ushtrimi i të drejtave dhe obligimeve për një periudhë të caktuar kohore, rast i tillë është pezullimi i Ruisë nga KiE. Ndërsa, përjashtimi është mënyra e tretë e përfundimit të anëtarësisë së shtetit nga organizata ndërkombëtare që pason nga mosrespektimi apo shkeljet serioze të parimeve të organizatës. Rekomandimi i AP-së për përjashtimin e Afrikës së Jugut nga OKB-ja tregon se ç'proces i komplikuar është përjashtimi. Tërheqja e shtetit nga organizata ndërkombëtare është mënyra e katërt e përfundimit të anëtarësimit të shtetit, e cila është e theksuar në nene të caktuara të statuteve të shumë organizatave ndërkombëtare. Në krahasim me mënyrat e tjera, raste të tërheqjeve ka më tepër, Lidhja e Kombeve ishte përballur me tërheqje të shumë shteteve, pastaj është tërheqja e Indonezisë nga OKB, tërheqjet e Polonisë, Kubës dhe Indonezisë nga FMN, tërheqja e Zanzibarit nga OBI, tërheqja e Francës nga NATO dhe tërheqja e Venezuelës

nga OSA. Shkaku kryesor që i ka shtyrë shtetet drejt vendimit për tërheqje nga anëtarësimi i organizatave ndërkombëtare është rezistenca e transferit të sovranitetit.

II.2 Vendimi i Mbretërisë së Bashkuar për t'u tërhequr nga anëtarësia e Unionit Evropian

II.2.1 Tërheqja e shtetit nga UE-ja

II.2.1.1 E drejta dhe rregullimi i tërheqjes së shtetit nga UE-ja

Në të kaluarën, nëse një shtet do të shprehte vullnetin për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së, praktikisht do të ishte e pamundur për shkak të zbrazëtirës juridike për të rregulluar këtë çështje. Prandaj, do të ishte e nevojshme të negociohej një marrëveshje mes shtetit anëtar dhe UE-së për të lidhur marrëdhënie stabile ekonomike dhe marrëdhënie të tjera, në mënyrë që të pamundësoheshin komplikimet (Piris, 2010, pp. 109-110). Përderisa gjithnjë është supozuar se UE-ja mund të shpërbëhet dhe tërheqjet individuale lejohen me një marrëveshje të të gjitha shteteve anëtare, shumë ekspertë të politikave dhe institucioneve të UE-së besonin se para hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës në vitin 2009, traktatet evropiane në versionin e tyre të Nicës nuk lejonin tërheqje unilaterale në funksion të dispozitave të tyre që shprehnin se këto traktate u lidhën për periudha të pakufizuara (Dörr & Schmalenbach, 2018, p. 1057). Zgjerimi gjeografik dhe thellimi i integritetit evropian në gjashtë dekadat e fundit kanë shkaktuar supozimin e ekzistencës së pandalur dhe të pakufizuar të lidhjes evropiane, si dhe mungesa e vëmendjes së doktrinës mbi çështjen e përfundimit të anëtarësisë mund të justifikohet me këtë arsye. Studiuesit përqendroheshin shumë më tepër në pranimin e vendeve aplikuese dhe anëtarësimin në KEE/UE, sesa në tërheqjen e shteteve anëtare (Troitiño et al., 2018, p. 200). Kjo e fundit kishte qenë për një kohë të gjatë pjesë e debateve të ashpra politike mes shteteve anëtare, ku kërkohet nga UE-ja që ashtu siç kishte përcaktuar kriteret e anëtarësimin,¹² duhej të përcaktonte edhe kur, si,

¹² Kriteret për anëtarësim në Unionin Evropian të njohura edhe si Kriteret e Kopenhagës që u përcaktuan më 21-22 qershor 1993 në Kopenhagë, Danimarkë, janë kushtet thelbësore që të gjitha shtetet kandidate duhet t'i plotësojnë për t'u anëtarësuar në UE, e që janë: kriteret politike (stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve), kriteret ekonomike (ekonomia funksionale e tregut dhe aftësia për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut) dhe aftësia administrative, si dhe institucionale për të zbatuar në mënyrë efektive Acquis Communautaire dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimin.

dhe në çfarë kushtesh e procedurash mund të tërhiqej një shtet nga anëtarësia. Një ndër rrisitë kryesore të Traktatit të Lisbonës ishte përcaktimi juridik i mundësisë së tërheqjes së shteteve nga anëtarësia e UE-së sepse ky traktat për herë të parë e mundësoi tërheqjen vullnetare të një vendi anëtar nga UE-ja nëpërmes Nenit 50.

II.2.1.2 Përmbajtja e Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës

Neni 50 i Traktatit të Lisbonës rregullon tërheqjen vullnetare të shteteve nga anëtarësia e UE-së. Sipas këtij neni:

- 1) *Çdo Shtet Anëtar mund të vendosë të dalë nga Unioni, në përputhje me kërkesat e tij kushtetuese.*
- 2) *Shteti Anëtar që vendos të dalë nga Unioni njofton Këshillin Evropian për këtë qëllim. Në dritën e orientimeve të dhëna nga Këshilli Evropian, Unioni negocion dhe arrin një marrëveshje me këtë Shtet, në të cilën përcaktohen masat organizative të daljes, duke pasur parasysh kuadrin për marrëdhënien e tij të ardhshme me Unionin. Kjo marrëveshje negocohet në përputhje me Nenin 218 (3)¹³ të Traktatit për Funkcionimin e Unionit Evropian. Marrëveshja lidhet në emër të Unionit nga Këshilli, duke vepruar me shumicë të cilësuar, pasi të merret pëlqimi i Parlamentit Evropian.*
- 3) *Traktatet pushojnë së zbatuari për Shtetin në fjalë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e marrëveshjes së daljes ose, nëse nuk arrihet një marrëveshje e tillë, dy vite pas njoftimit të përmendur në paragrafin 2, Këshilli Evropian në marrëveshje me Shtetin Anëtar në fjalë vendos unanimitisht ta zgjasë këtë afat.*
- 4) *Për qëllimet e paragrafëve 2 dhe 3, anëtari i Këshillit Evropian ose i Këshillit, i cili përfaqëson Shtetin Anëtar që del nga Unioni, nuk merr pjesë në diskutimet e Këshillit Evropian ose të Këshillit që kanë të bëjnë me këtë Shtet Anëtar. Shumica e cilësuar përcaktohet në përputhje me nenin 238(3)(b)¹⁴ të Traktatit për Funkcionimin e Unionit Evropian.*

¹³ Neni 218 (3) thekson: Komisioni, ose Përfaqësuesi i Lartë i Unionit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, kur marrëveshja e parashikuar lidhet ekskluzivisht apo kryesisht me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, do t'i paraqesë Këshillit rekomandime, i cili do të marrë një vendim që autorizon hapjen e negociatave dhe në varësi të temës së marrëveshjes së parashikuar emëron kreun e ekipit negociues të UE-së.

¹⁴ Neni 238 (3)(b) thekson: Me anë të shmangies nga pika (a), kur Këshilli nuk vepron me propozimin e Komisionit ose nga PLUEPJPS-ja, shumica e kualifikuar përcaktohet të paktën 72% e anëtarëve të Këshillit që përfaqësojnë Shtetet Anëtare pjesëmarrëse, që përbëjnë të paktën 65% të popullsisë së këtyre Shteteve.

5) Nëse një Shtet i cili ka dalë nga Unioni kërkon rianëtarësim, kërkesa e tij i nënshtrohet procedurës së parashikuar në Nenin 49¹⁵ (European Union Law, 2012).

Nga pikëpamja juridike, Neni 50 është ndeshur me një sërë kritikash për morinë e mangësive dhe shihej si një mjet i shkurtër, i cili nuk ishte i përgjithshëm në formulimet e tij, si dhe ofronte mundësi për interpretim fleksibël dhe vendosjen e praktikës kushtetuese. Abstraktësia e këtij neni e komplikon procesin e tërheqjes dhe krijon një shkallë serioze të pasigurisë, aq sa mund të kuptohet si një dispozitë kushtetuese arketipike. Mirëpo, duket se Neni 50 do të marrë cilësi të re juridike pasi të përdoret në procesin e tërheqjes së MB-së nga UE-ja (Troitiño et al., 2018, p. 202).

II.2.2 Referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në UE

II.2.2.1 Organizimi i referendumit

Më 23 janar 2013, Kryeministri i Britanisë David Cameron, në një fjalim të tij në Bloomberg kishte diskutuar për të ardhmen e UE-së dhe për sfidat e shumta brenda dhe jashtë kontinentit evropian. Ai kishte theksuar problemet në Eurozonë, krizën e konkurrencës evropiane, si dhe rritjen e hendekut ndërmjet UE-së dhe qytetarëve të saj që rezultonte nga mungesa e përgjegjësisë dhe pëlqimit demokratik. Gjithashtu Cameron kishte deklaruar haptazi se e favorizonte idenë e organizimit të një referendumi në të ardhmen, nëpërmes së cilit populli britanik do të vendoste për vazhdimin apo përfundimin e anëtarësisë së vendit të tij në UE. Në qoftë se Partia Konservatore do t'i fitonte zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2015 dhe nëse ai sërish do të ishte në krye të qeverisë britanike, Cameron kishte premtuar se do t'i rinegocionte marrëdhëniet e MB-së me UE-në dhe pastaj do të organizonte një referendum, më së largu deri në fund të vitit 2017, me ç'rast do t'i ofronte popullit "zgjedhjen e thjeshtë" mes qëndrimit apo largimit të Britanisë nga UE-ja (United Kingdom Government, 2013).

¹⁵ Neni 49 thekson: Çdo shtet evropian që respekton vlerat evropiane dhe është i angazhuar për promovimin e tyre, mund të aplikojë për anëtarësim në UE. Për këtë kërkesë njoftohet PE-ja dhe parlamentet kombëtare. Shteti aplikant ia adreson kërkesën Këshillit që vepron unanimisht, pasi të konsultohet me Komisionin dhe pasi të marrë pëlqimin e Parlamentit Evropian, që do të veprojë me shumicën e anëtarëve përbërës. Merren në konsideratë kushtet e përshtatshmërisë të miratuara nga Këshilli Evropian. Kushtet e pranimit dhe rregullimet e Traktateve mbi të cilat është themeluar Unioni Evropian, që kërkon një anëtarësim i tillë, i nënshtrohen marrëveshjes mes Shteteve Anëtare dhe Shtetit kërkues. Kjo marrëveshje do të paraqitet për ratifikim në të gjitha shtetet kontraktuese, në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre.

Meqë Konservatorët triumfuan në zgjedhjet e lartpërmendura, të cilat ishin mbajtur më 7 maj 2015, qeveria e udhëhequr prej tyre prezantoi Projektligjin për Referendumin e Unionit Evropian në Parlamentin britanik më 28 maj 2015, datë kjo që njihet edhe si leximi i parë i tij dhe në këtë fazë nuk kishte pasur debate mbi këtë projektligj. Ky i fundit pati leximin e dytë më 9 qershor 2015, në të cilin deputetët britanikë votuan 544/53 për miratimin e tij (United Kingdom Parliament, 2015).

Në takimin e KE-së më 25 dhe 26 qershor 2015, David Cameron kishte paraqitur planet e tij për mbajtjen e referendumit brenda/jashtë UE-së në MB (European Council, 2015). Ai kishte shpalosur tri objektiva në këtë takim:

- 1) *Sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj krizës së emigracionit;*
- 2) *Nxitjen e përparimit më të shpejtë në Tregun e Vetëm Digjital;*
- 3) *Rinegociimin e marrëdhënieve të vendit të tij me UE-në* (United Kingdom Government, 2015).

Në takimin e KE-së më 15 tetor 2015, liderët e UE-së u informuan për hapat e mëtutjeshëm të referendumit në Britani dhe Cameron duhej t'i parashtronte me shkrim shqetësimet specifike të vendit të tij gjër në fillim të nëntorit (European Council, 2015). Më 19 tetor 2015 në Parlamentin e MB-së ai kishte përcaktuar katër çështjet e paketës së rinegociimit për vazhdimësinë e anëtarësisë së vendit të tij në UE, të cilat ishin:

- 1) *Sovraniteti dhe subsidiariteti;*
- 2) *Konkurreshmëria tregtare;*
- 3) *Mosdiskriminimet në Eurozonë;*
- 4) *Lëvizja e lirë dhe emigracioni* (United Kingdom Government, 2015).

Më 10 nëntor 2015, nëpërmes një letre drejtuar Donald Tusk, Presidentit të atëhershëm të KE-së, Cameron kishte përcaktuar katër fusha në të cilat kërkonte reforma, e që ishin:

- 1) *Qeverisja ekonomike,*
- 2) *Konkurreshmëria,*
- 3) *Sovraniteti dhe*
- 4) *Emigracioni* (European Council, 2015).

Më 7 dhjetor 2015, Donald Tusk iu kishte drejtuar me një letër KE-së me informacione mbi çështjen e referendumit të anëtarësisë së Britanisë dhe për shqetësimet e popullit britanik në lidhje me UE-në. Në takimin e dytë të KE-së më 17 dhe 18 dhjetor 2015

ishite debatuar për planet e referendumit të MB-së dhe kishte pasur pajtueshmëri për të ofruar zgjedhje në katër fushat ku ishin ngritur shqetësime nga britanikët gjer në takimin e muajit shkurt 2016 (European Council, 2015).

Projektligji i Referendumit të UE-së kishte marrë pëlqimin mbretëror më *17 dhjetor 2015*, me ç'fakt tashmë ishte Ligj i Parlamentit (United Kingdom Government, 2015). Ky referendum duhej të bazohej në gjashtë pika:

- 1) Do të mbahej një referendum mbi atë nëse Mbretëria e Bashkuar duhej të mbetej anëtare e Unionit Evropian.
- 2) Sekretari i Shtetit, duke u bazuar dhe respektuar maksimalisht rregullat, duhej ta caktonte ditën në të cilën do të mbahej referendumi.
- 3) Dita e caktuar nën paragrafin (2):
 - a) Nuk duhej të ishte më vonë se 31 dhjetor 2017;
 - b) Nuk duhej të ishte më 5 maj 2016;
 - c) Nuk duhej të ishte më 4 maj 2017.
- 4) Pyetja që duhej të paraqitej në fletëvotim ishte:
“A duhet të qëndrojë Mbretëria e Bashkuar si anëtare e Unionit Evropian apo të largohet nga Unioni Evropian?”
- 5) Përgjigjet alternative lidhur me këtë pyetje që duhej të paraqiteshin në fletëvotim ishin:
 - a) *“Mbetet anëtare e Unionit Evropian” ose*
 - b) *“Largohet nga Unioni Evropian”.*
- 6) Në Uells, fletëvotimi i njëjtë, parashtrimi i pyetjes dhe opsionet për t'u përgjigjur duhej të paraqiteshin në versionin uellsian (United Kingdom Parliament, 2016).

Më *2 shkurt 2016*, Donald Tusk iu ishte drejtuar anëtarëve të KE-së me një letër për propozimin e tij mbi statusin e ri të Britanisë në UE dhe ofrimin e zgjedhjeve në katër shqetësimet e ngritura nga David Cameron. Qeverisja ekonomike kërkonte parime që do të rezultinin me respekt të fuqishëm të të drejtave dhe kompetencave të shteteve jopjesëmarrëse në Eurozonë. Konkurrenca tregtare do të rritej falë angazhimeve maksimale të UE-së në tërësi. Do të pranohej situata e veçantë e MB-së në UE sipas Traktateve të UE-së, e cila nuk ishte e angazhuar për integrim të mëtejshëm politik dhe do të forcohej respektimi i parimit të subsidiaritetit. Po ashtu, emigracioni kërkonte forcim të masave parandaluese që luftojnë çdolloj abuzimi me lëvizjen e lirë (European Council, 2016). Në

takimin e KE-së më 18 dhe 19 shkurt 2016 u theksua se pas këtyre negociatave liderët e UE-së ishin dakorduar për arritjen e marrëveshjes që do ta forconte statusin e veçantë të Britanisë në UE, pa kompromentuar vlerat themelore të UE-së (European Council, 2016).

Më 22 shkurt 2016, David Cameron kishte bërë një deklaratë në Dhomën e Komunave për statusin e ri të MB-së në UE, duke specifikuar të arriturat e lartpërmendura në një dokument të quajtur *“Më e mira e të dy botëve: statusi special i Mbretërisë së Bashkuar në një Union Evropian të reformuar”* (United Kingdom Government, 2016). Ai kishte theksuar se pas negociatave me UE-në, tanimë kishte ardhur koha për ta përmbushur një angazhim jetësor të qeverisë së tij, mbajtjen e referendimit mbi anëtarësinë e Britanisë në UE më 23 qershor 2016. Gjithashtu Cameron duke shpjeguar procesin që do të pasonte në qoftë se rezultati i referendimit të lartpërmendur do të ishte në favor të aktivizimit të Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës, kishte pohuar se tërheqja e vendit nga UE-ja do të rezultonte me një mori procedurash të komplikuar, të cilat do të ishin tejet kërcënuese veçanërisht për të ardhmen e ekonomisë dhe sigurisë kombëtare britanike (United Kingdom Government, 2016).

Figura 2.1

Fletëvotimi i Referendimit mbi Anëtarësinë e MB-së në UE

Referendum on the United Kingdom's membership of the European Union	
Vote only once by putting a cross <input checked="" type="checkbox"/> in the box next to your choice	
Should the United Kingdom remain a member of the European Union or leave the European Union?	
Remain a member of the European Union	<input type="checkbox"/>
Leave the European Union	<input type="checkbox"/>

(McCann, 2016)

II.2.2.2 Rezultatet e përgjithshme të referendumit

Elektorati britanik me të drejtë vote në referendumin e anëtarësisë së Britanisë në UE kishte përfshirë *46,500,001 persona të regjistruar*, prej të cilëve në votim kishin marrë pjesë *33,577,342 persona*, duke përfaqësuar kështu një pjesëmarrje prej *72,2%*. Me përjashtim të referendumit të pavarësisë së Skocisë,¹⁶ kjo kishte qenë pjesëmarrja më e madhe e britanikëve që nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të MB-së në vitin 1992.¹⁷ Gjithsej *17,410,742 persona* apo *51,9%* e votuesve kishin votuar për ta tërhequr vendin e tyre nga UE-ja, ndërsa *16,141,241 votues* ose *48,1%* kishin votuar për vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE. Për këtë referendum ishin dërguar rreth *8,556,000 vota postare*, të cilat përfaqësonin *18,4%* të totalit të votave. Përndryshe, duhet cekur se kjo kishte qenë përqindja më e lartë e votave me postë që nga lansimi i votimit postar në MB në vitin 2001. Ndërkaq, *26,3 milionë vota* ishin hedhur në qendrat e votimeve, prej të cilave *25,359 fletëvotime ishin të pavlefshme* (The Electoral Commission, 2019).

Bazuar në një hulumtim të realizuar nga Komisioni Elektorale Britanik rezultonte se *77%* e votuesve kishin pasur qëndrime pozitive për realizimin e referendumit, *87%* kishin qenë të kënaqur me procesin e regjistrimit për të votuar, si dhe *85%* kishin pohuar se me lehtësi kanë pasur qasje në informacione sa i përket mënyrës së votimit. Po ashtu, hulumtimi tregon se njerëzit kishin mbetur shumë të kënaqur me procedurat e votimit në referendum, qoftë në vendvotime (*97%*) apo me postë (*99%*). Shumica e tyre mendonin se kishin poseduar të dhëna të mjaftueshme për të marrë një vendim të duhur mbi mënyrën se si do të duhej të votonin në referendum, ku *62%* kishin qenë dakord, krahasuar me *28%* që nuk ishin pajtuar (The Electoral Commission, 2019).

Duke u bazuar në të dhënat e Zyrës së Statistikave Kombëtare në MB, moshë mesatare në Britani për vitin 2016 ishte 40 vjeç (Office for National Statistics of the UK, 2016). Karakteristikë e veçantë e këtij referendumi ka qenë mënyra se si kishin votuar britanikët që iu përkisnin moshave të ndryshme, ku kishte pasur dallime shumë të mëdha, të cilat duhet cekur gjithsesi.

¹⁶ Referendumi i Pavarësisë së Skocisë që ishte mbajtur më 18 shtator 2014, si dhe karakterizohej nga elektorati që kishte përfshirë gjithsej 4,283,392 skocezë, gjersa në votim kishin marrë pjesë 3,899,455 persona ose 84,59%.

¹⁷ Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare britanike të mbajtura më 9 prill 1992 ishin karakterizuar nga përbërja e elektoratit prej 43,275,316 britanikësh, ndërsa në procesin e votimit kishin marrë pjesë 33,614,074 persona apo 77,67%.

Tabela 2.1*Votimi i referendumit të Brexit-it sipas moshave të ndryshme*

Mosha	Tërheqje nga UE-ja	Qëndrim në UE
18-24	27%	73%
25-34	38%	62%
35-44	48%	52%
45-54	56%	44%
55-64	57%	43%
65+	60%	40%

(BBC News, 2016).

Tabela e lartcekur tregon haptazi se tërheqja e Britanisë nga anëtarësia e UE-së është kundërshtuar nga personat e moshave prej 18 gjer në 44, të cilët priren të jenë shumë të informuar rreth funksionimit të institucioneve të UE-së dhe benefitet që merrte MB-ja nga UE-ja i kanë vënë para opsionit të daljes. Por, britanikët e moshave 45 vjeç e më tej, brenda së cilëve përfshihen personat e papunësuar ose që janë të pensionuar, kanë pasur pakënaqësi dhe kundërshtime të thella lidhur me një sërë politikash të UE-së që prej filleve të anëtarësimit të Britanisë në KEE, si dhe emigracionin e kanë konsideruar tejmasë të rrezikshëm për sigurinë e vendit, e veçmas për mirëqenien dhe të ardhmen e pasardhësve të tyre.

II.2.2.2.1* *Votimi i referendumit në Angli

Vendi ku më së shumti ishte votuar tërheqja e MB-së nga UE-ja ishte Anglia. Elektorati me të drejtë vote kishte përfshirë *38,981,562 anglezë*, ndërkaq në procesin e votimit kishin marrë pjesë *28,456,540 persona* apo *73%*. Gjithsej *15,188,406 votues* ose ***53,4%*** kishin votuar për Brexit, kurse *13,266,996 persona* apo ***46,6%*** kishin votuar për vazhdimin e anëtarësisë së vendit të tyre në UE. Nga totali i votave në Angli, *22,184 fletëvotime* kishin qenë të pavlefshme (BBC News, n.d.).

Mirëpo, duhet theksuar se në kryeqytetin e Anglisë dhe të Britanisë, në Londër, ishte votuar më tepër opsioni për të qëndruar në UE, për dallim prej tetë regjioneve të tjera angleze ku në të gjitha prej tyre ishte votuar për Brexit. Të drejtën e votës e kishin *5,424,768*

londinezë, ndërsa në procesin e votimit kishin marrë pjesë 3,781,234 persona ose 69,7%. Kishin qenë 2,263,519 votues apo 59,9% që votat e tyre i kishin hedhur në favor të të qenurit pjesë e UE-së, gjersa 1,513,232 persona ose 40,1% kishin votuar në favor të Brexit-it. Gjithashtu Londra kishte pasur edhe numrin më të madh të fletëvotimeve të pavlefshme në krahasim me regjionet e tjera angleze, e që ky numër kishte qenë 4,453 (The Electoral Commission, 2019).

Ndërkaq, menjëherë pas Londrës sa iu përket fletëvotimeve të pavlefshme renditeshin South East me 3,427, North West me 2,682, West Midlands me 2,507, East me 2,329, South West me 2,179, Yorkshire and the Humber me 1,937, East Midlands me 1,981 dhe North East me 689 (The Electoral Commission, 2019).

Tabela 2.2

Votimi i referendumit të Brexit-it në tetë regjione të Anglisë

Regjionet	Elektorati (votues)	Dalja në votim (%)	Tërheqje nga UE-ja (votues)	Tërheqje nga UE-ja (%)	Qëndrim në UE (votues)	Qëndrim në UE (%)
<i>West Midlands</i>	4,116,572	72	1,755,687	59,3	1,207,175	40,7
<i>East Midlands</i>	3,384,299	74,2	1,475,479	58,8	1,033,036	41,2
<i>North East</i>	1,934,341	69,3	778,103	58	562,595	42
<i>Yorkshire and the Humber</i>	3,877,780	70,7	1,580,937	57,7	1,158,298	42,3
<i>East</i>	4,398,696	75,7	1,880,367	56,5	1,448,616	43,2
<i>North West</i>	5,241,568	70	1,966,925	53,7	1,699,020	46,3
<i>South West</i>	4,138,134	76,7	1,669,711	52,6	1,503,019	47,4
<i>South East</i>	6,465,404	76,8	2,567,965	51,8	2,391,718	48,2

(The Electoral Commission, 2019).

II.2.2.2.2 Votimi i referendumi në Uells

Shteti i dytë britanik që kishte votuar për tërheqjen e MB-së nga anëtarësia e UE-së ishte Uellsi. Të drejtë vote në këtë referendum kishin pasur *2,270,272 uellsianë*, ndërsa në votim kishin marrë pjesë *1,628,054 persona* apo *71,7%*. Gjithsej *854,572 votues* apo **52,5%** kishin votuar për Brexit, ndërsa *772,347 persona* ose **47,5%** kishin votuar kundër Brexit-it. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme të këtij referendumi në Uells ishte *1,135*.

Me përjashtim të qyteteve si Gwynedd, Ceredigion, Vale of Glamorgan dhe Monmouthshire ku ishte votuar për qëndrimin e Britanisë në UE, në të gjitha qytetet e tjera të Uellsit ishte votuar për Brexit. Madje kryeqyteti uellsian Cardiff kishte pasur numrin më të madh të përkrahësve të Brexit-it. Ishin *243,689 persona* me të drejtë vote në këtë qytet, përderisa dalja në votim ishte karakterizuar nga pjesëmarrja e *169,745 votuesve* apo *69,7%*. Në favor të tërheqjes së MB-së nga UE-ja kishin votuar *101,788 persona* ose *60,02%*, kurse kundër Brexit-it kishin votuar *67,816 votues* apo *39,98%*. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme ishte *141* (The Electoral Commission, 2019).

II.2.2.2.3 Votimi i referendumi në Irlandën Veriore

Një prej vendeve ku ishte kundërshtuar tërheqja e Britanisë nga UE-ja kishte qenë Irlanda Veriore. Prej *1,260,955 personave* me të drejtë vote, në votimin e referendumi kishin marrë pjesë *790,149 votues* apo *62,7%*. Gjithsesi duhet përmendur që dalja më e ulët në votimin e këtij referendumi kishte qenë në Irlandën Veriore. Kundër Brexit-it kishin votuar *349,442 persona* ose **44,2%**, ndërsa në favor të vazhdimit të anëtarësisë së MB-së në UE kishin votuar *440,707 votues* apo **55,8%**. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme ishte *374* (The Electoral commission, 2019). Në 11 zona elektorale të Irlandës Veriore ishte votuar për vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE, me përjashtim të North Antrim, Strangford, East Antrim, Lagan Valley, Upper Bann, Belfast East dhe South Antrim, ku ishte votuar pro-Brexit-it (BBC News, 2016).

II.2.2.2.4 Votimi i referendumit në Skoci

Vendi ku më së shumti ishte kundërshtuar Brexit-i kishte qenë Skocia. Elektorati me të drejtë vote kishte përfshirë gjithsej *3,987,112 skocezë*, nga të cilët pjesë e votimit të referendumit ishin *2,681,179 persona* ose *67,2%*. Gjithsej *1,018,322 votues* apo **38%** kishin votuar për përfundimin e anëtarësisë së MB-së në UE, kurse *1,661,191 skocezë* ose **62%** kishin votuar kundër Brexit-it. Fletëvotime të pavlefshme ishin *1,666* sosh. Në të gjitha qytetet skoceze ishte votuar për vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE (The Electoral Commission, 2019).

Ndonëse të gjitha qytetet në Skoci e kishin kundërshtuar Brexit-in, duhet theksuar kundërshtuesit më të ashpër që kishin qenë në kryeqytetin e kësaj të fundit, në Edinburg. Të drejtë votimi për këtë referendum në këtë qytet kishin pasur *346,073 persona*, ndërkaq pjesëmarrës në votim kishin qenë *252,294 votues* apo *73%*. Për vazhdimin e anëtarësisë së MB-së në UE kishin votuar *187,796 persona* ose *74%*, kurse për largimin e vendit nga UE-ja kishin votuar *64,498 votues* apo *26%*. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në këtë qytet kishte qenë *187* (The Electoral Commission, 2019).

II.2.3 Aktivizimi i Nenit 50 nga MB-ja

II.2.3.1 Ligji i Unionit Evropian (Njoftimi i Tërheqjes) 2017

Qeveria e Britanisë do të vendoste aktivizimin e Nenit 50 vetëm në përputhje me “prerogativën mbretërore” mbi punët e jashtme apo në konsultim me kabinetin qeveritar. Kryeministrja britanike Theresa May kishte pohuar se Parlamenti i MB-së do të kishte mundësinë e debatimit mbi çështjen e aktivizimit të këtij neni para se të merrej vendimi, mirëpo vendimi përfundimtar do t’i takonte qeverisë ngase Parlamenti britanik nuk do ta kishte mundësinë e vendimmarrjes së detyrueshme mbi këtë çështje (Institute for Government, 2016).

Rezoluta mbi shqyrtimin parlamentar të tërheqjes së Britanisë nga UE-ja u miratua nga Dhoma e Komunave më 12 tetor 2016. Mirëpo, rasti Miller ndryshoi rrjedhshmërinë e

planeve të Theresa May-it. Gina Miller¹⁸ ishte denonciesja kryesore e një aksioni historik që rrënoi planet e qeverisë britanike për aktivizimin e Nenit 50 dhe hapjen e procesit zyrtar të tërheqjes së MB-së nga UE-ja, pa votim në Parlamentin britanik. Ndonëse paditësja kryesore, ajo nuk ishte e vetme në sfidimin e qeverisë sepse një grup i britanikëve të shqetësuar, i njohur si “The People’s Challenge” (Sfida e Popullit), i cili ishte financuar nëpërmes një kampanje për fondin e grupit, kishte grumbulluar një shumë prej 175,550 £ për të ndihmuar financimin e kësaj çështjeje (Masters, 2016). Kjo e fundit kishte përfunduar në Gjykatën Divizionale dhe në atë Supreme të Britanisë. Miller kishte pohuar se ashtu siç ekzistonte Ligji i Komuniteteve Evropiane 1972 për t’iu bashkuar KEE-së/UE-së, duhej të ekzistonte edhe një ligj për njoftimin e largimit nga UE-ja. Mirëpo, qeveria britanike pohonte se LKE do të pushonte së zbatuari me tërheqjen e MB-së nga UE-ja. Gjykata Divizionale deklaroi se meqë “ministrat nuk mund të kërkojnë autorizime prerogative për të ndërmarrë veprime që do të rezultojnë me ndryshime në të drejtën vendore”, Neni 50 nuk mund të aktivizohej pa autorizim ligjor (UK Constitutional Law Association, 2017). Gjithashtu edhe Gjykata Supreme e Britanisë kishte theksuar që ekzekutivi nuk do të mundë të aktivizonte tërheqjen përmes prerogativës mbretërore dhe se miratimi ligjor ishte një kushtëzim kushtetues sipas precedentit ligjor britanik para se të fillonte procesi i tërheqjes së vendit nga UE-ja (United Kingdom Supreme Court, 2017).

Ligji i Unionit Evropian (Njoftimi i Tërheqjes) 2017 nënkuptonte fuqinë e tërheqjes së MB-së nga UE-ja, detyrë kjo që i përkiste kreut të qeverisë britanike, e që sipas paragrafit të dytë të Nenit 50 theksonte qëllimin e vendit për t’u tërhequr nga UE-ja dhe ky seksion ka efekt pavarësisht çdo dispozite të bërë nga ose në bazë të LKE-së apo ndonjë ligji tjetër (United Kingdom Government, n.d.). Deputetët britanikë nisën debatin mbi planin e prezantuar për Brexit nga Theresa May më 7 dhjetor 2016 (United Kingdom Parliament, 2016). Si projektligj u paraqit në Dhomën e Komunave më 26 janar 2017, ku iu dha leximi i tij i parë. Dy ditë radhazi, më 31 janar dhe 1 shkurt 2017, projektligji në fjalë kaloi leximin e dytë me 498/114 vota, si dhe më 13 mars 2017 kaloi në leximin e tij të tretë dhe u miratua me 494/122 vota. Pasi Dhoma e Komunave dhe Dhoma e Lordëve kishin rënë dakord për tekstin e Projektligjit të Unionit Evropian (Njoftimi për Tërheqje), më 16 mars 2017 ky

¹⁸ Gina Nadira Miller është një biznesmene e shquar guajanezo-britanike, një filantropiste dhe kapitaliste e përgjegjshme, e cila ka bërë kampanja në fushat e investimeve dhe reformës së pensioneve, transparencës politike dhe shqyrtimit, skllavërisë së ditëve moderne, drejtësisë sociale dhe sektorit të bamirësisë.

projektiligj mori pëlqimin mbretëror nga Madhëria e saj, Mbretëresha Elizabeta II dhe u bë ligj (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.3.2 Kërkesa e MB-së për aktivizimin e Nenit 50

Më 29 mars 2017, në Bruksel, Ambasadori i Britanisë në UE Tim Barrow, në emër të Theresa May-it ia kishte dorëzuar një letër Donald Tusk, duke ia konfirmuar UE-së kërkesën e qeverisë së tij për aktivizimin e Nenit 50. Në këtë letër May kishte pohuar se vendimi për tërheqje nga UE-ja nuk nënkuptonte refuzimin e vlerave evropiane apo përpjekjet për ta dëmtuar UE-në, por që shihej si një mundësi e rikthimit të vetëvendosjes kombëtare britanike, si dhe që MB-ja dëshironte që të mbetej partnere dhe aleate e përkushtuar e UE-së. Ajo kishte propozuar disa parime, të cilat do të ndihmonin dhe lehtësonin procesin e negociatave të ardhshme ndërmjet Britanisë dhe UE-së:

- **Procesi në MB:** *Sjellja e legjislacionit nga qeveria britanike që do të shfuqizonte LKE-në, e që iu ofron efekte ligjeve të UE-së në Britani;*
- **Negociatat mes MB-së dhe UE-së:** *Dakordimi për një partneritet të thellë dhe të veçantë, duke u fokusuar në bashkëpunimin ekonomik dhe të sigurisë, në mënyrë që Evropa të mbetet e fortë, me prosperitet dhe e aftë për të udhëhequr. Tërheqja nga UE-ja pa marrëveshje do të dobësonte të dy palët, prandaj duhej bërë shumë punë për t'iu shmangur në çdo formë këtij opsioni;*
- **Parimet e propozuara për diskutime të suksesshme:**
 - I. *Angazhimi me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të respektueshme, në një frymë të bashkëpunimit të sinqertë;*
 - II. *Vendosja e qytetarëve britanikë dhe të UE-së në radhë të parë;*
 - III. *Punë e madhe për të siguruar një marrëveshje gjithëpërfshirëse;*
 - IV. *Përkushtimi maksimal për të minimizuar përçarjet dhe mospajtimet;*
 - V. *Duhej kushtuar vëmendje marrëdhënieve unike të Britanisë me Republikën e Irlandës dhe rëndësisë së procesit të paqes në Irlandën Veriore;*
 - VI. *Fillimi i bisedimeve në fusha të detajuara të politikave sa më shpejt që të ishte e mundur, por duhej prioritetizuar sfidat e mëdha;*
 - VII. *Puna e përbashkët për të mbrojtur vlerat e përbashkëta evropiane (United Kingdom Government, 2017).*

II.2.3.3 Miratimi i UE-së për hapjen e negociatave të Brexit-it

Më 5 prill 2017, PE-ja kishte miratuar Rezolutën për Negociatat me MB-në pas njoftimit të synimit të saj për t'u tërhequr nga UE-ja. Këtu ritheksohej rëndësia e marrëveshjes së tërheqjes dhe çdo marrëveshjeje të mundshme kalimtare që do të hynte në fuqi para zgjedhjeve të PE-së në maj të vitit 2019, si dhe fakti që ato mund të lidheshin vetëm me pëlqimin e PE-së (European Parliament, 2017). Donald Tusk më 29 prill 2017 kishte deklaruar për sigurimin e mbështetjes unanime të 27 shteteve anëtare dhe institucioneve të UE-së për fillimin e negociatave të Brexit-it. Ai kishte cekur se gjersa të largohej nga UE-ja, Britania do të mbetej anëtare e plotë e UE-së, duke iu nënshtruar të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në Traktatet dhe në të drejtën e UE-së. Negociatat e Brexit-it do të mbeteshin të ndara nga bizneset e vazhdueshme të UE-së dhe nuk do të ndërhyjnë në zhvillimin e tyre. Sipas tij, faza e parë e bisedimeve do të duhej të fokusohet në arritjen e marrëveshjes së tërheqjes së MB-së nga UE-ja, kurse faza e dytë mbi marrëdhëniet e ardhshme mes dy palëve, në qoftë se faza e parë do të kishte arritur progres të mjaftueshëm (European Council, 2017). Më 22 maj 2017 gjatë një takimi të KE-së, 27 vendet anëtare të UE-së kishin miratuar vendimin që autorizonte fillimin e negociatave të UE-së me Britaninë, si dhe komisionin dhe direktivat negociuese që do të përcaktonin pozicionin e UE-së në fazën e parë të tyre. Çështjeve të cilave do t'iu kushtohet fokusim maksimal ishin:

- *Tërheqja e rregullt e MB-së nga UE-ja;*
- *Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve të prekur nga Brexit-i;*
- *Zgjidhja e çështjeve financiare, duke u siguruar se UE-ja dhe Britania do të respektojnë detyrimet e tyre;*
- *Kufiri Irlandez - mbështetja e Marrëveshjes të së Premtës të Mirë¹⁹ dhe procesit të paqes në Irlandën Veriore (European Council, 2017).*

Neni 50 karakterizohet nga tri faza, të cilat përfshijnë çështje kontestuese dhe substanciale të procesit. Faza e parë ndërlidhet me shkaqet, faza e dytë ka të bëjë me negocimin dhe faza e tretë hedh në pah rezultatet (Fabbrini, 2017, p. 171). Negociatat e

¹⁹ Marrëveshja e së Premtës së Mirë është një marrëveshje paqësore e nënshkruar më 10 prill 1998, e cila shënoi krijimin një numri të madh institucionesh ndërmjet Republikës së Irlandës dhe Irlandës Veriore, si dhe Republikës së Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Brexit-it i përkasin llojit dypalësh sepse zhvilloheshin ndërmjet dy palëve, negociatorëve britanikë dhe atyre të UE-së, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa praninë, rolin dhe ndërmjetësimin e ndonjë pale tjetër. Meqë Britania dhe UE-ja janë subjekte të së drejtës ndërkombëtare, karakteri i këtyre negociatave është zyrtaro-shtetëror. Ato duhej të zhvilloheshin në përputhje me normat e negocimit shtetëror britanik dhe të UE-së, bazuar në një agjendë të njohur paraprakisht, në vende të caktuara enkas për negociata, me një sërë rregullash dhe procedurash formale. Po ashtu, ato janë publike sepse duhej të ishin të hapura për opinionin publik dhe mediet. Llogaritja e periudhës dyvjeçare të Brexit-it fillonte nga data 29 mars 2017. Në qoftë se do të arrihej një marrëveshje e duhur e tërheqjes dhe për çdo çështje gjatë procesit negociues do të kishte pajtueshmëri mes palëve, dita e Brexit-it do të duhej të shënohej më 29 mars 2019. Mirëpo, kjo periudhë kohore mund të arrihej vetëm nëse nuk do të kishte komplikime, përçarje dhe mospajtime gjatë procesit negociues, ose në të kundërtën nuk përjashtohej mundësia që ky proces të zgjaste përtej afatit të parashikuar, apo edhe të dështonte. Aktivizimi i Nenit 50 përbënte një proces tejmase të vështirë, me implikime shumë serioze si për britanikët, ashtu edhe për UE-në. Meqë kjo ishte kërkesa e parë për aktivizimin e këtij neni, 27 shtetet anëtare dhe institucionet e UE-së duhej ta trajtonin procesin e Brexit-it me kujdes shumë të madh, posaçërisht pikat se ku dhe çfarë lëshimesh lejoheshin dhe mund të bëheshin. Pastaj UE-ja duhej vazhdimisht të gjente mënyra për t'i bindur shtetet e tjera anëtare që të mos e ndiqnin shembullin e MB-së (McGowan, 2018, p. 50).

II.2.4 Negociatat e Brexit-it

II.2.4.1 Palët negociuese të UE-së dhe MB-së

II.2.4.1.1 Negociatorët e UE-së

Michel Barnier është një mjeshtër i kalitur i diplomacisë franceze në UE, i cili pati rolin e Kryenegociatorit të UE-së për negociatat e Brexit-it që nga data 1 tetor 2016 gjer më 15 nëntor 2019, ndërsa që nga data 16 nëntor 2019 ai është Shef i Task Forcës për Marrëdhëniet me MB-në (European Commission, n.d.). Barnier vjen nga tradita Golliste që mbështetej në "Jo" të Charles de Gaulle për qasje të Britanisë në Tregun e Përbashkët të UE-së dhe gjithnjë ka qenë i dyshimtë mbi pikëpamjen botërore anglo-saksone. Që prej vitit

2010 cilësohet si një nga figurat më kryesore të Brukselit dhe si Komisioner i Tregut të Brendshëm kishte vëzhguar Qytetin e Londrës gjatë krizës financiare të vitit 2008. Ky rol i tij kishte shkaktuar shqetësime të mëdha në qarqet biznesore të MB-së, pasi ai kishte nxitur reforma financiare të qytetit, prej së cilave kishin shpërthyer ulërima të zemërimit se si një francez po e dëmtonte një pjesë të rëndësishme të ekonomisë britanike (Watt, 2017). Barnier ishte i bindur se “sekuencimi” i bisedimeve do të ishte thelbësor për progresin e negociatave të Brexit-it dhe gjithnjë kishte pohuar se Britania nuk do të kalonte në negociim të marrëdhënieve tregtare pa pasur dakordime mbi atë se termat ndarëse do të ruanin integritetin e Tregut të Vetëm të UE-së dhe gjersa t’i mbulonte faturat e papaguara. Vazhdimisht theksonte se do të përpiqej të siguronte marrëveshjen më të mirë të mundshme për 27 shtetet anëtare të UE-së, e cila do të ruante integritetin dhe parimet themelore që rregullojnë Tregun e Brendshëm (BBC News, 2018).

Sabine Weyand cilësohet si një nga “figurat më të mira të KoE-së”, sipas Jean-Claude Juncker, e cila ishte zgjedhur si Zëvendësuesja e Kryenegociatorit të UE-së në bisedimet e Brexit-it në shtator të vitit 2016. Ajo njihet si veterane e përfaqësimit të KoE-së dhe interesave të kësaj të fundit, si dhe ka përvojë 23-vjeçare në marrëdhëniet tregtare dhe më shumë se një dekadë në KoE. Weyand ka studiuar në “Cambridge University” në vitet e 80-ta për literaturë dhe linguistikë angleze, me ç’fakt e njeh mirë vendin që kishte vendosur të largohej nga UE-ja. Ajo i ka shërbyer ish-Shefit të Kabinetit të Komisionerit të Tregtisë së UE-së Pascal Lamy prej vitit 1999 gjer më 2004, si dhe më vonë ka ndihmuar udhëheqjen e politikave klimatike të UE-së. Gjithashtu ka monitoruar performancën ekonomike dhe financiare të qeverive kombëtare në Sekretariatit e Përgjithshëm të KoE-së (BBC News, 2018). Në listën e femrave më me ndikim në Bruksel për vitin 2017, faqja e internetit “Politico Europe” e kishte renditur atë në vendin tetë, duke e cilësuar si “zgjdhja e problemeve të KoE-së” (Politico Europe, n.d.). Më 1 qershor 2019 ajo është emëruar Drejtoreshë e Përgjithshme e Tregtisë së UE-së (European Commission, n.d.).

Donald Tusk kishte bërë të pamundurën për të gjetur një marrëveshje që do ta mbante MB-në brenda UE-së. Madje, ai kishte tingëlluar apokaliptik kur paralajmëronte se tërheqja e saj nga UE-ja mund të rezultonte “jo vetëm me shkatërrimin e UE-së, por edhe të civilizimit politik perëndimor në tërësi”. Tusk në vitin 2007 e kishte mposhtur partinë e djathtë në pushtetin e Polonisë që ishte Partia e Sundimit të Ligjit dhe Drejtësisë së Polonisë, pas një fushate të ashpër të kësaj të fundit, si dhe u bë Kryeministër i Polonisë,

detyrë të cilën e mbajti për shtatë vite radhazi dhe ishte kryeministri i parë i rizgjedhur në Poloninë demokratike. Sa ishte në krye të qeverisë polake ai kishte mbështetur politikat e mbështetura në tregtinë e lirë, ndërpreu punët në sektorin shtetëror dhe ndoqi privatizimin, shkurtoi taksat për të rifituar investitorët e huaj dhe u përpoq të bindte polakët jashtë Polonisë që të ktheheshin në vendin e tyre. Në vitin 2014 Donald Tusk u zgjodh President i KE-së dhe në vitin 2017 u rizgjodh për mandatin e dytë prej 2 vitesh e gjysmë, mandat ky i cili përfundoi më 30 nëntor 2019 (European Council, n.d.). Ai posedon respekt të madh nga ana e liderëve evropianë për trajtimin e konfliktit në Ukrainën Lindore, krizës së emigrantëve dhe negociatave për borxhin grek. Mirëpo, sfida e tij më e madhe si President i KE-së ishte t'i mbante udhëheqësit e Evropës të bashkuar gjersa negociohej Brexit-i (BBC News, 2018). Donald Tusk dhe Jean-Claude Juncker kanë qenë figurat kryesore në negociatat e lartcekura, ndonëse ata nuk ishin përfshirë brenda tyre në mënyrë direkte.

Didier Seeuws cilësohet si një diplomat i zellshëm, me sy që kapin detaje tejet të hollësishme, i cili ishte propozuar nga Donald Tusk për të kryesuar Grupin e Punës të KE-së në negociatat e Brexit-it. Përderisa ekipi i KoE-së Barnier-Weyand do të bënte “ngritjet e rënda” mbi detajet teknike të daljes së Britanisë nga UE-ja, ekipi i KE-së do të kishte për detyrë t'i mbante të lumtura 27 qeveritë e shteteve anëtare të UE-së dhe të formonte marrëdhënie strategjike afatgjata me MB-në. Ai posedon respekt të madh për rolin e tij në trajtimin e negociatave të borxhit grek, ku kishte punuar vazhdimisht në tejkalimin e përçarjeve mes krerëve të shteteve anëtare, të cilat pamundësonin arritjen e një marrëveshjeje. Nga viti 2007 gjer më 2010 ai kishte qenë Zëvendësues i Ambasadorit i Belgjikës në UE Jean De Ruyt, i cili për BBC-në kishte thënë se Didier Seeuws ka aftësi të zotërojë çështjet teknike më komplekse dhe të kuptojë menjëherë aksionet politike që duhet ndërmarrë, por në të njëjtën kohë është në gjendje të shpjegojë me fjalë të thjeshta atë që është diskutuar apo vendosur, si dhe është në gjendje të arrijë kompromis të drejtë edhe atëherë kur negociatat vështirësoheshin. Seeuws kishte shërbyer si Zëdhënës i Kryeministrit belg Guy Verhofstadt, njeriut të zgjedhur si Koordinator i Brexit-it për PE-në, ka qenë njeriu i dorës së djathtë i ish-Presidentit të KE-së Herman van Rompuy, si dhe ka punuar në KE si Shef i Transportit, Telekomunikacionit dhe Energjisë (BBC News, 2018).

Anëtarë të tjerë të grupit negociator nga UE-ja ishin:

- **Nina Obermaier** - Këshilltare e Sabine Weyand;

- **Stéphanie Riso** - e angazhuar për strategjinë, koordinimin dhe komunikimin në negociatë;
- **Stefaan De Rynck** - i angazhuar për marrëdhënie me qendrat e mendimit dhe komunikimit;
- **Georg Riekeles** - merrej me çështjet ndërinstitucionale;
- **Eugenia Dumitriu-Segnana** - e angazhuar me çështje ligjore;
- **Martin Selmayr** - Shef i kabinetit të Jean-Claude Juncker;
- **Nicola Pesaresi** - e angazhuar për politikat ndërthelbësore;
- **François Arbault** - i angazhuar për Tregun e Brendshëm dhe politikat sektoriale;
- **Philippe Bertrand** - merrej me çështje që ndërlidheshin me buxhetin, angazhimet e shpenzimeve dhe programet;
- **Antonio Fernandez-Martos** - i angazhuar për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe doganat (Lang & Miller, 2017, p. 12).

II.2.4.1.2 Negociatorët e MB-së

David Davis ishte Sekretar i Shtetit për Daljen nga UE-ja nga 13 korrik 2016 deri më 8 korrik 2018, kur kishte dhënë dorëheqje si rrjedhojë e mosdakordimeve të tij mbi rrjedhshmërinë e bisedimeve të Brexit-it dhe mospajtimeve që kishte me planin e Theresa May-it. Ai ka një karrierë të pasur dhe ka pasur pozita të ndryshme politike si atë të Ministrit të Shkencave në vitet 1993-1994, Ministrit të Zyrës së Jashtme në periudhën 1994-1997 ku ishte përgjegjës për negociatat qeveritare për Evropën, zgjerimin e NATO-s, Traktatin e Moshpërndarjes Bërthamore,²⁰ Traktatin Gjithëpërfshirës të Testit Bërthamor²¹ dhe Konventat e Gjenevës.²² Në vitin 1997 Davis u zgjodh Kryetar i Komitetit të Llogarive

²⁰ Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore është një traktat ndërkombëtar i nënshkruar më 1 korrik 1968 në Moskë, Londër dhe Uashington, i cili kishte hyrë në fuqi më 5 mars 1970, qëllimi i së cilit ishte parandalimi i përhapjes së armëve dhe teknologjisë bërthamore, promovimi i bashkëpunimit në përdorimin paqësor të energjisë bërthamore dhe synimi i arritjes së çarmatimit bërthamor, si dhe çarmatimi i përgjithshëm dhe i plotë.

²¹ Traktati Gjithëpërfshirës i Testit Bërthamor është traktat shumëpalësh që ndalon të gjitha shpërthimet bërthamore për qëllime civile dhe ushtarake në çdo mjedis, i cili ishte nënshkruar më 10 shtator 1996 në New York.

²² Konventat e Gjenevës ishin takime diplomatike ndërkombëtare që rezultuan me një numër marrëveshjesh, veçanërisht me Ligjin Humanitar të Konfliktëve të Armatosura, si dhe një grup ligjesh ndërkombëtare për trajtimin njerëzor të ushtarëve të plagosur apo të kapur, personelit mjekësor dhe civilëve joushtarakë gjatë luftës ose në konflikte të armatosura. Marrëveshjet kanë origjinën nga viti 1864 dhe janë rifuqësuar në vitin 1949 pas LDB-së.

Publike, prej vitit 2001 deri më 2002 ishte Kryetar i PK-së dhe në vitet 2002-2003 ishte Sekretar i Shtetit për Zyrën e Zëvendëskryeministrit, kurse në periudhën 2003-2008 shërbeu si Sekretar i Brendshëm. Në vitin 2010 ai kishte kryesuar Komisionin e të Ardhmes Bankare që merrej me hetimin e shkaqeve të krizës bankare (United Kingdom Government, n.d.).

Oliver Robins mori përsipër detyrën e Sekretarit të Përhershëm në Departamentin e Daljes nga UE-ja,²³ duke i ofruar mbështetje këtij të fundit në negociatat e Brexit-it dhe në krijimin e marrëdhënieve të ardhshme të MB-së dhe UE-së. Ai kishte qenë Sekretari i Dytë i Përhershëm në Zyrën e Brendshme, si dhe kishte pasur përgjegjësi për emigracionin dhe politikën e lëvizjes së lirë, mbikëqyrjen e kufijve, emigracionin dhe sistemin e shtetësisë. Nga janari 2014 deri në shtator 2015 ai ishte Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Civil, ku kishte drejtuar Reformën e Shërbimit Civil, ndërkaq para kësaj kishte qenë Zëvendës Këshilltar i Sigurisë Kombëtare i ish-Kryeministrit David Cameron dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare në Britani (BBC News, 2018).

Philip Rycroft u caktua për detyrën e Sekretarit të Dytë i Përhershëm në DDUE në prill 2017. Nga viti 2012 gjer më 2015 ishte Drejtor i Përgjithshëm në Zyrën e Zëvendëskryeministrit, ndërkaq në qershor 2015 ai u emërua Shef i Grupit të Qeverisjes në MB në Zyrën e Kabinetit, me përgjegjësi për çështjet kushtetuese dhe transferuese, si dhe e mban akoma këtë rol. Ka shërbyer edhe në kabinetin e Zëvendës Presidentit të KoE-së Leon Brittan (United Kingdom Government, 2018).

Sarah Healey ishte Drejtoreshë e Përgjithshme e DDUE-së, e emëruar në vitin 2016. Ka përfunduar studimet deridiplomike për historinë moderne dhe gjuhën angleze në "Oxford University", si dhe studimet pasdiplomike për politikën sociale në "London School of Economics and Political Science". Ajo udhëhoqi përpjekjet ndërqeveritare për të promovuar sa më shumë femrat në role të larta të shërbimit civil përmes marrëveshjeve për ndarjen e vendeve të punës (BBC News, 2018).

Alex Ellis startoi punën si Drejtor i Përgjithshëm i DDUE-së në janar 2017. Karrierën e tij të Shërbimit Civil e ka filluar me të qenurit pjesë e ekipit që mbështeti kalimin në demokraci shumëpartiake në Afrikën e Jugut pas lirimit të Nelson Mandelas. Ai ka qenë Drejtor i Strategjisë në Zyrën e Jashtme, si dhe Shef i Ekipit të UE-së dhe Çështjeve Ekonomike në Ambasadën e Britanisë në Madrid. Ishte anëtar i kabinetit të Presidentit të

²³ Departamenti për Dalje nga Unioni Evropian ishte një departament ministror britanik që funksionoi prej 14 korrikut 2016 deri më 31 janar 2020, i cili ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e negociatave të Brexit-it.

KoE-së José Manuel Barroso në periudhën 2004-2007, me përgjegjësi për energjinë, ndryshimet klimatike, konkurrencën, zhvillimin, tregtinë dhe strategjinë. Ellis ishte Ambasador i MB-së në Portugali gjatë viteve 2007-2010, si dhe pastaj Ambasador në Brazil në periudhën 2013-2016 (United Kingdom Government, 2018).

Mark Bowman është Drejtor i Përgjithshëm në Financat Ndërkombëtare të Thesarit të Madhërisë së saj,²⁴ me përgjegjësi në avancimin e interesave ekonomike dhe financiare të MB-së në arenën ndërkombëtare dhe në UE. Ai është Zëvendës i Financave në Britani në G7 dhe G20, si dhe e përfaqëson vendin e tij në Komitetin Ekonomik dhe Financiar të UE-së. Fillimisht iu bashkua Thesarit në vitin 1995 si një ekonomist dhe pastaj bëri një sërë punësh si Sekretar Kryesor Privat për Kancelarin e Thesarit në vitet 2001-2004, Drejtor i Financave Ndërkombëtare nga viti 2006 deri më 2008, si dhe Drejtor i Buxhetit dhe Taksave në periudhën 2008-2010. Ai e filloi karrierën e tij si një Bashkëpunëtor i Institutit për Zhvillimin e Jashtëm që punonte në Ministrinë e Planifikimit dhe Financave të Mozambikut (United Kingdom Government, 2018).

Simon Case ishte emëruar Drejtor i Përgjithshëm për Partneritetin e Mbretërisë së Bashkuar me UE-në në maj të vitit 2017. Ai kishte mbështetur përgatitjet e negociatave për daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga UE-ja, duke përfshirë këtu edhe krijimin e një partneriteti të thellë me UE-në në të ardhmen. Case ishte bashkuar me Shërbimin Civil në vitin 2006, ndërsaq rolet e tij të mëparshme kanë përfshirë poste me Selinë Qeveritare të Komunikimit, Zyrën e Irlandës Veriore dhe Zyrën e Kabinetit ku ai ishte Drejtor i Përgjithshëm i Grupit të Implementimit. Nga vjeshta e vitit 2012 deri në korrik 2014 ai ka shërbyer si Sekretar Privat, si dhe në periudhën 2016-2017 si Zëvendës Sekretari Kryesor Privat i Kryeministrit (United Kingdom Government, 2018).

Glyn Williams është Drejtor i Përgjithshëm në Zyrën e Brendshme, përgjegjës për politikën në sistemin e kufijve, emigracionit dhe shtetësisë në MB, duke përfshirë këtu zhvillimin e një regjimi të emigracionit pas Brexit-it. Ai ka punuar në politikën e emigracionit që nga viti 2010, kryesisht për reformat në rrugët e emigracionit legal edhe për shtetasit e

²⁴ Thesari i Madhërisë së saj (Her Majesty Treasury) është Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Britaninë e Madhe, që mban kontroll mbi shpenzimet publike, drejton politikën ekonomike britanike dhe punon për të arritur një zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm ekonomik. Është i mbështetur në 14 agjencione dhe organe publike.

vendeve jashtë UE-së, politikën në Ligjin e Emigracionit 2014²⁵ dhe Ligjin e Emigracionit 2016,²⁶ si dhe negociatat me UE-në për reformat në lëvizjen e lirë para referendumit të Brexit-it. Williams ka shërbyer edhe në Zyrën e Brendshme si Drejtor i Shërbimeve të Azilit dhe Drejtor i Shërbimeve të Vizave. Ai përfaqëson vendin e tij në Zyrën Evropiane për Mbështetjen e Azilit dhe punoi në një gamë të gjerë postesh, përfshirë këtu promovimin e tregtisë, kompletimin e tregut të vetëm të UE-së, ligjin e ndërmarrjeve, ligjin e punësimit, politikën e energjisë dhe privatizimin e biznesit të produkteve të çelikut “British Steel” (United Kingdom Government, 2018).

Catherine Webb e mori postin e Drejtoreshës së Qasjes së Tregut dhe Buxhetit në DDUE. Ajo në vitin 2000 mori rolin e këshilltares ekonomike dhe të tregtisë në Ambasadën e Britanisë në Pekin, ku punoi për forcimin e marrëdhënieve ekonomike të vendit të saj me Kinën. Catherine më pas u emërua Drejtoreshë e Çështjeve të Brendshme të UE-së në Sekretariatit e Çështjeve Evropiane dhe Globale në Zyrën e Kabinetit (United Kingdom Government, 2018).

Tim Barrow është një diplomat britanik me karrierë tridhjetëvjeçare, i cili në janar 2017 u emërua si Përfaqësues i Përhershëm i MB-së në UE. Ai kishte punuar si Sekretar Privat i Sekretarit të Jashtëm të Britanisë Robert Finlayson Cook, duke e këshilluar atë për UE-në, Rusinë dhe Lindjen e Mesme. Më pas ka qenë Ambasador i MB-së në Ukrainë në vitet 2006-2008, ka punuar si Përfaqësues i Britanisë në Komitetin Politik dhe të Sigurisë së UE-së në vitin 2008 gjer më 2011, si dhe ka qenë Ambasador i MB-së në Rusi në periudhën 2011-2015. Që nga data 1 shkurt 2020 vazhdon punën si Ambasador i Britanisë në UE (United Kingdom Government, 2018).

II.2.4.2 Faza e parë e negociatave

Faza e parë e negociatave të Brexit-it u realizua në periudhën qershor-dhjetor 2017, në Bruksel, në selinë e KoE-së në ndërtesën Berlaymont. Gjatë kësaj faze duhej specifikuar çështjet primare në mënyrë që të parandalohet rreziku i pasigurisë së Brexit-it. Ishin

²⁵ Ligji i Emigracionit 2014 është një ligj i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, i cili mori pëlqimin mbretëror më 14 maj 2014. Ligji parashikon parandalimin e pronarëve privatë për t’iu dhënë shtëpi me qira njerëzve pa status juridik, parandalimin e marrjes së lejeve të drejtimit dhe llogarive bankare emigrantëve të paligjshëm, si dhe hetimin e martesave mashtruese.

²⁶ Ligji i Emigracionit 2016 është Ligji i Emigracionit, Azilit dhe Kombësisë, një ligj i Parlamentit britanik që ka marrë pëlqimin mbretëror më 30 mars 2016. Është pjesa e pestë kryesore e legjislacionit në lidhje me emigracionin dhe azilin në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 1993.

planifikuar pesë raunde negociatash me nga një javë bisedime, kurse hapësira kohore mes tyre do të shfrytëzohej në përpunimin e propozimeve. KE-ja më 19 dhe 20 tetor 2017 do të vlerësonte nëse ishte arritur apo jo “progresi i mjaftueshëm” që pastaj të hapej faza e dytë e negociatave mbi marrëdhëniet e ardhshme të MB-së me UE-në dhe për aranzhimet tranzicionale. Duhet theksuar se fokusi kryesor i bisedimeve të kësaj faze ishte përqendruar në tri çështje urgjente:

- 1) **Të drejtat e qytetarëve të UE-së dhe Britanisë;**
- 2) **Marrëveshjet financiare, përfshirë këtu edhe detyrimet e MB-së gjersa ishte ende anëtare e UE-së** (Carrapico et al., 2019, pp. 19-20);
- 3) **Dilema e shkaktuar nga Kufiri Irlandez.**²⁷

Po ashtu bisedimet e kësaj faze kishin përfshirë edhe **çështjet e tjera të ndarjes**, të cilat ishin:

- **Euroatomi** - Njoftimi i Britanisë për tërheqjen nga UE-ja është edhe njoftim i tërheqjes nga Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike (Euroatom);
- **Mallrat e vendosura në treg para datës së tërheqjes** - Sigurimi i statusit të mallrave që qarkullojnë në UE sipas rregullave të Tregut të Vetëm, pas Brexit-it;
- **Bashkëpunimi në çështjet civile, tregtare, penale dhe administrative** - UE-ja dëshironte të sigurohej që procedurat ligjore pas Brexit-it të vazhdojnë përmbushjen e tyre sipas kritereve dhe procedurave të përdorura, sikur ato filluan;
- **Institucionet, agjencitë dhe organet e UE-së** - Në takimin e KE-së në qershor ishte diskutuar për zhvendosjen e dy agjencive të UE-së të vendosura në Londër, Agjencisë Evropiane të Barnave dhe Autoritetit Bankar Evropian;
- **Marrëveshjet e jashtme të UE-së** - Direktivat negociuese të KoE-së bënë thirrje për një “dialog konstruktiv” mbi një qasje të përbashkët ndaj “partnerëve të vendeve të treta, organizatave ndërkombëtare dhe konventave”;
- **Zonat Bazë Sovrane të MB-së në Qipro**²⁸ - Do të mbeteshin territor sovran i Britanisë pas Brexit-it dhe statusi i tyre nuk pritet të ndryshojë, por shqetësime ishin ngritur për

²⁷ Kufiri Irlandez apo kufiri i Irlandës Veriore dhe Republikës së Irlandës 500 km, është një nga çështjet më të komplikuar të negociatave të Brexit-it sepse me daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga UE-ja duhej të vendosej se cilës do t’i përkiste kufiri, Mbretërisë së Bashkuar jashtë UE-së apo Republikës së Irlandës në UE.

²⁸ Zonat Bazë Sovrane të Mbretërisë së Bashkuar në Qipro, Akrotiri dhe Dhekalia, sipas Traktatit të Themelimit të Republikës së Qipros më 16 gusht 1960 kanë mbetur nën juridiksionin britanik që nga krijimi i Republikës së pavarur të Qipros më 1 tetor 1960. Kur Qipro u anëtarësua në UE më 1 maj 2004, ZBSMBQ-të nuk u bënë pjesë e UE-së, por atyre iu dha një status i veçantë.

statusin e ardhshëm të 15,000 qipriotëve, qytetarë të UE - që jetojnë në ZBSMBQ (Lang & Miller, 2017, pp. 30-37).

II.2.4.2.1 Raundi i parë

Zyrtarisht negociatat e Brexit-it apo raundi i parë i fazës së parë u hap më 19 qershor 2017. Ky raund ishte përqendruar në pajtueshmërinë e kryenegociatorëve, Michel Barnier nga UE-ja dhe David Davis nga MB-ja për kohën, strukturën dhe prioritetet fillestare të bisedimeve. Mirëpo, qysh në fillim të negociatave ishin vënë re ndryshimet në pozicionet e Britanisë dhe UE-së në lidhje me tri çështjet urgjente (United Kingdom Parliament, 2017). Barnier duhej t'i raportonte sistematikisht KE-së, Këshillit dhe organeve përgatitore të tij mbi rrjedhshmërinë e negociatave (European Council, 2017). Ai theksonte se mbrojtja e Marrëveshjes të së Premtës së Mirë dhe mirëmbajtja e Zonës së Përbashkët të Udhëtimit²⁹ ishin çështjet më urgjente për t'u diskutuar (European Commission, 2017). Në takimin e KE-së më 20 qershor ishte diskutuar edhe për procesin e zhvendosjes së agjencive të UE-së që ndodheshin në Londër, AEB-së dhe ABE-së. Presidentët e KE-së dhe KoE-së iu kishin sugjeruar 27 shteteve anëtare të UE-së një procedurë specifike dhe një vendim përfundimtar prej tyre në takimin e KE-së më 20 nëntor 2017 (European Council, 2017). Më 22 qershor ministrat e jashtëm të 27 shteteve kishin votuar dhe miratuar një procedurë për zhvendosjen e agjencive të lartpërmendura, ndërkaq vendet e propozuara ishin Amsterdami për AEB-në dhe Parisi për ABE-në (European Council, 2017).

II.2.4.2.2 Raundi i dytë

Më 17 gjer më 20 korrik 2017 u zhvillua raundi i dytë i negociatave, qëllimi i së cilit ishte identifikimi i ngjashmërive dhe dallimeve mes pozicioneve të të dy palëve. Shumica e bisedimeve ishin zhvilluar mes zyrtarëve të ekipeve negociuese, që kishin qenë të ndara në takimet e koordinatorëve (Sabine Weyand nga UE-ja dhe Olly Robbins nga Britania për çështjen e Irlandës Veriore) dhe grupeve negociuese (në raundin e parë u krijuan grupet negociuese për të drejtat e qytetarëve, marrëveshjet financiare dhe çështjet e tjera të ndarjes) (Lang, 2017, p. 4). Lidhur me të drejtat e qytetarëve, palët ishin pajtuar për

²⁹ Zona e Përbashkët e Udhëtimit është zonë e kufinjve të hapur që përfshin Mbretërinë e Bashkuar, Republikën e Irlandës, Ishullin e Manit dhe Ishujt e Kanalit. ZPU-ja vendosi bashkëpunimin mes autoriteteve përkatëse të emigracionit, duke iu mundësuar qytetarëve britanikë dhe atyre irlandezë të lëvizin lirshëm mes këtyre ishujve.

mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të UE-së dhe familjarëve të tyre në MB, por mospajtime kishin për formën e garantimit të këtyre të drejtave, posaçërisht për të drejtat e familjarëve të ardhshëm dhe eksportimin e përfitimeve të caktuara sociale (United Kingdom Parliament, 2017). Mbi marrëveshjet financiare, David Davis kishte pohuar për zgjedhjen e obligimeve financiare të Britanisë ndaj UE-së si rrjedhojë e Brexit-it, por nuk kishte thënë publikisht se cilat detyrime i njihte qeveria britanike (United Kingdom Parliament, 2017). E vetmja pikë publike e bërë në progresin e çështjes së Irlandës Veriore ishte përkushtimi i dy palëve për të ruajtur ZPU-në dhe MPM-në, megjithëse asnjëra nuk kishte botuar dokumente mbi pozicionet e tyre në këtë çështje (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.4.2.3 Raundi i tretë

Prej 28 deri më 31 gusht 2017 ishte zhvilluar raundi i tretë i bisedimeve, në të cilin palët negociuese ishin fokusuar maksimalisht në të drejtat e qytetarëve, marrëveshjet financiare, Kufirin Irlandez dhe çështje të tjera të ndarjes (Lang & Miller, 2017, p. 5). Kishte pasur disa përparime në të drejtat e qytetarëve dhe në aspektet teknike të çështjeve të ndarjes, si dhe në marrëveshjet financiare. UE-ja kishte vazhduar t'i bënte presion qeverisë britanike për një "pozicion të qartë" mbi njohjen e angazhimeve "ligjore dhe morale" të Britanisë për një marrëveshje. Michel Barnier dhe David Davis kishin diskutuar mbi të drejtat e qytetarëve, thënë më saktësisht për pozicionet e tyre përkatëse, në veçanti për çështjet që nuk ishin përfshirë në raundin e kaluar, si kualifikimet profesionale dhe të drejtat ekonomike. Negociatorët vazhduan diskutimet dhe krahasuan analizat ligjore përkatëse të detyrimeve financiare të MB-së ndaj UE-së, por pala britanike nuk e kishte publikuar analizën e saj. Progres ishte arritur edhe në pajtueshmërinë e parimeve të ZPU-së dhe bashkëpunimit Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim të përcaktuara në MPM, megjithëse diskutimi teknik i hollësishëm kishte qenë ende i nevojshëm, veçanërisht për çështjen e lëvizjes së mallrave përtej kufirit. Negociatorët diskutuan gjithashtu për çështje të tjera të ndarjes, si Euratom-i, mallrat e vendosura në treg, procedurat e vazhdueshme të UE-së, si dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.4.2.4 Raundi i katërt

Ky raund u zhvillua nga 25 gjer më 28 shtator 2017. David Davis pohonte se ishin hedhur hapa vendimtarë mbi rrjedhshmërinë e negociatave, por sipas mendimit të përgjithshëm të UE-së nuk ishte arritur progresi i mjaftueshëm për vazhdimin e bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme të Britanisë me UE-në (Miller et al., 2017, p. 4). Qeveria britanike kishte vendosur për t'iu dhënë “efekt të drejtpërdrejtë” të drejtave të qytetarëve të UE-së në marrëveshjen e tërheqjes dhe David Davis kishte pohuar se ky do të përfshihej brenda ligjeve britanike. Michel Barnier e konsideronte këtë si “siguri për qytetarët e UE-së dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre” përpara gjykatave britanike. Mirëpo, zbrazëti kishte në ribashkimin e familjes, eksportin e përfitimeve të sigurimeve sociale, lëvizjen e mëtutjeshme brenda UE-së dhe procedurat administrative. Të dy palët ishin dakorduar që MB-ja pas Brexit-it të zbatonte konceptet e të drejtës së UE-së të përdorura në marrëveshjen e tërheqjes në mënyrë konsistente me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së UE-së, por qeveria britanike nuk pajtohej që GJDUE-ja të kishte rol në sigurimin e saj, duke këmbëngulur në zbatimin e të drejtave të qytetarëve nga gjykatat britanike. Për marrëveshjet financiare kishte pasur bisedime të dobishme në disa aspekte teknike, por Britania kishte shpjeguar se nuk ishte në pozicion ende për të identifikuar angazhimet e marra nga anëtarësimi i saj. Theresa May kishte pranuar se vendi i saj do t'i respektonte angazhimet e bëra gjatë anëtarësisë së saj në UE, por në lidhje me metodën e kalkulimit, shumën e përgjithshme dhe përgjegjësinë për të vazhduar me angazhime të tilla si pensionet e UE-së dhe projektet që kanë nevojë për fonde përtej vitit 2020. Mbi çështjen e Kufirit Irlandez, të dy palët shprehnin gatishmëri për nevojën e të mbajturit ZPU-së, por nuk kishte pasur qartësi se si do ta bënin këtë (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.4.2.5 Raundi i pestë

Ky raund filloi më 9 tetor dhe përfundoi më 12 tetor 2017. Progres ishte arritur në të drejtat e qytetarëve dhe Kufirit Irlandez, por jo në ‘faturën e divorcit’ (Miller et al., 2017, p. 4). Për të drejtat e qytetarëve, UE-ja dhe MB-ja kishin ndarë këto objektiva të përbashkëta:

- *Marrëveshja e tërheqjes të kishte efekt të drejtpërdrejtë e që të ishte thelbësore për të garantuar në mënyrë efektive të drejtat e të gjithë qytetarëve;*

- *Interpretimi i këtyre të drejtave të ishte plotësisht i qëndrueshëm në UE dhe në Britani.*

Lidhur me Irlandën Veriore negociatorët kishin njoftuar për progresin e arritur në pajtueshmërinë e parimeve të përbashkëta për vazhdimin e ZPU-së dhe qartësimin e fushave të bashkëpunimit që funksionojnë në bazën Veri-Jug (United Kingdom Parliament, 2017). Sa iu përket marrëveshjeve financiare pati bisedime teknike, por nuk kishte pasur përparime dhe Michel Barnier kishte ngritur shqetësimet e tij për bllokimin e kësaj çështjeje. Kjo pasoi me mosgatishmërinë e palëve për hapje të bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme të UE-së me MB-në (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.4.2.6 Raundi i gjashtë

27 shtetet anëtare të UE-së kishin rënë dakord që të fillonin përgatitjet e brendshme për fazën e dytë të negociatave të Brexit-it, ndonëse ishte kërkuar akoma më tepër progres për tri çështjet thelbësore të fazës së parë dhe pastaj në samitin e ardhshëm të KE-së që do të mbahej në dhjetor do të vlerësohej nëse ishte arritur “progresi i mjaftueshëm” për secilën nga çështjet e mësipërme (European Council, 2017). Bazuar në pajtueshmërinë e të dy palëve se kishte mungesë relative të progresit në raundet e mëparshme dhe në kushtin e UE-së se duhej arritur patjetër “progresi i mjaftueshëm” në tri çështjet kryesore para fillimit të bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme të UE-së me Britaninë, ishte parë i domosdoshëm zhvillimi i raundit të gjashtë të negociatave, ndonëse i paplanifikuar, i cili ishte mbajtur më 9 dhe 10 nëntor 2017 (Miller et al., 2017, p. 6). Michel Barnier pas këtij raundi kishte konkluduar se duhej bërë akoma më tepër progres në çështjet e fazës së parë. Për të drejtat e qytetarëve palët kishin kërkuar zgjedhje politike në disa pika të pazgjedhura, të tilla si ribashkimi familjar, eksportimi i benefiteve të sigurimit social dhe roli i GJUE-së. Mbi marrëveshjet financiare qeveria britanike nuk kishte sugjeruar një shifër për një marrëveshje financiare. Ndërsa, lidhur me Kufirin Irlandez kishte pasur përpjekje për të gjetur mënyrën më të mirë të ruajtjes së bashkëpunimit Veri-Jug, sfidave rreth kufirit, si dhe shmangies së ndonjë infrastrukture fizike (United Kingdom Parliament, 2017).

II.2.4.2.7 Përfundimi i fazës së parë të negociatave

Për zhvendosjen AEB-së dhe ABE-së nga Londra, ABE-ja kishte marrë 8 oferta nga shtetet anëtare të UE-së, kurse AEB-ja 19 oferta, të cilat ishin paraqitur në KoE për t'u vlerësuar (European Council, 2017). Sipas vendimit përfundimtar më 20 nëntor 2017 AEB-ja do të vendosej në Amsterdam, ndërsa ABE-ja në Paris (European Council, 2017). Raundi i gjashtë i negociatave nuk kishte prodhuar shumë rezultate në çështjet kryesore dhe Michel Barnier i kishte dhënë MB-së dy javë kohë për të ofruar propozime me të cilat UE-ja do të mbetej e kënaqur. Më 24 nëntor 2017, Theresa May së bashku me negociatorët e Britanisë ishin takuar me Donald Tusk. Ky i fundit i kishte theksuar mundësitë e arritjes së progresit të mjaftueshëm në bisedimet e Brexit-it në dhjetor, andaj kishte kërkuar më shumë përparime nga britanikët në të gjitha çështjet (European Council, 2017). Tusk kishte pohuar se ishte i gatshëm t'i paraqiste projekt-udhëzimet e 27 shteteve anëtare të UE-së për negociatat e Brexit-it mbi marrëdhëniet e ardhshme me MB-në, të cilat i kishte bërë publike më 8 dhjetor 2017. Në këtë datë pala britanike dhe ajo e UE-së njoftuan se kishin arritur pajtueshmëri për Raportin e Përbashkët, i cili plotësonte kushtin e arritjes së "progresit të mjaftueshëm" dhe kalimin e negociatave të Brexit-it në fazën e dytë. Mbi të drejtat e qytetarëve ishte arritur "mirëkuptim i përbashkët" në mbrojtjen reciproke të tyre, por qytetarët britanikë dhe të UE-së larg vendeve pritëse mbi pesë vite do t'i humbisnin të drejtat e qëndrimit dhe nuk kishte asnjë garanci për ruajtjen e të gjitha të drejtave për britanikët që lëviznin nga një shtet i UE-së në një tjetër pas Brexit-it. Për marrëveshjet financiare, Britania do t'i ofronte kontributin e saj buxhetit të UE-së deri në vitin 2020 dhe do t'i realizonte disa pagesa që do të bëheshin pas vitit 2020, por nuk do të paguante zhvendosjen e AEB-së dhe ABE-së nga Londra. Në lidhje me Kufirin Irlandez ishin përcaktuar disa objektiva nga raporti, por kishte pak detaje rreth asaj se si mund të arriheshin ato (United Kingdom Parliament, 2017). Më 13 dhjetor PE-ja kishte miratuar rezolutën për hapjen e fazës së dytë të negociatave dhe në takimin e KE-së më 14 dhe 15 dhjetor 2017 ishin rishikuar zhvillimet e fundit në bisedimet e Brexit-it, me ç'rast ishin rivlerësuar përparimet e arritura dhe ishte konfirmuar "progresi i mjaftueshëm" në çështjet kryesore të fazës së parë, si dhe u miratuan udhëzimet për hapjen e fazës së dytë të negociatave (Curtis et al., 2017, p. 5).

II.2.4.3 Faza e dytë e negociatave

Meqë çështjet e tërheqjes ishin diskutuar në fazën e parë të bisedimeve të Brexit-it, për tranzicionin dhe kornizën e marrëdhënieve të ardhshme të UE-së me MB-në ishte diskutuar në fazën e dytë të negociatave. Direktivat negociuese të miratuara nga KE-ja për këtë mbi pozicionin e UE-së në periudhën e tranzicionit theksonin se:

- *Acquis Communautaire e UE-së do të zbatohet në Britani sikur të ishte një shtet anëtar;*
- *MB-ja, si një vend i tretë, nuk do të ishte më pjesë e institucioneve dhe procesit të vendimmarrjes së UE-së.*

Po ashtu, direktivat e lartcekura i siguruan KoE-së një mandat si negociator i UE-së në fillim të bisedimeve me MB-në rreth këtyre çështjeve (European Council, 2018). Më 7 mars 2018, Donald Tusk kishte nxjerrë draft-udhëzuesin për kornizën e marrëdhënieve të UE-së me Britaninë. I bazuar në pozicionin aktual të MB-së, ai kishte cekur që i vetmi model për marrëdhëniet e tyre të ardhshme ekonomike ishte ai për një marrëveshje të tregtisë së lirë. Tusk kishte propozuar që palët të vazhdonin luftën e tyre të përbashkët kundër terrorizmit dhe urgjentisht t'i fillonin bisedimet për shmangien e pengimit të fluturimeve MB-UE, si dhe e kishte ftuar Britaninë të ishte pjesë e programeve hulumtuese dhe arsimore të UE-së.

Raundi i parë i fazës së dytë të negociatave apo raundi i shtatë i bisedimeve të Brexit-it u zhvillua nga 6 deri më 9 shkurt 2018, i cili rezultoi nga një takim joformal i Michel Barnier dhe David Davis në Londër më 5 shkurt. Tri çështjet thelbësore të këtij raundi ishin:

- 1) *Periudha e tranzicionit;*
- 2) *Kufiri Irlandez;*
- 3) *Arritja e Marrëveshjes së Tërheqjes.*

Grupi ad hoc punues për Nenin 50³⁰ ishte mbledhur më 7, 14 dhe 20 shkurt 2018 për t'i diskutuar çështjet e lartcekura. Michel Barnier theksonte se do të fillonin përgatitjet për takimin e KE-së në mars, në të cilin UE-ja pritej të miratonte udhëzime shtesë mbi kornizën e marrëdhënieve të ardhshme të UE-së me MB-në, megjithëse UE-ja kishte ankesa për mosqartësimin e pozicionit të qeverisë britanike për një sërë çështjesh të Brexit-it, përfshirë

³⁰ Partia e Punës ad hoc për Nenin 50 ishte themeluar më 22 maj 2017 dhe roli i saj ishte të sigurohej që negociatat e Brexit-it po realizoheshin në përputhje me udhëzimet e KE-së dhe direktivat e bisedimeve të Këshillit, si dhe të siguronte udhëzime të vazhdueshme për Kryenegociatorin e UE-së Michel Barnier.

këtu llojin e Brexit-it që ajo dëshironte dhe mënyrën se si e parashikonte zgjedhjen e papajtueshmërisë mes dëshirës për të lënë Tregun e Vetëm dhe Unionin Doganor, si dhe të poseduarit e një tregtie pa fërkime dhe pjesëmarrje të plotë në marrëveshjet e shërbimeve financiare (Miller, 2018, pp. 5-6).

II.2.4.3.1 Draft-Marrëveshja e Tërheqjes

Më 28 shkurt 2018 KoE-ja kishte publikuar Draft-Marrëveshjen e Tërheqjes ndërmjet UE-së dhe MB-së, i cili ishte një dokument i përbërë nga 118 faqe dhe e përkthente në terma juridikë Raportin e Përbashkët të dhjetorit 2017. Ky dokument propozonte tekstin në bazë të pozicioneve të UE-së për çështjet e tjera të tërheqjes që përmendeshin në Raportin e Përbashkët, por që ende nuk ishin bërë subjekt i një marrëveshjeje. Ai integron tekstin për periudhën e tranzicionit, bazuar në direktivat plotësuese të negociatave të KoE-së të miratuara nga KE-ja më 29 janar 2018. Dokumenti nuk ishte obligativ as për UE-në e as për Britaninë, por ishte një fillësë e negociatave të mëtutjeshme. Draft-Marrëveshja përbëhej nga gjashtë pjesë dhe një protokoll për Irlandën/Irlandën Veriore. Gjashtë pjesët ishin këto:

- 1) Dispozitat e përbashkëta** - përfshinin përkufizimet dhe referencat e përdorura në Draft-Marrëveshjen e Tërheqjes që mund të kenë nevojë për shpjegim apo interpretim mbi atë si kush janë palët kontraktuese, ose në këtë rast çfarë nënkuptohet nga periudha e “tranzicionit” ose “zbatimit”, “e drejta e UE-së” dhe “shtetet anëtare”;
- 2) Të drejtat e qytetarëve** - ishin disa çështje të pazgjidhura nga Raporti i Përbashkët, prandaj kjo pjesë pasqyrore marrëveshjen e palëve që qytetarët të kenë siguri dhe të drejtat e tyre të jenë të garantuara, pavarësisht rezultatit të negociatave për tërheqje;
- 3) Çështjet e tjera të ndarjes siç janë mallrat e vendosura në treg para datës së tërheqjes** - kishin të bënin me proceset në një larmi fushash që mund të vazhdonin në mbarimin e periudhës së tranzicionit dhe dispozitat e pjesës së tretë përcaktonin se si këto “procese të vazhdueshme” do të zgjidheshin në këndvështrimin e UE-së;
- 4) Tranzicioni dhe hyrja e tij në fuqi** - UE-ja dhe MB-ja ishin dakorduar që të negocionin një periudhë tranzicioni për dy vite, pas datës 29 mars 2019, si dhe pjesa më e madhe e Acquis Communautaire do të vazhdonte të zbatohet në Britani gjer në fund të kësaj

periudhe. Por, kishte mosmarrëveshje për shtrirjen e plotë të zbatimit të së drejtës së UE-së në MB dhe për aspekte të ndryshme të periudhës së tranzicionit;

5) Provizionet financiare - në përgjithësi çdo temë e adresuar në marrëveshjet financiare të arritura në Raportin e Përbashkët ishte përfshirë në Draft-Marrëveshjen e Tërheqjes, si dhe duke konvertuar ato në tekst ligjor, drafti përpiqej të siguronte disa nga detajet dhe logjistikat e marrëveshjeve financiare;

6) Dispozitat institucionale që mbulojnë procedurat gjyqësore dhe administrative - administrimi i marrëveshjes që përcakton rregullimet institucionale specifike për Marrëveshjen e Tërheqjes (Library Subject Specialists, 2018, pp. 12-61).

II.2.4.3.2 Bisedimet mars-qershor 2018

Pas negociatave të zhvilluara nga 13 deri më 19 mars 2018, negociatorët britanikë dhe ata të UE-së prezantuan një version të Draft-Marrëveshjes së Tërheqjes mbi progresin e arritur në bisedime dhe dakordimin e tyre për tekstin ligjor, i cili përfshinte:

- *Të drejtat e qytetarëve;*
- *Marrëveshjet financiare;*
- *Periudhën e tranzicionit;*
- *Çështjet e ndarjes;*
- *Kufirin Irlandez (European Council, 2018).*

Michel Barnier kishte njoftuar KE-në më 20 mars për zhvillimet e fundit në negociatat e Brexit-it, kurse më 23 mars në takimin e KE-së ishin miratuar direktivat mbi kornizën e një marrëdhënieje të ardhshme të UE-së me MB-në pas Brexit-it. Këto udhëzime do të shërbenin për fillimin e diskutimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme mes palëve, me qëllim të arritjes së një mirëkuptimi të përbashkët me Britaninë. UE-ja dëshironte të kishte partneritet më të afërt me MB-në, i cili do ta mbulonte tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik, si dhe sigurinë dhe mbrojtjen, krahas fushave të tjera, por pozicionet britanike “kufizonin thellimin e një partneriteti të tillë të ardhshëm” (European Council, 2018).

Në negociatat e kësaj faze, aktualisht ekzistonin dy çështje në të njëjtën kohë:

1) Bisedimet për Marrëveshjen e Tërheqjes - do të prodhonin një tekst ligjor të detyrueshëm, i cili do të duhej ratifikuar nga Britania e Madhe dhe nga Këshilli i

Ministrave i UE-së, më pas do të bëhej i detyrueshëm për të dy palët sipas së drejtës ndërkombëtare;

- 2) Bisedimet për 'marrëdhëniet e ardhshme'** - do të prodhonin një 'deklaratë politike' jo të detyrueshme, e cila do të përshkruante në terma të gjerë formën e negociatave mbi 'partneritetin e ardhshëm', të cilin MB-ja dhe UE-ja shpresonin ta përmbyllnin pas finalizimit të Brexit-it.

Dy çështjet duhej të plotësoheshin sipas kushteve të caktuara në Nenin 50, megjithëse në terma praktikë vetë Marrëveshja e Tërheqjes ka një rëndësi dukshëm më të madhe dhe duhet të jetë më e detajuar, e përfunduar deri në fund të vitit 2018, që të mund të hyjë në fuqi brenda afatit dyvjeçar siç cekët brenda nenit në fjalë. Nëse Marrëveshja e Tërheqjes nuk do të kishte ratifikim nga palët deri në mars 2019, Britania nuk do të hynte në periudhë 'tranzicioni', por rrezikonte të tërhiqej prej UE-së pa marrëveshje. Në takimin e KE-së më 14 maj 2018 ishte diskutuar për bisedimet e zhvilluara nga data 16 deri më 18 prill, si dhe prej 2 gjer më 4 maj. Michel Barnier kishte këmbëngulur në nevojën e vazhimit të punës për të gjitha çështjet e tërheqjes dhe në dritën e mungesës së progresit të rëndësishëm në raundet e fundit të bisedimeve kishte kujtuar nevojën për të intensifikuar punën, ashtu që UE-ja të kishte gatishmëri për t'u përballur me çdo skenar të mundshëm (European Council, 2018). KoE-ja dhe MB-ja më 19 qershor publikuan një deklaratë të përbashkët mbi progresin e arritur në kushtet e Draft-Marrëveshjes së Tërheqjes dhe më 29 qershor KE-ja kishte rishikuar gjendjen e negociatave të Brexit-it, si dhe kishte miratuar konkluzionet e progresit të arritur. Udhëheqësit e UE-së kishin shprehur shqetësimet e tyre për mosarritjen e përparimeve thelbësore mbi çështjen e Kufirit Irlandez, me ç'rast edhe kishin pranuar domosdoshmërinë e shpejtimit të punës (European Council, 2018).

II.2.4.3.3 Propozimi i Marrëveshjes së Tërheqjes nga UE-ja dhe MB-ja

Më 20 korrik 2018, KE-ja kishte theksuar se negociatorët do t'i shqyrtonin pikat e përbashkëta mes qëndrimeve të UE-së dhe Britanisë lidhur me kornizën e marrëdhënieve të ardhshme. Qëllimi kryesor i këtij shqyrtimi ishte dakordimi për një Deklaratë të Përbashkët Politike që do të shoqëronte Marrëveshjen e Tërheqjes dhe do të përmendej brenda saj (European Council, 2018). Në një takim joformal të krerëve shtetërorë të 27 shteteve anëtare të UE-së, më 19-20 shtator 2018 ishte analizuar progresi i arritur në negociatat e Brexit-it dhe ishte diskutuar për hapat e mëtejshëm, ndër të cilët ishte cekur prej tyre se

nuk do të arrihej Marrëveshja e Tërheqjes pa u zgjedhur në tërësi çështja e Kufirit Irlandez, si dhe pa pasur një deklaratë politike mbi marrëdhëniet e ardhshme të UE-së me MB-në dhe për specifikimin e kohës për negociatat e ardhshme (European Council, 2018). Më 16 tetor 2018, KE-ja ishte informuar nga Michel Barnier për bisedimet më të fundit me Britaninë, përfshirë edhe takimin e tij me Sekretarin e Shtetit në MB Dominic Raab, si dhe kishte pohuar se përkundër përpjekjeve të mëdha negociuese, disa çështje kryesore ende mbeteshin të hapura, në veçanti Kufiri Irlandez (European Council, 2018). Më 14 nëntor 2018, KoE-ja dhe negociatorët britanikë ishin dakorduar për Marrëveshjen e Tërheqjes dhe për një skicë të deklaratës politike mbi marrëdhëniet e ardhshme UE-MB. Ky dokument iu dorëzua Donald Tusk, i cili propozoi që marrëveshjen ta përfundonte dhe zyrtarizonte më 25 nëntor 2018, pasi kjo të ishte analizuar dhe vlerësuar nga ministrat e jashtëm të 27 shteteve anëtare të UE-së. Më 22 nëntor, ai ua kishte dërguar vendeve anëtare draftin e deklaratës politike që përcaktonte kornizën për marrëdhëniet e ardhshme mes UE-së dhe Britanisë, ku kishte pasur dakordim në nivelin e negociatorëve dhe në parim të nivelit politik, duke iu nënshtruar miratimit të liderëve.

Më 25 nëntor, liderët e UE-së miratuan Marrëveshjen e Tërheqjes, siç ishte paraqitur nga negociatorët e UE-së dhe MB-së, si dhe miratuan Deklaratën Politike mbi Marrëdhëniet e Ardhshme të UE-së me Britaninë. PE-ja, KoE-ja dhe KE-ja duhej të ndërmerrnin këta hapa për t'u siguruar që marrëveshja do të hynte në fuqi:

- 1) *KoE-ja të miratonte propozime për nënshkrimin dhe konkluzionin e Marrëveshjes së Tërheqjes;*
- 2) *KE-ja të miratonte vendimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Tërheqjes dhe konkluzionin, si dhe t'ia përcjellte PE-së për pëlqimin e tij;*
- 3) *PE-ja të siguronte pëlqimin e saj nëpërmes shumicës së deputetëve;*
- 4) *KE-ja në emër të UE-së të miratonte vendimin e finalizimit të Marrëveshjes së Tërheqjes dhe për këtë miratim vepronte me shumicë e kualifikuar (të paktën 20 shtete anëtare, të cilat përbënin të paktën 65% të popullsisë së shteteve anëtare të UE-së (European Council, 2018).*

Më 26 nëntor 2018, raporti që analizonte marrëveshjen e propozuar nga MB-ja dhe UE-ja, si dhe deklaratën politike që përcaktonte kornizën për marrëdhëniet e ardhshme mes Britanisë dhe UE-së ishin paraqitur në Parlamentin britanik (United Kingdom Parliament, 2018). Më 5 dhjetor 2018, KoE-ja filloi procedurën për nënshkrimin dhe përfundimin e

Marrëveshjes së Tërheqjes së MB-së nga UE-ja dhe miratoi dy propozimet për vendimet e Këshillit mbi nënshkrimin dhe përfundimin e tekstit. Liderët e UE-së kishin mbajtur një takim të veçantë të KE-së më 13 dhjetor për të diskutuar Brexit-in, ku rikonfirmuan konkluzionet e 25 nëntorit 2018, në të cilat ata nënshkruan Marrëveshjen e Tërheqjes dhe aprovuan Deklaratën Politike. Po ashtu, ishte cekur se përforsimi i çështjes së Kufirit Irlandez ishte bazuar në parandalimin e vështirësive të këtij kufiri dhe sigurimin e integritetit të Tregut të Vetëm (European Council, 2018). Më 11 janar 2019, KE-ja kishte miratuar vendimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Tërheqjes, draft-vendimin mbi përfundimin e kësaj të fundit dhe kishte vendosur t'ia përcjellte PE-së për të marrë pëlqimin e saj (European Council, 2019). Sipas liderëve të UE-së, kjo marrëveshje ishte përpiluar në atë mënyrë që të përfaqësonte një kompromis të drejtë dhe synonte të siguronte një tërheqje të rregullt të MB-së nga UE-ja, duke kufizuar sa më shumë pasojat negative të Brexit-it. Në një letër drejtuar Theresa May-it, Donald Tusk dhe Jean Claude Juncker kishin theksuar se UE-ja dëshironte të ndërtonte marrëdhënie sa më të mira me Britaninë në të ardhmen, prandaj kërkonin sa më shpejt që të jetë e mundur të fillonin negociatat e fazës së tretë. Deklarata Politike përshkruante marrëdhëniet e ardhshme mes UE-së dhe MB-së, të mbështetura krejtësisht në vlerat dhe interesat e përbashkëta të të dy palëve. Kjo deklaratë së bashku me Marrëveshjen e Tërheqjes përfaqësonin ekuilibër të drejtë të interesave dhe përgatitjet për partneritetin e ardhshëm të UE-së me Britaninë, që do të fillonte pas nënshkrimit të marrëveshjes së cekur. KoE-ja do ta krijonte strukturën e negociatave lidhur me marrëdhëniet e ardhshme deri në fund të tranzicionit, si dhe ishte e gatshme të propozonte zbatimin e përkohshëm të pjesëve përkatëse të marrëdhënies së ardhshme, në përputhje me kornizat ligjore në zbatim dhe praktikën ekzistuese, sapo Parlamenti britanik të kishte nënshkruar Marrëveshjen e Tërheqjes dhe PE-ja ta kishte miratuar atë. Nëse palëve iu duhej më shumë kohë për të negociuar marrëveshjen pasuese, ato mund të vendosnin ta zgjatnin periudhën e tranzicionit, siç parashikohej edhe në Marrëveshjen e Tërheqjes. Në atë rast, KoE-ja duhet të jetë e përkushtuar që t'i dyfishojë përpjekjet e saj dhe pret të njëjtat përpjekje nga negociatorët e palës tjetër, me qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të marrëveshjes pasuese (European Council, 2019).

II.2.4.3.4 Mosratifikimi i Marrëveshjes së Tërheqjes nga Parlamenti i MB-së më 29 mars 2019

Pas pesë ditësh debate që nga data 9 janar 2019, Dhoma e Komunave kishte votuar kundër Marrëveshjes së Tërheqjes të arritur nga qeveria britanike dhe UE-ja me 432/202 vota (United Kingdom Parliament, 2019). Më 7 shkurt 2019, në një takim ndërmjet Theresa May dhe Donald Tusk në Bruksel u pohua se si pasojë e “ngërçit të Brexit-it”, bisedimet duhej të vazhdonin. Më 29 janar 2019, Dhoma e Komunave votoi 317/301 në favor të zëvendësimit të shtyllës së Irlandës Veriore me “marrëveshje alternative për të shmangur një kufi të vështirë”, si formë kundërshtuese e idesë së largimit nga UE-ja pa marrëveshje (United Kingdom Parliament, 2019). Mirëpo, më 14 shkurt mocioni i Theresa May-it, me të cilin kjo e fundit synonte të siguronte mbështetjen e vazhdueshme të Dhomës së Komunave për ta forcuar pozicionin e saj në bisedimet me Brukselin, me 303/258 vota u hodh poshtë, me ç’fakt kjo e komplikoi strategjinë e saj mbi Brexit-in dhe e vështirësoi argumentimin e procesit të tërheqjes në UE (United Kingdom Parliament, 2019).

Jean Claude Juncker dhe Theresa May ishin takuar më 11 mars 2019 në Strasburg, ku ishin dakorduar për tekstet e dokumenteve vijuese:

- *Një instrument lidhur me Marrëveshjen e Tërheqjes, duke dhënë sqarime dhe garancione ligjore;*
- *Një deklaratë e përbashkët si plotësim i Deklaratës Politike mbi Kornizën e Marrëdhënieve të Ardhshme.*

Qeveria britanike kishte publikuar gjashtë dokumente për zgjedhjen e fundit të negociuar mbi tërheqjen e Britanisë nga UE-ja:

- 1) *Një Deklaratë e Marrëveshjes Politike;*
- 2) *Deklarata Politike (e pandryshuar);*
- 3) *Marrëveshja e Tërheqjes (e pandryshuar);*
- 4) *Një Instrument Interpretues i Përbashkët për Marrëveshjen e Tërheqjes;*
- 5) *Një Deklaratë e Përbashkët për Deklaratën Politike;*
- 6) *Një Deklaratë e Njëanshme nga MB-ja (Mars & Curtis, 2019, p. 4).*

Më 20 mars, Theresa May i kishte dërguar një letër Donald Tusk, nëpërmes së cilës ajo kishte kërkuar zgjatje të periudhës së caktuar të Nenit 50 deri më 30 qershor 2019. KE-ja kishte miratuar Instrumentin për Marrëveshjen e Tërheqjes dhe Deklaratën e Përbashkët që

plotëson Deklaratën Politike si dakordim mes KoE-së dhe qeverisë britanike në Strasburg më 11 mars (European Council, 2019). Më 22 mars, KE-ja kishte vendosur që nëse Marrëveshja e Tërheqjes miratohej nga Dhoma e Komunave deri më 29 mars 2019, zgjatja e periudhës së Nenit 50 do të ishte gjer më 22 maj, mirëpo, nëse marrëveshja në fjalë nuk miratohej, atëherë zgjatja do të ishte vetëm deri më 12 prill. Vendimi sqaronte se nëse MB-ja mbetej një shtet anëtar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në traktate dhe në të drejtën e UE-së, më 23-26 maj 2019 do të ishte pjesë e mbajtjes së zgjedhjeve të PE-së (European Council, 2019). Më 29 mars 2019, datë kjo e cila do të duhej të njihej si “Brexit Day”, me 344/286 vota në Dhomën e Komunave u hodh poshtë mocioni qeveritar që do ta aprovonte Marrëveshjen e Tërheqjes së negociuar nga Britania me UE-në (European Council, 2019).

II.2.4.3.5 “Brexit Day”

Më 5 prill 2019, Theresa May i kishte dërguar sërish një letër për Donald Tusk, ku kërkonte zgjatje të periudhës së Nenit 50 deri më 30 qershor 2019, si dhe kishte shprehur gatishmërinë e qeverisë britanike që të përgatitej për mbajtjen e zgjedhjeve të PE-së, nëse MB-ja do të vazhdonte të ishte vend anëtar i UE-së në kohën e këtyre zgjedhjeve (European Council, 2019). Më 10 prill, liderët e UE-së kishin rënë dakord që Brexit-i të shtyhej gjer më 31 tetor 2019, vendim ky i marrë bashkërisht me Britaninë. Ata kishin theksuar se MB-ja do të duhej t’i zhvillonte zgjedhjet e PE-së nëse ishte ende anëtare e UE-së ose në të kundërtën do të largohej nga UE-ja më 1 qershor 2019. Gjithashtu rihapje të marrëveshjes nuk do të kishte dhe shtyrja e afatit nuk mund të përdorej për fillimin e bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme (European Council, 2019).

Më 24 maj 2019 Theresa May kishte dhënë dorëheqje nga posti i kreut të qeverisë britanike, si pasojë e presioneve të vazhdueshme të ligjvënësve britanikë kundrejt planeve të saj për Brexit dhe dështimit për t’i realizuar ato. Po ashtu, ajo që nga 7 qershori nuk do të ishte as në krye të PK-së, por do të qëndronte në detyrë gjersa të zgjidhej pasardhësi/ja i/e saj (BBC News, 2019).

Në takimin e KE-së më 20 dhe 21 qershor, liderët e UE-së ishin pajtuar për këto pika:

- *Të punonin së bashku me Kryeministrin e ardhshëm të Britanisë së Madhe;*

- *T'i shmangen një Brexit-i të çrregullt dhe të krijonin marrëdhënie sa më të afërta me Mbretërinë e Bashkuar në të ardhmen;*
- *Gatishmëria për bisedime kur bëhej fjalë për Deklaratën e marrëdhënieve të ardhshme mes Mbretërisë së Bashkuar dhe UE-së, nëse pozicioni i Britanisë së Madhe do të shtjellohej, por marrëveshja e tërheqjes nuk do të ishte e hapur për rinegociim;*
- *Planifikimi i një skenari pa marrëveshje (European Council, 2019).*

Më 17 tetor 2019 KoE-ja i kishte rekomanduar KE-së miratimin e marrëveshjes së arritur në nivelin e negociuesve mbi Marrëveshjen e Tërheqjes, përfshirë një Protokoll të rishikuar për Irlandën/Irlandën Veriore, dhe të aprovonte një Deklaratë Politike të korrigjuar në kornizën e marrëdhënieve të ardhshme mes UE-së dhe MB-së. Po ashtu, KoE-ja i kishte rekomanduar edhe PE-së që ta ofronte pëlqimin e saj mbi këtë marrëveshje. Michel Barnier kishte pohuar se kjo marrëveshje e dëshmonte angazhimin dhe gatishmërinë e palëve për ta bërë më të mirën për qytetarët e UE-së dhe të Britanisë, për mbrojtjen e paqes dhe stabilitetit në ishullin e Irlandës dhe për mbrojtjen e plotë të Tregut të Vetëm të UE-së, ashtu që bizneset dhe qytetarët e kësaj të fundit të kenë sa më shumë siguri. Duhet theksuar ndryshimin kryesor në Deklaratën Politike që ndërlidhej me marrëdhëniet e ardhshme ekonomike mes UE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, ku qeveria britanike kishte propozuar modelin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me zero tarifa dhe kuota mes palëve. KE-ja duhej ta miratonte Marrëveshjen e Tërheqjes të rishikuar, gjithashtu edhe Deklaratën Politike të rishikuar mbi marrëdhëniet e ardhshme. Para se Marrëveshja e Tërheqjes të hynte në fuqi, ajo duhej të ratifikohej nga PE-ja dhe Parlamenti i Britanisë (European Commission, 2019).

Më 23 korrik Boris Johnson u bë lideri i ri i PK-së dhe që nga 24 korriku 2019 është udhëheqës i qeverisë britanike. Më 19 tetor 2019 ai dërgoi një letër për Donald Tusk nëpërmes së cilës kishte kërkuar zgjatje të periudhës së Nenit 50 gjer më 31 janar 2020 (European Council, 2019). Më 21 tetor KE-ja kishte miratuar vendimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Tërheqjes dhe Propozim-Vendimin e adoptuar të Këshillit që do t'i referohej PE-së për pëlqimin e saj (European Council, 2019). Më 29 tetor, KE-ja kishte miratuar vendimin për të zgjatur periudhën sipas paragrafit të tretë të Nenit 50 deri më 31 janar 2020, për të mundësuar më tepër kohë për ratifikimin e Marrëveshjes së Tërheqjes (European Council, 2019).

Më 13 dhjetor 2019, liderët e UE-së kishin diskutuar për Brexit-in dhe përgatitjet e bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme UE-Britani pas tërheqjes së kësaj të fundit. Ata kishin bërë thirrje për një ratifikim në kohë dhe zbatim efektiv të Marrëveshjes së Tërheqjes, si dhe rikonfirmuan qëllimin e tyre për të vendosur marrëdhënie sa më të afërta që ishte e mundur me MB-në. KE-ja i kishte bërë thirrje KoE-së për një mandat gjithëpërfshirës për marrëdhëniet e ardhshme me Britaninë pas largimit të saj. Gjithashtu ishte ftuar edhe Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të miratonte me shpejtësi vendimet e përshtatshme dhe mandatin e negociatave. Riemërimi i Michel Barnier si udhëheqës i negociatave të fazës së tretë ishte mirëpritur nga KoE-ja nga liderët e UE-së (European Council, 2019). Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm më 22 janar 2020 kishte miratuar parimet udhëzuese për transparencë në bisedimet mbi marrëdhëniet e ardhshme, të cilat do të lehtësonin vështrimin publik efektiv gjatë zhvillimit të tyre. Të gjitha dokumentet negociuese të negociatorit të UE-së që do të ndaheshin me shtetet anëtare të UE-së, KE-në, PE-në, parlamentet kombëtare të vendeve anëtare dhe Britaninë, do të ishin të lira për publikun brenda limiteve të përcaktuara nga e drejta e UE-së. Rregullat për transparencë dhe qasje të publikut në dokumente do të zbatoheshin për të gjitha dokumentet në kontekstin e negociatave (European Council, 2019). Projektligji i Unionit Evropian (Marrëveshja e Tërheqjes) pati leximin e parë në Dhomën e Komunave më 19 dhjetor 2019, leximin e dytë më 20 dhjetor dhe leximin e tretë më 9 janar 2020. Ndërkaq, leximin e parë në Dhomën e Lordëve e pati më 9 janar dhe leximin e dytë më 13 janar (United Kingdom Parliament, 2020). Pasi ky propozimligj ishte miratuar nga Dhoma e Komunave dhe Dhoma e Lordëve, ai mori pëlqimin mbretëror nga Madhëria e saj Mbretëresha Elizabeta II, më 23 janar 2020, me ç'rast edhe hyri në fuqi (United Kingdom Parliament, 2020). Presidenti i KE-së Charles Michel dhe Presidentja e KoE-së Ursula von der Leyen nënshkruan Marrëveshjen e Tërheqjes në Bruksel më 24 janar dhe në po të njëjtën datë dokumenti u nënshkrua edhe nga Kryeministri britanik Boris Johnson në Londër (European Council, 2020). Më 29 janar, Marrëveshja e Tërheqjes u miratua nga PE-ja me 621 vota pro, 49 vota kundër dhe 13 abstenime (European Parliament, 2020). Po në të njëjtën datë edhe Ambasadori britanik në UE Tim Barrow ia kishte dorëzuar njoftimin me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit Jeppe Tranholm-Mikkelsen, duke theksuar përfundimin e procedurave të brendshme të Britanisë për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për Tërheqje nga UE-ja (European Council, 2020). Më 30 janar KE-ja kishte miratuar vendimin për përfundimin e Marrëveshjes për Tërheqje në emër

të UE-së. Hyrja e saj në fuqi shënonte fundin e periudhës së Nenit 50 dhe fillimin e periudhës së tranzicionit, i cili se do të duhej të zgjaste deri më 31 dhjetor 2020, e që synonte t'iu siguronte më shumë kohë qytetarëve dhe bizneseve në MB dhe UE për t'u përshtatur me procesin e Brexit-it. Periudha e tranzicionit mund të zgjatej një herë, për një periudhë një ose dyvjeçare, në qoftë se palët do të arrinin dakordim për këtë para datës 1 korrik 2020 (European Council, 2020). Marrëveshja e Tërheqjes ka hyrë në fuqi pas daljes së Britanisë nga anëtarësia e UE-së më 31 janar 2020 në orën 23:00. Që nga kjo datë MB-ja më nuk ishte shtet anëtar i UE-së dhe konsiderohet një vend i tretë.

II.2.4.4 Faza e tretë e negociatave

MB-ja si vend i tretë me UE-në duhej të zhvillonin negociata mbi marrëdhëniet e tyre të ardhshme. Më 3 shkurt 2020 KoE-ja kishte nxjerrë një rekomandim për KE-në për hapjen e bisedimeve mbi partneritetin e ri mes UE-së dhe Britanisë. Rekomandimi në fjalë ishte bazuar në udhëzimet dhe konkluzionet e KE-së, si dhe në Deklaratën Politike për të cilën palët ishin dakorduar në tetor 2019. Ai po ashtu kishte përfshirë një propozim gjithëpërfshirës për direktivat negociuese, duke përcaktuar fushën dhe termat e marrëdhënieve të ardhshme që UE-ja parashikonte t'i kishte me MB-në (European Council, 2020). Më 25 shkurt 2020 KE-ja kishte miratuar vendimin që e autorizonte hapjen e negociatave, duke e emëruar zyrtarisht KoE-në si negociator të UE-së. Si synim parësor i kësaj të fundit në këto bisedime ishte arritja e një partneriteti me Britaninë, duke u mbështetur tërësisht në angazhimet e palëve për të siguruar një fushë të barabartë të konkurrencës së hapur dhe të ndershme, bazuar në afërsinë gjeografike dhe ndërvlerësinë ekonomike. Arritja e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë, me zero tarifa e kuota mbi tregtinë e mallrave, e karakterizuar nga bashkëpunimi në aspekte doganore dhe rregullatore ishte qëllim kryesor i UE-së në këtë fazë negociatash. Gjatë bisedimeve duhej të diskutoheshin fusha të tilla si: peshkimi, tregtia digjitale, prona intelektuale, prokurimi publik, lëvizshmëria, transporti dhe energjia, rreth së cilave palët negociuese duhej të përpiqeshin të siguronin bashkëpunim sa më të suksesshëm në të ardhmen, duke mos lënë anash edhe zbatueshmërinë e ligjeve dhe bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, si dhe politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen (European Council, 2020). Pyetja kryesore lidhur me negociatat e fazës së tretë ishte mbi atë se a do të dakordoheshin Britania dhe UE-ja për një marrëveshje më të thellë tregtare në linjat marrëveshjes së tregtisë së lirë që ka UE-ja me

Kanadanë, ose nëse marrëdhënia do të bazohet në Marrëveshjen e Tërheqjes, përfshirë këtu edhe Protokollin për Irlandën/Irlandën e Veriut. Në secilin rast MB-ja do të largohet nga Tregu i Vetëm dhe Unioni Doganor. Qeverisë britanike i duhet të punonte shumë për të arritur një marrëveshje të ekuilibruar dhe në interes të të dy palëve, duke pasqyruar gamën e gjerë të interesave të përbashkëta. Çdo marrëveshje duhet të respektojë sovranitetin e palëve dhe autonominë e vendeve të tyre ligjore. Britania në të ardhmen do të zhvillojë politika të ndara dhe të pavarura në fusha të tilla si sistemi i emigracionit, politika e konkurrencës dhe subvencioneve, mjedisi, politika sociale, prokurimi dhe mbrojtja e të dhënave. Bashkëpunimi për punët e jashtme dhe çështjet e lidhura me UE-në ka të ngjarë të jetë thelbësor, por në vetvete nuk kërkon një kornizë të përbashkët institucionale (Mars et al., 2020, p. 37). Negociuesit britanikë dhe ata të UE-së kishin tetë muaj kohë për të siguruar progres në tri rrjedha pune:

- 1) Sigurimi për zbatueshmërinë e duhur të Marrëveshjes së Tërheqjes;**
- 2) Përgatitja për pasojat ekonomike negative që do të sjellë fundi i periudhës së tranzicionit;**
- 3) Negocimi i një partneriteti të ardhshëm mes UE-së dhe MB-së me synimin për të kufizuar pasojat negative që mund të pasojnë.**

Negociatat duhet të startonin në javën e parë të marsit 2020, por pikërisht në këtë kohë bota po përballëj me sëmundjen e koronavirusit (Covid-19).³¹ Bazuar në nivelet alarmante të përhapjes dhe ashpërsisë, por edhe në nivelet alarmante të mosveprimit ndaj kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse që depërtoi jashtë kufijve të Kinës duke u përhapur në shumë vende të botës, nga vlerësimet e bëra prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë më 11 mars 2020, Covid-19 u emërua pandemi (World Health Organization, 2020). Kjo e fundit u bë shumë shpejt një çështje globale sepse shkaktoi probleme jashtëzakonisht të mëdha, për zgjidhjen e së cilave bashkëpunimi ndërkombëtar ishte i domosdoshëm. Përhapja e koronavirusit i detyroi shtetet të mbyllin kufijtë tokësorë, detarë dhe ajrorë, mbyllje këto që shkaktuan dëme të shumta ekonomike, të cilat konsiderohen të ngjashme me ato të

³¹ Sëmundja e koronavirusit (Covid-19) është një sëmundje infektive, e cila së pari ishte shfaqur në Wuhan të Kinës në dhjetorin e vitit 2019 dhe shkaktohet nga një koronavirus i quajtur SARS-CoV-2. Kryesisht të moshuarit dhe njerëzit që përballen me sëmundje të rënda, si sëmundja e zemrës ose mushkërive, apo diabeti, janë në rrezik më të lartë për të pasur komplikime më serioze prej sëmundjes Covid-19.

Depresionit të Madh.³² Mirëpo, këto mbyllje ndikuan edhe në punën tradicionale të liderëve dhe diplomatëve botërorë, të cilëve iu imponua adoptimi i platformave të ndryshme digjitale dhe takimet e tyre realizoheshin në forma virtuale. Për shkak të krizës së koronavirusit, raundet negociuese të fazës së tretë të negociatave ishin zhvilluar me video konferencë. Viktimë e hershme e pandemisë Covid-19 kishin qenë negociatat e kësaj faze mes UE-së dhe MB-së. Koronavirusi kishte marrë pothuajse gjithë vëmendjen e qeverisë britanike, gjersa institucionet e UE-së ishin fokusuar maksimalisht në rreziqet serioze që shkaktonte pandemia për ekonominë e bllokut, si dhe në veprimet adekuate për parandalimin e destabilizimit të mundshëm. Shanset për të arritur një marrëveshje në afat dhe për t'i përmbyllur tërësisht bisedimet mes Britanisë dhe UE-së po hasnin në probleme gjithnjë e më shumë (The Economist, 2020). Përpjekjet e palëve për të gjetur kompromis do të vazhdonin, por me përjashtim të shteteve të tjera anëtare të UE-së që mendonin se arritja e një marrëveshjeje në fund të vitit 2020 ishte jetike, si për MB-në ashtu edhe për UE-në. Franca nëpërmes Presidentit Emmanuel Macron kishte pohuar që opion më i favorshëm për bisedimet e kësaj faze ishte që ato të rifillonin në vitin 2021 sesa që të arrihej një marrëveshje e nxituar, prej së cilës do të pësonin bizneset evropiane në dekadat e ardhshme (BBC News, 2020).

Mospajtueshmëria kryesore ndërmjet palëve qëndron në faktin se Britania kërkonte qasje në Tregun e Vetëm pa kufizime të standardeve sociale, mjedisore dhe shëndetësore të britanikëve, gjë e cila po kundërshtohej nga UE-ja. Britanikët theksonin që këto kufizime ishin të padrejta për ta ngase nuk ekzistonin për vendet e tjera të treta, ku si shembull prej tyre merrej Kanadaja. Mirëpo, për UE-në në të ardhmen MB-ja do të ishte partneri kryesor tregtar jo UE, me të cilën do të zhvillonte dhjetë herë më shumë tregti se me vende e tjera, përfshirë këtu edhe Kanadanë, prandaj ishte më se normale kërkesa e UE-së për më tepër garancione. Kërkesat e UE-së për t'u siguruar mbi të ardhmen e bizneseve evropiane në Britani, posaçërisht për standardet mjedisore, sociale dhe ato të punës kanë penguar rrjedhshmërinë e duhur të negociatave (Boffley et al., 2020). Të drejtat e peshkimit ishin një çështje ku MB-ja dhe Franca si një prej vendeve anëtare më të fuqishme të UE-së kishin

³² Depresioni i Madh ishte një depresion i rëndë ekonomik në të gjithë botën që ndodhi gjatë viteve 30-ta të shekullit XX, duke filluar në ShBA pas një rënieje të madhe të çmimeve të aksioneve nga 4 shtator 1929, me ç'rast ishte bërë një lajm në tërë botën me rrëzimin e tregut të aksioneve të 29 tetorit 1929, që njihet ndryshe edhe si "e Marta e Zezë". Ky ishte depresioni më i gjatë, më i thellë dhe më i përhapur i shekullit XX. Mes viteve 1929 dhe 1932, GDP-ja botërore kishte rënë 15%. Në shumë vende efektet negative të Depresionit të Madh kishin zgjatur deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore.

shumë mospajtime. Sekretari i Shtetit për Çështje Evropiane në Francë Clément Beaune kishte pohuar më 4 dhjetor që nëse marrëveshja finale e fazës së tretë të bisedimeve ndërmjet Britanisë dhe UE-së nuk do t'i përshtatej shtetit francez, atëherë Franca do të përdorte "veton" e saj (France24, 2020). Nëse kjo fazë bisedimesh do të përmbylej pa marrëveshje të tregtisë së lirë mes palëve, atëherë UE-ja dhe Britania do të ballafaqoheshin me kontrolle kufitare dhe taksa për qarkullimin e mallrave mes tyre, dhe kjo nuk do të ishte në favor të asnjërës, posaçërisht MB-së, ekonomia e së cilës ka pësuar goditje të shumta nga Brexit-i. Por, me sa duket disa lëshime nga ana e UE-së në këto bisedime me qëllim të finalizimit të tyre me marrëveshje më 31 dhjetor kishin nxitur disa shqetësime serioze tek francezët.

II.2.4.4.1 Raundet e bisedimeve mars-dhjetor

Raundi i parë i bisedimeve mbi marrëdhëniet e ardhshme të MB-së me UE-në ishte hapur më 2 mars 2020. Këtu palët ishin dakorduar që raundet e plota të negociatave të zhvilloheshin çdo dy apo tri javë, si dhe ato do të alternoheshin mes Brukselit dhe Londrës. Më 15 prill 2020 Kryenegociatori i UE-së Michael Barnier dhe ai i Britanisë David Frost, kishin vlerësuar punën teknike të kryer në raundin e parë në bazë të teksteve ligjore të shkëmbyera nga të dy palët. Ata ishin pajtuar mbi nevojën për të organizuar raunde të mëtejshme negociuese, të cilat për shkak të pandemisë Covid-19 do të zhvilloheshin me video konferencë në datat vijuese: 20 prill, 11 maj dhe 1 qershor. Në raundin e dytë më 20 - 24 prill 2020 pala britanike kishte bërë të ditur që refuzonte çdo zgjatje të periudhës së tranzicionit. Në raundin e tretë më 11 - 15 maj, si dhe në atë të katërt më 1 - 5 qershor palët kishin shfaqur mospajtimet e tyre, të cilat kishin pamundësuar përparimin e bisedimeve në fushën e peshkimit, në lojën e ndershme ekonomike dhe tregtare, në arritjen e marrëdhënieve të ardhshme ndërmjet Britanisë dhe UE-së, si dhe në bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështje gjyqësore (European Council, 2020).

Më 12 qershor UE-ja dhe MB-ja kishin rënë dakord që të intensifikojnë negociatat me synimin e arritjes së një marrëveshjeje para përfundimit të vitit 2020. Raundet negociuese do të zhvilloheshin në korrik, në gusht dhe në shtator. Kryenegociatorët nga të dy palët dhe ekipet e tyre do të takoheshin sipas nevojës në një format më të kufizuar për të siguruar progres në negociata (European Council, 2020). Më 15 qershor 2020 ishte zhvilluar një takim i nivelit të lartë nëpërmes video-konferencës ndërmjet Presidentit të KE-së Charles

Michel, Presidentes së KoE-së Ursula von der Leyen, Presidentit të PE-së David Sassoli dhe Kryenegociatorit të KoE-së Michel Barnier me Kryeministrin e Britanisë Boris Johnson. Palët kishin vënë në pah vendimin e MB-së për të mos kërkuar ndonjë zgjatje të periudhës së tranzicionit, e cila do të përfundonte më 31 dhjetor 2020, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Tërheqjes. Udhëheqësit e UE-së dhe Britanisë kishin mirëpritur diskutimet konstruktive mbi marrëdhëniet e ardhshme MB-UE, të cilat iu kishin mundësuar të dy palëve që t'i qartësonin pozicionet e tyre dhe t'i kuptonin më mirë pozitat e njëra-tjetrës. Ata kishin vënë në dukje faktin se katër raunde bisedimesh kishin përfunduar, pavarësisht sfidave të paraqitura nga pandemia e Covid-19 (European Council, 2020).

Më 25 qershor 2020 KE-ja kishte miratuar këto konkluzione të arritura gjatë bisedimeve me marrëdhëniet UE-Britani:

- 1) *Mori shënim për vendimin e qeverisë britanike dhe qëllimin e saj për të mos kërkuar zgjatje të periudhës së tranzicionit të parashikuar në Marrëveshjen e Tërheqjes. Kjo do të thotë që periudha e tranzicionit do të përfundojë më 31 dhjetor 2020;*
- 2) *Ritheksoi vendosmërinë e UE-së për të pasur një partneritet sa më të afërt me Britaninë në të ardhmen, në përputhje me Deklaratën Politike që përcakton parametrat kryesorë të partneriteti i parashikuar mes UE-së dhe MB-së;*
- 3) *Rikonfirmoi mbështetjen e tij të plotë për negociatorin e UE-së dhe përsëriti gatishmërinë e tij për të arritur një marrëveshje ambicioze në përputhje me direktivat negociuese të 25 shkurtit 2020, duke respektuar udhëzimet e KE-së të dakorduara më parë, si dhe qëndrimet dhe deklaratat, veçanërisht ato të 25 nëntorit 2018;*
- 4) *Shënoi progresin e kufizuar të arritur në negociatave deri më tani;*
- 5) *Mirëpriti planet mbi të cilat kishin rënë dakord kryenegociatorët për të intensifikuar procesin e negociatave dhe për të krijuar kushtet më të favorshme për arritjen e një marrëveshjeje para fundit të vitit 2020;*
- 6) *Rikujtoi që KE-ja do të informohej plotësisht për çdo zhvillim të negociatave, të cilat do të realizoheshin nga KoE-ja në koordinim të vazhdueshëm dhe dialog të përhershëm me KE-në, si dhe duke ndjekur udhëzimet e tij;*
- 7) *Do të vazhdonte të ndjekë nga afër zbatimin efektiv të Marrëveshjes së Tërheqjes, veçanërisht pjesën mbi të drejtat e qytetarëve, dhe tri protokollet e saj. Në lidhje me Protokollin mbi Irlandën/Irlandën e Veriut, priste që Britania të paraqitej me hapa kuptimplotë dhe konkretë në këtë drejtim;*

8) *Bënte thirrje tek shtetet anëtare, institucionet e UE-së dhe tek të gjithë aktorët e interesuar të rrisin punën e tyre mbi përgatitjet dhe gatishmërinë në të gjitha nivelet dhe për të gjitha rezultatet, duke përfshirë edhe atë të mosarritjes së marrëveshjes (European Council, 2020).*

Më 27 qershor 2020 kryenegociatorët ishin takuar në format të kufizuar për të siguruar progresin e arritur në negociata para fillimit të raundit të pestë të bisedimeve në 20 korrik. Më pas, KoE-ja kishte miratuar më 9 korrik një komunikatë për të ndihmuar autoritetet kombëtare, bizneset dhe qytetarët që të përgatiteshin për ndryshimet që do të pasonin në fund të periudhës së tranzicionit. Këto ndryshime do të ndodhnin në shkëmbimet ndërkufitare mes UE-së dhe MB-së që nga 1 janari 2021, pavarësisht nëse do të arrihej një marrëveshje për një partneritet të ardhshëm ose jo. Bisedimet e raundit të gjashtë më 21 - 23 gusht dhe raundit të shtatë më 18 - 21 gusht ishin zhvilluar në Bruksel, si dhe ato të raundit të tetë më 8 - 10 shtator në Londër. Michel Barnier kishte theksuar përkushtimin maksimal të UE-së për t'i rritur shanset drejt arritjes së një marrëveshjeje me Britaninë, duke treguar fleksibilitet edhe në vijat e kuqe të MB-së dhe duke respektuar plotësisht sovranitetin e kësaj të fundit, por duke mos mohuar edhe mospajtimet në bisedime që kanë qenë prezente pothuajse në çdo raund. Vijat e kuqe të Britanisë ishin këto:

- 1) *Asnjë rol ndikues i GJUE-së në MB;*
- 2) *E drejta për të përcaktuar ligjet e ardhshme britanike pa kufizime;*
- 3) *Një marrëveshje për peshkimin që tregon se Brexit-i bën një ndryshim real krahasuar me situatën ekzistuese.*

Më 22 shtator 2020 Barnier kishte informuar KE-në për gjendjen e negociatave të UE-së me Britaninë, zbatimin e Marrëveshjes së Tërheqjes dhe përpjekjet e gatishmërisë së UE-së në funksion të përfundimit të periudhës së tranzicionit më 31 dhjetor 2020 (European Council, 2020). Raundi i nëntë i negociatave ishte zhvilluar më 29 shtator dhe 2 tetor 2020, gjersa më 1 tetor KoE-ja i kishte dërguar një letër të një njoftimi zyrtar MB-së për shkeljen e detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Tërheqjes. Kjo shënonte fillimin e një procesi zyrtar të shkeljes kundër Britanisë, e cila kishte një muaj kohë për t'iu përgjigjur kësaj letre. Me Projektligjin e Tregut të Brendshëm të MB-së, qeveria britanike kishte shkelur Nenin 5 të Marrëveshjes së Tërheqjes. Sipas *Nenit 5 të Marrëveshjes së Tërheqjes: Unioni dhe MB-ja, me respekt të plotë të ndërsjellë dhe me mirëbesim, do të ndihmojnë njëri-tjetrin në kryerjen*

e detyrave që burojnë nga kjo Marrëveshje. Ata do të marrin të gjitha masat e duhura, qofshin ato të përgjithshme apo të veçanta, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe do të përmbahen nga çdo masë që mund të rrezikojë arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje. Ky nen nuk paragjykon zbatimin e të drejtës së Unionit në përputhje me këtë Marrëveshje, veçanërisht parimin e bashkëpunimit të sinqertë (European Union Law, 2020). Marrëveshja e Tërheqjes parashikon që gjatë periudhës së tranzicionit GjDUE-ja të ketë juridiksion dhe KoE-ja të posedojë kompetencat e dhëna asaj nga e drejta e UE-së lidhur me Britaninë, gjithashtu edhe në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e marrëveshjes në fjalë (European Commission, 2020). Më 13 tetor 2020 Michel Barnier kishte njoftuar ministrat e jashtëm të 27 vendeve anëtare për gjendjen e negociatave ndërmjet UE-së dhe MB-së. Ministrat kishin riafirmuar mbështetjen e tyre për kryenegociatorin dhe mandatin e tij, kishin shprehur besimin se përkundër mospajtimeve ende mund të arrihej progres në bisedime, por edhe kishin theksuar nevojën që bizneset dhe vendet të kishin gatishmëri për çdo skenar (European Council, 2020). Më 15 dhe 16 tetor 2020, KE-ja kishte ndarë shqetësimet e saj për atë se nuk ishte arritur përparueshmëria e mjaftueshme në çështjet kryesore të UE-së, ndonëse periudha e tranzicionit duhet të përfundonte më 31 dhjetor 2020. Udhëheqësit e UE-së i bënë thirrje Britanisë që të bënte lëvizjet e nevojshme për ta bërë të mundur arritjen e një marrëveshjeje të kënaqshme për të dy palët (European Council, 2020). Bisedimet mes kryenegociatorëve Barnier dhe Frost ishin pauzuar për shkak se ata nuk kishin qenë në gjendje të tejkalonin boshllëqet mes palëve në lidhje me rregullat për të siguruar konkurrencë të ndershme, qasjen e peshkimit në ujërat e MB-së dhe një sistem për zgjidhjen e mospajtimeve. Më 4 dhjetor 2020 ata kishin konkluduar se kushtet për një marrëveshje mes palëve nuk ishin përmbushur (BBC News, 2020). Mirëpo, më 6 dhjetor nga një bisedë telefonike e realizuar ndërmjet Boris Johnson dhe Ursula von der Leyen ishte diskutuar mes tyre për atë se akoma kishte arsye për të besuar që një marrëveshje ishte ende e mundshme (BBC News, 2020). Bisedimet do të vazhdonin sepse palët kishin “dallime të konsiderueshme” dhe shumë mospajtime, por meqë 31 dhjetori afrohej, faktori “kohë” nuk i favorizonte aspak palët. Më 9 dhjetor Boris Johnson së bashku me David Frost ishin takuar në Bruksel me Ursula Van der Leyen dhe Michel Barnier. Rezultati i këtij takimi pritej me ankth në të gjithë kontinentin evropian, në mes të frikës për rritje të kaosit ekonomik dhe të sigurisë, kur periudha e tranzicionit të mbarojë në vetëm tri javë. Johnson kishte

pohuar se nuk do të pranonte një traktat, i cili do ta lidhte Britaninë me rregullat e UE-së. Duket sikur kjo e fundit kishte planifikuar t'i publikonte planet e saj për pasigurinë që shkaktonte mosarritja e marrëveshjes shumë më shpejt se ç'ishte e mundshme për t'i mbrojtur kufijtë në rast se bisedimet kolapsohen në mënyrë të pakthyeshme (Campbell, 2020). Prezenca e shumë boshllëqeve pengonte dakordimin e palëve për një marrëveshje të kënaqshme dhe gjasat për përfundimin e kësaj faze pa marrëveshje ishin rritur shumë (BBC News, 2020).

III.2.4.4.2 Takimet e Komitetit të Përbashkët

Më 30 mars 2020 ishte zhvilluar takimi i parë i Komitetit të Përbashkët ndërmjet MB-së dhe UE-së për implementimin dhe aplikimin e Marrëveshjes së Tërheqjes. Komiteti i Përbashkët bashkëkryesohej nga *Zëvendës-presidenti i KoE-së Maroš Šefčovič* dhe *Kancelari i Dukatit të Lançasterit në Britani Michael Gove*. Zbatimi i duhur dhe në kohë i Marrëveshjes së Tërheqjes ishte prioriteti kryesor për të dy palët. Kjo kishte të bëjë veçanërisht me mbrojtjen e të drejtave të rreth 4,5 milionë shtetasve të UE-së dhe shtetasve britanikë, si dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në ishullin e Irlandës në kontekstin e MPM-së, duke siguruar integritetin e Tregut të Vetëm. Ekzistonte një nevojë urgjente për të paraqitur një kalendar të detajuar dhe për të vazhduar me masat e nevojshme, të tilla si përgatitja për futjen e procedurave doganore për mallrat që hyjnë në Irlandën e Veriut nga MB-ja, dhe sigurimi që të gjitha kontrollet e nevojshme sanitare dhe fitosanitare, si dhe kontrollet e tjera rregullatore mund të kryheshin për mallrat që hyjnë në Irlandën e Veriut nga jashtë UE-së. Palët kishin vendosur të fillonin punën e gjashtë komiteteve të specializuara në fushat kryesore për zbatimin e Marrëveshjes së Tërheqjes (European Commission, 2020).

Më 10 shtator 2020 ishte zhvilluar një takim i jashtëzakonshëm në Londër i Komitetit të Përbashkët MB-UE, të cilin e kishte kërkuar Maroš Šefčovič pas publikimit të qeverisë britanike të draftit "Projektligji i Tregut të Brendshëm të Britanisë" më 9 shtator 2020. Ky takim sipas tij do të bëhej për t'i kërkuar qeverisë britanike që të elaborojë qëllimet e saj dhe t'iu përgjigjej shqetësimeve serioze të UE-së. Qeveria britanike kishte propozuar një kornizë të re ligjore për të parandaluar shfaqjen e pengesave të reja në tregtinë brenda vendit të saj: Projektligjin e Tregut të Brendshëm të MB-së, i cili ishte prezantuar në Dhomën e Komunave më 9 shtator 2020. Objektivat kryesore të politikës së projektligjit në fjalë kishin synim të siguronin vazhdimësi për bizneset dhe qytetarët dhe të përmirësonin

aftësinë konkurruese dhe mjedisin e biznesit në Britani. Qeveria gjithashtu kishte argumentuar se një treg i brendshëm i MB-së do ta ndihmonte vendin në arritjen e marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare dhe do të mundësonte që përfitimet e atyre marrëveshjeve të shtriheshin në të gjitha pjesët e Britanisë. Duke marrë parasysh që tregtia e mallrave mes Irlandës së Veriut dhe pjesës tjetër të MB-së i nënshtrohej Protokollit të Irlandës së Veriut në Marrëveshjen e Tërheqjes, projektligji kishte prezantuar dispozita të veçanta për të shmangur mundësinë që mallrat që udhëtonin nga Irlanda Veriore në Britani të diskriminoheshin dhe të fitonin qasje të pakufizuar në pjesën tjetër të MB-së (United Kingdom Parliament, 2020). Šefčovič i bënte thirrje qeverisë së Britanisë që të tërhiqte këto masa nga drafti në kohën më të shkurtër të mundshme dhe në çdo rast deri në fund të muajit. Ai kishte deklaruar se duke paraqitur këtë projektligj, MB-ja kishte dëmtuar seriozisht besimin e UE-së dhe tani i takonte qeverisë së Britanisë që të rivendoste atë besim. Ai ia kishte rikujtuar qeverisë britanike se Marrëveshja e Tërheqjes përmban një numër mekanizmesh dhe mjetesh juridike për të adresuar shkeljet e detyrimeve ligjore të përfshira në tekst, të cilat UE-ja nuk do të ngurronte për t'i përdorur (European Commission, 2020).

Më 28 shtator 2020 ishte zhvilluar takimi i tretë i Komitetit të Përbashkët, për të cilin Maroš Šefčovič kishte cekur që kishte akoma shumë punë për t'u bërë mes palëve para se perioda e tranzicionit të përfundonte në më pak se 100 ditë. Ai kishte shprehur shqetësimet e tij me qytetarët e UE-së në MB, gjegjësisht respektimin e të drejtave të tyre, si dhe brengat për Protokollin mbi Irlandën/Irlandën Veriore. Ai kishte pohuar që ky takim kishte shfaqur nevojën urgjente për të lëvizur në ingranazhe më të larta dhe për këtë arsye, takimi i ardhshëm i Komitetit të Përbashkët që pritej të mbahej në mes të muajit tetor duhej të përmbledhonte rezultatet e arritura nga Komitetet e Specializuara. Po ashtu, Šefčovič sërish i kishte bërë thirrje qeverisë britanike të tërhiqte masat e diskutueshme prej projektligjit të 9 shtatorit. Mirëpo, qeveria britanike me këtë rast kishte konfirmuar synimin e saj për të vazhduar me projektligjin (European Commission, 2020).

III.2.4.4.3 Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-UE

Ndonëse të zhvilluara në një situatë tejmasë të rënduar nga pandemia e koronavirusit, e cila i thelloi edhe më tepër mospajtimet mes palëve gjer në atë nivel sa që ato u detyruan të përgatiteshin edhe për skenarët më të vështirë njëkohësisht krahas

përpjekjeve të shumta për të arritur një marrëveshje, bisedimet e fazës së tretë ndërmjet UE-së dhe britanikëve po përmbylleshin me finalizimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-UE. Më 24 dhjetor 2020 negociatorët e UE-së dhe të Britanisë në Bruksel kishin arritur një marrëveshje, e cila përbënte një hap të madh të hedhur sa i përket mbrojtjes së interesave evropiane, si dhe për të siguruar konkurrencë të ndershme dhe për të vendosur bashkëpunim të ngushtë në fushat me interes të përbashkët ndërmjet palëve. Ursula von der Leyen kishte pohuar që ia kishin vlejtur të gjitha përpjekjet e arritjes së një marrëveshje të drejtë dhe të ekuilibruar me MB-në, ashtu që UE-ja ta linte pas Brexit-in dhe të fokusohej drejt së ardhmes së saj. Gjersa Michel Barnier apo protagonistin kryesor i negociatave të Brexit-it nga UE-ja që prej fillimit të tyre, kishte cekur që periudhës shumë intensive katërvjeçare të procesit të tërheqjes së Britanisë nga UE-ja tashmë po i vinte fundi (European Commission, 2020).

Marrëveshja e arritur për tregti të lirë mbi një partneritet të ri ekonomik dhe social ndërmjet UE-së dhe MB-së karakterizohet prej këtyre veçorive:

- *Marrëveshja përfshinte tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, por gjithashtu edhe një gamë të gjerë fushash të tjera, të tilla si investimet, konkurrenca, ndihma shtetërore, transparenca e taksave, transporti ajror dhe rrugor, energjia dhe qëndrueshmëria, peshkimi, mbrojtja e të dhënave, dhe koordinimi i sigurimeve shoqërore;*
- *Parashikoheshin tarifa zero dhe kuota zero për të gjitha mallrat që përputhen me rregullat e duhura të origjinës;*
- *Të dy palët ishin dakorduar që të sigurojnë një fushë të fortë të lojës duke ruajtur nivele të larta të mbrojtjes në fusha të tilla si mbrojtja e mjedisit, lufta kundër ndryshimit të klimës dhe çmimi i karbonit, të drejtat sociale dhe të punës, transparenca e taksave dhe ndihma shtetërore me zbatimin efektiv të brendshëm, një mekanizëm detyrues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe mundësinë që të dy palët të marrin masa përmirësuese;*
- *UE-ja dhe Britania ishin dakorduar mbi një kornizë të re për menaxhimin e përbashkët të rezervave të peshkut në ujërat e UE-së dhe MB-së. Kjo e fundit do të ishte në gjendje të zhvillonte më tej aktivitetet e saj të peshkimit, ndërsa aktivitetet dhe vazhdimësia e komuniteteve evropiane të peshkimit do të ishin të mbrojtura, si dhe burimet natyrore do të ruheshin;*

- *Për transportin, marrëveshja parashikonte lidhje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme ajrore, rrugore, hekurudhore dhe detare, megjithëse qasja në treg ndikohet nga ajo që ofronte Tregu i Vetëm. Ky i fundit përfshin dispozita të caktuara për të siguruar që konkurrenca mes operatorëve të UE-së dhe Britanisë të zhvillohet në mënyrë të barabartë, ashtu që të drejtat e pasagjerëve, të drejtat e punëtorëve dhe siguria e transportit të mos minoheshin;*
- *Në lidhje me energjinë, marrëveshja siguronte një model të ri për tregtinë dhe interkonektivitetin, duke garantuar konkurrencë të hapur dhe të ndershme, përfshirë këtu edhe standardet e sigurisë për det të hapur dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme;*
- *Në lidhje me koordinimin e sigurimeve sociale, marrëveshja në fjalë kishte synim të siguronte një sërë të drejtash të qytetarëve të UE-së dhe shtetasve të MB-së. Kjo ndërlidhet me shtetasit e UE-së që punojnë, udhëtojnë ose lëvizin në Britani dhe me britanikët që punonin, udhëtonin ose lëviznin në vendet e UE-së pas datës 1 janar 2021;*
- *Marrëveshja mundësonte pjesëmarrjen e vazhdueshme të MB-së në një numër programesh kryesore të UE-së përgjatë periudhës 2021-2027.*

Partneriteti i ri për sigurinë e të drejtave të qytetarëve të UE-së dhe atyre britanikë kishte përfshirë bashkëpunimin gjyqësor, veçmas në çështjet penale dhe të së drejtës civile. Ky bashkëpunim mund të pezullohet në rast të shkeljeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe zbatimit të saj të brendshëm nga ana e Britanisë. Për t'iu dhënë siguri maksimale ligjore bizneseve, konsumatorëve dhe qytetarëve, një kapitull i dedikuar për qeverisjen ofron qartësi se si do të operohet dhe kontrollohet marrëveshja. Kjo nënkupton atë që bizneset në UE dhe MB do të konkurrojnë në një fushë të barabartë dhe do t'iu shmangen pikave që mund të shtrembërojnë konkurrueshmërinë. Ndërkaq, politika e jashtme, siguria e jashtme dhe bashkëpunimi i mbrojtjes nuk janë mbuluar nga marrëveshja e arritur mes palëve në fazën e tretë të bisedimeve ngase Britania nuk ka dashur t'i negociojë këto çështje. Sidoqoftë, kjo marrëveshje nuk përputhet me përparësitë që ka gëzuar MB-ja si vend anëtar i UE-së (European Commission, 2020).

KE-ja më 29 dhjetor 2020 kishte miratuar vendimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit UE-Britani, gjegjësisht zbatimin e saj të përkohshëm që nga data 1 janar

2021, gjersa të merrej pëlqimi i PE-së. Ndërkaq, Projektligji i Unionit Evropian (Marrëdhëniet e Ardshme) kaloi në Dhomën e Komunave më 30 dhjetor 2020, me 521 vota pro dhe 73 kundër (United Kingdom Parliament, 2020). Pasi ky projektligj u mbështet edhe nga Dhoma e Lordëve, në po të njëjtën datë mori edhe pëlqimin mbretëror, me ç'rast tashmë është edhe ligj i Parlamentit të MB-së (United Kingdom Parliament, 2020). Po ashtu marrëveshja në fjalë më 30 dhjetor 2020 ishte nënshkruar nga Ursula von der Leyen në Bruksel dhe Boris Johnson në Londër. Hapat e mëtejshëm në vitin 2021 kishin të bënin me marrjen e pëlqimit të PE-së, ku duhet theksuar që pasi të kenë përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes, vendimi mbi përfundimin e kësaj të fundit duhet të miratohet nga KE-ja (European Council, 2020). Pra, për të hyrë zyrtarisht në fuqi kjo marrëveshje duhet të miratohet prej PE-së, deputetët e së cilës duhet shqyrtuar me kujdes tekstin në komisionet e specializuara parlamentare përpara se ta votojnë atë gjatë një seance plenare. Propozimi i KoE-së për ratifikimin e marrëveshjes fillimisht parashikoi një votim të pëlqimit të PE-së deri në fund të shkurtit 2021. Mirëpo, PE-ja po konsideron një periudhë më të gjatë kontrolli, me një votim pëlqimi në muajin mars (Fella et al., 2020, p. 4).

II.2.5 Konkluzionet

Një nga risitë kryesore të Traktatit të Lisbonës është rregullimi i tërheqjes së shtetit nga anëtarësia e UE-së në Nenin 50. Më 23 qershor 2016 në Britani ishte mbajtur një referendum mbi vazhdimësinë ose përfundimin e anëtarësisë së saj në UE. Në këtë të fundit 51,9% e britanikëve kishin votuar për largimin e vendit të tyre nga UE-ja, si dhe 48,1% kishin votuar kundër Brexit-it. Në Angli dhe Uells ishte votuar për Brexit, ndërkaq në Irlandën Veriore dhe në Skoci kundër Brexit-it. Meqë Ligji i UE-së (Njoftimi i Tërheqjes) ishte miratuar nga Parlamenti i MB-së dhe kishte marrë pëlqimin mbretëror, më 29 mars 2019 qeveria britanike kishte kërkuar aktivizimin e Nenit 50. Zyrtarisht negociatat e Brexit-it ishin hapur më 19 qershor 2017. Në fazën e parë të tyre brenda gjashtë raundeve ishin trajtuar çështjet kryesore të palëve si të drejtat e qytetarëve britanikë dhe të UE-së, marrëveshjet financiare dhe Kufiri Irlandez. Në fazën e dytë të negociatave ishte diskutuar për Marrëveshjen e Tërheqjes, e cila si pasojë e përplasjeve politike në Britani nuk ishte ratifikuar më 29 mars 2019, e që sipas Nenit 50 do të duhej të ishte "Brexit Day". Zgjatja e periudhës së caktuar nga ky nen ishte kërkuar tri herë radhazi nga qeveria britanike, gjersa Marrëveshja e

Tërheqjes në vitin 2020 kishte marrë miratimin e PE-së dhe të Parlamentit të MB-së dhe që nga 31 janar 2020 Britania është vend i tretë për UE-në. Gjatë negociatave të Brexit-it ka pasur mospajtime mes palëve, por kulmi i tyre kishte arritur në fazën e tretë të bisedimeve për partneritetin e ardhshëm të MB-së dhe UE-së. Krahas mospajtimeve mes palëve në komplikimet e këtyre bisedimeve kishte ndikuar edhe pandemia e koronavirusit, me ç'rast gjasat për mosarritje të marrëveshjes së tregtisë së lirë shtoheshin vazhdimisht. Mbi të gjitha këto rrethana të krijuara, përpjekjet maksimale të palëve rezultuan me finalizimin e fazës së tretë të negociatave me marrëveshje. Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit MB-UE ishte arritur më 24 dhjetor 2020. Më 30 dhjetor 2020, kjo marrëveshje ishte miratuar nga Parlamenti i Britanisë dhe kishte marrë pëlqimin mbretëror, si dhe ishte nënshkruar nga Ursula von der Leyen në Bruksel dhe Boris Johnson në Londër. Marrëveshja në fjalë ishte miratuar nga KE-ja më 29 dhjetor 2020 dhe prej datës 1 janar 2021 ka zbatim të përkohshëm derisa të merret pëlqimi i PE-së në vitin 2021 dhe të ketë zbatim të plotë.

KAPITULLI III

QASJA METODOLOGJIKE

III.1 Analiza e faktorëve që i kontribuuan Brexit-it bazuar në qasjen teorike realiste

III.1.1 Niveli individual

III.1.1.1 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitet e 70-ta

Prej vitit 1974 gjer në vitin 2016 kishte pasur vazhdimisht kërkesa të përsëritura prej politikanëve britanikë për tërheqjen e MB-së nga KEE-ja/UE-ja dhe thirrje për organizim referendumesh mbi çështjet kyçe të KEE-së/UE-së, konkretisht për traktatet specifike, madje edhe për vetë anëtarësinë e Britanisë (Glencross, 2016, p. 8). *Nga të gjitha karakteristikat djallëzore, asnjë nuk është më mbizotëruese, e pandryshueshme, apo e rrezikshme, sesa instikti i vullnetit për pushtet dhe dëshirës për të sunduar të tjerët* (Kegley, 2009, f. 27). Organizimi i një referendumi nëpërmes së cilit britanikët do të vendosnin për të ardhmen e vendit të tyre brenda apo jashtë KEE-së/UE-së, nuk kishte qenë ide, premtim dhe realizim vetëm i David Cameron-it, por kishte qenë në mendjet e politikanëve britanikë që nga filltet e anëtarësimit të MB-së në KEE.

Me vdekjen e Presidentit francez Charles de Gaulle në vitin 1970, nuk kishte pasur më pengesa për të bllokuar anëtarësimin e Britanisë në KEE. Traktati i anëtarësisë së MB-së në KEE ishte nënshkruar më 22 janar 1972 nga *Edward Richard George Heath* që kishte qenë në krye të qeverisë britanike gjatë periudhës 1970-1974, ndërkaq anëtarësia kishte hyrë në fuqi më 1 janar 1973 (United Kingdom Parliament, n.d.). Mirëpo, Edward Heath kishte humbur në dy palë zgjedhje parlamentare që ishin mbajtur gjatë vitit 1974, në të cilat kishte fituar *James Harold Wilson*, një politikan nga Partia Laburiste që e kishte udhëhequr

qeverinë britanike në periudhat 1964-1970 dhe 1974-1976 (Helm, 2016). Humbjet që kishte pësuar Heath e kishin favorizuar tejmase politikanen *Margaret Hilda Thatcher*, e cila e kishte sfiduar befasisht atë kur më 11 shkurt 1975 e kishte marrë përsipër udhëheqjen e PK-së (Institute for Government, n.d.). Thatcher kishte ofruar politika më alternative sesa Heath, por ajo çfarë e kishte diferencuar dhe favorizuar Thatcher-in akoma më shumë kishte qenë aspekti gjinor (Cannadine, 2017, pp. 22-23).

Pasi kishte triumfuar në dy palë zgjedhjet e vitit 1974,³³ Harold Wilson ishte angazhuar për realizimin e premtimit kryesor të PL-së për këto zgjedhje, rinegociimin e kushteve të anëtarësisë së MB-së në KEE, i cili do të pasonte me një referendum kombëtar ku do të përcaktohej kahja që do të ndiqte Britania, të qenurit vend anëtar në KEE me kushtet e reja të rinegociuara, apo largimin nga KEE-ja. Wilson që kishte marrë përsipër një detyrë shumë të vështirë, ishte ai që më 10 maj 1967 kishte aplikuar për herë të dytë për anëtarësimin e Britanisë në KEE pas Harold Macmillan,³⁴ por më 27 nëntor 1967 sërish ky aplikim ishte refuzuar si rrjedhojë e vetos së de Gaulle-it (Butler & Kitzinger, 1976, p. 11). Negociatat me KEE-në ishin realizuar nga Harold Wilson dhe nën kryesinë e tij ishte krijuar një komitet që e kishte trajtuar rinegociimin që kishte përfshirë: Sekretarin e Jashtëm të MB-së *Leonard James Callaghan*, Sekretarin e Shtetit për Industri *Anthony Neil Wedgwood Benn*, si dhe Sekretarin e Shtetit për Tregti *Peter David Shore*. Po ashtu, ishte krijuar një Njësi e Informimit të Referendumit në krye të së cilës kishte qenë *Martin Robert Morland*, qëllimi i së cilës kishte qenë informimi i shtypit dhe ofrimi i të dhënave faktike mbi procesin e rinegociimit dhe referendumin. James Callaghan në diskutimet e Këshillit të Ministrave në vitet 1974 dhe 1975 kishte parashtruar shqetësimet e popullit britanik mbi anëtarësinë e MB-së në KEE dhe pikat kryesore ku kërkohet rinegociim, duke kërkuar rishikim rrënjësor të politikave të KEE-së dhe ndryshime thelbësore në buxhetin e saj. Ai gjithashtu kishte pasur brenga edhe për marrëdhëniet e KEE-së me shtete apo grupe shtetesh të tjera, veçanërisht për mosmarrëveshjet e saj me ShBA-të, duke theksuar se Britania dëshironte të mbetej anëtare e një aleance atlantike efektive (Miller, 2015, pp. 5-10). Kryeministri Wilson kishte

³³ Gjatë vitit 1974, në Mbretërinë e Bashkuar ishin mbajtur dy palë zgjedhje të përgjithshme, më 28 shkurt dhe më 10 tetor. Në zgjedhjet e shkurtit Partia Laburiste e udhëhequr nga Harold Wilson nuk kishte arritur të siguronte mazhorancën dhe pasi partia e tij nuk kishte mundur të krijonte koalicion me parti të tjera, në shtator ai kishte bërë thirrje për zgjedhje të parakohshme, të cilat ishin mbajtur më 10 tetor dhe në këto zgjedhje Laburistët kishin siguruar shumicën më të ngushtë të regjistruar.

³⁴ Maurice Harold Macmillan e kishte udhëhequr qeverinë britanike në vitet 1957-1963, dhe ishte kryeministri britanik që aplikoi për herë të parë për anëtarësimin e Mbretërisë së Bashkuar në Komunitetin Ekonomik Evropian.

pretenduar se kishte arritur një marrëveshje më të mirë për MB-në dhe kishte udhëhequr fushatën për vazhdimësinë e anëtarësisë së Britanisë në KEE. Mirëpo, kishin qenë dy politikanë që fuqishëm e kishin mbështetur tërheqjen e MB-së nga KEE-ja, Laburisti Tony Benn dhe *John Enoch Powell*, një ish-Konservator që kishte kaluar në Partinë Unioniste të Ulsterit.³⁵ Benn gjatë fushatës kishte deklaruar se anëtarësia në KEE i kishte kushtuar Britanisë me humbje të 500,000 vendeve të punës brenda dy viteve. Kjo rritje e papunësisë, si dhe deficitit tregtar ndërmjet MB-së dhe pjesës tjetër të KEE-së, kishin rezultuar si pasojë e asaj që britanikët më shumë kishin importuar nga vendet evropiane sesa që kishin eksportuar mallrat e tyre në këto të fundit. Ndërsa, Powell gjatë fushatës vazhdimisht kishte pohuar se Tregu i Përbashkët “kishte përcaktuar me faza bashkimin e Britanisë me Francën, Gjermaninë, Italinë dhe vendet e tjera në një komb të vetëm”, në të cilin MB-ja do të ishte vetëm një “provincë e thjeshtë” (Wheeler, 2016).

Gjatë fushatës së referendumit të vitit 1975, Margaret Thatcher si admiruese e Tregut të Përbashkët kishte shprehur haptazi preferencat e saj për qëndrimin e Britanisë në KEE, gjersa katër vite më vonë, ajo do të bëhej kryeministrja e parë femër në MB. Pas dorëheqjes së Harold Wilson-it nga posti i kreut të qeverisë britanike më 16 mars 1976, roli i tij kishte kaluar tek James Callaghan (United Kingdom Government, n.d.). Gjersa sukseset e PK-së si parti kishin filluar të rriteshin, Callaghan kishte bërë një gabim fatal që i kishte kushtuar me humbje në zgjedhjet parlamentare të vitit 1979 sepse nuk e kishte thirrur mbajtjen e tyre në vjeshtën e vitit 1978 (Cannadine, 2017, p. 25). Në këto zgjedhje që ishin mbajtur më 3 maj 1979, kishin triumfuar Konservatorët në krye me Margaret Thatcher, e cila kishte marrë 43,9% të votave, ndërsa Laburistët me Jim Callaghan kishin marrë 36,9%. Këtë të fundit e kishte disfavorizuar shumë Dimri i Pakënaqësisë,³⁶ përderisa Thatcher ishte përkrahur më shumë, edhe pse në krahasim me Callaghan nuk kishte gëzuar popullaritet aq të madh (BBC News, 1979). Margaret Thatcher kishte shprehur disa kundërshtime ndaj KEE-së në Samitin e Dublin-it të KE-së më 29 dhe 30 nëntor 1979. Rreth 70% e buxhetit të KEE-së kishin qenë të dedikuara për subvencione bujqësore, por ky sektor në MB ishte i vogël dhe ekonomia britanike nuk ishte e bazuar në të. Ajo kishte kundërshtuar

³⁵ Partia Unioniste e Ulsterit është një parti politike nga Irlanda Veriore, e cila është themeluar më 3 mars 1905.

³⁶ Dimri i Pakënaqësisë ishte dimri mes vitit 1978 dhe 1979 në Mbretërinë e Bashkuar, i karakterizuar prej më shumë se 2000 grevave nga sindikatat e sektorit publik që kishin kundërshtuar përpjekjet e atëhershme të PL-së për të zvogëluar ngritjen e pagave.

subvencionimin e fermerëve evropianë me një shumë prej 1,000,000 £ në vit dhe si një nga vendet anëtare më të varfra të tri shteteve që kontribuonin më së shumti në buxhetin e KEE-së, Thatcher kishte kërkuar që Britania të hiqte dorë prej ofrimit të kësaj shume (Margaret Thatcher Foundation, n.d.).

III.1.1.2 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitet 80-ta

Premtimet dhe idetë për tërheqjen e Britanisë nga KEE-ja, si dhe mospajtimet me politika të caktuara të kësaj të fundit nuk kishin munguar as në vitet e 80-ta. Një premtim i ri i Laburistëve për tërheqjen e MB-së nga KEE-ja ishte paraqitur nga udhëheqësi i tyre *Michael Mackintosh Foot*, i cili në manifestin zgjedhor të PL-së për zgjedhjet parlamentare të datës 9 qershor 1983, kishte premtuar se në qoftë se do të bëhej kryeministër i Britanisë, do t'i fillonte negociatat për tërheqjen e menjëhershme të vendit nga KEE-ja (BBC News, 2015). Mirëpo, fituese e këtyre zgjedhjeve kishte dalë PK-ja, me ç'rast Margaret Thatcher kishte marrë mandatin e saj të dytë si kryeministre britanike (BBC News, 1983).

Peshkopi dhe filozofi i krishterë afrikano-romak, Shën Augustini, kishte shtuar një nocion të rëndësishëm të realizmit, duke argumentuar se natyra njerëzore është e deformuar, egoiste dhe defektive, megjithëse jo e paracaktuar për të qenë e tillë (Mingst, 2008, f. 996). Më 8 shtator 1988 nëpërmes një fjalimi drejtuar Kongresit të Unionit të Tregtisë Britanike në Bournemouth, Jacques Lucien Jean Delors³⁷ kishte nxitur një perspektivë më pro-evropiane mbi të majtën britanike (Drake, 2000, p. 116). Si pasojë e këtij fjalimi, i cilësuar si një prej më shkatërrimtarëve dhe kundërproduktivëve në historinë politike të MB-së pas LDB-së, euroskepticizmi nga PL-ja ishte bartur tek PK-ja, ndonëse ky nuk kishte qenë qëllim i Delors-it (MacShane, 2015, p. 151). Ky i fundit në fjalimin e lartpërmendur kishte pohuar se në dhjetë vitet e ardhshme KEE-ja do të kishte përgjegjësi në 80% të të gjithë legjislacionit ekonomik, ndoshta edhe të atij tatimor dhe social në 12 vendet e saj anëtare, duke hedhur kështu hapat fillestarë drejt fazës embrionale të një “qeverie evropiane” (European Commission, 1988). Sikur të mos mjaftonte kjo, ai po ashtu kishte thënë se brenda dy vitesh të gjitha vendimet kryesore lidhur me MB-në do të

³⁷ Jacques Lucien Jean Delors është një politikan francez, i cili kishte qenë Deputet i Parlamentit Evropian nga viti 1979 deri më 1981, kishte shërbyer si Ministër i Financave të Francës në periudhën 1981-1984, si dhe kishte qenë Presidenti i tetë i Komisionit Evropian prej vitit 1985 gjer më 1995.

merreshin në Bruksel. Kjo deklaratë e kishte zemëruar jashtë mase Margaret Thatcher, e cila ishte transformuar në një euroskeptike tepër të mllefosur (Berlinski, 2008, p. 320). Imazhi i “një super-shteti evropian” ishte makthi më i keq për të sepse sipas saj përmes një integrimi të tillë do të ishte e pamundur që Britania të kishte pozicione të rëndësishme dhe ndikuese në çështjet evropiane (Cannadine, 2017, 108). Pastaj, në një fjalim të mbajtur më 20 shtator 1988 në “College of Europe” në Bruges, Thatcher kishte theksuar se MB-ja nuk preferonte ekzistencë komode duke qenë e izoluar brenda kufijve të KEE-së. Gjithashtu, kishte thënë se mbështetja britanike për lëvizjet e rezistencës gjatë LDB-së ndihmoi për të mbajtur gjallë flakën e lirisë në shumë vende deri në ditën e fundit të luftës. Ky fjalim kishte marrë shumë kritika, duke u cilësuar i ashpër, famëkeq dhe ofendues për të pranishmit (Berlinski, 2008, p. 321). Ajo kishte cekur se bashkëpunimi mes shteteve sovraane ishte mënyra më e mirë për të ndërtuar një komunitet të suksesshëm evropian. Mirëpo, përpjekja për të shtypur kombësinë, duke përqendruar fuqinë në qendër të konglomeratit evropian do të ishte shumë e dëmshme dhe e rrezikshme për objektivat britanike (Margaret Thatcher Foundation, n.d.). Ndonëse e njohur dikur si avokate pasionante e bashkimit evropian, Margaret Thatcher, e cila kishte qëndruar në pushtet nga viti 1979 gjer në vitin 1990, kishte preferuar që KEE-ja të ishte vetëm një organizatë e thjeshtë ndërkombëtare, ku nuk do të kishte rreziqe për humbje të sovranitetit kombëtar.

III.1.1.3 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në vitet e 90-ta

Gjatë viteve të 90-ta në Britani ishin paraqitur disa personalitete të reja që kishin themeluar disa parti politike, bazamenti i së cilave ishte kundërshtimi i anëtarësisë së MB-së në UE. Në vitin 1991 ishte formuar Lidhja Anti-Federaliste, një parti politike euroskeptike që synim parësor e kishte largimin e Britanisë nga UE-ja. Pas dy vitesh, respektivisht në vitin 1993, kjo parti ishte riemëruar në United Kingdom Independence Party (Partia e Pavarësisë së Mbretërisë së Bashkuar). Themelet e kësaj të fundit i kishte hedhur *Alan Sked*, i cili kishte qenë edhe udhëheqësi i parë i UKIP-it prej vitit 1993 gjer në vitin 1997.

Filozofi italian Niccolò Machiavelli, në veprën e tij “Princi” shkruan se meqë bota shfaqej si një vend me rrezikshmëri të përhershme, maksimizimi i fuqisë dhe i sigurisë duhej ta dominonin agjendën vendimmarrëse të udhëheqësit të vendit (Machiavelli, 2003, f. 84). Sir James Michael Goldsmith, biznesmeni dhe investitori miliarder me prejardhje francezo-

britanike, kishte qenë i njohur si njëri prej personave më të pasur në MB. Pikëpamjet e tij për Evropën dhe Traktatin e Mastrohitit e kishin shtyrë atë drejt arenës politike, ku ai kishte qenë po aq dinamik, imponues dhe i suksesshëm sa kishte qenë në biznes (Sir James Goldsmith, n.d.). Ai kishte favorizuar një shoqëri të fortë mes vendeve evropiane, por jo një qeveri të vetme dhe të fortë qendrore ngase sipas tij do të pasonte humbja e sovranitetit kombëtar në mënyrë të pashmangshme, e që do ta bënte Evropën në ekuivalentin politik të një konglomerati me pasoja katastrofale (Sir James Goldsmith, n.d.). Në vitin 1994 ai kishte udhëhequr partinë politike L'Autre në Francë, si dhe në zgjedhjet e PE-së më 9 dhe 12 qershor 1994 ai kishte fituar 17% të votave dhe ishte bërë deputet. Në po të njëjtin vit Goldsmith kishte themeluar Partinë e Referendumit, e cila ishte një parti antievropiane dhe kishte ndarë 20 milionë £ për fushatën e tij elektorale në zgjedhjet parlamentare të Britanisë në vitin 1997, ku kishte shpenzuar më shumë para sesa PK-ja dhe PL-ja së bashku (Sir James Goldsmith, n.d.). Në këto zgjedhje ai dhe PR-ja kishin qenë të përqendruar në një çështje të vetme që ishte detyrimi i mbajtjes së një referendumit mbi atë nëse MB-ja duhej të vazhdonte anëtarësinë në UE apo të tërhiqej nga kjo e fundit. Goldsmith kishte dëshiruar që elektoratit britanik t'i mundësohej që të vendoste vetë për marrëdhëniet e vendit me Evropën. Sidoqoftë, pavarësisht që kishte marrë 800,000 vota apo 3,4% të totalit dhe ishte renditur si partia e katërt më e suksesshme në këto zgjedhje, PR-ja nuk kishte fituar asnjë vend në Dhomën e Komunave. Megjithatë, Goldsmith kishte arritur të bënte presion tek dy partitë kryesore britanike që të angazhoheshin rreth një referendumit të tillë dhe si rrjedhojë e këtij presioni MB-ja nuk ishte anëtarësuar në eurozonë (Sir James Goldsmith, n.d.).

III.1.1.4 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në dekadën e parë të këtij shekulli

Dekada e parë e shekullit XXI ishte karakterizuar nga debatet dhe premtimet e politikanëve britanikë për organizime referendumesh mbi çështje specifike lidhur me UE-në, duke e përfshirë edhe çështjen e vazhdimit të anëtarësisë së Britanisë. *Filozofi i lashtë indian Kautilya në librin e tij "Arthashastra" theksonte se në interes të prosperitetit të vendit, një udhëheqës duhet të jetë i kujdesshëm në parashikimin e mundësisë së fatkeqësive, të përpiqet t'i shmangë ato para se të ndodhin, të tejkalojë ato që ndodhin, të largojë të gjitha pengesat për aktivitetin ekonomik dhe të parandalojë humbjen e të ardhurave për shtetin* (Rangarajan, 2010, p. 412). *Anthony Charles Lynton Blair* njihet si politikani britanik nga

radhët e PL-së që ka qëndruar më së gjati në krye të qeverisë britanike, nga data 1 maj 1997 gjer më 27 qershor 2007 kur kishte dhënë dorëheqje (United Kingdom Government, n.d.). Ai kishte qenë njëri prej liderëve të 25 vendeve anëtare të UE-së që e kishin nënshkruar Traktatin për themelimin e Kushtetutës për Evropën më 29 tetor 2004. Mirëpo, para se ta nënshkruante traktatin në fjalë, Blair kishte premtuar se do të organizonte referendum mbi ratifikimin e tij, duke vendosur datën më të hershme të mundshme për një plebishit³⁸ në fillim të vitit 2005 (Tempest, 2004). Një pjesë e madhe e britanikëve nuk ishin pajtuar me nënshkrimin e tij sepse sipas një deklaratë të Kryeministrit belg të asaj kohe *Guy Verhofstadt*, kjo kushtetutë do të ishte “gur themeli” i një “shteti federal”. Ndonëse Tony Blair kishte tentuar që ta shtynte sa më shumë në kohë çështjen e referendumit të tillë, populli britanik do të duhej të kishte fjalën në votimin e tij më së largu në fund të vitit 2006 (Moran, 2015, p. 441). Në raport me Evropën, Blair kishte theksuar dy probleme:

- 1) Sjellja historike e mediave euroskeptike në MB, të cilat ishin tërësisht, egërsisht, e në mënyrë të papërballueshme tejet armiqësore ndaj UE-së, keqinterpretimin atë që bënte UE-ja dhe përgjithësisht konsideronin se çdo gjë që kënaqte Brukselin e dëmtonte Britaninë (Blair, 2010, p. 1487);
- 2) Mosmarrëveshja e tij me Gordon Brown mbi monedhën euro, për të cilën Blair kishte deklaruar vazhdimisht se në një botë me fuqi të reja në zhvillim, Britanisë i duhej Evropa në mënyrë që të ushtronte ndikim dhe të kishte përparueshmëri në interesat e saj. Brown shquhej për qëndrime negative ndaj euros, kurse Blair kishte pohuar që edhe nëse MB-ja nuk do t’i bashkohej eurozonës, kryesisht për arsye diplomatike, një bashkim i tillë tingëllonte pozitiv. Tony Blair në raport me eurozonën pohonte që do të ishte më mirë për britanikët që t’i bashkohen kësaj të fundit dhe të jenë lojtarë të plotë në vendimmarrjen ekonomike evropiane (Blair, 2010, pp. 1498-1499).

Fillet e rrugëtimit të *David Cameron*-it lidhur me referendumin e anëtarësisë së Britanisë në UE ishin brenda kësaj dekade, më saktësisht ku në vitin 2007 kur KoE-ja propozoi një traktat zëvendësimi, i cili njihet sot si Traktati i Lisbonës. Si udhëheqës i PK-së ai kishte premtuar që në qoftë se do të ishte në krye të qeverisë britanike do të organizonte referendum për çdo traktat që do të pasonte nga procesi i Lisbonës. Mirëpo, pas dy vitesh

³⁸ Plebishiti është konsultë e përgjithshme e popullit, nëpërmes së cilit i mundësohet popullit që të shprehë vullnetin e tij për një çështje të rëndësishme publike, p.sh. siç është ndryshimi i kushtetutës.

Cameron kishte pranuar që nuk do të kishte mundësi ta përmbushte këtë premtim sepse Traktati i Lisbonës ishte ratifikuar nga të gjitha vendet anëtare të UE-së. Por, kishte thënë që asnjë transferim substancial i kompetencave të ardhshme britanike nuk do të bëhej pa pasur aprovimin e popullit të MB-së (BBC News, 2015).

Nicholas William Peter Clegg, i cili ishte udhëheqës i Demokratëve Liberalë nga viti 2007 gjer më 2015 dhe ishte i njohur për pikëpamjet e tij pro-evropiane, më 25 shkurt 2008 kishte shprehur haptazi domosdoshmërinë e organizimit të një referendumit ku populli britanik do të vendoste nëse Britania do të mbetej vend anëtar apo do të tërhiqej nga UE-ja. Kjo kërkesë kishte rezultuar nga debatet helmuese mbi reformat që i kishte sjellë Traktati i Lisbonës, të cilat kishin destabilizuar politikanët britanikë eurofilë dhe euroskeptikë, prandaj ishte koha e duhur për një referendum të tillë si mënyrë e vetme e shuarjes së këtyre debateve të ashpra. Sipas Nick Clegg, ai/ajo që ishte eurofil/e përballë me akuza të të qenurit i/e shitur, gjersa kushdo që kishte pikëpamje euroskeptike, në këtë rast pjesa më e madhe e PK-së, akuzohej si “person i çmendur apo eksentrik” (Watt, 2008).

III.1.1.5 Politikanët përkrahës të idesë së referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE në dekadën e dytë të këtij shekulli

Në fillim të dekadës së dytë të shekullit XXI ishin shtuar politikanët britanikë që e favorizonin idenë për organizimin e një referendumit lidhur me anëtarësinë e MB-së në UE. Meqë pas dyzet e një vitesh një premtim për mbajtjen e një referendumit të tillë po realizohej, një numër jo i vogël i politikanëve britanikë kishin shfaqur haptazi pikëpamjet e tyre euroskeptike, duke kërkuar tërheqjen e vendit prej anëtarësimit në UE. *Teoricienti i njohur i marrëdhënieve ndërkombëtare Hans Morgenthau pohonte se triumfi i arsyes është, në të vërtetë, triumfi i forcave irracionale që arrijnë të përdorin proceset e arsyes për të kënaqur veten e tyre* (Morgenthau, 1967, p. 134).

Deputeti i PK-së *Peter William Bone*, i cili është i njohur për pikëpamjet e tij euroskeptike, më 1 shkurt 2011 kishte kërkuar amendamentimin e Projektligjit të UE-së, i cili aktualisht premtonte referendume në Britani sa herë që kishte ndryshime të mëdha në traktatet e UE-së. Ai propozonte që nëse në ndonjë referendum lidhur me çështje të caktuara do të kishte një votim “jo”, të pasonte referendumi i radhës mbi vazhdimësinë e anëtarësisë së MB-së në UE, apo edhe tërheqjen nga kjo e fundit. Mirëpo, ky amendament ishte refuzuar me 269 vota, ngase prej 295 deputetëve, vetëm 26 kishin votuar pro tij (BBC

News, 2011), me ç'rast përpjekjet e tij për të ndryshuar këtë ligj dhe për të siguruar referendumin mbi anëtarësinë e Britanisë në UE kishin dështuar.

Më 24 tetor 2011, ish-deputeti i PK-së *David John Nuttall* kishte prezantuar një mocion përmes së cilit kishte propozuar një debat mbi një kërkesë për të organizuar një referendum në muajin maj të vitit 2013 që do t'iu ofronte britanikëve tri mundësi për vendin e tyre:

- 1) MB-ja të mbetet anëtare e UE-së me kushtet e tanishme;
- 2) MB-ja të largohet nga UE-ja;
- 3) Rinegociimi i kushteve të anëtarësisë së MB-së në UE në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie e re bazuar në tregti dhe bashkëpunim.

I cilësuar nga David Nuttall si një debat historik, ky i fundit u paraqit nga Komiteti i Biznesit Backbench³⁹ pas dorëzimit të një peticioni të mbështetur nga 100,000 nënshkrues (David Nuttall, 2011). Mirëpo, ky mocion u hodh poshtë me 372 vota, sepse prej 483 deputetësh pati mbështetje nga 111 sosh. Deputetët në radhët e PK-së, PL-së dhe DL-së ishin udhëzuar që ta kundërshtonin këtë mocion (United Kingdom Parliament, 2011). Megjithatë, ishin 81 deputetë nga PK-ja që e mbështetën këtë mocion, kurse dy të tjerë abstenuan, me ç'rast duhet theksuar se ky ishte një nga rebelimet më të madha brenda PK-së mbi çështje të ndërlidhura me Evropën. Po ashtu, kundër udhëzimeve të partive të tyre dolën edhe 19 deputetë nga PL-ja dhe një deputet nga DL-ja (BBC News, 2015).

Ish-deputeti i PK-së *James Stephen Wharton* më 5 korrik 2013 kishte sjellë përpara projektligjin lidhur me premtimin e bërë nga David Cameron më 23 janar 2013 për organizimin e një referendumi mbi anëtarësinë e Britanisë në UE para se të përfundonte viti 2017. Projektligji në fjalë kaloi leximin e tij të dytë me 304 vota, si dhe po ashtu ishte diskutuar edhe pyetja që do të duhej të parashtrohej në këtë referendum e që parashihej të ishte: "A mendoni se Mbretëria e Bashkuar duhet të jetë anëtare e Unionit Evropian?" (United Kingdom Parliament, 2014).

Lideri i UKIP-it *Nigel Paul Farage*, para se të mbaheshin zgjedhjet e PE-së më 22-25 maj 2014, kishte deklaruar më 5 maj 2014 se dëshironte një referendum të menjëhershëm

³⁹ Komiteti i Biznesit Backbench është komiteti i parë i biznesit që u krijua më 15 qershor 2010 nga Dhoma e Komunave dhe që iu mundëson deputetëve/eve britanikë/e që të sjellin në parlament temat që ata/o i sugjerojnë, e që janë për t'u debatuar. Komiteti mund të konsiderojë çdo temë për debat, duke përfshirë subjekte të ngritura në fushata kombëtare ose lokale, raporte nga komitete të zgjedhura dhe grupe të tjera, si dhe çështje të sugjeruara nga zgjedhësit, duke përfshirë njerëz që kanë nënshkruar një peticion online ose një peticion tradicional letre (nuk ka kufizim në numrin e nënshkrimeve të kërkuara).

në MB lidhur me anëtarësinë e kësaj të fundit në UE. Farage me partinë e tij në këto zgjedhje kishin arritur një sukses të jashtëzakonshëm, duke marrë 24 ulëse në PE, ndonëse partia e tij nuk kishte asnjë deputet në Dhomën e Komunave (BBC News, 2015).

Drejtuesi i Dhomës së Komunave *Christopher Stephen Grayling* dhe Sekretarja e Shtetit për Irlandën Veriore në vitet 2012-2016 *Theresa Anne Villiers* kërcënonin me dorëheqje nga postet e tyre nëse nuk do të lejoheshin të bënin fushatë për daljen e Britanisë nga UE-ja. Për arsye të tilla David Cameron më 4 janar 2016 ishte pajtuar që ministrave/eve të kabinetit të tij t'iu lejohej që t'i bashkoheshin fushatës për largimin e MB-së nga UE-ja sepse imponimi i linjave pro-UE-së rrezikonte të pasonte me dorëheqjet e disa prej tyre (Shipman, 2016, p. 17). Chris Grayling deklaronte se vazhdimi i anëtarësisë së Britanisë në UE do të ishte shkatërrues dhe kjo deklaratë ishte cilësuar si shenja e parë drejt përgatitjes së një fushate anti-UE-së (BBC News, 2016). Kurse Theresa Villiers ishte thirrur që të dorëhiqej prej postit të saj në qoftë se do të mbështeste fushatën pro-largimit të MB-së nga UE-ja nga paralajmërimet e atilla se dalja e Britanisë nga UE-ja do të vinte në rrezik procesin e paqes në Irlandën Veriore (McDonald & Helm, 2016). Nga kabineti i tij qeveritar i Cameron kishte pasur mbështetje prej 24 anëtarëve/eve, kurse 6 të tjerë kishin favorizuar Brexit-in. Krahas dy të lartpërmendurve, katër të tjerë ishin: Sekretari i Kulturës *John Whittingdale*, Sekretari i Drejtësisë *Michael Gove*, Ministrija e Shtetit për Punësim *Priti Patel*, si dhe ish-kryetari i atëhershëm i Bashkisë së Londrës *Boris Johnson* (BBC News, 2016). Ky i fundit më 21 shkurt 2016 kishte deklaruar se do ta mbështeste fushatën për daljen e Britanisë nga UE-ja sepse dëshironte një marrëveshje më të mirë për popullin britanik, duke i kursyer para MB-së dhe duke marrë sërish kontrollin e vendit (Watt, 2016). Madje Johnson më 15 maj 2016 kishte bërë një deklaratë të ashpër ndaj UE-së, ku kishte thënë se kjo e fundit po bëhej një "supershtet" dhe ishte duke e shkelur autonominë e Britanisë. Sipas tij, synimet e UE-së për të unifikuar Evropën ishin të ngjashme me përpjekjet e Hitlerit për dominim në kontinentin evropian. Gjithashtu, ai kishte thënë se Evropës i mungonte "besnikëria themelore ndaj idesë së Evropës" dhe që "nuk kishte asnjë autoritet të vetëm që dikush e respektonte apo e kuptonte" (Johnston, 2016). Më 21 qershor 2016, në Debatën e Madhë Përfundimtare në Wembley Arena, Boris Johnson kishte pohuar se data 23 qershor 2016 do të cilësohej si "Dita e Pavarësisë së Britanisë", nëse britanikët do të votonin për daljen e MB-së nga UE-ja (Wilkinson, 2016).

Referendumi i vitit 2016 i kishte ndarë Konservatorët në dy grupe, në grupin e deputetëve që përkrahnin vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE, ku bënë pjesë 185 deputetë, si dhe në atë të deputetëve që mbështesnin Brexit-in, numri i të cilëve ishte 138. Në grupin e dytë bënë pjesë: *Nigel Adams, Adam Afriyie, Lucy Allan, David Amess, Stuart Andrew, Caroline Ansell, Richard Bacon, Steven Baker, Stephen Barclay, John Baron, Henry Bellingham, Andrew Bingham, Bob Blackman, Crispin Blunt, Peter Bone, Victoria Borwick, Graham Brady, Julian Brazier, Andrew Bridgen, Fiona Bruce, Conor Burns, David Burrowes, Bill Cash, Maria Caulfield, Rehman Chishti, Christopher Chope, James Cleverly, Geoffrey Clifton-Brown, Geoffrey Cox, Christopher Davies, David Davies, Glyn Davies, James Davies, Mims Davies, Philip Davies, David Davis, Nadine Dorries, Steve Double, Richard Drax, James Duddridge, Iain Duncan Smith, George Eustice, Nigel Evans, Michael Fabricant, Suella Fernandes, Liam Fox, Mark Francois, Richard Fuller, Marcus Fysh, Nusrat Ghani, Cheryl Gillan, Zac Goldsmith, James Gray, Chris Green, Rebecca Harris, John Hayes, Chris Heaton-Harris, Gordon Henderson, Philip Hollobone, Adam Holloway, Gerald Howarth, Stewart Jackson, Ranil Jayawardena, Bernard Jenkin, Andrea Jenkyns, Gareth Johnson, David Jones, Daniel Kawczynski, Greg Knight, Kwasi Kwarteng, Andrea Leadsom, Edward Leigh, Charlotte Leslie, Julian Lewis, Peter Lilley, Jack Lopresti, Jonathan Lord, Tim Loughton, Karen Lumley, Craig Mackinlay, Anne Main, Kit Malthouse, Scott Mann, Paul Maynard, Karl McCartney, Jason McCartney, Stephen McPartland, Stephen Metcalfe, Nigel Mills, Penny Mordaunt, Anne-Marie Morris, Sheryll Murray, Andrew Murrison, David Nuttall, Matthew Offord, Owen Paterson, Mike Penning, Andrew Percy, Stephen Phillips, Christopher Pincher, Tom Pursglove, Will Quince, Dominic Raab, John Redwood, Jacob Rees-Mogg, Laurence Robertson, Andrew Rosindell, Paul Scully, Henry Smith, Royston Smith, Andrew Stephenson, Bob Stewart, Iain Stewart, Julian Sturdy, Rishi Sunak, Desmond Swayne, Robert Syms, Derek Thomas, Justin Tomlinson, Michael Tomlinson, Craig Tracey, Anne-Marie Trevelyan, Andrew Turner, Martin Vickers, Charles Walker, David Warburton, James Wharton, Heather Wheeler, Bill Wiggin, Mike Wood, William Wragg dhe Nadhim Zahawi (BBC News, 2016).*

Kishte pasur edhe deputetë prej partive të tjera që e kishin mbështetur Brexit-in. Nga PL-ja kishin qenë 10 deputetë, e të cilët ishin: *Ronnie Campbell, John Cryer, Frank Field, Roger Godsiff, Kate Hoey, Kelvin Hopkins, John Mann, Dennis Skinner, Graham Stringer,*

Gisela Stuart. Më pas, kishin qenë tetë deputetë nga Partia Demokratike Unioniste⁴⁰ që e kishin përkrahur daljen e MB-së nga UE-ja, si: *Gregory Campbell, Nigel Dodds, Jeffrey M. Donaldson, Ian Paisley, Gavin Robinson, Jim Shannon, David Simpson dhe Sammy Wilson*. Po ashtu, edhe *Douglas Carswell* nga UKIP dhe *Tom Elliott* nga PUU ishin për largimin e Britanisë nga UE-ja (BBC News, 2016).

III.1.1.6 Reagimet e politikanëve botërorë lidhur me referendumin e vitit 2016 në MB

Çështja e referendunit të anëtarësisë së MB-së në UE nuk kishte qenë preokupim vetëm i politikanëve britanikë sepse referendumi në fjalë nuk mund të cilësohej vetëm si një çështje e brendshme e Britanisë, por konsiderohej si një çështje ndërkombëtare. Pasojat që mund të rezultonin prej aktivizimit të Nenit 50 ishin tejmase serioze dhe shumë shqetësuese për politikanët britanikë dhe ata evropianë, por edhe për shumë politikanë të vendeve të tjera të botës. Megjithatë, nuk mungonin edhe politikanët e atillë që Brexit-in e konsideronin si opsionin e duhur për të ardhmen e MB-së. *Hans Morgenthau theksonte se çdo studiues i politikës ndërkombëtare duhet të mësojë dhe të mos e harrojë kurrë një leksion shumë të rëndësishëm, atë se ndërlikimet e çështjeve ndërkombëtare i bëjnë zgjedhjet e thjeshta dhe profecitë e besueshme të pamundura* (Morgenthau, 1948, p. 20).

Gjatë vitit 2016 ishin disa politikanë evropianë, me pikëpamje euroskeptike që e kishin mbështetur Brexit-in dhe e kishin marrë shembullin e Britanisë si shembull inkurajues për t'u ndjekur edhe në vendet e tyre. Me theks të veçantë duhet përmendur *Marine Le Pen* nga Franca dhe *Geert Wilders* prej Holandës. Ky i fundit si udhëheqës i Partisë për Liri (Partij voor de Vrijheid) kishte pasur mbështetje të madhe nga holandezët gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e parlamentare të Holandës së vitit 2017, gjersa Le Pen ishte përkrahur jashtëzakonisht shumë nga francezët për zgjedhjet presidenciale të Francës të vitit 2017, përkrahje kjo që kishte shkaktuar dridhje të fuqishme në Evropë, duke u bërë ankthi më i keq për UE-në. Këta dy politikanë krahas që kishin të përbashkët politikat e antiemigracionit, që të dy i tërhiqte ndjekja e shembullit të Britanisë për dalje nga UE-ja, nëse ata do të fitonin në zgjedhjet për të cilat kandidonin. Geert Wilders kishte pohuar se edhe Holanda meritonte organizimin e një referendumi mbi anëtarësinë e saj në UE, pra rrjedhimisht kërkonte një referendum për "NExit" ose daljen e Holandës prej UE-së

⁴⁰ Partia Demokratike Unioniste është një parti politike në Irlandën Veriore, e cila është themeluar më 30 shtator 1971.

(Goulard, 2016). Ndërsa Marine Le Pen kishte deklaruar me vendosmëri të madhe gatishmërinë për organizimin e referendumit mbi anëtarësinë e Francës në UE, të ashtuquajturin “Frexit”, madje edhe kishte theksuar se do të dorëhiqej nga posti i presidentes nëse ajo do të dilte fituese në zgjedhjet presidenciale të Francës në vitin 2017, e gjatë votimit të një referendumi të tillë rezultatet do të ishin pro-UE-së (Les Echos, 2016).

Kryeministri holandez *Mark Rutte* për dallim nga të lartcekurit shpresonte se britanikët do të votonin për vazhdimësinë e anëtarësisë së vendit të tyre në UE, ngase kjo e fundit kishte shumë nevojë për një shtet ekonomikisht të fortë dhe me rëndësi strategjike si MB-ja (Reuters, 2016). Pastaj edhe *François Gérard Georges Nicolas Hollande*, i cili në vitin 2017 do të largohej nga posti i presidentit francez, kishte shprehur haptazi dëshirën e tij që Britania të vazhdonte anëtarësinë në UE sepse tërheqja nga kjo e fundit do të kishte pasoja të rënda veçmas për emigracionin dhe ekonominë në MB, por edhe në Francë (BBC News, 2016). Kurse Kancelarja gjermane *Angela Merkel* kishte deklaruar në vazhdimësi se shpresonte që populli britanik do të votonte për qëndrimin e Britanisë në UE (BBC News, 2016). Mirëpo, ndonëse në Gjermani kishte fare pak mundësi për udhëheqje populiste, zhurma e zërave euroskeptikë nuk mund të anashkalohej asesi. *Frauke Petry* që ishte lidere e Alternativës për Gjermaninë (Alternative für Deutschland) në periudhën 2015-2017, madje edhe kishte marrë pseudonimin “Adolfina” për shkak të pikëpamjeve të saj antiemigracioniste dhe antiislamike, ishte kritike shumë e madhe e UE-së dhe njëkohësisht mbështetëse e shumë argumenteve rreth Brexit-it (Connolly, 2016).

Kryeministrja norvegjeze *Erna Solberg* kishte përmendur disa arsye mbi atë se populli britanik duhej të votonte për vazhdimësinë e vendit të tyre në UE, duke ua dedikuar ato euroskeptikëve britanikë që shpresonin të bazoheshin në modelin e marrëdhënieve të Norvegjisë me UE-në nëse rezultatet e referendumit do të ishin në favor të Brexit-it. Sipas saj, humbja e ndikimit në Bruksel duke u mënjanuar nga takimet e politikave të mbrojtjes dhe ato të pranimit të rregullave të UE-së në këmbim të qasjes në Tregun e Brendshëm si pasojë e votimit për dalje do t’i bënte britanikët të pendoheshin përjetësisht (Gurzu, 2016).

Ish-Presidenti i ShBA-ve *Barack Hussein Obama* më 22 prill 2016, në vizitën e tij të pestë në Londër përgjatë dy mandateve të tij si president amerikan, kishte bërë thirrje tek populli britanik që të votonte kundër tërheqjes së MB-së nga UE-ja. Ai kishte theksuar që ShBA-të kishin synim realizimin e marrëdhënieve tregtare me UE-në si bllok, jo me Britaninë në veçanti. Obama gjithashtu kishte thënë se negociimi i marrëveshjeve tregtare të ShBA-ve

me MB-në jashtë UE-së nuk do të ishte aq i lehtë siç mendonin dhe pohonin mbështetësit e Brexit-it (Hughes, 2016). Kundër daljes së Britanisë nga UE-ja ishte edhe kandidatja për presidente të ShBA-ve nga radhët e Partisë Demokratike *Hillary Diane Rodham Clinton*. Për këtë të fundit, referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në UE ishte si një “kryengritje” e britanikëve euroskeptikë ndaj UE-së që ngjallte frikë edhe për rezultatet që do të pasonin nga zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016. Hillary Clinton kishte cekur prezencën shumë të theksuar të nacionalizmit në ShBA dhe të një sërë veprimeve që përbënin rrezik të madh për vlerat demokratike amerikane. Ajo kishte mbështetur maksimalisht rekomandimin e David Cameron-it për vazhdimësinë e anëtarësisë së MB-së në UE (Healy, 2016). Por, për dallim nga Obama dhe Clinton, kandidati për president të ShBA-ve nga radhët e Partisë Republikane *Donald John Trump*, fitorja e së cilit ngjallte një frikë shumë të madhe mbi të ardhmen e politikave amerikane gjatë periudhës 2016-2020 jo vetëm në ShBA, por në tërë botën, ishte pro daljes së Britanisë nga UE-ja. Ai i kishte bërë thirrje popullit britanik që të votonte për tërheqjen e MB-së nga UE-ja sepse sipas tij përgjegjësinë për krizën e shkaktuar nga emigracioni në vitin 2015 në kontinentin evropian e kishte pasur pikërisht UE-ja. Donald Trump pohonte se kjo e fundit me veprimet e saj joefikase vetëm e kishte thelluar atë, prandaj për t’iu dhënë fund njëherë e mirë problemeve të tilla, ai kishte pohuar se opsioni më i mirë për Britaninë ishte dalja e saj nga UE-ja (Levin, 2016).

Kryeministri i Kanadës *Justin Pierre James Trudeau* kishte komentuar sugjerimin për ndjekje të “modelit kanadez” nga MB-ja, në qoftë se rezultatet e referendumit do të ishin në favor të tërheqjes nga UE-ja. Ai kishte theksuar se realizimi i marrëveshjeve tregtare me UE-në jashtë saj as që mund të krahasohet me atë brenda saj, kështu që sipas tij populli britanik duhej të votonte për vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE, ngase separatizmi nuk do të ofronte fare rezultate pozitive (Mason, 2016).

Ndonëse rrallëherë politikanët kinezë interesohen dhe dalin me deklarata rreth çështjeve sovrane të shteteve të tjera sepse fokusohen maksimalisht në preokupimet e tyre të brendshme, në lidhje me referendumin e vitit 2016 në MB befasisht kishte ndarë mendimin e tij edhe Presidenti *Xi Jinping*, i cili kishte deklaruar se e mbështeste vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE (Brown, 2016). Kryeministri indian *Narendra Damodardas Modi* në nëntor të vitit 2015 kishte ndarë pikëpamjet e tij lidhur me referendumin e anëtarësisë së MB-së në UE, ku sipas tij rezultatet pro-Brexit-it e dëmtonin depërtimin e Indisë në UE, ngase nëse ekziston një pikë hyrje për Indinë në UE ajo është Britania (Limaye,

2016). Kryeministri japonez *Shinzō Abe* kishte paralajmëruar votuesit britanikë që dalja e MB-së nga UE-ja mund të kërcënonte investimet nga vendi i tij dhe t'i vinte në rrezik mbi 100,000 vende pune. Ai kishte cekur se mbi 1000 kompani japoneze investojnë në Britani për arsyen kryesore që ajo ishte porta për të depërtuar në UE, prandaj Japonia iu kushtonte shumë rëndësi marrëdhënieve me MB-në (Stewart, 2016).

Ish-Kryeministri i Australisë *Malcolm Bligh Turnbull* kishte potencuar që votimi për dalje të Britanisë nga UE-ja do të kishte ndikim në një sërë marrëveshjesh të MB-së me Australinë. Ai prante rolin e fuqishëm të Britanisë në UE dhe do të mirëpriste vendimin e popullit britanik për vazhdimin e anëtarësisë së vendit në UE (BBC News, 2016).

Përderisa një numër i madh i udhëheqësve botërorë deklaruan haptazi pikëpamjet e tyre lidhur me referendumin e anëtarësisë së MB-së në UE, ku shumica e tyre favorizonin vazhdimësinë e anëtarësimit, presidenti rus *Vladimir Vladimirovich Putin* nuk kishte thënë absolutisht asgjë dhe kishte pasur heshtje totale nga Kremli mbi këtë çështje. Mirëpo, komentet rreth një heshtjeje të tillë nuk kishin munguar nga ana e David Cameron, ku sipas tij dalja e Britanisë nga UE-ja do ta lumturonte presidentin rus (BBC News, 2016).

Sekretari Gjeneral i trembëdhjetë i NATO-s *Jens Stoltenberg*, edhe pse nuk kishte preferuar të komentonte çështje specifike të referendunit mbi anëtarësinë e MB-së në UE, kishte paralajmëruar se Brexit-i do të ishte i dëmshëm për NATO-n, mbi të gjitha për sigurinë ndërkombëtare veçmas në kohën kur bashkëpunimi për luftimin e terrorizmit dhe ruajtjen e stabilitetit në Evropë ishte i domosdoshëm (Sculthorpe, 2016). Drejtoresha menaxhuese e FMN-së *Christine Madeleine Odette Lagarde* kishte pohuar që nuk shihte asgjë pozitive prej daljes së MB-së nga UE-ja, madje ajo kishte theksuar që Brexit-i rrezikonte që ta shpiente Britaninë drejt një recesioni teknik. Efektet negative të Brexit-it ajo i shihte si rreziqe të mëdha rajonale dhe ndërkombëtare. Pastaj, sipas Christine Lagarde referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në UE ishte një çështje me karakter ndërkombëtar sepse në qoftë se rezultatet do të ishin në favor të tërheqjes së Britanisë nga anëtarësia e UE-së, pasojat e Brexit-it do të depërtonin edhe jashtë kufijve evropianë (BBC News, 2016).

III.1.2 Niveli shtetëror

III.1.2.1 Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të MB-së në vitin 2015

Për të kuptuar rritjen e lartë të euroskepticizmit në MB që kishte pasur ndikim të madh në votimin e britanikëve për Brexit, duhet analizuar disa karakteristika të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të Britanisë të mbajtura më 7 maj 2015, produkt i së cilave është edhe referendumi i vitit 2016. Në këto zgjedhje elektorati me të drejtë vote kishte përfshirë 46,354,197 *persona*, kurse në procesin e votimit kishin marrë pjesë 30,697,525 *britanikë* apo 66,2%. Në përgjithësi këto zgjedhje do të veçoheshin edhe prej faktit se kishte pasur rritje të pjesëmarrjes në procesin e votimit në çdo vend të MB-së, ku me theks të veçantë në Skoci kishte pasur ngritje për 7,2% (The Electoral Commission, 2019). Fitues në këto zgjedhje ishin Konservatorët që në krahasim me zgjedhjet e parlamentare të vitit 2010 kishin shënuar rritje për 0,8%. Premtimet e tyre kryesore kishin qenë:

- *Eliminimi i deficitit dhe mbajtja e një suficiti;*
- *Ekstra 8 miliardë £ mbi inflacionin për shërbimet shëndetësore nacionale;*
- *Zgjatja e të drejtës së blerjes për qiramarrësit e shoqatës së strehimit në Angli;*
- *Legjislacioni për t'i mbajtur njerëzit që punojnë 30 orë me pagë minimale larg taksave;*
- *30 orë të lira në javë për kujdestarët e fëmijëve, të cilët punojnë për prindërit e fëmijëve të moshave 3-4 vjeç;*
- *Referendumi i anëtarësimit të Britanisë së Madhe në UE (BBC News, n.d.).*

Në qoftë se fokusi përqendrohet ekskluzivisht vetëm tek premtimet e PK-së në lidhje me UE-në, kjo parti kishte pasur këto katër premtime:

- 1) *Mbajtja e referendumit mbi anëtarësinë e rinegociuar të Britanisë në UE deri në vitin 2017;*
- 2) *Mbrojtja e ekonomisë së MB-së nga integrimi i mëtejshëm i eurozonës;*
- 3) *Zëvendësimi i Ligjit për të Drejtat e Njeriut⁴¹ me një projektligj britanik të të drejtave;*
- 4) *Rezistenca ndaj përpjekjeve të UE-së për t'i kufizuar shërbimet financiare legjitime të shërbimeve financiare (BBC News, n.d.).*

⁴¹ Ligji i të Drejtave të Njeriut është një ligj i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, i cili mori pëlqimin mbretëror më 9 nëntor 1998 dhe hyri në fuqi më 2 tetor 2000. Qëllimi i tij ishte përfshirja e të drejtave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të drejtën e Britanisë.

Tabela 3.1

Votimi i partive politike në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare britanike në vitin 2015

Partitë	Gjithsej ulëse	Ulëse të fituara	Ulëse të humbura	Vota të fituara	Përqindja %
<i>Partia Konservatore</i>	331	35	11	11,334,226	36,9
<i>Partia Laburiste</i>	232	22	48	9,347,273	30,4
<i>Partia Nacionale Skoceze</i>	56	50	0	1,454,436	4,7
<i>Demokratët Liberalë</i>	8	0	49	2,415,916	7,9
<i>Partia Unioniste Demokratike</i>	8	1	1	184,260	0,6
<i>Sinn Féin⁴²</i>	4	0	1	176,232	0,6
<i>Plaid Cymru⁴³</i>	3	0	0	181,704	0,6
<i>Partia Social- Demokrate dhe e Punës</i>	3	0	0	99,809	0,3
<i>Partia Unioniste e Ulsterit</i>	2	2	0	114,935	0,4
<i>UKIP</i>	1	1	0	3,881,099	12,6
<i>Partia Jeshile</i>	1	0	0	1,157,630	3,8

(BBC News, n.d.).

⁴² Sinn Féin është parti politike irlandeze republikane dhe socialiste demokratike, e cila është themeluar në vitin 1905 dhe është aktive në Republikën e Irlandës dhe Irlandën e Veriut.

⁴³ Plaid Cymru është parti politike nacionaliste uellsiane, e cila është themeluar në vitin 1925.

Duhet cekur gjithsesi faktin se këto zgjedhje ishin karakterizuar edhe prej një suksesti të jashtëzakonshëm të UKIP-it që nga themelimi i saj, ku kjo parti ishte renditur në vendin e tretë pas Konservatorëve dhe Laburistëve. Krahasuar me zgjedhjet e vitit 2010, UKIP në vitin 2015 kishte pasur rritje për 9,5%, gjë që e kishte vulosur shkallën e lartë të euroskepticizmit në MB. Thelbi i euroskepticizmit britanik qëndron në refuzimin e anëtarësisë së Britanisë në UE (Harmsen & Spiering, 2004, p. 129).

III.1.2.2 Ngritja e UKIP-it

Edhe pse Britania e Madhe llogaritet si një ndër shtetet me sistem të qëndrueshëm dypartiak, në sistemin politik të saj veprojnë edhe 150 parti ose semiparti. Kohëve të fundit partitë e vogla kanë një mbështetje më të madhe të elektoratit, megjithatë ajo përkrahje është e pamjaftueshme për t'ua rrezikuar pozicionet PK-së dhe PL-së. Sistemi zgjedhor i shumicës, shkalla e lartë e disproporcionalitetit dhe fragmentimit pamundësojnë që partitë e vogla të sigurojnë numrin adekuat të vendeve në Dhomën e Përfaqësuesve (Aziri, 2012, f. 128). Edhe në MB partitë politike përballen me shumë mospajttime dhe kundërshtime. Një nga linjat më të mëdha të kritikave të demokracisë partiake britanike është plotësimi i kësaj të fundit me forma të reja dhe substanciale radikale të angazhimit pjesëmarrës apo të drejtpërdrejtë të qytetarëve. Ekzistojnë dy arsye që i shpjegojnë ato:

- 1) *Partitë politike në Britani vuajnë nga perceptimi i përhapur se ato dështojnë të ofrojnë zgjedhje të mjaftueshme dhe domethënëse për votuesit;*
- 2) *Forca që posedojnë dy partitë kryesore, e që nënkupton shkallën e kontrollit që ato ushtrojnë mbi personelin shtetëror dhe procesin legjislativ (Lawson, 2010, p. 116).*

Një parti politike britanike, e cila ndonëse nuk posedon fuqi shumë të madhe kundrejt Konservatorëve dhe Laburistëve, gjatë referendumit të vitit 2016 kishte pasur një rol jashtëzakonisht të madh dhe kjo parti është UKIP. Sa i përket orientimit programor, kjo e fundit është parti djathtiste dhe karakterizohet prej ideologjisë nacionaliste. Në filllet e saj kjo parti veçohet nga një gamë e gjerë politikash, por nuk përfshihej emigracioni për shkak se ndërlidhej me mënyrën e anëtarësimin në UKIP dhe me atë që kjo parti nuk kishte paragjykimet ndaj të huajve apo pakicave të etnive të tjera (The Guardian, 2018). Euroskepticizmi i UKIP-it është i karakterizuar nga përfaqësimi i gjashtë lirive:

- 1) *Liria prej KEE-së/UE-së;*
- 2) *Liria nga korrektësia politike dhe marksizmi kulturor;*

- 3) *Liria e fjalës;*
- 4) *Liria e të qenurit krenar/e që je britanik/e;*
- 5) *Liria e të qenurit krenar/e për historinë dhe trashëgiminë britanike;*
- 6) *Liria për të vepruar sipas ligjeve britanike, jo sipas ligjeve të Brukselit (UK Independence Party, n.d.).*

Ekzistojnë dy faktorë që nuk e lanë UKIP-in në harresë:

- 1) *Si faktor i jashtëm, cilësohet ndryshimi në sistemin e votimit në zgjedhjet e PE-së me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit më 1 maj 1999, i cili mundësoi inkuadrimin e partive me përqindje të ulëta të votave në vendet e tyre në zgjedhjet e PE-së;*
- 2) *Si faktor i brendshëm konsiderohen rezultatet e zgjedhjeve lokale britanike të vitit 2012, në të cilat UKIP kishte pasur ngritje për 13%, e që historikisht kjo parti ka qenë e karakterizuar nga performanca shumë e dobët në këto zgjedhje (The Guardian, 2018).*

Që nga themelimi e gjer në vitin 2016, UKIP është udhëhequr nga këta shtatë liderë:

- 1) *Alan Sked, i cili e kishte themeluar dhe udhëhequr këtë parti prej vitit 1993 gjer më 1997, vit në të cilin ishte tërhequr për t'iu përkushtuar jetës akademike si profesor i historisë ndërkombëtare në London School of Economics and Political Science;*
- 2) *Craig McKinlay e kishte udhëhequr partinë për më pak se dy muaj në vitin 1997;*
- 3) *Michael Holmes kishte qenë udhëheqës i UKIP-it nga viti 1997 deri më 1999, si dhe po ashtu kishte qenë deputet në PE;*
- 4) *Jeffrey Titford e kishte udhëhequr UKIP-in prej vitit 2000 gjer më 2002, si dhe kishte qenë deputet në PE për një dekadë;*
- 5) *Roger Knapman kishte qenë lider i UKIP-it në periudhën 2002-2006. Ai ishte një ish-deputet i PK-së që iu bashkua UKIP-it pas zgjedhjeve parlamentare britanike të vitit 1997 dhe në vitin 2004 ishte zgjedhur deputet i PE-së;*
- 6) *Lord Pearson ishte zgjedhur udhëheqës i UKIP-it në fund të vitit 2009 dhe shërbeu në këtë detyrë deri në vitin 2010, kur ishte larguar nga partia duke u deklaruar se nuk ishte "i duhuri" për realizimin e synimeve politike të kësaj partie (BBC News, 2016);*
- 7) *Nigel Farage ishte lider i UKIP-it në periudhat 2006-2009 dhe 2010-2016. Ai konsiderohej si figura kryesore e kësaj partie, i cili arriti ta bënte UKIP-in një forcë të madhe në politikën britanike, posaçërisht gjatë fushatës së referendumit të anëtarësisë së Britanisë në UE (Brexit Party, n.d.).*

Tabela 3.2

Numri i votave të marra nga UKIP në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare britanike që nga viti 1997 deri më 2015

Zgjedhjet	Numri i votave	Përqindja e votave
01.05.1997	105,722	0.3%
01.06.2001	390,563	1.5%
05.05.2005	606,000	2.2%
06.05.2010	919,546	3,1%
07.05.2015	3,881,099	12,6%

Shënim: Të dhënat janë përshtatur nga: *United Kingdom Parliament, 1997; Mellows-Facer, 2005, p. 47; BBC News, n.d.; BBC News, n.d.*

UKIP ishte bërë pjesë e zgjedhjeve parlamentare të MB-së në vitin 1997 dhe në çdo palë zgjedhje kishte pasur rritje. Por, në vitin 2015 kjo parti kishte befasuar me suksesin që e kishte arritur, duke marrë 12,6% të totalit të votave, ku duhet përmendur që UKIP në Angli kishte marrë gjithsej 3,611,400 vota ose 14,1% (Hawkins et al., 2015, p. 36). Mirëpo, shtrohet pyetja, me çfarë premtimesh ishte karakterizuar kjo parti gjatë fushatës elektorale për këto zgjedhje, pasi kishte arritur një rezultat të tillë? Premtimet kyçe të UKIP-it kishin qenë këto:

- *Organizimi i shpejtë i referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në UE;*
- *Kontroll i rreptë i emigracionit, 50,000 punëtorë të kualifikuar në vit, si dhe ndalimi i emigracionit të pakualifikuar për pesë vite;*
- *Ekstra 3 miliardë £ në vit për Kujdesin Kombëtar Shëndetësor në Angli;*
- *Eliminimi i tatimeve për pagat minimale;*
- *Të rritet “substancialisht” përqindja e GDP-së britanike në kontributin për mbrojtje në NATO, që ishte 2% (BBC News, n.d.).*

Kurse, premtimet kryesore të UKIP-it në lidhje me UE-në ishin:

- *Tërheqja nga UE-ja nëpërmes votave “pro daljes” nga referendumi i organizuar;*
- *Të gjitha kompetencat legislative të pushojnë me Westminster-in;*
- *Negocimi i marrëveshjes së re tregtare me UE-në (BBC News, n.d.).*

Tabela 3.3

Numri i votave të marra nga UKIP në zgjedhjet e PE-së nga viti 1999 deri më 2014

Zgjedhjet	Numri i votave	Përqindja e votave	Numri i deputetëve në PE
<i>10-13 Qershor 1999</i>	<i>696,057</i>	<i>7%</i>	<i>3</i>
<i>10-13 Qershor 2004</i>	<i>2,660,768</i>	<i>16,2%</i>	<i>12</i>
<i>4-7 Qershor 2009</i>	<i>2,498,226</i>	<i>16,5%</i>	<i>13</i>
<i>22-25 Qershor 2014</i>	<i>4,376,635</i>	<i>27,49%</i>	<i>24</i>

Shënim: Të dhënat janë përshtatur nga: *Morgan & Cracknell, 1999, p. 11; Schlager et al., 2006, p. 1426; BBC News, n.d.; BBC News, n.d.*

Para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2015 në Britani, UKIP kishte arritur sukses shumë të madh edhe në zgjedhjet e PE-së së vitit 2014, kur u rendit e para nga partitë britanike duke lënë pas vetes Konservatorët dhe Laburistët. Në vitin 2014 dhe 2015 UKIP ishte votuar kryesisht prej personave të moshave 65 vjeç e lart, si dhe krahas mbështetjes së madhe që kishte prej euroskeptikëve, kjo parti ishte përkrahur edhe nga ajo pjesë e popullit që e konsideronte emigracionin tejmase të dëmshëm për MB-në, si dhe që kishte mospajtime, kundërshtime dhe pakënaqësi të thella me politika të caktuara të UE-së. Kjo parti kishte marrë vota më së shumti prej shtresës së papunësuar dhe asaj të pensionuar. Sa i përket etnicitetit, UKIP kishte pasur përkrahje marramendëse nga të bardhët krahasuar me etnitë e tjera (Milazzo & Goodwin, 2015, p. 375).

Filozofi anglez Thomas Hobbes mendon se njerëzit, e para, duan të mbijetojnë dhe, e dyta, duan të kenë një jetë të këndshme e të lirshme dhe, për më tepër, duan pushtet dhe nder. Njëkohësisht, ai mendon se njerëzit janë relativisht njësoj në ndjeshmëri dhe aftësi, ndërkohë që ka mungesë të mirash. Nga ky shkak, zhvillohet një luftë e të gjithëve, kundër të gjithëve. Disa sulmojnë pronat, jetën dhe lirinë e të tjerëve, për të siguruar mbijetesën dhe për të përmirësuar interesat materiale. Të tjerët luftojnë për nderë dhe pushtet (Malnes & Midgard, 2007, ff. 90-91). Organizimi i referendumit mbi anëtarësinë e Britanisë në UE pasoi me përpjekje maksimale të UKIP-it për t'ua imponuar britanikëve votimin për largimin e MB-së nga UE-ja, për të realizuar qëllimin kryesor të kësaj partie. Sipas Panelit Britanik për Zgjedhjet në Internet, mbështetja partiake e UKIP-it për daljen e vendit nga UE-ja kishte

qenë 95%, përderisa ajo e PK-së ishte 55% (British Election Study, 2016). Mbështetësit e Brexit-it kishin pohuar se votat e tyre për dalje të Britanisë nga UE-ja shiheshin si mundësi të krijimit të perspektivave më të mira për të ardhmen e tyre dhe të pasardhësve të tyre, ndërkaq UKIP ishte cilësuar si partia e vetme që kishte dëgjuar këto brenga e që kishte folur në gjuhën që ata e kuptonin (Seidler, 2018, p. 11).

Në lidhje me emigracionin UKIP-i vazhdimisht kishte pohuar se MB-në e ka dëmtuar së tepërmi emigracioni masiv dhe i pakontrolluar, për të cilin adresonte kritika të ashpra ndaj qeverive të njëpasnjëshme. Gjersa shifra zyrtare e popullsisë britanike në vitin 1997 kishte qenë 58 milionë banorë, në vitin 2016 ajo kishte arritur në 66 milionë. Sipas kësaj partie rritja e popullsisë për 6.6 milionë mes viteve 2000 dhe 2016 ishte 80%, kryesisht për shkak të migrantëve dhe lindjeve të tyre. Një normë e tillë e rritjes ishte e paqëndrueshme për një nga vendet më të populluara në botë, prandaj duhej të vendoseshin masa kufizuese ndaj migrantëve, përfshirë këtu edhe punëtorët me leje pune dhe studentët. Gjithashtu emigrantët nuk do të mund të kërkonin strehim apo beneficione publike gjersa nuk paguanin taksa për një periudhë pesëvjeçare të qëndrimit në Britani. UKIP-i kërkonte edhe anulimin e pëlqimit të MB-së për Deklaratën e Barcelonës së vitit 1995,⁴⁴ dokument ky që prej kësaj partie cilësohej si një hapje dyersh për emigrim të pakontrolluar dhe të pakufizuar të njerëzve që vinin nga Afrika, Lindja e Mesme dhe më gjerë (UK Independence Party, n.d.). UKIP kishte theksuar që një nga problemet më domethënëse për MB-në ka qenë mundësia që qytetarët e UE-së kishin qasje në strehimin social në të njëjtën bazë si britanikët, gjë e cila pas daljes nga UE-ja do të merrte fund (UK Independence Party, n.d.).

Sa iu përket politikave tregtare britanike, sipas UKIP-it ato kanë qenë nën kontrollin e KEE/UE-së që nga viti 1973. Bizneset britanike kanë qenë të detyruara t'i binden legjislacionit UE-së edhe kur nuk eksportonin në vendet e saj anëtare. Kjo parti pohonte se përmes Brexit-it Britania do të ishte e lirë t'i ndiqte politikat e saj tregtare dhe komerciale, të cilat do të rezultonin me mundësi më të mëdha për tregti dhe rritje punësimi. UKIP kishte deklaruar që përafërsisht 10-12% e ekonomisë britanike ishte e koncentruar në eksportet me vendet e UE-së, ndërsa 100% e bizneseve britanike duhej t'i respektonin të gjitha ligjet e UE-së. Partia në fjalë kishte pohuar se Brexit-i do t'ia mundësonte MB-së forcimin e lidhjeve

⁴⁴ Deklarata e Barcelonës është një marrëveshje e arritur më 27-28 nëntor 1995 mes shteteve anëtare të UE-së dhe disa vendeve mesdhetare, e cila iu mundëson banorëve të vendeve mesdhetare të jetojnë në vendet anëtare të UE-së, pa pasur nevojë që të integrohen në to.

ekonomike me miqtë dhe aleatët e saj historikë në Komonuelth, përfshirë këtu një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë të Komonuelthit (UK Independence Party, n.d.). Sipas UKIP-it Britania kishte deficit të përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime me UE-në, vlera e së cilit ishte 64 miliardë £ (UK Independence Party, n.d.). Po ashtu, pasi të jetë larguar nga UE-ja, MB-ja do të mund të ushtronte kontroll mbi TVSH-në, që nënkuptonte mundësinë për të ulur normat e TVSH-së në zero për disa mallra si karburantet shtëpiake, produktet sanitare dhe riparimet në ndërtesat tregtare, banesore dhe historike (UK Independence Party, n.d.).

Mbi drejtësinë penale, UKIP e përmendte faktin se Britania duhej të shfuqizonte tërë legjislacionin e frymëzuar nga UE-ja, i cili krijonte lidhje mes institucioneve juridike britanike dhe atyre të UE-së, si dhe me instrumentet ligjore të kësaj të fundit, si p.sh., Urdhri Evropian i Arrestit,⁴⁵ dhe t'i zëvendësojë ato me marrëveshjet paraekzistuese për bashkëpunimin reciprok, ose traktate të reja që mbrojnë të drejtat themelore të qytetarëve në MB sipas ligjeve britanike (UK Independence Party, n.d.). Pas daljes së Britanisë nga UE-ja, UKIP theksonte se Britania do të mund t'i shfuqizonte të gjitha ligjet e UE-së që kanë kufizuar lirinë e shprehjes (UK Independence Party, n.d.).

UKIP kishte cekur se pas Brexit-it politika e jashtme britanike nuk do të kishte më nevojë të lidhej me Politikën e Përbashkëta të UE-së për Punë të Jashtme, të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, të cilat në mënyrë të pashmangshme do ta përfshinin MB-në në forcat e armatosura të planifikuara të UE-së, si dhe do ta ngatërronin Britaninë në ambiciet e politikës së jashtme të UE-së (UK Independence Party, n.d.). Gjithashtu në lidhje me politikën ambientaliste, pas largimit nga UE-ja, UKIP kishte theksuar që MB-ja do të ishte e lirë të mbështeste standarde të larta mjedisore që mbrojnë cilësinë e ajrit, rrugët ujore, pyjet, tokën bujqësore dhe vendbanimet e tjera (UK Independence Party, n.d.).

Dalja e MB-së nga UE-ja ishte çështje që buroi nga brendësia e PK-së dhe medieve britanike sepse këto të fundit ndikuan në shtytjen e këtij procesi (K. Featherstone, interview via email, September 1, 2020). Mirëpo, UKIP e solli çështjen e daljes së Britanisë nga UE-ja në krye të agjendës politike britanike. Meritat e kësaj partie për Brexit janë të pamohueshme, veçmas për faktin se gjatë shpërndarjes së informacioneve në fushatën e referendumit të vitit 2016, kjo parti me parimet e saj kishte ndikuar në rritjen e ndjenjave

⁴⁵ *Urdhëri Evropian i Arrestit* është është një procedurë e thjeshtësuar e dorëzimit gjyqësor ndërkufitar, me qëllim të ndjekjes penale apo ekzekutimit të një vendimi të dënimit me burg ose urdhërin e ndalimit. Vendimi për UEA ka hyrë në fuqi prej 1 janarit 2004 dhe ka zëvendësuar procedurat e gjata të ekstradimit që ekzistonin mes vendeve të UE-së.

euroskeptike të një pjese të caktuar të popullatës britanike, ndikim ky që pasoi edhe me rezultatet në favor të daljes së Britanisë nga UE-ja, duke e drejtuar vendin drejt një të ardhmeje shumë të pasigurt dhe përplot rreziqe.

III.1.2.3 Ndikimi i gazetave britanike

Bindja e opinionit publik në Britani për të mbështetur dëshirën e David Cameron-it që të votohej vazhdimi i anëtarësisë së MB-së në UE kishte qenë i ndikuar edhe prej nivelit shumë të ulët të njohurive të britanikëve rreth funksionimit të institucioneve dhe politikave të UE-së. Këto mangësi të njohurive kishin krijuar hapësira favorizuese për depërtimin e lajmeve të gazetave të ndryshme britanike, veçmas atyre me pikëpamje euroskeptike që shquheshin për artikuj shumë armiqësorë ndaj UE-së, me ç'rast ishin krijuar qëndrime të gabueshme për UE-në dhe çdo gjë që kishte të bënte me të (McGowan, 2018, p. 3).

Gjatë fushatës së referendumit të vitit 1975 gazetatat që me artikujt e tyre e kishin favorizuar vazhdueshmërinë e anëtarësisë së Britanisë në KEE ishin: *“Daily Mirror”*, *“The Sun”*, *“Daily Express”*, *“Daily Mail”*, *“The Daily Telegraph”*, *“Financial Times”*, *“The Times”*, *“The Guardian”* dhe *“Daily Record”*. Ndërsa ishte vetëm gazeta *“The Morning Star”* që e kishte favorizuar daljen e Britanisë nga UE-ja (Butler & Kitzinger, 1996, pp. 226-228).

Ndërsa, gjatë fushatës së referendumit të vitit 2016 gazetatat britanike kishin qenë të klasifikuara në dy grupe:

- 1) Gazetat pro-qëndrimin të MB-së në UE** - *“The Times”*, *“The Mail on Sunday”*, *“Daily Mirror”*, *“Financial Times”*, *“The Observer”* dhe *“The Guardian”*;
- 2) Gazetat pro-daljes së MB-së nga UE-ja** - *“The Sun”*, *“The Sunday Times”*, *“The Sunday Telegraph”*, *“The Daily Telegraph”*, *“Daily Mail”*, *“Daily Express”* dhe *“The Daily Star”* (Levy et al., 2016, p. 11).

Një muaj para votimit të referendumit të Brexit-it, “Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë” në Universitetin e Oxford-it kishte bërë një hulumtim lidhur me artikujt e gazetave britanike gjatë fushatës së referendumit në vitin 2016. Të gjeturat e këtij hulumtimi, të cilat kishin mbuluar dy ditë mostra të një jave gjatë dy muajve të parë të fushatës së referendumit, menjëherë pas mbledhjes së kabinetit pas Samitit të David Cameron-it më 20 shkurt 2016, kishin zbuluar se prej 928 artikujve të fokusuar në referendum, 45% kishin qenë në favor të daljes së MB-së nga UE-ja krahasuar me 27% që kishin qenë në favor të qëndrimit të Britanisë në UE. Nga pjesa e mbetur, 19% e artikujve të

përqendruar në referendum ishin kategorizuar si “të përzier ose të pavendosur” dhe 9% pa asnjë pozicion. Prej numrit të përgjithshëm të zëdhënësve të cituar në artikuj, 36% kishin qenë politikanë të MB-së, nga të cilët 69% Konservatorë dhe 14% Laburistë. Të gjitha gazetatat, pavarësisht pozicionit të tyre favorizues apo antifavorizues sa i përket Brexit-it, kishin përfshirë disa artikuj që paraqisnin edhe këndvështrimet e tjera, por përqindja e këtyre ishte më e vogël në “Daily Express” dhe “Daily Mirror”. Të gjeturat paraprake kishin treguar se mesatarisht në një ditë brenda kësaj periudhe kishte pasur 42 artikuj të fokusuar në çështjen e referendumit në gazetatat si “Daily Mail”, “The Daily Telegraph” dhe “The Times”, tri gazeta që kishin pasur numrin më të madh të artikujve mbi referendumin, duke vazhduar me “Financial Times”, “Daily Express”, “The Guardian” dhe “The Sun”, kurse “Daily Mirror” dhe “The Daily Star” që kishin pasur numër më të vogël të artikujve për këtë çështje.

Nëse lihen anash artikujt mbi personalitetet, argumentet më të cituara në 765 artikuj kishin qenë ata për ekonomi/biznes me 33%, sovranitetet 29%, migrim 18%, rregullore 14% dhe terrorizëm/siguri 6%. Gazetat “The Sun” dhe “Daily Mirror” ndonëse kishin pasur pozicione të ndryshme kundrejt UE-së, me artikujt e tyre kishin qenë kryesisht të fokusuar rreth çështjes së sovranitetit. “Financial Times”, “The Guardian”, “The Daily Telegraph” dhe “The Times” më së shumti kishin qenë të përqendruara në argumente rreth ekonomisë dhe më pak me sovranitetin. Me çështjen e migracionit ishin marrë më së shumti “Daily Express”, “The Daily Star” dhe “Daily Mail”. Kur Konfederata e Industrisë Britanike kishte paralajmëruar rrezikshmërinë e pasojave ekonomike që mund të buronin prej Brexit-it, pas datës 21 mars 2016 përqendrimi i gazetave në përgjithësi në çështje ekonomike ishte rritur për 60%. Ndërsa argumentet e fokusuar në terrorizëm dhe çështje të sigurisë e rritën frekuencën e tyre pas sulmeve terroriste të datës 22 mars 2016 në Bruksel (University of Oxford, 2016). Gazetat e lartpërmendura kishin arritur të shtrijnë ndikimin e tyre nëpërmes faqeve të para, duke vendosur tituj që kishin tërhequr vëmendje shumë të madhe. Përpos ndikimit të drejtpërdrejtë tek audienca, kishin ndikuar edhe tek vetë politikëbërësit.

III.1.2.4 Fushata “Vote Leave and Take Control”

Më 9 tetor 2015 ishte lansuar kampanja “Vote Leave and Take Control” nëpërmes një videoje, gjersa më 13 prill 2016 Komisioni Elektoral i MB-së përcaktoi dy kampanja lidhur me referendumin: “Vote Leave and Take Control” dhe “Britain Stronger in Europe” (Shipman, 2016, pp. 16-18). Fushata “Vote Leave and Take Control” ishte njëra nga

kampanjat kryesore në referendumin e 23 qershorit 2016 për anëtarësinë e Britanisë në UE, si dhe më e rëndësishmja për Brexit-in. Veçoritë e saj bazoheshin në shpalosjen e arsyeve specifike mbi atë se përse britanikët duhej të votonin për tërheqjen e vendit të tyre nga UE-ja dhe ofrimin e një skenari se çfarë do të mund të ndodhte me MB-në nëse do të vazhdonte të ishte vend anëtar në UE.

Realizmi bazohet në tri pandehma themelore rreth faktit se si funksionon bota dhe njëra prej tyre është egoizmi. Egoizmi motivon sjelljen politike. Megjithëse disa kushte lehtësojnë sjelljen altruiste, egoizmi i ka rrënjët në natyrën njerëzore. Në rastin më të keq dhe ekstrem të përballjes mes interesit kolektiv dhe interesit vetjak, egoizmi ka tendencë të mposhtë altruizmin. Siç thotë shprehja e vjetër klasike realiste: “Çnjerëzorja është thjeshtë njerëzorja nën presion” (Smith et al., 2012, f. 69). Pesë arsytet për të cilat do t’ia vlente tërheqja e MB-së nga UE-ja sipas kësaj fushate ishin:

- 1) Votimi për dalje nga UE-ja nënkuptonte kursimin e 350 milionë £ që MB-ja ia ofronte UE-së çdo javë, para këto që do të mund të shpenzoheshin për çështje më të rëndësishme për britanikët siç ishin KKS, shkollat dhe strehimi. Që nga viti 1973 Britania ia ka dërguar UE-së mbi gjysmë trilion £ dhe 350 milionë £ në javë janë pothuajse gati 20 miliardë £ në vit;*
- 2) Pas largimit nga UE-ja, britanikët do të ishin përgjegjës për kufijtë e MB-së. Në një botë me kaq shumë kërcënime të reja, për Britaninë do të ishte më e sigurt që t’i kontrollonte kufijtë e saj dhe të vendoste vetë se kush do të mund të vizitonte territorin e saj, e jo të sundohej nga gjykatësit e UE-së. Një çerek milioni i migrantëve nga UE-ja vinë në Britani çdo vit dhe kjo shkakton tendosje shumë të madhe tek shërbimet publike si KKS dhe shkollat. GjDUE-ja nuk mund t’i ndalojë kriminelët e dhunshëm që të vijnë në Evropë, si dhe ia ndalon MB-së dëbimin e personave të dyshuar si të rrezikshëm për terrorizëm;*
- 3) Përmes tërheqjes nga UE-ja, britanikët do ta kontrollonin emigracionin dhe do të kishin një sistem më të drejtë, i cili do t’i mirëpriste njerëzit në MB duke u bazuar në aftësitë që kanë, e jo nga pasaporta që mbajnë. Kriza e UE-së me migrantët kishte dalë jashtë kontrollit, pastaj gjykatësit e UE-së po përdorin Kartën e UE-së për të Drejtat Themelore për të marrë më shumë fuqi nga policia dhe shërbimet britanike të sigurisë. Ish-Sekretari Gjeneral i INTERPOL-it nga viti 2000 gjer më 2014 Ronald K. Noble kishte thënë se marrëveshja me kufij të hapur e Evropës do të shërbente si një*

zonë ndërkombëtare pa pasaporta për terroristët dhe kjo ishte si “varje e një shenje që mirëpriste terroristët në Evropë”;

- 4) Pas Brexit-it, MB-ja do të ketë liri të tregtojë me tërë botën, sepse UE-ja ia ndalonte Britanisë që të nënshkruajë marrëveshje tregtare me aleatët kryesorë të saj, si Australia dhe Zelanda e Re, dhe ekonomitë në rritje si India, Kina dhe Brazili. Vetëm 5% e bizneseve britanike eksportojnë në UE, por 100% e tyre vuajnë barrën e shiritave të UE-së. Rregulloret e UE-së janë shumë të dëmshme për ekonominë britanike, duke u kushtuar bizneseve të vogla miliona £ çdo javë. Pastaj, rregulloret e energjisë së UE-së kanë kosto për miliona familje dhe biznese të vogla në MB. Britania nuk ka fuqi të bëjë marrëveshje të tregtisë së lirë me ekonomi në zhvillim të shpejtë si India dhe Kina, ndryshe nga Islanda dhe Zvicra që nuk janë vende anëtare të UE-së;
- 5) Britanikët duhet t'i bëjnë vetë ligjet e tyre, përmes njerëzve të zgjedhur nga populli në mënyrë demokratike. Gjysma e ligjeve britanike janë bërë nga burokratët e pazgjedhur të UE-së në Bruksel, të cilët britanikët nuk i kanë votuar kurrë. Eurozona ka një shumicë të përhershme në sistemin e votimit në UE, që do të thotë se MB-ja gjithnjë është nënvlerësuar, po ashtu është nënvlerësuar çdoherë që ka votuar kundër UE-së, si dhe këto ligje taksapaguesve britanikë iu kanë kushtuar 2,4 miliardë £ (Vote Leave and Take Control, n.d.).

Kjo fushatë konkludonte që marrëveshja e arritur nga David Cameron prej rinegociimit me UE-në ishte dështim total, e cila nuk i kursente MB-së para sepse prej 350 milionë £ në javë deri në vitin 2020 kjo shumë mund të rritej në 400 milionë £. Pastaj, kjo marrëveshje nuk ishte edhe ligjrisht e detyrueshme. Sipas kësaj kampanje, nëse votat e britanikëve do të ishin në favor të vazhdimit të anëtarësisë së Britanisë në UE, ato do të nënkuptonin:

- Dorëzim të përhershëm të shumës prej 350 milionë £ çdo javë në Bruksel;
- Anulim të përhershëm të ligjeve të MB-së dhe dominim të ligjeve të UE-së dhe GjDUE-së;
- Kontroll të përhershëm të UE-së në realizimin e tregtisë dhe ekonomisë britanike;
- Kontrollin e përhershëm të UE-së mbi sigurinë dhe migracionin (Vote Leave and Take Control, n.d.).

III.1.3 Niveli sistematik

III.1.3.1 Referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitin 1975

Me kalimin e kohës, u argumentua se përdorimi i referendumeve nuk binte ndesh me konceptin e sovranitetit parlamentar sepse nëse parlamenti mund të bëjë gjithçka që i pëlqen, atëherë mund të thërrasë një referendum. Për më tepër, sovraniteti parlamentar do të thotë se nuk mund të kufizohet ligjërisht nga rezultati. Britania është një demokraci liberale dhe si e tillë fuqia qeveritare pranohet nga marrëveshja e të qeverisurve. Në shumicën e rasteve të qeverisurit shprehin pikëpamjet e tyre përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, gjë që është edhe arsyeja për zgjedhje të rregullta dhe konkurruese. Sidoqoftë, ndonjëherë ekziston ndonjë çështje e fortë kushtetuese për një demokraci të drejtpërdrejtë, për të cilën kërkohet pëlqimi i të qeverisurve nëpërmjet një referendumi. Koncepti i “pëlqimit” nënkupton atë që njerëzit duhet të bien dakord për mënyrën se si do të qeverisen (Farrell & Goldsmith, 2017, pp. 619-620). Mirëpo, jo gjithnjë referendumet mund të cilësohen si mjete të duhura për marrjen e vendimeve themelore lidhur me drejtimin në të cilin duhet lëvizur vendi. Ligjshmëria e tyre ndikohet shumë nga koha e organizimit, formulimi i pyetjes, niveli i pjesëmarrjes ose marzhi i fitores (Butler & Kitzinger, 1996 p. 7).

Përdorimi i referendumeve në MB ka një histori paksa të ngatërruar, por viteve të fundit ato janë bërë mjete gjithnjë e më të popullarizuara, si dhe mekanizma të vendosur për vërtetimin e nismave kushtetuese britanike. Referendumet shihen si mjete të duhura për të forcuar demokracinë, duke iu dhënë votuesve mundësi më të mëdha për inkuadrim në procese politike. Disa prej tipareve pozitive të referendumeve në Britani janë:

- *Rritja e procesit demokratik;*
- *Mundësia për të zgjedhur një sërë çështjesh;*
- *Forcimi i angazhimit të qytetarëve dhe promovimi i edukimit të votuesve;*
- *Aftësia e votuesve për të bërë gjykime të arsyeshme;*
- *Plotësimi i demokracisë përfaqësuese.*

Mirëpo, nuk duhet të përjashtohen edhe tiparet negative të referendumeve, të tilla si:

- *Konsiderohen pajisje taktike;*
- *Dominohen prej grupeve elitare;*
- *Nuk ofrojnë “zgjidhje” për çdo çështje;*

- *Mund të mos kenë lidhshmëri me çështjen mbi të cilën realizohen;*
- *Minojnë demokracinë përfaqësuese.*

Korniza kryesore rregullatore për referendumet në MB është përcaktuar nga Ligji i Partive Politike, Zgjedhjeve dhe Referendumeve në vitin 2000.⁴⁶ Megjithatë, secili referendum ende kërkon legjislacion të veçantë për ta bërë të mundur realizimin e tij (House of Commons, 2016). Në MB janë organizuar gjithsej tri referendume, dy nga të cilat ndërlidhen me anëtarësinë e Britanisë në KEE/UE. Referendumi i Brexit-it është referendumi i dytë nëpërmes së cilit politikanët britanikë i kërquan popullit të tyre që të vendosnin për kahjen e marrëdhënieve të MB-së me Evropën, pas atij të vitit 1975 kur ishte organizuar një referendum mbi atë nëse Britania duhej të mbetej apo të largohej nga KEE-ja (Glencross, 2016, p. 8). Duhet theksuar që krahas këtyre dy referendumeve në MB ishte organizuar edhe një tjetër referendum mbi votën alternative në MB në vitin 2011.⁴⁷

Përpos rezultateve, ndërmjet dy referendumeve britanike mbi anëtarësinë e Britanisë në KEE/UE në vitet 1975 dhe 2016 ekzistojnë edhe disa dallime të tjera. Në krahasim me referendumin e vitit 2016 që u realizua nga qeveria e udhëhequr prej Konservatorëve, referendumi mbi anëtarësinë e MB-së në KEE i vitit 1975 ishte organizuar nga Laburistët. Pastaj, fushat kryesore mbi të cilat Britania kishte shprehur shqetësime sa i përket anëtarësimin të saj në KEE kishin qenë:

- 1) *Politika e Përbashkët Bujqësore*** – *MB-ja kishte kërkuar ndryshime të mëdha në politikën e përbashkët bujqësore, në mënyrë që ajo të pushonte së qenuri kërcënim për tregtinë botërore të produkteve ushqimore dhe në këtë mënyrë prodhuesit me kosto të ulëta jashtë Evropës mund të kishin vazhduar që të kishin qasje në tregun britanik ushqimor;*
- 2) *Kontributi i Britanisë në buxhetin e KEE-së*** - *MB-ja kishte kërkuar metoda të reja dhe më të drejta në financimin e buxhetit të KEE-së;*

⁴⁶ Ligji i Partive Politike, Zgjedhjeve dhe Referendumeve, i cili ka marrë pëlqimin mbretëror më 30 nëntor 2000, përcakton kornizën ligjore për zhvillimin e referendumeve në Mbretërinë e Bashkuar, në një ose më shumë vende përbërëse të saj, ose në ndonjë rajon të Anglisë, ku ai referendum zhvillohet në zbatim të një ligji të miratuar nga Parlamenti britanik.

⁴⁷ Referendumi i Mbretërisë së Bashkuar mbi Votën Alternative apo Referendumi në Britani për Sistemin e Votimit Parlamentar ishte mbajtur më 5 maj 2011. Arsyeja e një referendumi të tillë ishte ndryshimi i mënyrës së zgjedhjes së Deputetëve në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, mirëpo me një dalje prej 42,0%, ishin 67,9% e votuesve kundërshtuan ndryshimin e sistemit zgjedhor në votën alternative, ndërsa 32,1% e mbështetën atë.

- 3) **Qëllimi i Unionit Ekonomik dhe Monetar** - në lidhje me Unionin Ekonomik dhe Monetar, Britania kishte cekur që do të refuzonte çdolloj marrëveshje ndërkombëtare që detyrohej të pranonte rritje të papunësisë për hir të ruajtjes së një barazie fikse;
- 4) **Harmonizimi i TVSH-së** - MB-ja nuk pranonte asnjë harmonizim të TVSH-së që do t'i kërkonte të taksonte nevojat;
- 5) **Sovraniteti parlamentar në ndjekjen e politikave rajonale, industriale dhe fiskale** - kjo nënkuptonte mbajtjen nga ana e Parlamentit të Britanisë së atyre fuqive mbi ekonominë britanike, të cilat ishin të nevojshme për të ndjekur politika efektive rajonale, industriale dhe fiskale. Lëvizjet e kapitalit ndërlidheshin me nevojën e një marrëveshjeje për lëvizjet e kapitalit, e cila do të mbronte bilancin e pagesave britanike dhe politikat e plota të punësimit (Miller, 2015, pp. 12-18).

Gjersa në referendumin e vitit 2016 emigracioni konsiderohet si faktor kyç në vendimin e MB-së për t'u tërhequr nga UE-ja, ai nuk ishte shqetësues në referendumin e vitit 1975, madje ishte përmendur fare pak. Në këtë dekadë ekzistonin kufijtë për punëtorët e shteteve të tjera anëtare të KEE-së që pamundësonin lëvizjen e lirë dhe të plotë të tyre në KEE, gjersa nuk kishte hyrë në fuqi Traktati i Mاستrihit më 1 nëntor 1993. Pastaj, ideja që njerëzit do të dëshironin të vinin në një Britani të dëshpëruar, dhe ekonomikisht të stagnuar, do të dukej fantastike në rastin më të mirë në vitin 1975.

Krahas dallimeve, referendimet kanë edhe të përbashkëta. Çështjet ekonomike si konkurrueshmëria dhe kontributet financiare, si dhe sovraniteti kishin qenë fusha shqetësuese të britanikëve në vitin 1975, por edhe në vitin 2016. Pastaj, kryeministrat Harold Wilson në vitin 1975 dhe David Cameron në vitin 2016, kishin premtuar organizimin e referendimit mbi anëtarësinë e rinegociuar të MB-së në KEE/UE në zgjedhjet për të cilat ata kishin qenë kandidatë të partive të tyre për ta marrë pushtetin, e kishin mbajtur këtë premtim, si dhe kishin bërë thirrje për vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në KEE/UE, duke theksuar gjithnjë benefitet që vinin nga anëtarësimi në këtë të fundit për popullin britanik.

Referendumi në fjalë ishte mbajtur më 5 qershor 1975. Elektorati i regjistruar kishte përfshirë gjithsej *40,456,877 britanikë*, gjersa pjesëmarrja e tyre kishte qenë **64,5%**. Për vazhdimin e anëtarësisë së MB-së në KEE kishin votuar **17,378,581 persona** apo **67,2%**, kurse për dalje **8,470,073 persona** ose **32,8%**. Nga 25,903,194 vota në total, prej tyre kishin qenë 25,848,654 vota vlefshme, kurse 54,540 vota të pavlefshme (Miller, 2015, p. 25).

Tabela 3.4*Votimi i referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE në vitin 1975 nga vendet britanike*

Vendet	Dalja në votim	Po	Jo
<i>Anglia</i>	64,6%	68,7%	31,3%
<i>Uellsi</i>	66,7%	66,5%	33,5%
<i>Skocia</i>	61,7%	58,4%	41,6%
<i>Irlanda Veriore</i>	47,4%	52,1%	47,9%

(King, 1977, p. 145).

Ndonëse të gjitha vendet e MB-së kishin votuar për vazhdimin e anëtarësisë së kësaj të fundit në KEE, po të krahasohen rezultatet e këtij referendumi me ato të vitit 2016 vihet re se mbështetja e vazhdimin të anëtarësisë së Britanisë në UE kishte rënë 18% në Angli, kurse 19,2% në Uells. Kurse në Skoci përkrahja e daljes së MB-së nga UE-ja ishte zvogëluar 3,6% dhe në Irlandën Veriore 3,7%.

Duket se aspekti i sigurisë, mbrojtja e vlerave britanike, qëllimet komerciale dhe industriale, si dhe benefitet e zhvillimit të tregtisë së lirë me KEE-në e kishin disfavorizuar daljen e MB-së nga KEE-ja. Referendumi i vitit 1975 ishte bazuar mbi atë nëse duhet të vazhdonte anëtarësia britanike në Tregun e Përbashkët të përbërë nga 9 shtete, apo Britania do të kthehej në EFTA⁴⁸ që kishte 6 shtete. Qeveria e Harold Wilson-it në ekuilibër, por jo pa ndonjë mospajtim të konsiderueshëm në radhët e saj, duke rezultuar në një heqje të përkohshme të doktrinës së solidaritetit të kabinetit kishte preferuar që MB-ja të mbetej në KEE. Megjithëse kjo e fundit ishte një “union gjithnjë e më i afërt”, në atë kohë nuk kishte sugjerime të ndonjë forme të bashkimit politik dhe as që KEE-ja do të zgjerohej në 28 vende anëtare, prandaj votimi i popullit britanik ishte në favor të mbetjes së vendit të tyre në KEE (D. Farrington, interview via email, September 6, 2020). Në referendumin e vitit 1975 organizatat përfaqësuese të biznesit në Britani kishin favorizuar mbetjen në KEE, pastaj pjesa më e madhe gazetave e kishin përkrahur vazhdimin e anëtarësisë, si dhe udhëheqësit

⁴⁸ EFTA (European Free Trade Association) apo Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë është një organizatë rajonale e tregtisë dhe zonë e tregtisë së lirë e përbërë nga katër shtete evropiane: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra. Organizata vepron paralelisht me UE-në dhe katër vendet anëtare marrin pjesë në Tregun e Vetëm Evropian dhe janë pjesë e Zonës Shengen.

e PK-së dhe PL-së kishin favorizuar vazhdimin e anëtarësimit në KEE, kurse në vitin 2016 udhëheqësi i Laburistëve Jeremy Corbyn kishte pasur qëndrime ambivalente gjër në fund të fushatës (K. Featherstone, interview via email, September 1, 2020).

III.1.3.2 Humbja e sovranitetit kombëtar

Nevoja për të ruajtur sovranitetin kombëtar paraqet një shqetësim të përbashkët të shumë shteteve në botë, përfshirë këtu edhe vendet anëtare të UE-së, por që ky shqetësim ka qenë shumë më i fuqishëm në MB ngase kjo e fundit nuk është angazhuar për integrim të mëtejshëm politik dhe ka kërkuar në vazhdimësi forcimin e parlamenteve kombëtare dhe mbrojtjen e së drejtës së Britanisë për të zgjedhur vetë disa çështje të rëndësishme siç janë ato të policisë, drejtësisë penale dhe civile, si dhe emigracionit dhe azilit. Ndonëse e integruar në UE, MB-ja vazhdimisht i ka rezistuar transferimit të sovranitetit në institucionet e saj. Përderisa politikanët britanikë që mbështetnin kampanjën e vazhdimin të anëtarësisë së Britanisë në UE kishin theksuar se nuk do të lejojnë shkatërrimin e ekonomisë britanike vetëm që të ulë emigracionin, politikanët britanikë që e kishin përkrahur Brexit-in vazhdimisht pohonin që janë kundër ndryshimit të MB-së vetëm që vendi të ketë benefite ekonomike që buronin nga anëtarësia në UE (Barnett, 2016, pp. 251-252).

Dy luftërat botërore të shekullit të kaluar dhe shuarja e perandorisë britanike kanë lënë gjurmë që kanë rezultuar me ndryshime në rregullimin politik britanik. Sovraniteti parlamentar mbetet parimi suprem i kushtetutës britanike që mund të krijojë ligje apo të rrëzojë ato dhe ligjet e Parlamentit të Britanisë nuk mund të kundërshtohen tradicionalisht në gjykata. Nëse analizohet thellësisht roli i MB-së në Evropë, është i paqartë dhe i vështirë për t'u shprehur. Në Parlamentin e Britanisë në vitin 1972 ishte miratuar Ligji për Komunitetet Evropiane i vitit në fjalë që kufizoi sovranitetin parlamentar të MB-së, si dhe bashkërisht me ligje të tjera pas tij pasqyroi zhvillime të mëdha politike, si brenda ashtu edhe jashtë Britanisë, që nga vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar. Këto ligje karakterizoheshin nga:

- 1) Shpërndarja e kompetencave të Westminster-it tek Parlamenti i Skocisë dhe Asambleja Uellsiane;*
- 2) Vendosja e Ligjit për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998, i cili inkorporonte Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të drejtën britanike;*

3) *Vendimi për krijimin e GjSMB-së në vitin 2009, i cili përfundon funksionin e Dhomës së Lordëve, si gjykata e fundit e apelit në MB.*

Kompetencat e PE-së janë rritur shumë nga Traktati i Lisbonës, së pari nëpërmes shtrirjes së fushëveprimit të procedurës së bashkëvendimmarrjes, por edhe në shumë mënyra të tjera. Nëse fokusohemi tek ndërlidhshmëria e PE-së me parlamentet kombëtare të vendeve anëtare të UE-së, atëherë duhet cekur ca gjëra. Integrimi evropian mbështetet në atë se shtetet anëtare kanë pranuar transferimin e disa kompetencave nga institucionet kombëtare në institucionet e UE-së, rritje kjo e arritur përmes traktateve të njëpasnjëshme të UE-së. Parlamentet kombëtare, duke humbur fuqitë e tyre të drejtpërdrejta në nivelin nacional, duhej të kontrollonin mënyrën e veprimit të qeverive të tyre përkatëse në UE, pavarësisht rolit të PE-së. Në disa shtete anëtare të UE-së, reagimet kanë qenë të shpejta për t'u përshtatur me këtë situatë sepse parlamentet e tyre kanë ndryshuar rregullat e procedurës, duke negociuar procedura të reja praktike me qeveritë e tyre, si dhe kanë bërë ndryshime në kushtetutat kombëtare që t'iu ofrojnë parlamenteve kombëtare më shumë kontroll mbi vendimet e marra nga përfaqësuesit e qeverive të tyre në KE. Reformat e këtij lloji kanë qenë më të shpejta dhe më thelbësore në ato shtete ku tradicionalisht parlamentet kombëtare kanë pozita të forta politike, si MB-ja dhe Danimarka (Piris, 2010, pp. 122-123).

Duhet përmendur gjithsesi se një fushë ku David Cameron kishte kërkuar ndryshime ishte rritja e kompetencave për Parlamentin e Britanisë. Evropa ka qenë gjithnjë e orientuar në rrugën e bashkimit gjithnjë e më të afërt, por britanikët bashkimin politik të Evropës nuk e kanë pëlqyer dhe nuk e kanë dashur asnjëherë, prandaj gjatë rinegociimit me UE-në Cameron kishte cekur që MB-ja do të përjashtohet përgjithmonë dhe ligjërisht prej atyre referimeve të traktateve për një bashkim gjithnjë e më të afërt politik të Evropës. Ai kishte përmendur se tashmë ishte miratuar një Akt Referendumi si masë siguroese lidhur me atë se asnjë kompetencë nuk mund t'i dorëzohet Brukselit pa miratim të popullit britanik përmes referendumeve. Sipas tij gjatë rinegociimit ishte kërkuar forcimi i rolit të Dhomës së Komunave dhe parlamenteve kombëtare të vendeve britanike, ashtu që nëse UE-ja do të prezantonte një legjislacion të padëshiruar për britanikët parlamentet të bashkoheshin për ta bllokuar atë. Britanikët do të ishin në ato pjesë të Evropës që punojnë për britanikët, ndikojnë në vendimet që prekin britanikët dhe të ishin jashtë pjesëve jofunkionale për britanikët (United Kingdom Government, 2016). Mbrojtja e ushtrimit të kompetencave

sovrane nga shteti, të cilat kufizohen duke integruar një bashkim nën kushtet në të cilat këto kompetenca ushtrohen nëpërmjet një institucioni të përbashkët, mund të shpien drejt vendimit për t'u tërhequr nga organizata (Cabral et al., 2017, p. 50).

Pastaj, pjesë e Zonës së Shengenit nuk janë MB-ja dhe Republika e Irlandës. Kjo zonë ka njëzet e gjashtë vende⁴⁹ dhe tri nga to nuk janë shtete anëtare të UE-së, përderisa shtetet si Bullgaria, Kroacia dhe Rumania janë në proces të anëtarësimit në të (European Commission, n.d.). Britania kishte dilema për Zonën Shengen sepse dëshironte t'i mbrojë kufijtë e saj, derisa Irlanda preferon të ruajë marrëveshjen e saj të lëvizjes së lirë me MB-në apo ZPU-në, në vend që t'i bashkohet Zonës Shengen (BBC News, 2016). Britania dhe Irlanda nuk pranuan të regjistroheshin në Sistemin Informativ të Shengenit⁵⁰ sepse në MB mbizotëronte idea që një sistem i tillë do ta shkatërronte sovranitetin e vendit. Mirëpo, në negociatat ndërqeveritare për Traktatin e Amsterdami, Irlanda dhe Britania ishin dakorduar që të ndajnë vendimmarrjen e përbashkët të politikave dhe vendimmarrjen lidhur me bashkëpunimin policor (Havlíček et al., 2018, pp. 22-23). Britania ishte krahas shteteve të UE-së që kishin perceptim negativ kundrejt përdorimit praktik të Marrëveshjes së Shengenit.

III.1.3.3 Eurozona

Zona e euros përbëhet nga ato shtete anëtare të UE-së që kanë miratuar euron si monedhën e tyre. Ajo përbëhet nga 19 vende anëtare,⁵¹ por ka raste kur shtetet anëtare negociojnë përjashtime nga ndonjë legjislacion apo traktat i UE-së dhe dakordohen që të mos marrin pjesë në fusha të caktuara politike (European Union, n.d.). Britania ishte vend anëtar i UE-së, por kishte vendosur që të mos e përdorte euron si monedhë të përbashkët të vendeve anëtare të UE-së dhe e mbante monedhën e saj paundin ngase monedha euro nuk i kishte plotësuar këto pesë teste:

- 1) *Ciklet e biznesit dhe strukturat ekonomike duhet të jenë mjaftueshëm të pajtueshme që MB-ja të mund të jetojë me normat e interesit të eurozonës;*

⁴⁹ Zona Shengen ka 26 vende: Austria, Belgjika, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Islanda, Italia, Latvia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Qiproja, Slovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Zvicra.

⁵⁰ Sistemi Informativ i Shengenit është sistemi më i përdorur dhe më i madh i shkëmbimit të informacioneve për sigurinë dhe menaxhimin e kufijve në Evropë. Ky sistem ndihmon autoritetet kompetente në Evropë të ruajnë sigurinë e brendshme në mungesë të kontrolleve të brendshme kufitare.

⁵¹ Eurozona përbëhet nga 19 shtete: Austria, Belgjika, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Holanda, Irlanda, Italia, Latvia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Portugalia, Qiproja, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja.

- 2) *Sistemi duhet të ketë fleksibilitet të mjaftueshëm për t'u marrë me problemet ekonomike lokale dhe ato të përgjithshme;*
- 3) *Miratimi i euros duhet të krijojë kushte të favorshme për firmat dhe individët që investojnë në Britani;*
- 4) *Euro do të mundësojë që industria e shërbimeve financiare e vendit të mbetet në një pozicion konkurrues ndërkombëtarisht;*
- 5) *Miratimi i euros duhet të promovojë rritje më të lartë, stabilitet dhe një rritje afatgjatë të vendeve të punës (Segal, 2019).*

Çështje tejet shqetësuese për britanikët gjatë kohës kur zhvilloheshin bisedimet me UE-në në vitin 2015 ishte eurozona. David Cameron kishte specifikuar domosdoshmërinë për ndryshimet që duheshin bërë në eurozonë. Ai pati përmendur dy lloje të vendeve anëtare të UE-së, ato që janë anëtare të eurozonës dhe ato që nuk janë pjesë e saj. MB-ja si vend joanëtar i eurozonës kishte nevojë për masa mbrojtëse, në mënyrë që të mbronte Tregun e Vetëm dhe aftësinë e Britanisë për të vendosur rregullat e saj, si dhe për t'u siguruar që britanikët nuk do të përballëshin as me diskriminime dhe as me kosto shtesë nga integrimi i eurozonës. Ai theksonte që UE-ja dhe eurozona nuk ishin e njëjta gjë dhe ato shtete që nuk janë pjesë e kësaj të fundit kishin nevojë për një pranim të tillë. MB-ja kishte nevojë për një model britanik të anëtarësimit që do të funksiononte për të dhe për çdo anëtar tjetër të UE-së që nuk është brenda eurozonës. Sipas britanikëve gur themeli i UE-së është Tregu i Përbashkët, prandaj nuk ka asnjë arsye që monedha e vetme të ndante të njëjtin kufi, më shumë sesa Tregu i Vetëm dhe Shengeni. Prandaj UE-ja kishte nevojë për fleksibilitet për të akomoduar vendet, si brenda ashtu edhe jashtë eurozonës sepse nëse UE-ja do të evoluonte në një klub të monedhës së vetme, ku ata që janë jashtë monedhës së vetme tërhiqen mënjanë dhe mbisundohen, atëherë Britania nuk do të ishte pjesë e këtij klubi dhe do të preferonte tërheqjen (United Kingdom Government, 2015).

III.1.3.4 Emigracioni

III.1.3.4.1 Emigrantët e UE-së në MB

Në MB ekziston një kategorizim i veçantë i migrantëve të UE-së, të cilët janë të ndarë në dy grupe:

- 1) **Më të mirët** - që përfshin kategori shumë specifike, siç janë studentët e UE-së, hulumtuesit, punonjësit e Kujdesit Kombëtar Shëndetësor, duke u bazuar në kontributet që këto grupe ofrojnë për ekonominë e Britanisë;
- 2) **Pjesa tjetër** - që përfshin migrantët, të cilët janë të përmendur brenda argumenteve të punës dhe sigurimeve sociale, duke iu referuar presioneve që ata bëjnë mbi pagat e vendit dhe shërbimeve publike, të tilla si KKSh-ja, shkollat dhe strehimi (Fleming, 2018, p. 40).

Faktorët vullnetarë të migrimin ndahen në socialë që përfshijnë kushtet më të mira të jetesës dhe qasjen në KKSh e edukim cilësor, si dhe në ata ekonomike shembuj të së cilëve janë perspektivat më të mira të punësimit dhe pagat më të larta. Ndonëse shtetet kanë benefite të shumta nga migracioni, duke siguruar tregje të reja, aftësi dhe forcë pune me çmime më të ulëta, megjithatë ka edhe pengesa të shumta. Tensionimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, mungesa e strehimit si rrjedhojë e fluksit të madh të migrantëve, tensionet racore si rezultat i ndryshimeve kulturore, si dhe dëmtimi i sistemit të mirëqenies nga kërkesat e migrantëve për përfitime, janë disa prej vështirësive me të cilat ndeshen shtetet si rrjedhojë e migracionit. Në vitin 2004 Britania e përdori anëtarësimin e 10 shteteve anëtare të reja për ta kufizuar substancialisht qasjen e migrantëve të UE-së në benefite sociale (Guild et al., 2009, p. 235). Qytetarët e shteteve të lartpërmendura nëpërmes anëtarësimin në UE fituan të drejtën për t'u transferuar në MB për të punuar dhe jetuar. Si pasojë e kësaj, numër i madh i emigrantëve erdhën në Britani pasi ekonomia e saj po lulëzonte. Mes viteve 2004 dhe 2006 Britania u bë vend pritës i gjithsej 600,000 migrantëve nga Evropa Lindore. Me anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë në UE më 1 janar 2007, edhe shtetasit e tyre përzgjedhën MB-në si vendin e duhur për të jetuar. Shumë prej tyre gjetën vende pune, veçanërisht në tregtinë e ndërtimit dhe të shitjes me pakicë, duke fituar pesë herë më shumë në MB sesa në vendet prej nga vinin (BBC News, n.d.).

Emigracioni ishte një nga çështjet më shqetësuese për David Cameron-in, kur ai udhëhiqte procesin e rinegociimit të anëtarësisë së Britanisë në UE. Në shkurt 2016 ai kishte cekur kërkesën e popullit britanik për ta zvogëluar nivelin e lartë të migracionit nga UE-ja dhe parandalimin e abuzimit të lëvizjes së lirë dhe sistemit të mirëqenies britanike. Sipas Cameron-it, në Britani do të përdorej një “frenues emergjent”, ku personat që vinin nga UE-ja dhe nuk kishin gjetur punë në Britani brenda gjashtë muajve, mund t’iu kërkohej që të largoheshin. Pastaj migrantët që do të vinin nga vendet e tjera të UE-së, do të duhej të prisnin katër vite që të kishin qasje të plotë në benefitet britanike dhe pasi frenuesi të aktivizohej, ky vendim do të ishte aktiv për shtatë vite (United Kingdom Government, 2016).

Mbështetësit e fushatës për vazhdimin e anëtarësisë së MB-së në UE vazhdimisht kishin theksuar se sa e dobishme ishte liria e lëvizjes në UE për britanikët, e cila iu kishte ofruar atyre mundësi për të udhëtuar, punuar, studiuar dhe për t’u pensionuar në UE, pa pasur nevojë për viza. Gjithashtu, ata kishin përmendur edhe argumentin multikultural të studentëve britanikë jashtë vendit, duke e theksuar përvojën e tyre ndërkombëtare shumë të vlefshme, të fituar falë studimeve që kishin bërë në vendet anëtare të UE-së. Megjithatë, krahas kategorive pozitive siç ishin studentët dhe hulumtuesit nga UE-ja, si dhe profesionistët mjekësorë, migrantët e UE-së përmendeshin edhe në kontekstin e kategorive negative, të cilat përfshinin kriminelët dhe evropianët lindorë me kualifikime të dobëta (Fleming, 2018, pp. 40-41). Shkalla e rritjes së emigrantëve nga 12 vendet anëtare të UE-së në vitet 2004 dhe 2007 ishte cekur edhe në fushatën “Vote Leave and Take Control”. Kjo e fundit kishte pohuar që migracioni kryesisht nga vendet e Evropës Lindore kishte pasur ndikim shumë të lartë tek britanikët në votën e tyre për Brexit. Mirëpo, nuk mund të identifikohet mekanizmi i saktë në qoftë se ky lloj impakti tek votuesit kishte qenë për shkaqe të natyrës ekonomike si pasojë e konkurrencës në tregjet e punës dhe strehimit, ose më tepër për sa i përket ndryshimit të kushteve sociale (Fleming, 2018, p. 31). Sipas fushatës në fjalë, nëpërmes daljes nga UE-ja, Britania do të kishte mundësinë e kontrollit të emigracionit, me ç’rast do t’i mirëpriste njerëzit në territorin e saj duke bazuar në aftësitë që ata do të posedonin, e jo nga pasaportat që ata mbajnë.

Gënjeshtrat rreth emigracionit kanë pasur ndikim të madh në votimin e referendumit të Brexit-it. Fatkeqësisht, shumë prej medieve anti-UE kishin pasur fuqi të nxisin një fushatë të tmerrshme kundër të huajve, duke ngjallur frikë në mbarë vendin se shumica e tyre ishin tepër të rrezikshëm për mirëqenien e britanikëve. Nëse përqendrohemi

tek partitë politike në Britani, PK-ja prej kohësh kishte qenë ksenofobe, UKIP cilësohet si parti raciste sa i përket emigrantëve, kurse PL-ja duhet të kishte bërë shumë më tepër përpjekje që t’iu kundërvihet skandaleve për të huajt. Në vend të përpjekjeve, kjo parti kishte ofruar versionet e saj të pakuptimta për “të mbajtur të pastër MB-në”. Qëndrimet rreth emigracionit ishin pjesa më e shëmtuar e fushatës së referendumit të vitit 2016, si dhe kishin qenë reflektuar prej një trendi shumë më të gjerë ndërkombëtarisht (Aidan Hehir, interview via email, August 26, 2020). Ngjashëm me modelet populiste, mbështetja për Brexit kishte qenë prezente kryesisht në zonat industriale që kishin pësuar ndryshime, humbje të industrisë apo vendeve të punës në automatizim. Kjo i atribuohet globalizmit dhe më së shumti për këtë ishte fajësuar UE-ja, me pretekstin se kinse emigrantët që vinin prej vendeve anëtare të saj po ua merrnin punët britanikëve dhe po rrezikonin të ardhmen e tyre (Christopher Jackson, interview via email, August 28, 2020).

III.1.3.4.2 Kriza e refugjatëve në Evropë në vitin 2015

Në vitin 2015 më shumë se një milion migrantë dhe refugjatë nga Siria, Afganistani, Iraku, Kosova, Shqipëria, Pakistani, Eritrea, Nigeria, Irani dhe Ukraina ishin shpërngulur prej vendeve të tyre dhe kishin kaluar në Evropë për t’iu shpëtuar konflikteve të dhunshme ose ishin në kërkim të një perspektive më të mirë ekonomike. Shumë persona kishin arritur të depërtojnë në vende të ndryshme të UE-së nëpërmes udhëtimeve të rrezikshme tokësore dhe detare, me ç’rast kishin kërkuar ndihma bazike si sigurimi i ujit të pastër, kujdesi shëndetësor, strehimore urgjente dhe ndihma juridike. Po ashtu një pjesë e madhe e njerëzve të shpërngulur ishin fëmijë, të cilët kishin pasur nevoja të veçanta (European Commission, 2016). Ky numër kaq i madh i refugjatëve kishte shkaktuar një krizë të thellë në UE, gjersa shtetet e saj anëtare bënin përpjekje të fuqishme për ta përballuar fluksin e tyre të jashtëzakonshëm që i kishte tejkaluar kapacitetet e menjëhershme të reagimit. Brenda UE-së ishin ngritur shumë tensione si pasojë e ngarkesës disproporcionale me të cilën ishin përballur disa shtete, posaçërisht ato në të cilat kishin ardhur shumica e emigrantëve e që ishin Greqia, Italia dhe Hungaria, tri shtete që ishin shndërruar në epiqendër të depërtimit të refugjatëve nga Lindja e Mesme (BBC News, 2016).

Institucionet e UE-së ishin munduar maksimalisht që t’iu dilnin në ndihmë shteteve anëtare dhe vendeve fqinje ashtu që ta përballonin më lehtë fluksin e refugjatëve. Në nëntor 2015 UE-ja kishte themeluar “Lehtësimin e UE-së për Refugjatët në Turqi” përmes së

cilit institucionet dhe shtetet anëtare do ta ndihmonin Turqinë me 6 miliardë € sepse do të mirëpriste 4 milionë refugjatë (European Commission, 2016). Bazuar në të dhënat e Zyrës së Statistikave të UE-së, në vitin 2015 në shtetet anëtare të UE-së kishin aplikuar gjithsej *1,255,600 azilkërkues*, prej të cilëve më shumë se gjysma ishin nga Siria rreth 362,775 persona, pastaj nga Afganistani ishin 178,230, prej Irakut 121,535, prej Kosovës 66,885, nga Shqipëria 65,935, prej Pakistanit 46,400, nga Eritrea 33,095, prej Nigerisë 29,915, Iranit 25,360, si dhe nga vendet e tjera 325,510 (European Commission, 2016).

Tabela 3.5

Numri i aplikimeve për azil në vitin 2015 në vendet anëtare të UE-së


Shtetet	Numri i aplikantëve për azil në vitin 2015	Ndryshimi në përqindje 2015/2014
<i>Austria</i>	85,505	+233%
<i>Belgjika</i>	38,990	+178%
<i>Bullgaria</i>	20,165	+87%
<i>Danimarka</i>	20,825	+43%
<i>Estonia</i>	225	+54%
<i>Finlanda</i>	32,150	+822%
<i>Franca</i>	70,570	+20%
<i>Greqia</i>	11,370	+50%
<i>Gjermania</i>	441,800	+155%
<i>Holanda</i>	43,035	+98%
<i>Hungaria</i>	174,435	+323%
<i>Irlanda</i>	3,270	+127%
<i>Italia</i>	83,245	+31%
<i>Kroacia</i>	140	-63%
<i>Latvia</i>	330	-10%
<i>Lituania</i>	275	-29%
<i>Luksemburgu</i>	2,360	+129%
<i>Malta</i>	1,695	+33%
<i>Mbretëria e Bashkuar</i>	38,370	+19%
<i>Polonia</i>	10,255	+83%
<i>Portugalia</i>	830	+89%
<i>Qiproja</i>	2,105	+42%
<i>Republika Çeke</i>	1,235	+36%
<i>Rumania</i>	1,225	-18%
<i>Sllovakia</i>	270	+18%
<i>Sllovenia</i>	260	-27%
<i>Spanja</i>	14,600	+167%
<i>Suedia</i>	156,110	+108%

(European Commission, 2016).

Mesatarja e azilkërkuesve në UE kishte qenë 260, Gjermania kishte pasur më së shumti kërkesa për azil, Hungaria kishte përqindjen më të lartë bazuar në popullsinë e saj lokale, ndërsa vetëm MB-ja kishte pasur 60 kërkesa për azil në 100,000 banorë të popullsisë së saj lokale. Britania kishte hequr dorë nga çdolloj plani i vendeve anëtare të UE-së për zhvendosje të refugjatëve nga Greqia dhe Italia, por në vitin 2015 sipas shifrave të qeverisë britanike 1,000 refugjatë sirianë ishin zhvendosur në bazë të Skemës së Zhvendosjes së Personave Sirianë të Rrezikuar.⁵² David Cameron kishte deklaruar se MB-ja do t'i pranonte 20,000 refugjatë nga Siria gjatë pesë viteve të ardhshme. Megjithëse një numër shumë i madh i personave kishin aplikuar për azil, UE-ja në vitin 2015 iu kishte ofruar azil 292,540 refugjatëve nga Siria, Eritrea, Iraku, Afganistani dhe Irani. Gjermania kishte aprovuar më së shumti kërkesa për azil, gjithsej 140,910 sosh, përderisa MB-ja kishte aprovuar 13,905 kërkesa (BBC News, 2016).

Figura 3.1

Përqindja azilkërkuesve në shtetet anëtare të UE-së sipas vendeve të tyre, në vitin 2015




(European Commission, 2016).

⁵² Skema e Zhvendosjes së Personave Sirianë të Rrezikuar është një program i qeverisë së MB-së që planifikonte të zhvendosë 20,000 refugjatë sirianë nga kampet e refugjatëve në Jordani, Liban, Irak, Egjipt dhe Turqi për periudhën shtator 2015-maj 2020.

Figura 3.2


Shtetet anëtare të UE-së që kishin aprovuar më së shumti aplikime për azil në vitin 2015



(BBC News, 2016).

Figura 3.3


Pikëpamjet euroskeptike dhe eurofile në dhjetë shtete anëtare të UE-së në vitin 2016



(Stokes, 2016).

Figura 3.4

Mospajtueshmëria mbi menaxhimin e krizës së refugjatëve në vitin 2015 në dhjetë shtete të UE-së



(Stokes, 2016).

Kriza e refugjatëve e vitit 2015 nuk kishte ndikuar në rritjen e euroskepticizmit vetëm në Britani, por edhe në vendet e tjera të UE-së. Mospajtueshmëria në menaxhimin e kësaj krize kishte depërtuar në vendet kyçe të UE-së, si dhe problemet dhe tensionet e ngritura, si rrjedhojë e krizës në fjalë kishin pasur impakt të lartë në shtimin e pikëpamjeve euroskeptike. Bazuar në një hulumtim të realizuar nga Pew Research Center më 4 prill deri më 12 maj 2016 me gjithsej 10,419 persona të anketuar prej 10 vendeve anëtare të UE-së, të gjeturat hulumtuese kishin treguar që niveli i euroskepticizmit po rritej në Greqi, Francë, Mb, Spanjë, Gjermani, Holandë, Suedi, Itali, Hungari dhe Poloni (Stokes, 2016).

III.1.4 Niveli global

III.1.4.1 Prezenca e popullizmit në vende të ndryshme të botës

Viti 2016 do të njihet si një vit tejet i trazuar në marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht për faktin se në disa vende të botës kishte pasur një prezencë mjaft të theksuar të një nacionalizmi të zhurmshëm dhe populist. Rritja e ndikimit të aktorëve joshtetërorë ka shënuar një kthesë revolucionare në marrëdhëniet ndërkombëtare (McGlinchey, 2017, p. 43). Pastaj ndryshimi afatgjatë i gjeneratave dhe zgjerimi i arsimimit si rezultat i fluksit të

njerëzve me kombësi, fe, gjuhë, zakone dhe prejardhje të ndryshme kanë ndikuar në transformimin e vlerave themelore kulturore të shoqërive perëndimore. Mirëpo, ky ndryshim i shpejtë kulturor shihej edhe si rrezik nga këto të fundit sepse sipas tyre po ua rrezikonte vlerat themelore. Në forcimin e këtyre ndjenjave të rrezikshmërisë kishte ndikuar edhe rritja e diversitetit etnik dhe spektri i terrorizmit islamik (Norris & Inglehart, 2019, p. 175). Sulmet terroriste të sponsorizuara nga ISIS ishin kthyer në një ankth global. Ndërkaq, kriza e refugjatëve e vitit 2015 kishte ç'ekuilibruar botën, por që barrën më të madhe të saj e kishte pasur Evropa. Edhe pse ShBA-të kishin shprehur gatishmëri të ofrimit të ndihmave financiare në vlerë prej 419 milionë \$ si ndihmë humanitare për krizën në fjalë, nuk kishin pranuar numër të madh të emigrantëve. Meqë Turqia kishte pranuar dy milionë emigrantë, si dhe Jordania dhe Libani nga një milion secila prej tyre, pjesa më e madhe e ndihmave financiare amerikane iu ishte dedikuar këtyre vendeve (Morello, 2015). Krahas krizës së refugjatëve, ekspansionizmit agresivisht të pashmangshëm të Presidentit të Rusisë Vladimir Putin, ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të tyre, tejet shqetësuese kishin qenë edhe rezultatet tronditëse të referendumit të Brexit-it, si dhe tensionet e përshkallëzuara racore, politike dhe ekonomike në ShBA (Adams, 2017, p. 40). Brexit dhe fitorja e Donald Trump-it në zgjedhjet presidenciale amerikane ishin ngjarjet kryesore të vitit 2016, të cilat e kishin vënë në rrezik efektivitetin e vlerave demokratike. Shqetësimet britanike drejtuar UE-së, të kombinuara me nacionalizëm dhe ksenofobi, ishin bërë argumente të fuqishme në votimin e popullit britanik për tërheqjen e Britanisë nga UE-ja. Brexit shihej si një sinjal i fundit i epokës së besimit në përfitimet e globalizimit, si dhe në benefitet e tregjeve të hapura dhe integritit evropian, i cili kishte ofruar edhe një parashikim mbi rezultatin e zgjedhjeve presidenciale amerikane në vjeshtën e vitit 2016. Bashkërisht me Brexit-in dhe fitoren e Trump-it në ShBA, fushata e së djathtës ekstreme e Nobert Hofer në zgjedhjet presidenciale austriake, triumfi i Rodrigo Duterte në zgjedhjet presidenciale filipinase, rezultatet e referendumit kushtetues në Itali, si dhe impeaçmenti i bërë ndaj Presidentes së Koresë së Jugut Park Geun-hye, kishin vulosur prezencën e popullizmit në nivel global (Taylor, 2016).

Ndonëse në fjalorin akademik të shkencave politike popullizmi përdoret rrallë, në vitin 2016 si rrjedhojë e ngjarjeve të lartpërmendura ai kishte dalë në pah, me ç'rast kishte pasur edhe debate të shumta për versione të ndryshme të tij si popullizmi ekonomik, popullizmi autoritar, popullizmi radikal, etj. (Taylor, 2016). Madje po të kërkohet një sinonim për vitin në fjalë, mund të përdoret fjala "popullizëm". Përdorimi i retorikës populliste


legjitimon stilin qeverisës të bazuar në vlerat autoritare, të cilat kërcënojnë normat liberale që mbështesin demokracinë. Duhet përmendur se populizmi ka rrënuar shumë modele të konkurrencës partiake të vendosura prej kohësh në shoqëritë bashkëkohore perëndimore. Partitë populiste mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin, por ato janë uniforme sa i përket armiqësisë së tyre ndaj emigracionit, së bashku me nacionalizmin, ksenofobinë dhe proteksionizmin kulturor. Duke reflektuar këto vlera, partitë e tilla kërkojnë të kufizojnë lëvizjen e popujve brenda vendeve të tyre, të kufizojnë fluksin e migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuessve që vinë prej shteteve të tjera, të integrojnë emigrantët në kulturat kombëtare, si dhe të propozojnë masa më të rrepta mbi parandalimin e terrorizmit. Kishin qenë pasojat e krizës së refugjatëve të vitit 2015 ato që kishin krijuar hapësira favorizuese për depërtimin e pikëpamjeve populiste në shumë vende të botës, por që shumë shqetësuese ishte prezenca e tyre në disa shtete që shquhen për respektim maksimal ndaj vlerave demokratike. Këto pikëpamje të mbështetura kryesisht në islamofobi kishin pasur mbështetje të lartë, e cila kishte kaluar në një nivel tejet shqetësues.

III.1.4.2 Rimarrja e “vendit të humbur” të MB-së në botë

Në vitin 2016 MB-ja ishte e renditur në vendin e pestë në botë sa i përket fuqisë ekonomike (World Economic Forum, 2017). Kurse, prej shteteve anëtare të UE-së në këtë vit Britania e kishte zënë vendin e dytë për vlerën e GDP-së, si shteti i dytë më i zhvilluar në aspektin ekonomik në kontinentin evropian (European Statistics, 2017). Mbështetësit e Brexit-it kishin cekur në vazhdimësi që nëpërmes daljes së MB-së nga UE-ja britanikët do të posedonin lirinë e zhvillimit të tregtisë me të gjitha shtetet e botës, duke përfshirë këtu aleatët e Britanisë si Australia dhe Zelanda e Re, si dhe ekonomitë në rritje si India, Kina dhe Brazili. Madje sipas tyre Brexit-i do të ofronte një sërë mundësish për rritjen e zhvillimit ekonomik me hapa shumë të shpejtë sikurse vendet e sapoindustrializuara. Për dekada të tëra, politikëbërësit në MB e kanë kuptuar pozicionin e vendit të tyre nëpërmes thjerrëzave të të qenurit një ishull i vogël evropian në brigjet e Atlantikut, i destinuar të kyçet me partnerë të tjerë evropianë ose si një fuqi perëndimore, e aleatizuar fuqimisht me ShBA-të (Buckle et al., 2015, p. 113).

Figura 3.5


Pesë ekonomitë më të mëdha të botës dhe përqindja në GDP-në globale në vitin 2016



(World Economic Forum, 2017)

Figura 3.6

Pesë ekonomitë më të mëdha të UE-së dhe përqindja në GDP-në e UE-së në vitin 2016



(European Statistics, 2017)

Një leksion të rëndësishëm që na mëson historia është ai për ngritjen dhe rënien e fuqive të mëdha. Gjatë shekullit XIX shteti në ngritje ishte Britania dhe hegjemonia britanike

kishte qenë e karakterizuar nga shkalla e rendit dhe stabilitetit në sistemin ndërkombëtar. Fuqia britanike në këtë shekull ishte mbështetur në tri burime: fuqia detare, dominimi në ekonominë globale dhe perandoria e saj. Kontrollueshmëria e deteve kishte qenë arsyeja kryesore e dominimit të saj në botë, përderisa avantazhi i saj ekonomik kishte rezultuar nga dominimi në prodhim, tregti dhe financa. Nevoja për të siguruar rrugët tregtare për kolonitë vitale si India, Burma dhe Malaya, kishte inkurajuar kolonializmin e mëtejshëm në rajone të vendosura strategjike, siç janë ato rreth Kanalit të Suezit. MB-ja në fillim të shekullit XX kishte pasur në kontroll rreth 1/4 e sipërfaqes së tokës dhe 1/5 e popullsisë botërore. Mirëpo, në fund të shekullit XIX hegjemonia britanike kishte pasur disa sfida ushtarake dhe industriale nga rivalët e saj të rinj si Gjermania dhe ShBA-të. Pastaj LPB i kishte dhënë një goditje shkatërruese fuqisë britanike, gjersa LDB e kishte thyer atë. Brenda disa dekadash Britania kishte humbur perandorinë e saj në periudhën e pasluftës të dekolonizimit të shpejtë. Bilanci i fuqisë mes ShBA-ve dhe MB-së ishte zhvendosur plotësisht gjatë luftës, prandaj dhe mund të pohohet se Britania e kishte humbur luftën nga ShBA-të, e jo nga Gjermania (Lamb & Snape, 2017, p. 52). Fushata e mbështetësve të Brexit-it kishte krijuar përshtypje të atilla se disa britanikë e shihnin daljen e MB-së nga UE-ja si mundësi për rikthimin e saj në lavditë e së kaluarës, si fuqi globale dhe e pavarur nga UE-ja. Ndonëse ditët e hegjemonisë britanike janë zhdukur prej kohësh, duket se e kaluara perandorake vazhdon të ketë ndikim në politikën e brendshme të Britanisë. Brexit-i i MB-së, fuqisë botërore të shekullit XIX, një nga protagonistët kryesorë të kolonializimit të botës, pjesë e fuqive të mëdha botërore dhe anëtares së përhershme të KS-së në OKB, në këtë konkurrencë multipolare që i karakterizon marrëdhëniet ndërkombëtare, mund të perceptohet edhe si produkt i dëshirës së madhe të britanikëve për të rimarrë “vendin e humbur” në botë.

III.1.5 Konkluzionet

Votimi i britanikëve për Brexit ka qenë i ndikuar prej shumë faktorëve, zanafilla e së cilëve duhet kërkuar që në fillet e anëtarësisë së Britanisë në KEE. Për të specifikuar faktorët kryesorë që i kanë kontribuar Brexit-it, duhet të bëhet një analizë e thellë, e bazuar në qasjen teorike realiste me qëllim të hedhjes së të vërtetës në pah, e ndarë në katër nivele: individual, shtetëror, sistematik dhe global. Niveli individual i analizës tregon se prej viteve

të 70-ta e gjer tek dekada e dytë e shekullit XXI çështja e referendumit mbi anëtarësinë e MB-së në KEE/UE vazhdimisht ka qenë pjesë e ideve dhe premtimeve të politikanëve britanikë. Për shkak të mospajtueshmërisë me politika të caktuara të UE-së, zgjedhje e vetme për shumicën prej tyre shihej referendumi përmes së cilit britanikëve do t'iu ofrohej mundësia për të vendosur mbi të ardhmen e vendit brenda apo jashtë UE-së. Meqë pasojat e Brexit-it shtrihen përtej Evropës, për referendumin e vitit 2016 kishin reaguar edhe disa politikanë të rëndësishëm botërorë, pjesa më e madhe e së cilëve kishin rekomanduar vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë në UE, por nuk kishin munguar ata që e kishin rekomanduar tërheqjen. Niveli shtetëror i analizës specifikon disa dukuri që kanë qenë në favor të Brexit-it brenda MB-së. Referendumi i anëtarësisë së kësaj të fundit në UE kishte qenë premtim i PK-së dhe UKIP-it në zgjedhjet parlamentare të vitit 2015. UKIP është shquar për rolin e saj gjatë fushatës së referendumit, duke shfrytëzuar maksimalisht brengat kryesore të britanikëve për t'i shtyrë ata që të votonin Brexit-in. Gazetat britanike gjatë fushatës së referendumit kishin qenë të ndara në dy grupe: pro-UE-së dhe anti-UE-së, ku numri i këtyre të fundit ishte më i madh. Me artikujt e tyre armiqtësorë ndaj UE-së ato kishin marrë vëmendje të jashtëzakonshme, përfshirë këtu edhe fushatën e famshme për Brexit "Vote Leave and Take Control". Niveli sistematik rezulton me disa ngjarje dhe procese që kanë pasur lidhshmëri me Britaninë dhe UE-në. Për dallim nga referendumi i anëtarësisë së MB-së në KEE në vitin 1975, emigracioni kishte qenë faktor kyç në vendimin e britanikëve për votimin e Brexit-it në vitin 2016. Emigracioni si një nga brengat kryesore britanike lidhej me emigrantët e UE-së në MB, por edhe me krizën e refugjatëve të vitit 2015 që kishte destabilizuar Evropën, kishte rritur tensionet brenda UE-së, si dhe kishte favorizuar akoma më tepër opsionin për largim. Pastaj, humbja e sovranitetit kombëtar dhe problemet në eurozonë kanë qenë përherë shqetësime të britanikëve. Niveli global i analizës tregon se vitin kur ishte votuar Brexit-i, bota ishte kapluar nga popullizmi, i cili po vinte në rrezik efikasitetin e vlerave demokratike. Pastaj, duke u bazuar në të kaluarën e lavdishme të MB-së para dy luftërave botërore dhe zhvillimin politik, ekonomik dhe ushtarak të disa shteteve që aktualisht rangohen në vendet e para në botë, krijohen përshtypje se Brexit mund të jetë produkt i dëshirës së britanikëve për të rimarrë pozicionin e humbur.

III.2 Pasojat ekonomike të Brexit-it

III.2.1 Pasojat ekonomike të Brexit-it për Mbretërinë e Bashkuar

III.2.1.1 Detyrimet financiare të MB-së ndaj UE-së pas Brexit-it

Një nga pasojat kryesore të Brexit-it për MB-në, e cila do ta shoqërojë këtë të fundit për një periudhë të gjatë kohore është tërësia e detyrimeve financiare të saj ndaj UE-së pas përfundimit të negociatave të Brexit-it. Çështje shqetësuese për britanikët që nga fillet e bisedimeve me UE-në ka qenë fatura e divorcit. Kjo faturë përbën shumën që Britania është dakorduar të paguajë për mbulimin e të gjitha obligimeve financiare ndaj UE-së që prej momentit kur do të tërhiqet prej anëtarësimit. MB-ja do t'i kryente kontributet e saj të rregullta në buxhetin e UE-së deri në fund të periudhës së tranzicionit, njësoj sikur ka qenë vend anëtar, pra deri në fund të vitit 2020, por edhe do t'i gëzonte përfitimet ekonomike të anëtarësisë brenda periudhës në fjalë (Adam, 2020, p. 150).

Megjithëse në dhjetor 2017 kur kishte përfunduar faza e parë e negociatave ndërmjet MB-së dhe UE-së nuk ishte caktuar ndonjë një shifër e saktë në lidhje me shumën e faturës së divorcit, zyrtarët britanikë kishin vlerësuar se fatura në fjalë do të mund të kishte vlerë prej 35-39 miliardë £. Dakordimi i Britanisë me UE-në për mbulimin e të gjitha obligimeve financiare britanike është pjesë e Marrëveshjes së Tërheqjes, e cila tashmë është traktat ligjërishit i detyrueshëm për të dy palët. Marrëveshja e arritur ndërmjet MB-së dhe UE-së në lidhje me zgjedhjen e çështjeve financiare thekson detajisht se në cilat pjesë do të kontribuojë Britania sapo të finalizohen bisedimet e Brexit-it ekonomik me UE-në, por edhe mënyrën se si do të llogariten pagesat. Ende nuk ka ndonjë kosto definitive për mbulimin e këtyre obligimeve sepse kostoja përfundimtare do të varet prej ngjarjeve të ardhshme që do të pasojnë. Megjithatë, sipas Zyrës për Përgjegjësinë e Buxhetit të MB-së vlerësohet se kostoja neto për Britaninë mund të arrijë vlerën e pothuajse afro 33 miliardë £. ZPBMB-ja gjithashtu kishte përcaktuar një faturë totale prej 41.4 miliardë € apo 37.1 miliardë £. Pjesa më e madhe e kësaj shume do të duhej të mbulohej gjer në vitin 2023 apo 2024, kurse shumat relativisht më të vogla do të duhet të mbulohen deri në vitin 2064 (UK Institute for Government, n.d.).

Tabela 4.1

Tërësia e detyrimeve financiare të MB-së ndaj UE-së nga viti 2020 deri më 2064

Pagesat	Periudha e pagesës	Miliardë £
<i>Participimi në buxhetin e UE-së</i>	2020	8,9
<i>Pjesa mbetur e pagesës</i>	2021-2028	19,2
<i>Detyrimet e tjera neto</i>	2020-2064	4,8
<i>Total</i>	2020-2064	32,9

(Keep, 2020, p. 4.)

III.2.1.2 Rritja e kostove tregtare

Procesi i integritit ekonomik të shteteve evropiane në KEE/UE ka sjellë ulje të konsiderueshme të kostove tregtare dhe ka ndikuar pozitivisht në rritjen e vëllimit të tregtisë mes shteteve të anëtarësuar në KEE/UE. Kontinenti evropian posedon pjesën më të madhe të tregtisë ndërrajonale dhe ekonomia britanike është pjesë e këtij rrjeti intensiv të marrëdhënieve tregtare. Partneri më i rëndësishëm tregtar i MB-së për sa iu përket eksporteve të mallrave dhe shërbimeve britanike është UE-ja (Campos & Coricelli, 2017, p. 254). Mirëpo, marrëdhëniet e ardhshme tregtare të Britanisë me UE-në, por edhe me pjesën tjetër të botës do të kenë rol vendimtar në përcaktimin e ndikimit të Brexit-it në ekonominë britanike.

Rritja e kostove tregtare përbënte një prej shqetësimeve kryesore të kundërshtuesve të Brexit-it gjatë fushatës së referendimit në vitin 2016. Sipas tyre largimi i MB-së nga UE-ja do të ndikonte në zvogëlimin e vëllimeve të tregtisë dhe në uljen e GDP-së. Në lidhje me kostot tregtare është e dobishme që të sqarohen dy pika:

- 1) *Kostot më të rëndësishme të tregtisë nuk imponohen nga tarifrat, por nga masat jotarifore siç janë rregulloret dhe kostot kufitare. Jashtë Tregut të Vetëm të UE-së, MB-ja potencialisht ekspozohet ndaj kostove të lartpërmendura dhe tarifës së përbashkët të jashtme për tregtinë me UE-në;*
- 2) *Britania mund të kërkojë të negociojë një marrëveshje tregtare për të vazhduar që të marrë pjesë në Tregun e Vetëm njëjtë sikur Norvegjia, por kjo do të kërkonte vazhdimin e një pagese të anëtarësimit në kushtet e një kontributi buxhetor së*

bashku me pranimin e disa rregulloreve dhe në mënyrë thelbësore lëvizjen e lirë të njerëzve (Campos & Coricelli, 2017, pp. 29-30).

Negociatat e plota tregtare ndërmjet MB-së dhe UE-së filluan pas Brexit-it politik, respektivisht me mbarimin e fazës së dytë të bisedimeve dhe në fillimin e fazës së tretë. Çfarëdo qofshin rezultatet finale të tyre, ka të ngjarë që marrëdhënia e re tregtare ndërmjet Britanisë dhe UE-së do të sjellë vështirësi në realizimin e tregtisë së kompanive britanike me ato të vendeve anëtare të UE-së. Shkalla e vështirësisë do të varet krejtësisht nga lloji i marrëdhënies tregtare të negociuar. Anëtarësia në UE nënkupton edhe të qenurit pjesë e Tregut të Vetëm dhe Unionit Doganor, nëpërmes së cilës mënjanoheshin shumë barrierat tregtare. Si rrjedhojë e largimit të MB-së nga Tregu i Vetëm dhe Unioni Doganor, negociimi i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të tregtisë së lirë me UE-në nuk ka shumë të ngjarë që të ketë të njëjtin nivel të hyrjes në tregun e UE-së sikurse me atë të të qenurit vend anëtar i UE-së. Pengesat shtesë për tregtinë që do të pasojnë nga Brexit-i shfaqin hapësira për të kuptuar nivelin e ulët të tregtisë së Britanisë në krahasim me atë kur ishte vend anëtar i UE-së. Ndonëse duke qenë anëtare e Unionit Doganor nuk mund të operonte politikën e saj tregtare dhe nuk mund të negocionte marrëveshjet tregtare në mënyrë të pavarur prej UE-së, MB-ja nuk duhet anashkaluar faktin se UE-ja ka marrëveshje tregtare me afër 70 vende në botë.

Tabela 4.2

Eksportet dhe importet e MB-së me vendet anëtare dhe joanëtare të UE-së gjatë vitit 2019

Vendet	Eksportet në miliardë £	Eksportet në %	Importet në miliardë £	Importet në %	Balanci në miliardë £
<i>Vendet anëtare të UE-së</i>	300.3	43.0%	372.2	51.4%	- 71.9
<i>Vendet joanëtare të UE-së</i>	398.3	57.0%	352.3	48.6%	46.0
Total	698.6	100.0%	724.5	100.0%	- 25.9

(Harari, 2018, p. 4).

Në vitin 2002 eksportet britanike në UE kishin qenë 54%, gjersa në vitin 2019 ato kishin rënë në 43%, kurse importet e Britanisë në UE në vitin 2002 kishin qenë 58% dhe në vitin 2019 kishin rënë në 51% (Ward, 2020, p. 4). Deficiti tregtar me UE-në në vitin 2019 kishte qenë 72 miliardë £, por MB-ja kishte pasur suficit tregtar me vendet joanëtare të UE-së në vlerë 35 miliardë £. Deficiti në mallra me vendet anëtare të UE-së kishte pasur vlerë 95 miliardë £, gjersa me vendet joanëtare të UE-së 35 miliardë £. Nuk duhet përjashtuar suficitin tregtar në shërbime me UE-në që kishte qenë 23 miliardë £ dhe me vendet joanëtare të UE-së 81 miliardë £. UE-ja përbën 46% të eksporteve të mallrave britanike dhe 40% të eksporteve të shërbimeve, si dhe 53% të mallrave të importuara të Britanisë dhe 48% të shërbimeve të importuara nga UE-ja. Si pasojë e masave jotarifore, eksportet e Britanisë me UE-në rrezikojnë të ulen 14%, me vlerë 32 miliardë \$ (United Nations News, 2020). Nafta dhe produktet e saj përbënin eksportet më të mëdha të MB-së në vitin 2019 në UE me vlerë 20 miliardë £ dhe përfshinin 12% të të gjitha eksporteve të mallrave të Britanisë në UE, si dhe 68% të totalit të eksporteve të naftës dhe produkteve të naftës të MB-së. Eksportet e tjera të mallrave britanike në UE përbënin automjete rrugore me vlerë 17 miliardë £ apo 10% të eksporteve të mallrave në UE dhe pajisje të tjera transporti me vlerë 10 miliardë £ ose 6% të të gjitha eksporteve të mallrave në UE. Automjetet rrugore përbënin importin e vetëm më të madh të Britanisë në UE me vlerë 49 miliardë £ apo 18% të të gjitha importeve të mallrave të MB-së nga UE-ja dhe 45% të të gjitha importeve të automjeteve rrugore në Britani. Importet e tjera të mallrave në UE përfshinin produkte mjekësore dhe farmaceutike me vlerë 18 miliardë £ ose 7% të totalit të importeve në UE (Ward, 2020, p. 7).

Shërbimet biznesore përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të eksporteve britanike të shërbimeve në UE apo 29% të totalit të eksporteve të tilla të MB-së në UE, të cilat në vitin 2018 kishin vlerë prej 35 miliardë £. Kjo kategori përfshin shërbime juridike, kontabiliste, reklamuese, kërkimore dhe zhvillimore, arkitektonike, inxhinierike dhe shërbime të tjera profesionale dhe teknike. Irlanda përbënte tregun më të madh të UE-së për shërbime në biznes, 23% të totalit, ndërsa Gjermania 16%. Si bllok UE-ja përbën 36% të eksporteve të shërbimeve biznesore të MB-së. Kurse eksportet e tjera të shërbimeve britanike në UE përfshinin shërbime financiare me vlerë prej 26 miliardë £ apo 22% të eksporteve të shërbimeve të Britanisë me UE-në. Shërbimet biznesore dhe ato financiare përbëjnë pak më shumë se gjysmën e të gjitha eksporteve të shërbimeve të MB-së në UE. Ndërsa në vitin 2018 importi i vetëm më i madh i Britanisë nga UE-ja ishin shërbimet e

udhëtimit që përbënin 35% të importeve të shërbimeve të MB-së nga UE-ja. Duhet cekur që 1/3 e këtyre shërbimeve ishin importuar nga Spanja, më pas 16% e totalit edhe nga Franca. Importet e shërbimeve të udhëtimit dhe shërbimeve të tjera të biznesit së bashku përbëjnë më pak se 60% të importeve të shërbimeve në Britani nga UE-ja (Ward, 2020, pp. 8-9).

III.2.1.3 Devaluimi i monedhës paund

Menjëherë pas referendimit në vitin 2016 pati rënie të ndjeshme të vlerës së paundit, kur pushimet dhe mallrat e importuara u bënë më të kushtueshme, si dhe personat që tërheqin pensione nga MB-ja kanë pësuar humbje për shkak të rënies së paundit. Brexit-i rrezikon devaluimin e kësaj monedhe për 20%. Kjo mund të rrisë normën e inflacionit, duke sjellë efekte negative të mirëqenies dhe mund të zvogëlojë kërkesën globale për paundin si një valutë rezervë. Kur vlera e monedhës rritet, ajo blihet, ndërkaq kur vlera i ulët ajo më tepër shitet. Pjesa e ekonomisë britanike brenda GDP-së botërore rrezikon të bie me të njëjtën përqindje si shkalla e zhvlerësimit të paundit, gjë që nënkupton zvogëlimin e fuqisë dhe ndikimit politik të Britanisë në negociatat ndërkombëtare mbi tregtinë, traktatet e investimeve etj. Ulja e përgjithshme e peshës së MB-së në ekonominë globale për shkak të Brexit-it mund të arrijë në 30% në planin afatgjatë. Po ashtu, zhvlerësimi i paundit rrezikon përkeqësimin e kushteve të tregtisë, duke ulur eksportet dhe duke rritur importet e Britanisë (Welfens, 2017, pp. 229-230). Ndryshimet e vazhdueshme që kanë pësuar kurset e këmbimit që nga viti 2016 tregojnë disa nga efektet negative ekonomike të Brexit-it.

Tabela 4.3

Ndryshimet në kurset e këmbimit për \$ dhe €, si dhe norma mesatare e tyre në vite dhe përqindja

Vitet	Vlera \$	Përqindja e \$ në vit	Vlera €	Përqindja e € në vit
2017	1.29	- 4.8%	1.14	- 6.7%
2018	1.34	3.6%	1.13	- 0.9%
2019	1.28	- 4.4%	1.14	0.9%
2020	1.25	- 1.2%	1.11	- 0.9%

(House of Commons Library, 2020).

Figura 4.1

Raporti i kursit të këmbimit funtë vs euro nga viti 2015 deri më 2020



(European Central Bank, 2020).

Figura 4.2

Raporti i kursit të këmbimit funtë vs dollar nga viti 2015 deri më 2020



(Macrotrends Blog, n.d.).

III.2.1.4 Rënia e investimeve të huaja direkte

Fluksi i investimeve të huaja direkte lidhet me një larmshmëri përfitimesh ekonomike, duke filluar nga rritja e produktivitetit deri te inovacioni i zgjeruar dhe zhvillimi teknologjik. MB-ja ka qenë relativisht e suksesshme në tërheqjen e flukseve të brendshme të IHD-ve që përbëjnë një nga fushat ku Brexit-i do të ketë ndikim negativ (Whyman & Petrescu, 2017, p. 123). Atraktiviteti i Britanisë për investitorët e huaj lidhet ngushtë me tregtinë që nënkupton aftësinë e kompanive shumëkombëshe me qendër në MB për të qenë pjesë e zinxhirëve globalë të furnizimit dhe për t'i shërbyer një tregu më të gjerë përtej brigjeve britanike. IHD-të mund të mbulojnë një varg formash të investimeve. Një kompani britanike themelon një degë ose një kompani në një vend të huaj duke injektuar kapital fillestar, një kompani britanike blen ose shet, plotësisht ose pjesërisht kapitalin e një kompanie të huaj ekzistuese, si dhe një kompani britanike vendos kapital shtesë në një kompani të huaj ekzistuese ose ia mundëson asaj të mbajë fitime sesa t'i kthejë ato në kompaninë mëmë. IHD-të mund të jenë të brendshme ose të jashtme:


1) IHD-të e brendshme - masin investimet e bëra në një vend nga një vend tjetër, p.sh. investimet nga një vend i huaj në Britani;

2) IHD-të e jashtme - masin investimet e bëra nga kompanitë vendase në një ekonomi të huaj, si p.sh., investimet nga MB-ja në një vend të huaj (Ward, 2019, p. 4).

Në vitin 2018 vlera e IHD-ve në Britani kishte qenë 49,3 miliardë £, ndërsa në vitin 2017 ato kishin pasur vlerë 80,6 miliardë £, përderisa në vitin 2016 kishin pasur vlerën 192 miliardë £. Investimet prej UE-së në MB kishin shënuar rënie që nga viti kur zyrtarisht kishin filluar negociatat e Brexit-it. Ato kishin rënë 24 miliardë £ në vitin 2017, duke pasuar prej një mosinvestimi të 12 miliardë £ në vitin 2018. Në vitin 2016 IHD-të kishin qenë të barabarta me 10% të GDP-së së Britanisë, kurse në vitin 2017 kjo përqindje kishte rënë në 4%, si dhe në vitin 2018 kishte qenë 2%. Gjer në vitin 2017 MB-ja kishte marrë më së shumti IHD prej UE-së, përqindja e së cilave në vitin 2016 kishte qenë 35%, në vitin 2017 ishte ulur në 30%, si dhe në vitin 2018 kishte pësuar rënie në 23%. Gjatë vitit 2018, IHD-të prej UE-së kishin pësuar rënie prej 12%, ndërsa IHD-të e vendeve joanëtare të UE-së kishin qenë 61,3%, kurse ato nga bota kishin qenë 49,3% (Ward, 2019, pp. 3-6). IHD-të e UE-së në MB kishin pësuar rënie të vazhdueshme që nga aktivizimi i Nenit 50 dhe kjo rënie ishte thelluar akoma pa u finalizuar Brexit-i, me ç'fakt përbën një situatë shqetësuese për ekonominë britanike.

Figura 4.3

Investimet e huaja direkte në MB gjatë vitit 2018



(Ward, 2019, p. 6)

III.2.1.5 Zhvendosja e firmave nga MB-ja

Pasojë e pashmangshme e Brexit-it sa i përket aspektit ekonomik është zhvendosja e kompanive nga MB-ja. Bazuar në disa hulumtime të realizuara nga forumi britanik “New Financial” më 31 tetor 2019, janë identifikuar 330 firma që kanë lëvizur nga Britania në UE ose janë duke lëvizur disa prej bizneseve të tyre, stafet, asetet apo personat juridikë si rrjedhojë e Brexit-it. Sipas hulumtimit në fjalë, 310 firma kanë zgjedhur qendra specifike për bizneset e tyre në UE pas Brexit-it, si dhe që nga data 29 mars 2019 e gjer më 31 tetor 2019 janë identifikuar 63 firma që janë zhvendosur nga MB-ja. Bankat kanë lëvizur ose po lëvizin rreth 800 miliardë £ në asete nga Britania në UE, të cilat përbëjnë 10% të sistemit bankar britanik, ndërkaq firmat e sigurimeve po lëvizin dhjetëra miliarda asete dhe menaxherët e pasurive kanë transferuar më shumë se 65 miliardë £ fonde. Komplikueshmëria e fazës së tretë të negociatave të Brexit-it për arritjen e një marrëveshjeje tregtare ndërmjet Britanisë dhe UE-së i ka detyruar disa firma që të përgatiten për lloj-lloj skenari dhe të vënë në veprim planet e tyre të paparashikuara (New Financial, 2019).

Zhvendosja e firmave ka pasur ndikim edhe në pozicionin e Londrës si një nga qendrat dominuese financiare në Evropë, duke pasuar me rritje të kostove tregtare,

zvogëlim të ndikimit të MB-së në industritë bankare dhe ato financiare në nivel evropian dhe global, goditje të rënda në faturat e taksave kryesisht për eksportet në shërbimet financiare, si dhe do të ndikojë në zvogëlimin e vendeve të punës. Raporti i “New Financial” thekson gjithashtu edhe qytetet evropiane që do të kenë benefite të mëdha nga zhvendosja e firmave prej Londrës. Qyteti më i madh përfitues nga kjo zhvendosje është Dublini me 115 sosh, duke lënë pas vetes Luksemburgun me gjithsej 71, Parisin me 69, Frankfurtin me 45 dhe Amsterdamin me 40. Raporti në fjalë ka treguar se Dublini ka qenë pikë shumë tërheqëse për bizneset e zhvendosura nga MB-ja si rezultat i daljes së saj nga UE-ja. Pothuajse gjysma e menaxherëve të aseteve, fondeve mbrojtëse dhe firmave private të kapitalit kanë zgjedhur Dublinin, përderisa 3/4 e firmave apo 40% që lëvizën në Frankfurt janë banka, përderisa 2/3 e firmave që lëvizën në Amsterdam janë platforma tregtare. Jashtë mase shqetësues vazhdon të jetë fakti se akoma edhe më shumë firma të tjera pritet të zhvendosen nga Britania në vendet e tjera të UE-së gjatë viteve të ardhshme, gjë që pashmangshmërisht do të lë pasojë negative në ekonominë britanike (New Financial, 2019).

III.2.1.6 Ulja e migrimit neto

Niveli i lartë i emigracionit ndikon pozitivisht në rritjen e GDP-së shtetërore, por shkalla këtij ndikimi varet shumë nga profili i migrantëve në raport me popullsinë ekzistuese. Përqindja e migrantëve të punësuar, produktiviteti i tyre në punë dhe plotësimi i aftësive të popullsisë ekzistuese janë parametra kyçë në këtë aspekt (Hope, 2019, p. 12).


Ulja e migrimit neto ka qenë e pritur pas votimit të referendumit të Brexit-it, me ç'rast deri në muajin mars 2019 numri i migrantëve kishte rënë nga 100,000 në 200,000. Migrimi prej UE-së në qershor 2016 kishte qenë 55,000, kurse në mars 2019 kishte rënë në 226,000, si dhe duhet theksuar se rënia e migrimit neto nga UE-ja është më e madhe krahasuar me atë të të gjithë migrantëve në MB. Deri në qershor 2016 rreth 300,000 migrantë kishin ardhur në Britani për arsye që ndërlidheshin kryesisht me punën, kurse në mars 2019 ky numër kishte rënë për 200,000. Numri i migrantëve nga UE-ja që vinë për të punuar në MB ka shënuar rënie dhe krahasuar me migrantët e pjesës tjetër të botës është më i vogël. Arsyeja kryesore që po i shtyn njerëzit të vijnë në Britani lidhet kryesisht me interesin për të studiuar në universitetet britanike, si dhe ata njerëz që vijnë nuk janë nga vendet anëtare të UE-së. Numri i migrantëve në Britani kishte arritur kulmin në tremujorin e fundit të vitit 2014, por ka qenë në rënie për pesë vite radhazi. Brenda periudhës 2014-2019

rënia ka qenë nga 197,000 në 105,000. Jo çuditërisht kontributi i shtetasve të vendeve anëtare të UE-së në tregjet e punës në MB ka stagnuar. Para referendumit kishte rritje në numrin e vendeve të punës të shtetasve të vendeve anëtare të UE-së, por pas referendumit, veçmas që nga gjysma e dytë e vitit 2018 ky numër është zvogëluar (Hope, 2019, pp. 40-47).

Londra përbën një destinacion shumë të rëndësishëm dhe shumë tërheqës për turistët dhe sipas vlerësimeve të bëra në vitin 2019 ky qytet renditej i treti në botë sa iu përket qyteteve më të vizituara (CNN Travel, 2019). Megjithatë, edhe në Londër ka ndikuar negativisht Brexit-i sepse edhe në vitin 2019 kishte pasur rënie të lehtë të numrit të vizitorëve. Në vitet 2014-2019 numri i migrantëve në Londër nga 77,000 kishte rënë në 45,000, rënie prej 33,000 migrantësh. Ndryshimet në politikat e emigracionit në Britani për shtetasit që vijnë prej UE-së paraqesin një sërë sfidash të vështira për pjesë të caktuara të ekonomisë në Londër. Tregu i punës në këtë qytet ka të ngjarë të ndikohet më së shumti nga numri i propozimeve të profesioneve që mund të përballen me çështje të rregullimit të tregut të punës me kualifikim të lartë, të mesëm dhe të ulët (Hope, 2019, 45).

Figura 4.4


Përqindja e punëve në MB nga britanikët, migrantët e UE-së dhe migrantët e vendeve të tjera



(Hope, 2019, p. 50)

Figura 4.5

Përqindja e punëve në Londër nga britanikët, migrantët e UE-së dhe migrantët e vendeve të tjera



(Hope, 2019, p. 45)

III.2.1.7 Rënia e GDP-së britanike

Gjatë fushatës për referendumin e vazhdimësisë së anëtarësimit të MB-së në UE, ekonomistë të ndryshëm nga Britania dhe jashtë saj kanë provuar të dëshmojnë nëpërmes shembujve të ndryshëm se sa i dëmshëm do të jetë Brexit-i për ekonominë britanike, duke specifikuar veçanërisht rënien e GDP-së së vendit. Kostot e larta tregtare me UE-në si pasojë e Brexit-it do të ndikojnë negativisht në ekonominë e MB-së, duke bërë që GDP-ja britanike të jetë e ulët për një periudhë afatgjatë ngase efektet e Brexit-it në GDP do të shfaqen ngadalë, por që do të jenë të përhershme. Në çdolloj skenari të parashikuar për ndikimin e Brexit-it në GDP-në e Britanisë që nga viti 2016 e gjer në vitin 2020 ka rënie të saj, mirëpo skenari më i frikshëm për ekonominë britanike do të ishte mosarritja e një marrëveshjeje tregtare ndërmjet MB-së dhe UE-së në fazën e tretë të bisedimeve, bisedime këto që u karakterizuan nga mospajtimet e thella ndërmjet palëve. Nëse duhet specifikuar fazën më të komplikuar të negociatave të Brexit-it, padyshim që ajo do të jetë faza e tretë e bisedimeve sepse populli dhe bizneset britanike ndikohen shumë prej saj, veçanërisht në kuptimin praktik dhe ekonomik (C. Jackson, interview via email, August 8, 2020).

Tabela 4.4


GDP-ja e MB-së sipas të dhënave të Bankës Botërore nga viti 2015 gjer në vitin 2019

Viti	GDP-ja e Mbretërisë së Bashkuar
2015	2,929 trilionë \$
2016	2,694 trilionë \$
2017	2,666 trilionë \$
2018	2,861 trilionë \$
2019	2,827 trilionë \$

(World Bank, n.d.)

Figura 4.6

Ndryshimet aktuale në vlerën e ardhshme të GDP-së së MB-së



(Sampson, 2020)

Sa i përket vlerës së GDP-së së Britanisë, në vitin 2019 ajo renditej në vendin e gjashtë në botë pas ShBA-ve, Kinës, Japonisë, Gjermanisë, Indisë. Mirëpo, meqë në vitin 2020 bota pësoi goditje të rënda nga pandemia e shkaktuar prej koronavirusit, e cila konsiderohet si pandemia më e keqe që bota ka hasur për 100 vite e që pasojat ekonomike të saj për të gjitha shtetet e botës pavarësisht nivelit të zhvillimit ekonomik janë

jashtëzakonisht të mëdha, shtrohet pyetja se a do të jetë më e dëmshme pandemia e koronavirusit apo Brexit-i për GDP-në britanike. Që prej vitit 2016 vazhdimisht ka pasur skenarë të ndryshëm që tregonin se si mund të ketë rënie të GDP-së së MB-së, por që në vitin 2020 kishte prezantim të tri skenarëve, në mesin e së cilëve përfshihet edhe ndikimi i pandemisë Covid-19 në GDP-në britanike. Mirëpo, pavarësisht dëmeve ekonomike që rezultojnë nga pandemia në fjalë, goditjet e Brexit-it për GDP-në e Britanisë parashikohet të jenë dy deri në tri herë më të mëdha se ndikimi i koronavirusit. Ky i fundit mund të shpie drejt humbjeve afatshkurtra, për dallim nga Brexit-i që do të ketë humbje më të mëdha dhe afatgjata. Përmbyllja e fazës së tretë pa një marrëveshje të tregtisë së lirë do të ishte një cunami për ekonominë britanike sepse kjo e fundit rrezikon të përballlet me një rënie prej 7,6% të GDP-së së MB-së në 15 vitet e ardhshme. Mirëpo, edhe me arritje të marrëveshjes së tregtisë së lirë prapëseprapë GDP-ja e Britanisë do të ketë rënie prej 4,9%. Duket se Pandemia Covid-19 mund të shkaktojë humbje të vendeve të punës dhe ndryshime të mëdha në prodhim nëse krahasohet me Brexit-in, por pasojat e këtij të fundit në MB do të jenë prezente gjer në vitin 2035 (Sampson, 2020). Duke pasur parasysh performancën e Britanisë në bisedimet e fazës së tretë me UE-në dukej sikur ishte e vendosur që të largohej nga UE-ja në fund të dhjetorit 2020 ose në fillim të vitit 2021, edhe pa një marrëveshje të vendosur, gjë që sigurisht që do ta shpinte drejt një situatë me më shumë kaos dhe pasiguri (R. Jasini, interview via author, October 8, 2020).

III.2.2 Pasojat ekonomike të Brexit-it për Unionin Evropian

III.2.2.1 Humbja e kontributit britanik në buxhetin e UE-së

Brexit-i mund të konsiderohet si sfida më e rëndë me të cilën UE-ja është përballur gjatë ekzistencës së saj sepse është rasti i parë ku ajo do të tkurret, si nga përmasat ashtu edhe nga rëndësia ekonomike (Jacobs, 2018, p. 7). Siç dihet, kontributet e shteteve anëtare të UE-së përbëjnë shumicën dërrmuese të të ardhurave të saj. Ato kontribuojnë në buxhetin e UE-së përmes tri burimeve, që njihen si “burime vetanake”:

- 1) Tarifat doganore dhe taksat e sheqerit;
- 2) Kontributet bazuar në një masë të bazës së TVSH-së;
- 3) *Kontributet e bazuara në të Ardhurat Kombëtare Bruto - GNI.*

Shtetet anëtare duhet të kontribuojnë me 0,3% të bazës së tyre të rregulluar ose të harmonizuar të TVSH-së në buxhetin e UE-së. Kontributet e tyre të bazuara në GNI përdoren si një element balancues për t'u siguruar për atë në qoftë se kontributet e vendeve anëtare janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e UE-së, si dhe çdo vend anëtar paguan të njëjtën përqindje të GNI-së së tij në buxhetin e saj. Proporcioni i tyre është vendosur në një nivel që mbledh të ardhura të mjaftueshme për të bërë ndryshimin mes shpenzimeve të planifikuara të UE-së dhe asaj që pret të mbledhë nga të gjitha burimet e tjera (Keep, 2020, pp. 9-10).

Si vend anëtar i UE-së, MB-ja kishte bërë pagesa apo kontribute në buxhetin e UE-së dhe kjo e fundit ka shpenzuar para në Britani përmes programeve të ndryshme financuese, që ofronin mbështetje për bujqësi, kontribuonin në zhvillimin e ekonomive rajonale dhe përmirësonin konkurrencën. MB-ja kontributin e saj në buxhetin e UE-së e ka dhënë përmes tri burimeve:


- 1) *Ka mbledhur tarifa dhe taksa doganore në emër të UE-së. 20% e tarifave të mbledhura mbahen prej shteteve anëtare për të mbuluar koston e mbledhjes;*
- 2) *Ka kontribuar me një përqindje të bazës së saj të rregulluar, ose të harmonizuar, të TVSH-së;*
- 3) *Ka kontribuar në një përqindje të GNI-së (Keep, 2020, 3).*

Kur Britania iu bashkua KEE-së në vitin 1973, neto kontributi i saj ishte shumë i lartë përderisa nga buxheti i KEE-së përfitonte pak, kjo si rrjedhojë e fokusimit të KEE-së në politikat bujqësore. Mekanizmat për korrigjimin e çekuilibrit të kontributeve britanike në buxhetin e KEE-së ishin paraqitur në vitin 1975, pastaj në vitin 1979, gjersa një rënie e kontributeve të MB-së kishte arritur dakordime në qershor 1984 në një takim të KE-së të mbajtur në Fontainebleau (Keep, 2020, 13). Vlerësimet e Thesarit të Britanisë kishin pohuar se MB-ja në vitin 2019 kishte dhënë një kontribut bruto me vlerë prej 14,4 miliardë £ në buxhetin e UE-së, me rënien e llogaritur. Kur analizohen thellësisht pasojat e Brexit-it me karakter ekonomik, duket se Britania do të jetë më e rrezikuar. UE-ja nuk duket humbëse më e madhe nga rezultati i Brexit-it në krahasim me MB-në, ekonomia e së cilës do të pësojë më shumë humbje (R. Dowd, interview via email, October 6, 2020). Megjithatë, nuk duhet anashkaluar faktin se prej Brexit-it rezultojnë disa pasoja ekonomike për UE-në. Nga kjo e fundit po tërhiqet një prej shteteve me peshë të madhe ekonomike në kontinentin evropian. Duke qenë si një prej pak vendeve anëtare më të pasura brenda KEE-së/UE-së,

Britania është shquar për kontribute shumë të larta në buxhetin e KEE-së/UE-së. Humbja e këtyre kontributeve do të mund të përbënte një hendek të konsiderueshëm financiar që kërkon ulje të buxhetit dhe kontribute shtesë nga shtetet anëtare në buxhetin e UE-së. Në vitin 2019, vendet anëtare të UE-së kishin kontribuar me 0,64% të GNI-së së tyre për të balancuar buxhetin e UE-së (RAND Corporation, 2020). Po ashtu, sa i përket tregtisë së brendshme të UE-së, kjo e fundit po humbet një partner tejet të rëndësishëm tregtar, gjersa vendet e saj anëtare si Irlanda, Holanda, Belgjika dhe Danimarka janë shumë më të ekspozuara ndaj tregut të MB-së. Duhet përmendur që Irlanda, Holanda dhe vendet nordike gjithashtu ndajnë edhe interesa të ngjashme të politikës dhe qasjes së përgjithshme të ekonomisë në Britani, të tilla si një preferencë për tregti të lirë sesa për një qasje më proteksioniste, kujdesshmëri apo armiqësi e plotë ndaj perspektivës së harmonizimit apo edhe përafrimit të taksave (Jacobs, 2018, p. 16).

Figura 4.7

Kontributet e MB-së në buxhetin e UE-së dhe të ardhurat nga ky i fundit në miliarda £



(Keep, 2020, p. 6)

Tabela 4.5

Kontributet e MB-së në UE që nga viti 2014 deri më 2019 në miliona £

Kontributet e MB-së në UE	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<i>Detyrimet doganore dhe taksat</i>	2,238	2,325	2,463	3,172	2,608	2,711
<i>Kontributet e TVSH-së</i>	2,388	2,661	2,677	3,040	3,074	2,966
<i>Kontributet GNI</i>	12,521	14,003	11,856	12,154	14,267	14,044
<i>Rregullimet e TVSH-së dhe GNI-së</i>	1,631	571	-	258	-2,505	-777
<i>Rënia e pagesave të MB-së</i>	-4,416	-4,914	-3,878	-5,633	-4,247	-4,516
<i>Kontributet bruto (pas rënies)</i>	14,362	14,646	13,118	12,991	13,198	14,430
<i>Pranimet totale të sektorit publik</i>	4,583	3,883	3,429	4,084	4,273	4,988
<i>Kontributi Neto</i>	9,779	10,763	9,626	8,909	8,925	9,442

(Keep, 2020, p. 7)

III.2.2.2 Impakti i Brexit-it në marrëdhëniet ekonomike të UE-së me Japoninë

Japonia është ekonomia e tretë më e madhe në botë dhe partneri i dytë më i madh i UE-së në Azi. Që prej vitit 2013, Japonia dhe UE-ja kanë negociuar Marrëveshjen e Partneritetit Ekonomik, synim i së cilës është që të sjellë lehtësime të mëtejshme për realizimin e tregtisë ndërmjet tyre. Kryeministri japonez Shinzo Abe, i njohur si një prej politikanëve që ka shërbyer më së shumti në krye të qeverisë japoneze, ka qenë tejet i fokusuar në tregtinë ndërkombëtare dhe investimet e politikës ekonomike. Marrëveshja bilaterale e arritur me UE-në i mundësonte Japonisë krijimin e një zone të re ekonomike, e cila përfshinte rreth 28% të GDP-së botërore dhe 37% të tregtisë globale. Mirëpo, rezultatet e referendumit të vitit 2016 në MB sollën një perspektivë të re mbi marrëdhëniet ekonomike japoneze me UE-në. Shumë firma japoneze me bazë në Britani filluan t'i marrin në konsideratë mënyrat se si do t'iu përgjigjeshin rregullave të reja dhe se si do të përballeshin me rrezikun që kishte lidhshmëri me luhatjet e kursit të këmbimit pasi Britania të largohej nga UE-ja (Kowalski, 2018, pp. 273-274).

Reagimi i Tokios ndaj vendimit të MB-së për t'u larguar nga UE-ja u shpreh më qartë në mesazhin e Japonisë për Britaninë dhe UE-në, të nxjerrë nga Ministria e Jashtme e Japonisë më 2 shtator 2016. Në këtë raport, Japonia kishte shprehur shqetësimet e saj në lidhje me realizimin e tregtisë së lirë pas Brexit-it, sistemin dhe pasigurinë e përgjithshme ekonomike, si dhe kishte theksuar nevojën për një periudhë tranzicioni. Sidoqoftë, ajo që e kishte trazuar më së shumti qeverinë e Tokios është e ardhmja e zhvillimit të biznesit japonez në MB. Brenda këtij mesazhi Japonia kishte shprehur shqetësime të mëdha të natyrës ekonomike si rrjedhojë e Brexit-it. Një numër i konsiderueshëm i bizneseve japoneze që veprojnë në Evropë janë të përqendruara në Britani dhe kanë një sërë kërkesash lidhur me Brexit-in, duke përfshirë:

- *Mirëmbajtjen e tregtisë së mallrave pa ngarkesa të detyrimeve dhe procedurave doganore;*
- *Investime të pakufizuara;*
- *Mirëmbajtjen e një ambienti në të cilin shërbimet dhe transaksionet financiare në të gjithë Evropën mund të sigurohen dhe të kryhen normalisht;*
- *Qasjen në fuqinë punëtore me aftësitë e nevojshme;*

- *Rregullore dhe standarde të harmonizuara mes Britanisë dhe UE-së (Ministry of Foreign Affairs of Japan, 2016).*

Si pasojë e Brexit-it situata ekonomike mund të përkeqësohej në MB dhe UE, me ç'rast mund të kishte rënie të eksporteve të Japonisë për shkak të kërkesave më të dobëta në Britani dhe UE, si dhe këto të fundit po ashtu mund të përballen me rënie të IHD-ve. Ndërkaq, ndikimi nëpërmes kursit të këmbimit mund të rezultojë me rënie të përfitimeve të kompanive japoneze sepse vlera e eksporteve, dividendët dhe honoraret në kompanitë e vendosura jashtë Japonisë mund të ulen bashkë me aftësitë konkurruese të eksporteve. Nga faktet e lartcekura mund të kuptohet se Japonia si një ekonomi e mbështetur në eksporte mund të vuajë nga çdo pengesë e re tregtare që pason prej Brexit-it. Prandaj, Japonia është angazhuar maksimalisht për arritje të dy marrëveshjeve të rëndësishme ekonomike, si me UE-në ashtu edhe me MB-në.

Marrëveshja e Partneritetit Ekonomik të UE-së dhe Japonisë ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2019. Firmat e UE-së tashmë eksportojnë pothuajse afro 70 miliardë € në mallra dhe 28 miliardë € në shërbime në Japoni çdo vit. Në të kaluarën ato ishin përballur me pengesa tregtare kur eksportonin në Japoni, gjë që ua vështirësonte konkurrencën. MPE-ja karakterizohet nga disa pika, të cilat janë:

- *Largimi i tarifave dhe pengesave të tjera tregtare, si dhe krijimi i një platforme bashkëpunuese në mënyrë që të parandalohen pengesat në tregti;*
- *Ndihmesa në formimin e rregullave të tregtisë globale në përputhje me standardet evropiane dhe vlerat e përbashkëta;*
- *Dërgimi i një sinjali të fuqishëm për refuzimin e proteksionizmit të dy prej ekonomive më të mëdha në botë (European Commission, 2020).*

Mirëpo, më 11 shtator 2020 MB-ja dhe Japonia kanë arritur një marrëveshje historike sa i përket tregtisë së lirë, me vlerë prej 15,2 miliardë £. Kjo marrëveshje mes tyre do të sigurojë përfitime shtesë përtej marrëveshjes tregtare të arritur nga UE-ja me Japoninë, duke iu dhënë kompanive britanike mundësi që të eksportojnë në Japoni me një avantazh konkurrues në një numër fushash. Kuptohet që kjo marrëveshje do të ndihmojë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe nxitjen e rritjes ekonomike në të gjithë Britaninë. Përmes saj bizneset britanike do të përfitojnë nga tregtia pa tarifa në 99% të eksporteve në Japoni (United Kingdom Government, 2020).

III.2.3 Pasojat ekonomike të Brexit-it në nivel global

III.2.3.1 Ndikimi i Brexit-it në marrëveshjet ekonomike ndërkombëtare të UE-së

UE-ja posedon gjithsej 982 marrëveshje ndërkombëtare bilaterale (European External Action Service, n.d.) dhe 284 marrëveshje multilaterale (European External Action Service, n.d.). Prej këtyre marrëveshje ndërkombëtare, 161 kanë lidhshmëri me tregtinë, 115 me peshkimin, 92 i përkasin veprimtarive bujqësore, 86 transportit, 68 ambientit, 63 doganave, 59 kërkimit dhe inovacionit, 50 energjisë, 23 zhvillimit dhe Tregut të Brendshëm (European External Action Service, n.d.). Afër 3/4 e marrëveshjeve mbi bazën e të dhënave të traktateve të UE-së janë negociuar dhe miratuar nga UE-ja mbi bazën e një kompetence ekskluzive të saj, e cila bazohet në atë se Traktatet e UE-së i ofrojnë vetëm UE-së fuqinë për të negociuar dhe përfunduar një marrëveshje ndërkombëtare. Kjo ndërlidhet me çështjet doganore, rregullat e konkurrencës, politikën monetare për vendet e eurozonës, ruajtjen e burimeve biologjike detare dhe politikën e përbashkët tregtare që mbulon marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare të UE-së me vendet që nuk janë të anëtarësuara në të. Mirëpo, ekziston edhe një kategori tjetër e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku kompetencat për lidhjen e tyre ndahen mes UE-së dhe shteteve anëtare të saj. Këto njihen ndryshe edhe si marrëveshje të përziera, për të cilat vendet anëtare të UE-së duhet të shprehin pëlqimin e tyre, gjë që nënkupton se krahas UE-së edhe shtetet e saj anëtare do të duhet të miratojnë marrëveshjen sipas procedurave të tyre kushtetuese. Kjo kategori përfshin 1/4 e marrëveshjeve të UE-së, të cilat mbulojnë kryesisht shërbimet dhe pronën intelektuale, si dhe tregtinë e mallrave (Fella, 2019, p. 14). Si rrjedhojë e Brexit-it, është shtruar pyetja se çfarë mund të ndodhë me ato marrëveshje ku si palë kontraktuese është e përfshirë edhe MB-ja. Shumë zëra brenda UE-së pohojnë që marrëveshjet ndërkombëtare, pavarësisht a janë ato bilaterale ose multilaterale, por që janë të lidhura nga UE-ja nuk do të zbatohen në Britani pas Brexit-it. Mirëpo, kjo gjë nuk vlen për marrëveshjet e përziera multilaterale, ku sipas qeverisë britanike do të vazhdonte zbatueshmëria e tyre nga MB-ja edhe pas Brexit-it.

Faza e tretë e negociatave mbi partneritetin e ardhshëm Britani-UE ka impakt të madh në një sërë marrëveshjesh ekonomike të UE-së me vende që cilësohen si ekonomi shumë të fuqishme. Më 28 gusht 2018, ish-Kryeministrja britanike Theresa May gjatë një vizite të bërë në Afrikën e Jugut kishte njoftuar që një partneritet i ri ekonomik ndërmjet

Britanisë dhe Afrikës së Jugut do të ishte gati sa më shpejt që partneriteti aktual ekonomik mes UE-së dhe Afrikës së Jugut, që mbulonte vendet si Botsvana, Lesoto, Namibia, Afrika e Jugut, Eswatini/Swaziland dhe Mozambiku, të pushonte së zbatuari në MB. Mirëpo, Ministri i Tregtisë së Botswana-s kishte bërë një deklaratë duke iu referuar rëndësisë së një marrëveshjeje Britani-UE në periudhën e tranzicionit dhe grumbullimin e MB-së, UE-së dhe të gjitha palëve në marrëveshje për të siguruar vazhdimësinë e tregtisë (Fella, 2019, p. 27). Pastaj, meqë Londra ishte njëra nga qendrat kryesore financiare dhe të shërbimeve për UE-në, gjithnjë ky qytet nga Pekini është parë si pikë lidhëse për marrëdhënie të ngushta ekonomike mes Kinës dhe UE-së, si dhe mes Kinës dhe vendeve anëtare të kësaj të fundit në veçanti (Huang & Michael Reilly, 2018, p. 91). Roli dhe pozicionimi i UE-së si një aktor global ka rol shumë kyç në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike UE-Kinë.

III.2.3.2 Lidhja e marrëveshjeve të reja tregtare të MB-së

Për të parandaluar përçarjen e flukseve tregtare nga të cilat varet ekonomia britanike, Britania krahas negocimit të një marrëveshjeje me UE-në, duhet të negociojë marrëveshje edhe me vendet joanëtare të UE-së, veçmas me ato shtete që kanë rol të madh ekonomik në botë, duke përfshirë këtu ShBA-të, Indinë, Kinën, Japoninë dhe Australinë. Për të qenë më të saktë Britania duhet të krijojë marrëveshje të reja tregtare me 168 vende të botës. Brexit-i ndodhi në kontekstin mjaft të zyrtë të zhvillimit global, kur ekonomitë e vendeve të përparuara kapitaliste janë në krizë të thellë dhe motorët e rinj të rritjes së ekonomive në zhvillim si, Brazili, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut janë po ashtu të zhytura në probleme. Lëvizjet antiglobalizuese së bashku me rritjen e populizmit dhe nacionalizmit në Evropë, si dhe në pjesë të tjera të botës, mund të konsiderohen si një pengesë e madhe për zhvillimin optimist të globalizimit që nga mesi i viteve të 90-ta (Huang and Reilly, 2018, p. 92).

Gjatë kohës kur Britania ishte anëtare e UE-së, kishte qenë palë kontraktuese në 1,261 marrëveshje ndërkombëtare, në mesin e të cilave 759 me rëndësi të mëdha për ekonominë britanike që mbulonin tregtinë, bashkëpunimin rregullator, peshkimin, bujqësinë, bashkëpunimin bërthamor dhe bashkëpunimin e transportit, duke përfshirë këtu edhe aviacionin. Duhet theksuar që si pasojë e Brexit-it, MB-ja humbet 750 marrëveshje ndërkombëtare, nga të cilat 295 në tregti, 202 në bashkëpunim rregullator, 69 në peshkim, 65 transport, 49 në dogana, 45 në energji nukleare dhe 34 në bujqësi (McClellan, 2017).

Tabela 4.6

Lista e marrëveshjeve ndërkombëtare ku MB-ja ka qenë palë kontraktuese nëpërmes anëtarësisë në UE dhe që sipas qeverisë britanike duhet të zëvendësohen

Fushat	Numri i marrëveshjeve
<i>Aviacioni</i>	<i>19 marrëveshje - 16 për shërbimeve ajrore dhe 3 aranzhime të sigurisë ajrore</i>
<i>Doganat</i>	<i>10 marrëveshje - 7 për bashkëpunim doganor dhe 3 të operatorëve ekonomikë</i>
<i>Ambienti</i>	<i>8 marrëveshje</i>
<i>Peshkataria</i>	<i>9 marrëveshje/konventa të peshkimit</i>
<i>Ushqimi dhe pijet</i>	<i>8 marrëveshje</i>
<i>Transporti tokësor</i>	<i>3 marrëveshje</i>
<i>Blegtoria</i>	<i>3 marrëveshje</i>
<i>Tregtia</i>	<i>39 marrëveshje për mbulimin e 75 vendeve.</i>
<i>Tregtia më e gjerë dhe doganat</i>	<i>5 marrëveshje</i>

(Fella, 2019, p. 55-58)

UE-ja ka deklaruar se me tërheqjen e MB-së nga anëtarësia, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, përfshirë edhe ato të përziera do të pushojnë së zbatuari. Mirëpo, ndonëse marrëveshjet e lidhura vetëm me UE-në nuk do të zbatohen në Britani pas largimit nga UE-ja, disa ekspertë ligjorë britanikë kanë sugjeruar që aspektet e marrëveshjeve të përziera mund të vazhdojnë zbatimin. Britania po kërkon traktate të vazhdimësisë ose “përmbysje” të të gjitha marrëveshjeve tregtare të UE-së dhe rregullimeve të tjera tregtare preferenciale me vendet e treta. Kjo do të bëjë të mundur që marrëveshjet me vendet e treta në të cilat MB-ja është aktualisht palë si shtet anëtar i UE-së të përsëriten në marrëveshjet e vendeve të treta në Britani pas Brexit-it (Fella, 2019). Qeveria britanike në mars 2019 kishte identifikuar 157 marrëveshje ndërkombëtare që duhet zëvendësuar nga Britania, por ka shumë pasiguri nëse MB-ja mund të jetë pjesë e këtyre marrëveshjeve sepse shkalla në të cilën Britania do të hyjë në negociata për ta siguruar pjesëmarrjen e vazhdueshme varet nga qëndrimi i palëve kontraktuese të atyre marrëveshjeve. Ka shumë juristë britanikë që cekin vazhdimisht se marrëveshjet ndërkombëtare tregtare që janë marrëveshje të përziera kanë

nevojë për t'u rinegociuar dhe ky rinegociim përbën një proces që merr kohë, është i komplikuar dhe ka kosto të larta financiare. Përfundimi i suksesshëm i një negociimi të tillë është krejtësisht i varur nga vullneti i vendeve të treta. Pastaj, ka dekada që Britania nuk ka negociuar marrëveshje të tilla dhe ka shumë pikëpyetje mbi rrjedhshmërinë dhe rezultatet e rinegociimit të tyre. Në vend të rinegociimit MB-ja mund të binte dakord me vendet e treta për një rrotullim të dispozitave të marrëveshjeve ekzistuese, por sado që Britania të mbështetej në vullnetin e mirë të një vendi të tretë për t'i zgjeruar këto marrëveshje në një kontekst krejtësisht të ri, nuk është e sigurt që pala e fundit do t'i rezistonte tundimit për të zbërthyer aspekte specifike të marrëveshjes (Miller, 2017, pp. 7-8).

III.2.4 Konkluzionet

Pasojat e Brexit-it në aspektin ekonomik duhet trajtuar me shumë seriozitet. Ekonomia e MB-së do të pësojë goditje shumë të rënda si pasojë e daljes nga UE-ja. Detyrimet financiare britanike ndaj UE-së do të vazhdojnë deri në vitin 2064. Rritja e kostove tregtare do të ndikojë në zvogëlimin e aktiviteteve tregtare me UE-në dhe uljen e GDP-së britanike. Devaluimi i monedhës paund mund të përkeqësojë zhvillimin e tregtisë, duke shkaktuar ulje eksportesh dhe rritje importesh për Britaninë. Rënia e IHD-ve bashkërisht me zhvendosjen e firmave nga MB-ja mund të zvogëlojë ndikimin e kësaj të fundit në industrinë bankare dhe ato financiare në nivel evropian dhe global. Ulja e migrimit neto rrezikon stagnimin e tregjeve të punës në Britani. Ndërkaq rënia e GDP-së është pasojë e pashmangshme, por mosarritja e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë mes MB-së dhe UE-së, si dhe efektet negative të pandemisë Covid-19 do të jenë një cunami për GDP-në britanike. Ndonëse jo e dëmtuar ekonomikisht si Britania, edhe UE-ja do të ketë pasoja ekonomike nga Brexit-i. Humbja e kontributit të MB-së në buxhetin e UE-së mund të rezultojë me rritje të kontributeve të vendeve të tjera anëtare në buxhetin e saj. MPE mes UE-së dhe Japonisë ka rëndësi të jashtëzakonshme, por në vitin 2020 kjo e fundit ka arritur një marrëveshje historike të tregtisë së lirë edhe me Britaninë. Pastaj, disa marrëveshje ekonomike të UE-së mund të vazhdojnë për MB-në, e disa të tjera duhet të zëvendësohen, por Britania duhet të lidhë edhe marrëveshje tregtare me vende të tjera, rinegociimi i së cilave varet nga vullneti i vendeve të treta dhe merr shumë kohë.

III.3 Pasojat politike të Brexit-it

III.3.1 Pasojat politike të Brexit-it për Mbretërinë e Bashkuar

III.3.1.1 Dorëheqja e David Cameron-it nga posti i kryeministrit britanik

Politikanët britanikë i karakterizon përkushtimi i tyre maksimal për të mirën e kombit, për zgjedhjen e interesave të përgjithshme, duke bërë çmos që të shmangnin konfliktet (Filo, 2008, f. 195). Politikani David Cameron, i cili kishte pasur një barrë të rëndë mbi supe me organizimin e referendumit të dytë në MB mbi anëtarësinë e saj në UE, kishte qenë optimist nga arritja e marrëveshjes mbi statusin e special të Britanisë në UE që rezultoi nga rinegociimi me këtë të fundit. Mirëpo, një sërë faktorësh e shuan optimizmin e tij aq sa më 23 qershor 2016 edhe pse me një rezultat shumë të ngushtë populli britanik zgjodhi rrugën e daljes së MB-së nga UE-ja. Këtë vendim të britanikëve ai e cilësonte si një destinacion drejt një të ardhmeje të pasigurt dhe të rrezikshme për vendin dhe popullin e tij. Cameron më 24 qershor 2016 kishte vendosur të dorëhiqej nga posti i kreut të qeverisë, në të cilin kishte qëndruar për gjashtë vite radhazi dhe siç ai e kishte përshkruar, kishte qenë një detyrë të cilën e kishte dashur më shumë se çdo gjë, si dhe kishte dhënë maksimumin nga vetja për të udhëhequr vendin në mënyrën më të mirë të mundshme. Në fjalimin e dorëheqjes së tij, ai kishte thënë se referendumin e Brexit-it e konsideronte si stërvitje gjigante demokratike të Britanisë. Sipas tij politikanët e MB-së duhej të mburrehin me faktin që kanë besim maksimal te populli i tyre sa herë që bëhet fjalë për vendime të mëdha, siç ishte edhe vendimi për ta tërhequr Britaninë nga anëtarësia e UE-së. Cameron kishte falënderuar të gjithë ata që kishin marrë pjesë në fushatat e referendumit të vitit 2016, qofshin ato pro apo kundër qëndrimit të Britanisë në UE, madje edhe këta të fundit i kishte uruar për fitoren dhe i kishte përgëzuar për angazhimin e tyre frymëzues dhe pasionant. Ai kishte përmendur se vullneti i popullit britanik domosdoshmërisht duhet respektuar dhe tanimë MB-ja me njerëzit dhe liderët e saj, pavarësisht mënyrës se si ata kishin votuar duhej “të përgatiteshin për negociimin me UE-në”. Kjo nënkuptonte nevojën e përfshirjes së qeverive të Skocisë, Uellsit dhe Irlandës Veriore, me qëllim për t’u siguruar që interesat e të gjitha vendeve të Britanisë do të mbroheshin. Ai kishte shprehur besimin e tij që MB-ja do të ishte më e fuqishme dhe më e sigurt brenda UE-së, duke përmendur atë që

referendumi ishte organizuar vetëm për vendin dhe jo për të caktuar të ardhmen e ndonjë politikani/eje britanik/e, përfshirë edhe veten e tij. Mirëpo, populli kishte vendosur për të marrë rrugë tjetër dhe për këtë rrugë ai nuk mendonte se ishte i denjë për pozitën e udhëheqësit që do të drejtonte vendin e tij në destinacionin e ardhshëm. Duke e pranuar se ishte një vendim shumë i vështirë për të, ai kishte deklaruar dorëheqjen e tij, ku kishte thënë se ishte në interesin kombëtar britanik që të ruhej stabiliteti dhe më pas të kërkohet udhëheqja e re. Gjer në konferencën e PK-së në tetor 2016 kur duhej të zgjidhej edhe kryeministri i ardhshëm britanik, Cameron do të ishte në krye të qeverisë së Britanisë (BBC News, 2016). David Cameron kishte konkluduar që si rrjedhojë e rezultateve të referendumit për Brexit dhe pasojave të këtij të fundit, nuk do të ishte i gatshëm t'i përballonte ato në pjesën tjetër të jetës. Një rrezik që ai e kishte paralajmëruar që atëherë ishin negociatat e daljes nga UE-ja, ku MB-ja do të ishte e vetme kundër 27 vendeve të tjera anëtare të UE-së dhe në këtë mënyrë UE-ja do të ishte shumë më e fuqishme dhe më e favorizuar në bisedime. Sipas tij, ajo çfarë e bënte Britaninë të madhe nuk ishte madhësia e saj territoriale, por populli i saj, si dhe çdo politikan/e britanik/e është me fat që sistemi politik i MB-së iu mundëson atyre të veprojnë sipas asaj që mendojnë shumica e britanikëve. Interesi kombëtar dhe shërbimi publik në Britani kanë një lidhshmëri shumë të ngushtë mes tyre, duke e bërë kështu popullin britanik më të veçantë nga popujt e tjerë të botës (Cameron, 2019, p. 1332).

Çfarë ndodh kur një kryeministër nga radhët e Konservatorëve dorëhiqet nga posti? Nëse një kryeministër i PK-së largohet prej udhëheqjes së partisë, atëherë pason gara për drejtuesin/en e ri/e. Personi që vendos të dorëhiqet mund të qëndrojë në postin e kreut të qeverisë gjersa të zgjedhet një kryeministër/re i/e ri/e, ose të ofrojë dorëheqjen në favor të një deputeti /eje tjetër nga PK-ja që përkohësisht do të mbante postin e kryeministrit derisa të mbaronte konkursi i lidhshimit. Mirëpo, sa ndikon kjo sfidë lidhshimit në punën e qeverisë? Realisht qeveria dhe shërbimi civil funksionojnë pa ndryshime dhe derisa gara të përfundojë, personi që ka postin e kryeministrit gëzon akoma të gjitha kompetencat e kryeministrit britanik (Institute for Government, n.d.). Nga PK-ja kishte pasur pesë pretendentë për të zëvendësuar David Cameron-in:

- 1) *Theresa May - Sekretare e Brendshme e MB-së, me pikëpamje anti-Brexit;*
- 2) *Michael Gove - Sekretar i Shtetit për Drejtësi, me pikëpamje anti-Brexit-it;*
- 3) *Stephen Crabb - Sekretar i Shtetit për Punë dhe Pensione, përkrahës i Brexit-it;*

4) *Andrea Leadsom - Sekretare e Shtetit për Energji, me pikëpamje pro-Brexit-it;*

5) *Liam Fox - Deputet i PK-së, mbështetës i Brexit-it (Cowburnd & Cooper, 2016).*

Deputetët e PK-së do të duhej të votonin në tri raunde për udhëheqjen e re të partisë dhe kreun e qeverisë britanike që pritej të definohej më 9 shtator 2016. Në raundin e parë më 5 korrik 2016, Theresa May kishte marrë 165 vota, Andrea Leadsom 66 vota, Michael Gove 48 vota, Stephen Crabb 34 vota dhe Liam Fox 16 vota. Pastaj, në raundin e dytë më 7 korrik 2016 kishin votuar 329 deputetë, ishte eliminuar Michael Gove që kishte marrë 46 vota, si dhe gara kishte vazhduar ndërmjet Theresa May që kishte marrë 199 vota dhe Andrea Leadsom 84 vota (Stewart & Mason, 2016). Raundi i tretë nuk ishte realizuar sepse Andrea Leadsom ishte tërhequr nga gara më 11 korrik 2016 për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme nga kolegët e saj (Asthana et al., 2016). Më 13 korrik 2016 Theresa May ishte konfirmuar si udhëheqësja e re e PK-së dhe kryeministrja e re britanike, respektivisht kryeministrja e dytë femër e MB-së pas Margaret Thatcher, e cila ishte ftuar nga Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeta II, që të formonte kabinetin e ri qeveritar të Britanisë (United Kingdom Government, 2016). Me përjashtim të Natalie Evans, Andrea Leadsom, Chris Grayling, Priti Patel, Liam Fox, David Davis dhe Boris Johnson, të gjithë anëtarët e tjerë të kabinetit të saj qeveritar të vitit 2016 kishin pikëpamje kundër Brexit-it (Mason et al., 2016).

III.3.1.2 Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017

Konservatorizmi është një prej ideologjive kryesore që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në teorinë dhe praktikën e zhvillimit të shoqërive bashkëkohore. Si ideologji politike, është kundër ndryshimeve të shpejta, të menjëhershme dhe rrënjësore në shoqëri. Pra, konservatorizmi është ideologji e cila në princip mbron gjendjen ekzistuese të shoqërisë, duke e trajtuar atë si diçka që ka ekzistuar gjithmonë. Konservatorizmi që nga lindja e tij e gjer më sot ka pësuar ndryshime konform kushteve dhe rrethanave konkrete shoqërore (Aziri, 2015, ff. 60-61). PK-ja gëzon një rol shumë të rëndësishëm në MB, por bazuar në faktin se qeveria britanike e udhëhequr nga partia në fjalë organizoi referendumin mbi anëtarësinë e Britanisë në UE dhe kishte përgjegjësi për realizimin e këtij procesi, shtrohet pyetja nëse marrëdhëniet britanike me UE-në e kanë favorizuar apo disfavorizuar PK-në karshi PL-së? Realisht shikuar në këtë aspekt, të vogla janë gjasat se votuesi britanik është përcaktuar se për cilën parti politike do të votojë, në varësi nga ajo se cilat relacione partia në rast të të qenurit në pushtet do i ndërtojë me UE-në. Është plotësisht e

kuptueshme për atë shoqëri ku ka qytetarë që janë euroskeptikë dhe që nuk janë të tillë. Gjithsesi që për kategorinë e parë më joshëse mund të jetë dëshmuar PK-ja e për të tjerët ndoshta PL-ja. Megjithatë votuesi edhe në Britaninë e Madhe ka votuar në bazë të ofertës programore në kontekst të asaj se çka ajo ofertë ka ofruar për qytetarin dhe në bazë të orientimeve ideologjike të caktuara (E. Aziri, intervistë nëpërmes email-it, 17 Qershor 2020).

Theresa May gjatë fushatës së referendumit në vitin 2016 kishte pohuar se Brexit-i do të ishte sfidë shumë e rëndë për çdokënd që do ta udhëhiqte PK-në në rast se David Cameron do të dorëhiqej nga posti i kryeministrit (Bennett, 2016). Pas dorëheqjes së tij, May ishte ajo që ishte përballur me këtë sfidë, vështirësia e së cilës doli në pah qysh në ditët e para kur ajo kishte marrë përsipër udhëheqjen e qeverisë. Si rrjedhojë e përplasjeve politike në Parlamentin e Britanisë, para se të fillonin bisedimet e procesit të Brexit-it, gjegjësisht faza e parë e tyre, ajo kishte marrë vendim për organizimin e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme. Më 18 prill 2017 kishte njoftuar britanikët mbi planet e saj për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, duke ngjallur habi sepse në shtator 2016 ajo kishte pohuar që zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të mbaheshin në vitin 2020. Por, arsyeja e një vendimi të tillë kishte të bënte me fuqizimin e ndikimit të saj në negociatat e Brexit-it sepse PL-ja, DL-ja dhe PNS-ja do të bënin përpjekje për t'i penguar planet e saj mbi procesin e Brexit-it, duke e destabilizuar parlamentin. Mandati pesëvjeçar do t'i shërbente May-it që të negocionte edhe marrëveshjet me UE-në për tregtinë e lirë, të cilat ishin shumë të rëndësishme për të ardhmen e MB-së pas Brexit-it, por njëkohësisht edhe shumë të vështira (BBC News, 2017). Premtimet kryesore të PK-së në këto zgjedhje kishin qenë këto:

- *Dalja pa probleme dhe e rregullt e Britanisë nga UE-ja;*
- *Rritja e buxhetit të KKSh-së për 8 miliardë £ në vit deri më 2022/2023;*
- *Një shtesë prej 4 miliardë £ për shkollat në Angli gjer në vitin 2022;*
- *Përkushtimi i vazhdueshëm për të ulur migracionin nga dhjetëra në mijëra;*
- *Balancimi i buxhetit gjer në vitin 2025;*
- *Zëvendësimi i pengut pensional me bllokim të trefishtë në bllokim të dyfishtë (BBC News, n.d.).*

Ndërkaq, premtimet kryesore të PK-së lidhur me Brexit-in kishin qenë:

- *Largimi nga Tregu i Vetëm dhe Unioni Doganor gjersa kërkohej “një partneritet i thellë dhe i veçantë me UE-në;*

- *Sigurimi i një “Brexit-i të qetë dhe të rregullt” duke ruajtur atë që “asnjë marrëveshje nuk është më mirë sesa një marrëveshje e keqe për MB-në”;*
- *Përcaktimi për një “zgjedhje të drejtë mbi të drejtat dhe obligimet e Britanisë në tërheqjen nga UE-ja;*
- *Projektligji i Shfuqizimit të Madh të konvertimit të të drejtës së UE-së në atë të Britanisë (BBC News, n.d.).*

Premtimet kryesore të PL-së në zgjedhjet e vitit 2017 kishin qenë si vijon:

- *Përfundimi i masave shtrënguese dhe investime të shumta në shërbimet publike;*
- *Negocimi i marrëveshjes së Brexit-it “duke vënë në vend të parë ekonominë dhe standardet jetësore”;*
- *Nacionalizimi i një numri shërbimesh përfshirë këtu hekurudhat, postën, ujin dhe Rrjetin Kombëtar;*
- *Rritja e taksave në biznese dhe tek më të paguarit;*
- *Investimi në ekonominë britanike përmes një pakoje stimuluese prej 250 miliardë £;*
- *Largimi i tarifave të shkollimit për studentët universitarë në Angli (BBC News, n.d.).*

Ndërsa, lidhur me Brexit-in, PL-ja kishte dhënë këto premtime:

- *Copëzimi i letrës së bardhë të Brexit-it duke e zëvendësuar atë me shumë përparësi negociuese, “me theks të veçantë në tregun e vetëm dhe unionin doganor”;*
- *Garantimi i menjëhershëm i të drejtave të qytetarëve të UE-së që jetojnë në Britani;*
- *Zëvendësimin e “Projektligjit të Shfuqizimit të Madh” me një projektligj të UE-së mbi të drejtat dhe mbrojtjet që do të siguronte eliminimin e çdo ndryshimi në të drejtat e punëtorëve apo mbrojtjen e mjedisit;*
- *Refuzimi i “asnjë marrëveshje” me UE-në si mundësi e zbatueshme (BBC News, n.d.).*

Duke pasur parasysh premtimet e UKIP-it në zgjedhjet e vitit 2015 që i sollën suksesin më të madh të arritur ndonjëherë, për zgjedhjet e vitit 2017 kjo parti kishte pasur këto premtime:

- *Përfundimi i procesit të Brexit-it gjer në vitin 2019, pa paguar para në UE;*
- *Rivendosja e “kontrollit të plotë” të zonës ekskluzive ekonomike detare të MB-së;*
- *Ulja e nivelit të migracionit në zero brenda 5 viteve duke përgjysmuar gjysmën e emigracionit në Britani;*
- *Puna e pakualifikuar dhe me kualitet të dobët të ndalohet për pesë vite, ndërsa punëtorët e kualifikuar dhe studentët do të kenë nevojë për viza;*

- *Zvogëlimi i buxhetit për ndihmat e huaja dhe shpenzimi i tij në prioritete të brendshme, të tilla si KKSh-ja;*
- *Gjykatat e Sheriatit⁵³ dhe veshja e mbulesave të fytyrës në vende publike (BBC News, n.d.).*

Kurse, premtimet e UKIP-it në lidhje me procesin e Brexit-it kishin qenë këto:

- *Largimi nga juridiksioni i GjDUE-së, tregut të vetëm të UE-së dhe unionit doganor;*
- *Rikthimi i “sovrانيتit të plotë detar”;*
- *Mospagesa e parave të “divorcit” nga UE-ja dhe moskontribuimi në buxhetin e kësaj të fundit;*
- *Përfundimi i procesit të Brexit-it deri në fund të vitit 2019 (BBC News, n.d.).*

Zgjedhjet parlamentare të parakohshme të MB-së ishin mbajtur më 8 qershor 2017. Kureshtja më e madhe e britanikëve dhe jo vetëm ishte bazuar tek ndikueshmëria e Brexit-it në rezultatet e tyre. Në këto zgjedhje elektorati me të drejtë vote përfshinte *46,835,433 persona*, gjersa në votim morën pjesë *32,294,928 votues* ose *69%*. Po të krahasohen këto zgjedhje me ato të vitit 2015, këtë vit dalja e votuesve ishte më e lartë për *1,597,403 persona* apo *2,6%*. Konservatorët sërish e kishin marrë pushtetin dhe krahasuar me zgjedhjet e vitit 2015 kishin pasur rritje prej *2,335,657 votash* apo *5,5%*. Por, në këto zgjedhje edhe PL-ja shënoi ngritje dhe për dallim nga zgjedhjet e kaluara kishte *3,531,187* vota më shumë dhe ngritje prej *9,5%*. Derisa dallimi mes kësaj partie dhe PK-së në vitin 2015 kishte qenë për *1,986,953* vota ose *6,5%*, në vitin 2017 dallimi mes tyre ishte zvogëluar në *791,423* vota apo *2,4%*. Ndërsa, UKIP që kishte shënuar sukses marramendës në zgjedhjet e vitit 2015, në këto zgjedhje kishte pasur një dështim po aq marramendës me *3,387,031* vota më pak dhe rënie prej *10,8%*. Rezultatet e këtyre zgjedhjeve kishin shfaqur haptazi impaktin e Brexit-it sepse britanikët që e kishin kundërshtuar daljen e MB-së nga UE-ja dhe ata që i kishin kuptuar pasojat e Brexit-it, i kishin shfaqur pakënaqësitë dhe pendimin nëpërmes votave, duke ndëshkuar UKIP-in në veçanti, por edhe PK-në, si meritore kryesorë të Brexit-it.

⁵³ Gjykata e Sheriatit ka të bëjë me atë se ShBA-të dhe shtetet e ndryshme, përfshirë edhe MB-në, e kanë të “ndaluar ligjin e Sheriatit”, ose e kanë kaluar këtë çështje në një lloj të masës së votimit që ‘ndalon gjykatat e shtetit të marrin parasysh ligjin e huaj, ndërkombëtar ose fetar’.

Tabela 5.1

Votimi i partive politike në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të parakohshme të MB-së në vitin 2017

Partitë	Gjithsej ulëse	Ulëse të fituara ose të humbura	Vota të fituara	Përqindja e votave të fituara	+/- %
<i>Partia Konservatore</i>	318	-13	13,669,883	42,4	+5,5
<i>Partia Laburiste</i>	262	+30	12,878,460	40,0	+9,5
<i>Partia Nacionale Skoceze</i>	35	-21	977,569	3,0	-1,7
<i>Demokratët Liberalë</i>	12	+4	2,371,910	7,4	-0,5
<i>Partia e Unioniste Demokratike</i>	10	+2	292,316	0,9	+0,3
<i>Sinn Féin</i>	7	+3	238,915	0,7	+0,2
<i>Plaid Cymru</i>	4	+1	164,466	0,5	-0,1
<i>Partia Jeshile</i>	1	0	525,435	1,6	-2,1
<i>Partia Social-Demokrate dhe e Punës</i>	0	-3	95,419	0,3	-0,0
<i>Partia Unioniste e Ulsterit</i>	0	-2	83,280	0,3	-0,1
<i>UKIP</i>	0	-1	594,068	1,8	-10,8

(BBC News, n.d.)

Theresa May nuk e kishte arritur mazhorancën meqë nuk i kishte 325 deputetë dhe këto rezultate kishin krijuar pasiguri në strategjinë e saj për bisedimet e Brexit-it. Konservatorët kishin arritur marrëveshje me PUD-në, parti kjo që kishte marrë 10 ulëse në

parlament dhe kështu së bashku kishin 328 deputetë (Hunt, 2017). Deputetët e PUD-së shquheshin për pikëpamjet e tyre pro-Brexit-it dhe jo anti-UE-së. Gjithsesi, duhet cekur që në mes të PK-së dhe PUD-së nuk ishte formuar koalicion ngase kuptohet që në një koalicion këto dy parti do të duhej të ishin dakorduar mbi një program të përbashkët dhe ministrat do të kishin qenë nga të dy partitë. Konservatorët do ta kishin mbështetjen e deputetëve të kësaj partie vetëm kur të kishin nevojë për vota në çështjet buxhetore dhe në rast të mocionit të mosbesimit (Hunt, 2017).

III.3.1.3 Dorëheqja e Theresa May-it nga posti i kryeministres britanike

Theresa May do të njihet në historinë britanike si një politikane që e kishte marrë përsipër udhëheqjen e qeverisë së MB-së në një periudhë shumë të vështirë për vendin dhe me shumë gjasa më sfiduesen e këtij shekulli. Që nga vendimi i qeverisë së kryesuar nga ajo për aktivizimin e Nenit 50 e gjer tek përpjekjet e njëpasnjëshme për të ofruar një marrëveshje të daljes sa më të favorshme për britanikët, duke mos i harruar raundet e ndryshme të negociatave me UE-në për Brexit, ajo ishte përballur me sulme të njëpasnjëshme si rrjedhojë e përplasjeve parlamentare në Britani.

Në MB është një konventë thelbësore dedikuar çështjes së thirrjes së mocionit të mosbesimit nga Dhoma e Komunave, të cilën qeveria duhet të jetë në gjendje ta respektojë, si dhe kjo konventë rregullon si emërimin ashtu edhe dorëheqjen e kryeministrave. Sipas saj pozicioni tradicional ishte që një qeveri që humb kundrejt mocionit të mosbesimit, do të dorëhiqej në favor të një administrate alternative, apo kryeministri do të kërkonte shpërbërje nga Mbretëresha, duke nxitur zgjedhje të përgjithshme. Mirëpo, Akti i Parlamenteve me Mandate Fikse të 15 shtatorit 2011, hoqi fuqinë prorogative të shpërbërjes së Parlamentit. Sipas aktit në fjalë, ekzistojnë dy nxitje për çfarë Dhoma e Komunave mund të sjellë zgjedhje të parakohshme:

- 1) *Nëpërmes një votimi të thjeshtë të sjellë nga 2/3 e deputetëve;*
- 2) *Nëpërmes mocionit të mosbesimit (Kelly, 2019, p. 4).*

Në dhjetor të vitit 2018, deputetët e pakënaqur nga politika e saj në procesin e Brexit-it lansuan mocion mosbesimi ndaj Theresa May-it, mirëpo më 12 dhjetor 2018 ajo i kishte shpëtuar këtij mocioni sepse nga deputetët e partisë së saj kishte pasur mbështetje nga 200 sosh dhe kishin qenë 117 të tjerë që e kishin përkrahur mocionin kundrejt saj (Johnston, 2019, pp. 11-12). Megjithatë, humbja e 1/3 së mbështetjes së deputetëve të PK-së, të cilët

kishin shprehur pakënaqësitë e tyre me May-in, duke pohuar se ajo e kishte tradhtuar rezultatin e referendumit të vitit 2016 kishte përbërë një çështje mjaft serioze.

Marrëveshja e propozuar në Dhomën e Komunave nga Theresa May si rezultat i negociatave të MB-së me UE-në për Brexit ishte refuzuar tri herë radhazi. Herën e parë më 15 janar 2019 kur 432 deputetë kishin votuar kundër Marrëveshjes së Tërheqjes, në mesin e të cilëve 118 kishin qenë nga PK-ja, ndërsa 202 të tjerë e kishin mbështetur atë. Herën e dytë më 13 mars 2019, marrëveshja e propozuar ishte kundërshtuar nga 391 deputetë, ku kishin qenë 75 deputetë të PK-së, gjersa marrëveshja në fjalë ishte votuar 242 deputetë (Fella, 2019, 8). Herën e tretë më 29 mars 2019, datë kjo që sipas përmbajtjes së Nenit 50 do të duhej të kishte qenë “Brexit Day”, Marrëveshja e Tërheqjes ishte refuzuar nga 344 deputetë, nga të cilët Konservatorë kishin qenë 34, ndërsa ishte votuar nga 286 deputetë (United Kingdom Parliament, 2019). Përpjekjet e Theresa May-it për të gjetur kompromis lidhur me Marrëveshjen e Tërheqjes nga UE-ja me PL-në gjithashtu kishin dështuar, ndërsa thirrjet për dorëheqje të saj ishin shtuar. Presionet e vazhdueshme kundër planeve të saj për Brexit nga ligjvënësit e kishin detyruar atë që në vitin 2019, respektivisht më datën 24 maj të këtij viti të dorëhiqej nga posti i kreut të qeverisë së MB-së nëpërmes një deklaratë shumë emocionuese. Pjesë e zemërimit të saj nuk kishte qenë mosmbështetja nga PL-ja aq sa kishte qenë mospërkrahja nga PK-ja, posaçërisht nga ata deputetë që kishin favorizuar Brexit-in. Pastaj anëtarë të kabinetit të saj qeveritar filluan ta kundërshtonin atë haptazi, madje disa edhe duke u dorëhequr nga pozitat në të cilat ishin caktuar. Gjatë deklaramit të dorëheqjes së saj, ajo kishte pohuar se gjithmonë do të ndiente keqardhje të thellë që nuk kishte mundur të finalizonte Brexit-in, por e kishte më se të qartë se ishte në interesin më të mirë të Britanisë që një kryeministër i ri të vazhdonte me përpjekjet e tilla (BBC News, 2019).

Pas dorëheqjes së May-it, kryeministri/ja i/e ri/e në Britani do të zgjedhej në korrik 2019. Kandidatët që kishin synuar të merrnin udhëheqjen e PK-së, si dhe bashkë me të postin e kreut të qeverisë britanike kishin qenë: *Boris Johnson, Jeremy Hunt, Michael Gove, Sajid Javid, Rory Stewart, Dominic Raab, Matt Hancock, Andrea Leadsom, Mark Harper dhe Esther McVey*. Në raundin e parë të votimit më 13 qershor 2019, garën do ta kishin vazhduar Boris Johnson me 114 vota, Jeremy Hunt me 43 vota, Michael Gove me 37 vota, Dominic Raab me 27 vota, Sajid Javid me 23 vota, Matt Hancock me 20 vota, Rory Stewart me 19 vota, ndërsa ishin eliminuar Andrea Leadsom me 11 vota, Mark Harper me 10 vota dhe

Esther McVey me 9 vota. Më 14 qershor 2019 nga gara ishte tërhequr Matt Hancock sepse kishte qenë pretenduesi më i ri në moshë dhe mendonte se PK-së i duhej një lider që do të kishte suksese “këtu dhe tani” (BBC News, 2019). Në raundin e dytë që ishte mbajtur më 18 qershor 2019, garën e kishin vazhduar Boris Johnson me 126 vota, Jeremy Hunt me 46 vota, Michael Gove me 41 vota, Rory Stewart me 37 vota dhe Sajid Javid me 33 vota, kurse ishte eliminuar Dominic Raab me 30 vota. Në raundin e radhës më 19 qershor 2019 në mesin e pretendentëve për marrjen e lidërsipit të PK-së dhe udhëheqjen e qeverisë britanike kishin qenë: Boris Johnson me 143 vota, Jeremy Hunt me 54 vota, Michael Gove me 51 vota dhe Sajid Javid me 38 vota, ndërkaq ishte eliminuar Rory Stewart me 27 vota. Raundi i katërt në votimin e mëngjesit të 20 qershorit 2019 kishte nxjerrë në pah tre kandidatë: Boris Johnson me 157 vota, Michael Gove me 61 vota dhe Jeremy Hunt me 59 vota, si dhe kishte eliminuar Sajid Javid me 34 vota. Në po të njëjtën datë u votua për dyshen finale, ku ishte eliminuar Michael Gove me 75 vota, ndërsa gara kishte vazhduar ndërmjet Jeremy Hunt me 77 vota dhe Boris Johnson me 160 vota (Institute for Government, n.d.).

Në një proces ku të drejtë votimi kishin pasur afër 160,000 anëtarë të PK-së, e që në procesin e votimit dalja kishte qenë 87,4% dhe 509 vota ishin refuzuar, Boris Johnson kishte marrë 92,153 vota dhe Jeremy Hunt 46,656 vota, me ç’fakt më 13 korrik 2019 ishte konfirmuar Boris Johnson si udhëheqësi i ri i PK-së dhe kreu i ri i qeverisë britanike (BBC News, 2019). Ky i fundit, ishte ftuar nga Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeta II, më 24 korrik 2019, që të formonte kabinetin e ri qeveritar të MB-së (Royal Family, 2019).

III.3.1.4 Prorogimi i Parlamentit të MB-së në vitin 2019

Vendimi i britanikëve për ta tërhequr vendin e tyre nga anëtarësia e UE-së solli një prorogim të veçantë të Parlamentit të Britanisë. Prorogimi është një proces që shënon fundin e një sesioni parlamentar dhe përbën periudhën mes përfundimit të një sesioni parlamentar dhe hapjen shtetërore të sesionit të ardhshëm. Mbretëresha formalisht e prorogon parlamentin me këshilla të ofruara nga Këshilli Privat i MB-së.⁵⁴ Duhet theksuar dallimin e prorogimit nga shpërbërja e parlamentit, me të cilën deputetëve iu përfundojnë mandatet e legjislaturës për të cilën janë zgjedhur dhe më pas organizohen zgjedhjet e reja.

⁵⁴ Këshilli Privat i Mbretërisë së Bashkuar është një organ zyrtar i këshilltarëve të Sovranit të MB-së. Anëtarësia e tij kryesisht përfshin politikanë të moshuar, të cilët janë deputetë ose ish-deputetë të Dhomës së Komunave ose Dhomës së Lordëve.

Prorogimi zakonisht merr formë të një njoftimi, në emër të Mbretëreshës, të lexuar në Dhomën e Lordëve. Ajo iu drejtohet të dy Dhomave dhe Kryetarit të Dhomës së Komunave, si dhe deputetët marrin pjesë në Dhomën e Lordëve për të dëgjuar fjalimin. Njoftimi i prorogimit përcakton projektligjet kryesore që janë miratuar gjatë asaj seance dhe gjithashtu përshkruan masa të tjera të marra nga qeveria (United Kingdom Parliament, 2020). Më 28 gusht 2019 Boris Johnson i kërkoi Mbretëreshës që të prorogonte parlamentin brenda një periudhe pesëjavore, nga 9 shtator gjer më 14 tetor, periudhë brenda së cilës deputetët nuk do të mbanin as debate dhe as nuk do të votonin ligje si rezultat i mosmbajtjes së asnjë seance në Dhomën e Komunave dhe në Dhomën e Lordëve. Mbretëresha e kishte aprovuar kërkesën e Kryeministrit Johnson dhe fjalimi i saj pritej të mbahej më 14 tetor 2019 (BBC News, 2019). Sipas saj periudha pesëjavore do t'i shërbente Johnson-it që të rivendoste orarin parlamentar dhe të lansonte një program të ri legjislativ. Mirëpo, plani për të proroguar parlamentin gjerësisht ishte parë si një tendencë për t'iu kufizuar kohë kundërshtarëve të Johnson-it dhe për të shuar çdo përpjekje që do të mund të parandalonte një dalje të Britanisë nga UE-ja pa marrëveshje (Cowie, 2019, p. 21).

Biznesmenja guajano-britanike Gina Miller edhe kësaj radhe ishte përpjekur për të parandaluar veprime që sipas saj kishin qenë kundër demokracisë britanike, duke e dërguar çështjen e prorogimit të parlamentit në GjSMB. Gjykata e Lartë e Anglisë kishte vendosur që çështja e prorogimit të parlamentit i përkiste natyrës politike dhe jo asaj juridike, me ç'rast nuk mund të cilësohej çështje gjykatash (BBC News, 2019). Mirëpo, më 24 shtator 2019 GjSMB-ja kishte vendosur për dy pika lidhur me prorogimin e Parlamentit të MB-së, se a mundej ky veprim t'iu nënshtrohej gjykatave, si dhe a ishte ky veprim i ligjshëm. Vendimi i kësaj gjykate konstatonte se kjo e fundit kishte fuqinë e shqyrtimit të kësaj çështjeje dhe vendimi i qeverisë për të proroguar parlamentin për një periudhë pesëjavore ishte i paligjshëm. Meqë prorogimi i parlamentit nga GjSMB-së ishte shpallur i pavlefshëm, atëherë sesioni vjeshtor i Parlamentit të Britanisë duhej të hapej më 25 shtator 2019. Bazuar në Aktin mbi të Drejtat të vitit 1689, qeveria theksonte që prorogimi ishte “veprim në parlament”, i cili nuk mund të vihej në dyshim nga asnjë gjykatë, e që ky ishte edhe elementi kyç i privilegjit parlamentar. Mirëpo, GjSMB-ja kundërvij duke pohuar që prorogimi nuk kishte qenë veprim i parlamentit dhe nuk vinte nga dhomat brenda tij, por iu imponohej deputetëve nga jashtë. Konkludimi i gjykatës theksonte mosprorogimin e parlamentit, mirëpo gjykata nuk kishte përcaktuar implikimet e urdhrit, me ç'rast kishte deklaruar se

meqë parlamenti nuk është proroguar, vendimi për hapat e mëtutjeshëm do t'i takonte parlamentit (United Kingdom Parliament, 2019). Roli i fuqishëm i traditës britanike mbështetet në legjitimimin e madh të institucioneve shtetërore saqë MB-ja mbetet e vetme mes demokracive moderne për faktin që asnjëherë nuk ka pasur një kushtetutë të shkruar formalisht. Nuk ka ligj të shkruar në MB që të jetë superior ndaj një Akti të parlamentit. Në Britani diçka mund të jetë krejt ligjore, por jo kushtetuese sepse kushtetuta nuk është kryesisht një dokument ligjor (Mayer, 2003, f. 95). Rrethanat ishin të komplikuar prej faktit që autoriteti i prorogimit të parlamentit i përkiste Mbretëreshës dhe në praktikë ushtrohej me këshillë të kryeministrit dhe gjykatat asnjëherë më parë nuk ishin thirrur për të rishikuar fuqinë e Kurorës lidhur me prorogimin e parlamentit. Për shekuj me radhë gjykatat britanike kanë zhvilluar parime të reja për të kufizuar fuqinë e Kurorës dhe kjo është ajo që bëri GjSMB-ja në këtë çështje, theksoi atë që nëse ekzekutivi do të kishte pushtet të pakufizuar për të proroguar legjislaturën, ai pushtet do të ishte në papajtueshmëri me sovranitetin parlamentar. Kushtetutat ndihmojnë në zgjedhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë që të gjitha palët të mund ta pranojnë atë si legjitime. Por në MB, britanikët nuk binin dakord rreth mënyrës se si ta zgjedhin mosmarrëveshjen me Brexit-in. Ky problem kushtetues ka rezultuar me tejkalimin e ekzekutivit dhe me kundërshtimin e parimeve kushtetuese që mbrojnë parlamentin, tejkalim që justifikon edhe vendimin e GjSMB-së (Grant, 2019). Sesioni i parlamentit u hap nga Mbretëresha Elizabeta II më 14 tetor 2019, e cila gjatë fjalimit të saj përmendi prioritetet e qeverisë dhe 22 projektligje lidhur me Brexit-in, parandalimin e krimit dhe emigracionin krahas temave të tjera (BBC News, 2019).

III.3.1.5 Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019

Nëse iu referohemi zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare britanike të vitit 2017, atëherë zgjedhjet e ardhshme do të duhej të mbaheshin në vitin 2022. Mirëpo, Boris Johnson në tetor të vitit 2019 kishte deklaruar se me qëllim të sigurimit të më shumë vendeve në Dhomën e Komunave për deputetë nga radhët e partisë së tij, dëshironte që të organizoheshin zgjedhjet e parakohshme. Sipas tij mbajtja e këtyre zgjedhjeve do t'ia lehtësonte kalimin e marrëveshjes për Brexit (Edgington, 2019). Shpërbërja e Parlamentit të Britanisë ishte bërë më 6 nëntor 2019, gjersa zgjedhjet do të mbaheshin më 12 dhjetor 2019 (United Kingdom Parliament, n.d.). Për këto zgjedhje partitë politike kishin dhënë premtime

mjaft interesante. Në qoftë se fokusohemi tek premtimet kryesore të PK-së së udhëhequr nga Boris Johnson për zgjedhjet e vitit 2019, ato kishin qenë:

- *Rikthimi i Projektligjit të Marrëveshjes së Tërheqjes në Parlament para Krishtlindjeve për të arritur finalizimin e Brexit-it deri në fund të janarit;*
- *20,5 miliardë £ fonde shtesë për KKSh-në në Angli gjer në vitet 2023-2024, 50 milionë më shumë praktikantë të përgjithshëm dhe 50,000 infermierë më shumë;*
- *20,000 oficerë të tjerë policorë gjatë tri viteve të ardhshme në Angli dhe Uells;*
- *Asnjë rritje në tatime mbi të ardhurat, kontributet e sigurimeve kombëtare ose TVSH;*
- *Prezantimi i një sistemi të emigracionit të bazuar në pikat e stilit australian, i cili i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga vijnë (BBC News, n.d.).*

Ndërkaq, premtime të specifikuara mbi procesin e Brexit-it kishin qenë këto:

- *Negocimi i marrëveshjes së tregtisë së lirë me UE-në me synim të hyrjes në fuqi gjer në vitin 2021;*
- *Moszgjatja e periudhës së tranzicionit pas daljes së MB-së përtej dhjetorit 2020;*
- *Fundi i lirisë së lëvizjes mes UE-së dhe Britanisë, si dhe një sistem i ri i emigracionit;*
- *Negocimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me partnerë të tjerë tregtarë në botë (BBC News, n.d.).*

PL-ja në krye me Jeremy Corbyn nëse do t'i fitonte zgjedhjet do t'i kishte këto prioritetet:

- *400 miliardë £ fonde për fondin kombëtar të transformimit, duke përfshirë 250 miliardë £ për energjinë, transportin dhe mjedisin, si dhe 150 miliardë £ për shkollat, spitalet dhe banimin;*
- *75 miliardë £ për 100,000 shtëpi të reja këshilli për vit, gjer në vitin 2024 dhe 50,000 shtëpi të përballeshme për vit nëpërmes Shoqatave të Banimit;*
- *Broadband falas për çdo shtëpi dhe biznes në MB deri në 2030;*
- *Pagë minimale prej 10 £ në orë për të gjithë punëtorët;*
- *Mbajtja e një referendumi tjetër për Brexit (BBC News, n.d.).*

Ndërkaq, mbi procesin e Brexit-it, PL-ja kishte premtuar:

- *Rinegociimin e një marrëveshjeje të Brexit-it brenda tre muajsh dhe mbajtjen e një votimi publik brenda gjashtë muajsh, me marrëveshjen e negociuar anash opsionit "mbetet" në fletëvotim;*

- *Negocimi i anëtarësimit në bashkimin doganor, përafrimin e ngushtë të tregut të vetëm, si dhe garantimin e të drejtave të punëtorëve dhe mbrojtjen e mjedisit;*
- *Çdo marrëveshje duhet të përmbushë detyrimet ndërkombëtare të MB-së, veçanërisht të MPM-së;*
- *Largimi i kërcënimit “pa marrëveshje” (BBC News, n.d.).*

Risi e këtyre zgjedhjeve kishte qenë prezenca e një partie të re, Brexit Party (Partia e Brexit-it). Kjo e fundit ishte themeluar më 12 prill 2019, me qëllim të sigurimit të largimit të Britanisë nga UE-ja, si dhe për t’i ndryshuar politikat britanike për të mirë, lancues i së cilës ishte ish-figura kryesore e UKIP-it dhe njëri prej personaliteteve më me ndikim gjatë fushatës për referendumin e vitit 2016, Nigel Farage (Brexit Party, n.d.). Në zgjedhjet e PE-së të mbajtura më 23 dhe 26 maj 2019, Partia e Brexit-it kishte fituar 29 ulëse apo 31,6% të votave. Kjo parti në këto zgjedhje kishte pasur një sukses të jashtëzakonshëm dhe krahasuar me UKIP-in në zgjedhjet e PE-së të vitit 2014 kishte përqindje më të madhe për 4,11%. Ndërkaq PL-ja ishte renditur e treta me 10 ulëse të fituara apo 14,1% të votave, kurse PK-ja e kishte zënë vendin e pestë me 4 ulëse të fituara ose 9,1%. Laburistët dhe Konservatorët në këto zgjedhje kishin marrë më pak se 25% dhe këto janë rezultatet më të këqija në çdo palë zgjedhjesh të PE-së për këto parti (BBC News, n.d.). Premtimet kryesore të PB-së për zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 kishin qenë këto:

- *Largimi nga të gjitha institucionet e UE-së dhe rikthimi i primatit të së drejtës së Britanisë;*
- *Negocimi i një marrëveshjeje të tregtisë së lirë me UE-në, të ngjashme me marrëveshjet që blloku ka me Kanadanë dhe Japoninë, me një afat të ri nga data 1 korrik 2020;*
- *Largimi nga UE-ja dhe kalimi tek rregullat tregtare të Organizatës Botërore të Tregtisë nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje e tregtisë së lirë me UE-në;*
- *200 miliardë £ program shpenzimesh në infrastrukturë, wi-fi dhe shërbime për të rinjtë (BBC News, n.d.).*

Duke pasur parasysh bazamentin e themelimit të PB-së, kuptohet se premtimet kyçe të saj ndërlidhen me Brexit-in, krahas së cilave ishte përfshirë edhe dënimi i marrëveshjes së Boris Johnson-it si “jo Brexit” (BBC News, n.d.).

Tabela 5.2

Votimi i partive politike në zgjedhjet parlamentare të parakohshme të MB-së në vitin 2019

Partitë	Gjithsej ulëse	Ulëse të fituara ose të humbura	Vota të fituara	Përqindja e votave të fituara	+/- %
<i>Partia Konservatore</i>	365	+47	13,966,451	43,6	+1,2
<i>Partia Laburiste</i>	203	-59	10,295,912	32,2	-7,8
<i>Partia Nacionale Skoceze</i>	48	+13	1,242,380	3,9	+0,8
<i>Demokratët Liberalë</i>	11	-1	3,696,419	11,5	+4,2
<i>Partia e Unioniste Demokratike</i>	8	-2	244.127	0,8	-0,1
<i>Sinn Féin</i>	7	0	181,853	0,6	-0,2
<i>Plaid Cymru</i>	4	0	153,265	0,5	0,0
<i>Partia Jeshile</i>	1	0	865,707	2,7	+1,1
<i>Partia e Aleancës së Irlandës Veriore</i>	1	+1	134,115	0,4	+0,2
<i>Partia e Brexit-it</i>	0	0	644,257	2,0	+2,0
<i>Partia Unioniste e Ulsterit</i>	0	0	93,123	0,3	0,0
<i>Partia e Yorkshire</i>	0	0	29,201	0,1	0,0
<i>UKIP</i>	0	0	22,817	0,1	-1,8

(BBC News, n.d.)

Boris Johnson kishte arritur një fitore gjithëpërfshirëse në këto zgjedhje, prej së cilave kishte marrë një mandat të favorshëm për ta finalizuar Brexit-in. Përpjekjet e tij për të rritur shumicën e tij parlamentare kishin qenë të vlefshme sepse në këtë formë ishin penguar bllokimet që ndikonin në daljen e MB-së nga UE-ja. Marrja e 385 vendeve në parlament cilësohej si një sukses shumë i madh për PK-në që nga viti 1987 kur numri i ulëseve të fituara nga kjo parti kishte qenë 368. Sa i përket Jeremy Corbyn, ai kishte pësuar një humbje të thellë në këto zgjedhje, ku kishte humbur mbështetje edhe në vendet që janë shquar për mbështetje ndaj PL-së (BBC News, 2019). Zona të pjesës veriore dhe qendrore të Anglisë që njiheshin si bastione të PL-së, kësaj radhe kishin votuar për PK-në, madje edhe Blyth Valley një zonë që PL-ja e kishte mbajtur që nga viti 1950 kishte votuar në favor të Konservatorëve. Po ashtu, vende të tilla si Ashfield, Bishop Auckland, dhe Workington kurrë më parë nuk kishin zgjedhur një deputet nga radhët e PK-së (Curtice, 2019).

III.3.1.6 Pozicioni i Irlandës Veriore si rrjedhojë e Brexit-it

Anëtarësia e Britanisë dhe Irlandës në KEE/UE e kishte ndryshuar dinamikën e marrëdhënieve mes tyre. Në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, kur Britania ishte tregu më i madh i Irlandës, kjo e fundit ishte e detyruar të ndiqte shembullin e MB-së me përpjekje për t'iu bashkuar KEE-së. Sidoqoftë, për Irlandën ishte me rëndësi fakti që kur ajo dhe Britania ishin anëtarësuar në KEE në vitin 1973, këtë e kishin bërë si anëtarë të barabartë. Nga kjo bazë e respektit reciprok, përfaqësuesit e këtyre ishujve anglistfolës në periferinë veri-perëndimore të Evropës kishin zbuluar se kishin një sërë interesash të përbashkëta politike. Ndonëse rezultatet e referendumit mbi vazhdimësinë e anëtarësisë së MB-së në UE ishin në favor të Brexit-it, në Irlandën Veriore ishte kundërshtuar ky i fundit. Që nga shpallja e rezultateve të referendumit, pjesa më e madhe e jetës politike në Irlandën e Veriut ka qenë e fokusuar në implikimet e Brexit-it. Për këtë ekziston një arsye e fuqishme që lidhet me kufirin ndërmjet Irlandës Veriore dhe Republikës së Irlandës, e cila ka qenë një çështje e diskutuar në vazhdimësi brenda çdo faze të negociatave të Brexit-it. Pasojat negative të Brexit-it në Irlandën Veriore filluan të shfaqen me zbehjen e partneritetit mes partive politike Sinn Féin dhe PUD në ekzekutiv gjatë viteve 2016 dhe 2017. Këto dy parti kishin bërë fushatë në anë të kundërta të referendumit të Brexit-it. Me përjashtimin e të përbashkëtave mes Irlandës dhe Britanisë, të parashikuara nga korniza e UE-së, Sinn Féin e kishte konsideruar Brexit-in si orientim të ekuilibrit kushtetues të Irlandës së Veriut drejt

Londrës dhe larg Dublinin. Ndërkaq, PUD-ja gjithashtu ishte bërë gjithnjë e më mosbesuese ndaj Sinn Féin, për të cilën konsideronte se po e përdorte Brexit-in për të agjituar për një sondazh kufiri në Irlandën e Veriut (Mars et al., 2018, pp. 4-6). Çështja e Kufirit Irlandez ishte një nga çështjet më të komplikuar në bisedimet e Brexit-it. Ky kufi paraqet një sfidë të madhe ngase negociimi i pikave të tilla si kontrolli i kufijve, e drejta e shtetësisë, liria e lëvizjes dhe qasja në tregjet e huaja gjatë bisedimeve të MB-së dhe UE-së kanë impakt të madh në Irlandën Veriore. Pastaj, një gjë akoma më e rrezikshme prej kësaj çështjeje është mundësia që të krijojë humbës dhe fitues brenda Irlandës Veriore. Sa më afër orbitës së Westminster-it, në procese të caktuara mund të duket sikur ka një përafrim me Dublinin.

MPM-ja ka rëndësi jetike si për Britaninë, ashtu edhe për Irlandën dhe menjëherë pas referendumit të Brexit-it në vitin 2016 janë paraqitur dilema mbi atë se çfarë mund të ndodh me këtë marrëveshje. Një çështje e tillë si kjo është akoma pa përgjigje si rrjedhojë e pasigurisë mbi të ardhmen, por do të ishte çmenduri të minohej MPM-ja sepse kjo do të mund të shpinte drejt situatave të rrezikshme për paqen në Irlandë. Në planin afatshkurtër, klima politike mund të varet nga rëndësia e kontrolleve kufitare mes pjesës tjetër të Britanisë dhe Irlandës Veriore (K. Featherstone, interview via email, September 1, 2020). Kufiri i krijuar atëherë kur 6 qarqet e Irlandës së Veriut refuzuan të bashkohen me Shtetin Irlandez të Lirë (më vonë Republika e Irlandës) në vitet 1920-1922 ishte bazuar në kufijtë historikë të qarkut dhe synohej të ishte i përkohshëm, siç e kishte përcaktuar Këshilli i Irlandës sipas Aktit të Qeverisë së Irlandës në vitin 1920 ku supozohej se do të integronte gradualisht ishullin e Irlandës. Pasi mbaruan problemet dhe MPM-ja ishte vendosur, gradualisht ka pasur një lëvizje për të përmbushur atë që ishte menduar në vitet 1920-1922, d.m.th., një formë e “Irlandës së Bashkuar”. Sondazhet e fundit të opinioneve sugjerojnë se opsioni i disa integritimeve të mëtejshme ka mbështetje prej afro 60% të njerëzve të Irlandës së Veriut, por nuk është e qartë nëse njerëzit e Republikës së Irlandës tani dëshirojnë atë që kishin kërkuar aq shumë në vitin 1920 dhe që e kishin mbajtur në kushtetutën e tyre deri në vitet e 80-ta. Mbajtja e Kufirit Irlandez sa më i hapur që të jetë e mundur dhe integrimi i mëtejshëm i funksioneve të Irlandës, të tilla si turizmi, prodhimi i energjisë elektrike, peshkimi, arsimit i lartë, etj., shihen si elemente thelbësore për ta shmangur rrezikimin e MPM-së (D. Farrington, interview via email, September 6, 2020).

Sipas së drejtës ndërkombëtare, krahas krijimit të shteteve në mënyrë origjinale, ato mund të krijohen edhe në formë derivative apo të prejardhur, e cila mund të bëhet me forcë

(kryengritje) ose në mënyrë paqësore (me marrëveshje), duke respektuar rendin e deriatëhershëm juridik (Gruda, 2013, p. 72). Në qoftë se pas daljes së Britanisë nga UE-ja, Irlanda e Veriut do t'i bashkohej Republikës së Irlandës, ajo do të bëhet automatikisht pjesë e UE-së, duke iu referuar pikës së lartcekur të së drejtës ndërkombëtare (Rankin, 2017). Ky premtim i bërë nga UE-ja për Irlandën e Veriut e kishte rritur frikën për shpërbërjen e MB-së. Sipas një sondazhi të vitit 2017 të realizuar nga PE-ja me më shumë se 2000 persona në Irlandën e Veriut, të cilët ishin përgjigjur rreth pyetjes se a do të votonin për t'iu bashkuar Irlandës Veriore apo do të qëndronin në MB, 47,9% e njerëzve ishin për bashkim me Republikën e Irlandës dhe 45,4% për të qëndruar në Britani, 6% ishin të pavendosur, ndërsa më pak se 1% kishin thënë se nuk do të votonin fare për një çështje të tillë (Smith, 2017).

III.3.1.7 Rreziku i shkëputjes së Skocisë nga MB-ja

III.3.1.7.1 Referendumi i pavarësisë skoceze në vitin 2014

MB-ja është një shtet sovran që përbëhet nga katër vende: Anglia, Skocia, Uellsit dhe Irlanda Veriore. Ekziston një histori e gjatë që ka ndjekur formimin e saj, por nëse duhet specifikuar pikat kryesore, ato janë:

- 1) *Në vitin 925 themelohet Mbretëria e Anglisë nga bashkimi i fiseve anglo-saksone;*
- 2) *Në vitin 1536 formohet Mbretëria e Anglisë dhe Uellsit, ku nga një projektligj i miratuar prej Mbretit Henry VIII,⁵⁵ Anglia dhe Uellsit bëhen i njëjti vend, i qeverisur prej ligjeve të njëjta;*
- 3) *Në vitin 1707 ngritet Mbretëria e Britanisë së Madhe kur Mbretëria e Anglisë, e cila përfshinte Uellsin, ishte bashkuar me Mbretërinë e Skocisë;*
- 4) *Në vitin 1801 formohet Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës;*
- 5) *Në vitin 1922 themelohet Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore. Republika e Irlandës tërhiqet nga unioni, duke lënë vetëm qarqet veriore të Irlandës. Shteti i ngritur këtë vit është Britania e Madhe, që është sot (Johnson, n.d.).*

Më 18 shtator 2014 në Skoci ishte mbajtur referendumi i pavarësisë skoceze, ku populli i Skocisë kishte pasur mundësinë që të pavarësonte vendin e tij ose të vazhdonte të ishte pjesë e MB-së. Rezultatet e këtij referendumi përbënin vendimin më të madh

⁵⁵ Henry VIII ishte Mbret i Anglisë nga viti 1509 gjer në vitin 1547, kur edhe kishte ndërruar jetë. Gjatë udhëheqjes së tij 36-vjeçare të Anglisë, ai kishte kryesuar ndryshimet e mëdha që sollën Reformat Protestante në kombin e tij.

demokratik kushtetues të kombit skocez. Fushata e referendumit në fjalë kishte rezultuar me rritje të panikut sepse në disa sondazhe ishte ngushtuar në mënyrë dramatike votimi “jo” për pavarësi nga Britania dhe ekzistonte rreziku që Skocia të shkëputej nga MB-ja. Nëse duhet të specifikojmë veçoritë thelbësore të fushatës “po pavarësisë” duhet përmendur arsyet kyçe, të cilat ishin:

- *Skocia do t’i menaxhonte pasuritë e saj dhe do të vendoste se si do të mund të shpenzoheshin ato;*
- *Fuqia për të vendosur se si të shpenzonte gjithë buxhetin e saj do t’i mundësonte Skocisë largimin e shpenzimeve për armët bërthamore;*
- *Deficiti demokratik apo mundësia që elektorati skocez të kishte një qeveri për të cilën ata votonin;*
- *Skocia e pavarur do të krijonte një shoqëri më të mirë për njerëzit e saj në aspektin e drejtësisë sociale, si dhe prosperitetit ekonomik;*
- *Duke qeverisur vetë, Skocia do të bëhej një vend më demokratik, i barabartë dhe progresiv, me motivimin e adresimit të problemeve të saj më presionuese, siç janë ato të varfërisë së fëmijëve dhe të shëndetit të dobët të të rriturve.*

Kurse, pikat kryesore të fushatës “jo pavarësisë” ishin si vijon:

- *Rreziqet e pavarësisë së Skocisë për ekonominë e kësaj të fundit, posaçërisht pasiguria mbi atë se çfarë monedhe do të përdorej në qoftë se vendi do të votonte pro pavarësisë, si dhe ngritjen e dyshimeve mbi besueshmërinë e rezervave të naftës dhe mënyrën se si vendi do të paguante shërbimet e tij publike;*
- *Votimi “po pavarësisë” nënvizonte rrezikun për humbje të vendeve të punës nëse biznese të caktuara me rëndësi thelbësore në ekonominë skoceze do të tërhiqeshin nga Skocia, si dhe paqëndrueshmëria ekonomike do të përkeqësohej akoma nga pasiguria e anëtarësimit të vazhdueshëm të Skocisë në Evropë;*
- *Premtimet e qeverisë skoceze për pavarësi nga kjo fushatë konsideroheshin cinike për elektoratin dhe mbështeteshin në rrethana të panjohura të së ardhmes (Brooks et al., 2014).*

Dallimi thelbësor në mes të fushatës “jo pavarësisë” prej asaj “po pavarësisë” kishte qëndruar në mbështetjen e fushatës së parë në taktika trembëse për dështime në ekonomi nëse shkëputej Skocia nga Britania. Mirëpo, a do të kishte ndryshime drastike nëse Skocia

do të pavarësohej? Nëse një gjë e tillë do të ndodhte, atëherë Skocia do ta mbante Madhërinë e Saj Mbretëreshën Elizabeta II si kryetare shteti, do të vazhdonte të përdorte monedhën £, do të ndante kufijtë e hapur, politikën e sigurisë dhe tregtinë pa ndërprerje me pjesën tjetër të MB-së, por me shprehje nga Britania do ta humbiste anëtarësimin në UE (Brooks et al., 2014). Skocia e pavarur nga MB-ja do të trajtohej si një shtet i ri dhe për këtë arsye do t'i duhej të aplikonte për anëtarësim në UE. Ky proces do të zgjaste me vite derisa të gjitha vendet anëtare të UE-së do të duhej të kishin miratuar aplikimin e saj. Pastaj, shprehja e Skocisë pro-evropiane nga Britania konsiderohej do të mund të rriste rrezikun për Brexit, bazuar në premtimin e David Cameron për referendumin e anëtarësisë së MB-së në UE gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2015 (Petroff, 2014).

Figura 5.1

Fletëvotimi i Referendumi mbi Pavarësinë e Skocisë nga MB-ja në vitin 2014

BALLOT PAPER	
Vote (X) ONLY ONCE	
Should Scotland be an independent country?	
YES	<input type="checkbox"/>
NO	<input type="checkbox"/>

(The New York Times, 2014)

Në votimin e këtij referendumi kishin marrë pjesë *3,619,915 njerëz*, me ç'rast dalja kishte qenë *84,6%*. Për pavarësinë e Skocisë kishin votuar *1,617,989 persona* apo *44,7%*, ndërkaq kundër pavarësisë kishin qenë *2,001,926 votues* ose *55,3%*. Duhet cekur që arkipelagu i Orkney-it kishte votuar më së shumti për pavarësinë e Skocisë, ku përqindja e

votave kishte qenë 67,1%, kurse qyteti Dundee e kishte kundërshtuar më së shumti pavarësinë e Skocisë, ku përqindja e votave në favor të opsionit “jo pavarësisë” kishte qenë 57,3%. Ndërkaq, në kryeqytetin e Skocisë, në Glasgow 53,4% ishte përkrahja për pavarësinë e Skocisë dhe 46,4% kundër pavarësisë (Scottish Parliament Information Centre, 2014).

III.3.1.7.2 Mundësia e organizimit të referendumit të dytë të pavarësisë në Skoci

Skocia e kishte kundërshtuar më së shumti daljen e MB-së nga UE-ja dhe pakënaqësitë e skocezëve me rezultatet e referendumit për Brexit kanë krijuar hapësira favorizuese për organizimin e referendumit të dytë të pavarësisë së Skocisë. Në zgjedhjet parlamentare të Skocisë më 5 maj 2016, PNS-ja kishte marrë 46,5% të votave, duke fituar 59 nga 73 vendet e zonave elektorale (The Electoral Commission, 2019). Gjatë fushatës së zgjedhjeve në fjalë kjo parti kishte cekur që Parlamenti i Skocisë duhej të kishte të drejtën që të mbante një referendum tjetër në qoftë se do të kishte prova të qarta dhe të qëndrueshme se pavarësia ishte opsion i preferuar i shumicës së popullit skocez, apo nëse ka ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mbizotëruan në vitin 2014. Nëse Skocia do të largohej kundër vullnetit të saj nga UE-ja, kjo do të justifikonte mbajtjen e referendumit të dytë të pavarësisë (Scottish National Party, 2020). Më 30 mars 2017, Ministria e parë e Skocisë Nicola Sturgeon kishte nënshkruar zyrtarisht një letër ku kishte kërkuar kompetenca për të mbajtur referendumin e dytë për pavarësinë skoceze si rezultat i votimit të deputetëve në parlament më 28 mars 2019 me rezultat 69/59 në favor të kërkesës së mbajtjes së referendumit. Këto masa sipas Sturgeon-it ishin më se të nevojshme për t’ia lehtësuar Skocisë rrugën që duhet zgjedhur pas votimit të Brexit-it. Mirëpo, ish-Kryeministrja Theresa May kishte theksuar që do të bllokohej mbajtja e çdo referendumi në MB gjersa të finalizohet procesi i Brexit-it (BBC News, 2017). Më 24 prill 2019, Sturgeon sërish kishte filluar me përpjekjet e saj për organizimin e një referendumi të pavarësisë së Skocisë brenda dy viteve të ardhshme. Madje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019, PNS gjatë fushatës kishte prezantuar dy prioritete kyçe, mbajtjen e referendumit të pavarësisë së Skocisë në vitin 2020 dhe mbajtjen e Skocisë në UE që ndërlidhej me mbështetjen e një referendumi të dytë të UE-së me “mbetet” si një opsion (BBC News, 2019). Meqë PNS kishte triumfuar në 48 prej 59 vendeve të Skocisë, liderja e partisë Nicola Sturgeon kishte pohuar mandatin e saj të rifreskuar dhe të forcuar për t’u angazhuar më tutje me çështjen e referendumit të dytë të pavarësisë. Më 19 dhjetor 2019, një dokument

me argumentet e saj dhe një projektligj për transferim të kompetencave i ishte dërguar qeverisë së MB-së. Mirëpo, Kryeministri Boris Johnson mbetej kundër mbajtjes së referendumit tjetër të pavarësisë, duke argumentuar se një referendum i tillë ishte mundësi “një herë në një brez” dhe rezultatet e vitit 2014 duhej të respektoheshin (BBC News, 2019).

Sipas Aktit të Skocisë së vitit 1998, Parlamentit të Skocisë nuk i lejohet të miratojë legjislacion në çështje të “rezervuara” mbi Westminsterin, përfshirë këtu “Unionin e Mbretërive të Skocisë dhe Anglisë”. Kjo nënkupton se çdo referendum lidhur me pavarësinë e Skocisë do të kërkonte miratimin e Westminsterit. Mirëpo, kjo çështje nuk ishte testuar në gjykata, prandaj edhe ka paqartësi rreth asaj nëse Holyrood mund të mbajë referendum pa pëlqimin e Westminsterit. Qeveria e Britanisë në vazhdimësi ka përjashtuar çdo mundësi për autorizimin e referendumit të dytë të pavarësisë (Institute for Government, n.d.).

Qeveria skoceze do të duhet të miratojë legjislacionin primar për të mundësuar zhvillimin e referendumit, sapo të posedonte fuqinë për ta bërë këtë. Më 28 maj 2019, ajo kishte prezantuar Projektligjin për Referendume, i cili do t’i ofronte qeverisë skoceze pushtet për të vendosur mbajtjen e një referendumi në Skoci dhe për të vendosur rregullat lidhur me referendumin. Ky projektligj, nëpërmes së cilit do të mundësohej mbajtja e referendumeve skoceze pa pasur nevojë për miratime të akteve specifike çdoherë nga Parlamenti i MB-së, më 29 janar 2020 ishte bërë ligj që kishte kaluar me 68 vota pro, 54 kundër dhe dy abstenime (Scottish Parliament, n.d.). Ndonëse qeveria skoceze kishte deklaruar ambiciet e saj për organizimin e referendumit të dytë të pavarësisë në vitin 2020, puna përgatitore e saj mbi këtë çështje ishte ndërprerë si pasojë e pandemisë Covid-19. Pastaj, për të mbajtur një referendum mbi një bazë të qartë ligjore, qeverisë skoceze do t’i duhet një marrëveshje me qeverinë e Britanisë. Në qoftë se qeveria britanike do të transferonte pushtetin për të mbajtur një referendum të dytë për pavarësinë në Skoci, atëherë ajo do të mund të vendoste kushte se kur do të mund të mbahej votimi. Gjer tani pjesa më e madhe e sondazheve sugjerojnë se shumica e skocezëve mendojnë që duhet të ketë një referendum të dytë të pavarësisë, por një pakicë e vogël mendon se ai duhet organizuar në të ardhmen e afërt. Në vitin 2020, mbështetja pro pavarësisë duket se është rritur dukshëm sepse disa sondazhe kanë gjetur një shumicë mbështetëse në favor të pavarësisë brenda skocezëve (Institute for Government, n.d.). Mbajtja e referendumit të dytë të pavarësisë në Skoci duket shumë e mundur në 5-10 vitet e ardhshme (Featherstone, interview via email, September 1, 2020). Kjo bën të kuptojmë se Brexit-i e bën shpërbërjen

të mundshme ngase argumentet e mbështetësve të tij mund të përdroreshin edhe nga nacionalistët skocezë për të ngritur çështjen e tyre për pavarësi. Gjithashtu, fakti që skocezët janë historikisht pro-Evropës dhe votimi i tyre në numër të madh në favor të mbetjes ka krijuar një mundësi tjetër për fërkime. Çështja tjetër është po ashtu se ia bën më të lehtë Irlandës së Veriut të bashkohet me Irlandën nëse do të bënin një referendum (G. Macaj, interview via email, October 7, 2020).

Mirëpo, a ka ndonjë zgjedhje tjetër që Skocia të vazhdojë të jetë pjesë e UE-së, ose të paktën të vazhdojë të jetë pjesë e Tregut të Vetëm të UE-së, përpos shkëputjes nga Britania? Një mënyrë e mesme do të kërkonte inxhinierinë ligjore në dy nivele: të jashtme dhe të brendshme. Nga ana e jashtme, UE-së mund t'i bashkohen vetëm shtetet e pavarura dhe traktatet e UE-së nuk kanë mundësuar anëtarësimin e subjekteve nënshtetërore, prandaj një gjë e tillë politikisht është e vështirë. Nga ana e brendshme, një zgjedhje e diferencuar do të kërkonte një transferim të mëtejshëm të pushtetit ndaj Skocisë. Si anëtare e Tregut të Vetëm, Skocia do të duhej të pajtohej me standardet rregullatore të UE-së për mallrat, shërbimet dhe kapitalin. Skocia do të duhej të lejonte lëvizjen e lirë të njerëzve, përfshirë këtu edhe njohjen e kualifikimeve dhe koordinimin e sigurimeve sociale siç janë pensionet. Nëse Skocia do të donte të ishte në UE, edhe më shumë kompetenca do të duhej të vinin në Skoci, veçanërisht për t'i dhënë asaj mundësi të pjesëmarrjes në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së UE-së. Por, një marrëveshje e diferencuar për Skocinë nuk duket lehtë e arritshme sepse varet nga vullneti politik i Skocisë, qeverisë britanike dhe qeverive të 27 vendeve anëtare të UE-së (Hassan & Gunson, 2017, pp. 73-74).

III.3.2 Pasojat politike të Brexit-it për Unionin Evropian

III.3.2.1 Rreziku i inkurajimit të shteteve të tjera për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së

Ndryshe nga OKB-ja dhe organizatat e tjera ndërqeveritare, UE-ja ushtron një shkallë të sovranitetit mbi shtetet e saj anëtare nëpërmjet fuqive ligjvënëse në fusha të caktuara, për të cilat anëtarët e saj janë dakorduar të zhvendosen në nivelin supranacional. Mirëpo, me rritjen e fuqisë së UE-së janë rritur edhe pakënaqësitë ndaj saj, të cilat kanë lidhshmëri me synimet e disa qarqeve politike që ta dobësojnë apo edhe ta shpërbëjnë UE-në, në mënyrë që fuqia t'iu rikthehet sërish shteteve. Vota e popullit britanik për dalje nga UE-ja në referendumin e vitit 2016 është një shembull interesant i sfidimit të idesë së

supranacionalizmit (McGlinchey, 2017, pp. 73-74). Projekti i integritit evropian është përballur me një sërë krizash, siç janë: kriza financiare, kriza e borxheve, kriza ekonomike, kriza greke, kriza e popullizmit, kriza e produktivitetit, kriza e terrorizmit, kriza e refugjatëve dhe kriza e deficitit demokratik. Mirëpo, Brexit-i është një krizë tjetër, e cila ngrit pyetjen fundamentale rreth projektit të integritit sepse e sfidon qëllimin e UE-së për të qenë bashkim gjithnjë e më i ngushtë (Campos & Coricelli, 2017, p. 48).

Një nga rreziqet kryesore që buron prej Brexit-it për UE-në është inkurajimi i shteteve të tjera që të largohen prej saj. Dalja e Britanisë nga UE-ja është parë si një triumf i euroskepticizmit kundrejt eurofilizmit. Pas referendumit të Brexit-it, në vitin 2017 ishin mbajtur zgjedhje të rëndësishme në vendet kryesore të UE-së, në Holandë, Francë dhe Gjermani, karakteristika të së cilave kishin qenë pikëpamjet tejet të theksuara euroskeptike dhe ato të antiemigracionit të disa kandidatëve që garonin në zgjedhje e që kishin marrë përkrahje jashtëzakonisht të madhe prej shtetasve të tyre. Viti 2017 do të ishte një vit shumë i rëndësishëm për UE-në, e ardhmja e së cilës do të varej shumë prej rezultateve të zgjedhjeve në vendet e lartcekura (Goldman, 2017).

Sinonim i agjendës parazgjedhore të Gert Wilders në Holandë kishte qenë çështja e emigracionit të kombinuar me euroskepticizëm. Politikat e tij të antiislamizimit ndonëse ishin shquar nga paqartësitë rreth mënyrave se si ato do të zbatoheshin, mbështeteshin nga një pjesë e madhe e holandezëve, me ç'fakt kjo mbështetje e kishte trazuar Holandën dhe Evropën. Ekstremizmi i Wilders-it kishte kaluar në atë masë sa që kishte premtuar se do ta de-islamizonte vendin, proces ky që do t'i kushtonte Holandës mbi 7 miliardë €, sepse sipas tij vendi kishte probleme serioze me traditën dhe kulturën islamike. Po ashtu, ai kishte premtuar rritjen e shpenzimeve ushtarake dhe bërjen e Holandës "më të pavarur nga UE-ja", si dhe nuk e kishte mohuar mundësinë e të ndjekurit shembullin e tërheqjes së MB-së nga UE-ja apo për "Nexit". Ndonëse Wilders praktikisht nuk kishte shansin për të formuar qeveri, ai kishte shansin që të fitonte votën popullore, e cila normalisht në Holandë arrin rreth 20% (Tasch, 2017). Mirëpo, në këto zgjedhje duket se kishin dominuar forcat pro-evropiane ngase fituese e tyre kishte qenë Partia Popullore për Liri dhe Demokraci (Volkspartij voor Vrijheid en Democratie) në krye me Mark Rutte, që kishte marrë 21,3% të votave, kurse Partia për Liri (Partij voor de Vrijheid) e Wilders-it kishte marrë 13,1% të votave, duke u renditur kështu në vendin e dytë dhe duke fituar 20 ulëse. Këto rezultate

ishin mirëpritur nga UE-ja ngase ishin parë si një çerek-finale e fituar kundrejt popullizmit që kishte kapluar Evropën pas referendumit britanik të vitit 2016 (BBC News, 2017).

Bashkarisht me Brexit-in lëkundje tektonike brenda kontinentit evropian kishte shkaktuar edhe kandidatja për zgjedhjet presidenciale të Francës, Marine Le Pen. Kjo e fundit që udhëhiqte partinë franceze Fronti Nacional (Front National) kishte synuar daljen nga eurozona dhe vendosjen e proteksionizmit ekonomik si formë promovuese të ekonomisë franceze. Sipas saj largimi nga UE-ja do të rezultonte me kursime parash si rrjedhojë e mosfrimit të kontributit francez në buxhetin e UE-së. Po ashtu, ajo kishte pasur synim zvogëlimin e të gjitha shpenzimeve që ishin të lidhura me emigracionin, përfshirë këtu heqjen e ndihmës mjekësore shtetërore, duke bërë kushtëzimin më drastik i alokimit të ndihmës sociale për të huajt dhe taksimin e punonjësve të huaj. “Frexit” ose dalja e Francës nga UE-ja kishte qenë gjithashtu një premtim i Le Pen-it në fushatën parazgjedhore (Dagorn et al., 2017). Më 23 prill 2017 ishin mbajtur zgjedhjet presidenciale në Francë. Në raundin e parë, dy kandidatët e kualifikuar për raundin e dytë të këtyre zgjedhjeve kishin qenë Emmanuel Macron nga partia Republika në lëvizje! (La République En Marche!), i cili kishte marrë 8,656,346 vota dhe Marine Le Pen me 7,678,491 vota (Gouvernement de la France, 2017). Kjo e fundit me platformën e saj politike të karakterizuar nga premtimet e bazuara në një brend të veçantë të izolacionizmit politik dhe nacionalizmit ekonomik, antiemigracionit, tërheqjes së Francës nga NATO, dhe ndjekjes së shembullit të Britanisë kishte pasur mbështetje shumë të madhe nga populli francez, e cila kishte ngritur aq shumë shqetësime sa që kishte filluar të bëhej ankthi më i keq për UE-në. Mirëpo, në raundin e dytë të këtyre zgjedhjeve fitues kishte dalë politikani pro-evropian Emmanuel Macron me 20,257,167 vota kundrejt politikanes antievropiane Marine Le Pen me 10,584,646 vota (Gouvernement de la France, 2017).

Zgjedhjet federale në Gjermani ishin mbajtur më 24 shtator 2017, ku për të katërtën herë kishte fituar Angela Merkel, e cila me partinë e saj Unioni Demokristian i Gjermanisë (Christlich Demokratische Union Deutschlands) kishte marrë 32,9% të votave, por kësaj radhe kishte fituar me një autoritet më të zvogëluar. Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve kishte qenë partia populliste Alternativa për Gjermaninë (Alternative für Deutschland) që kishte marrë 9,2% të votave, parti kjo e cila ishte e karakterizuar nga euroskepticizmi dhe antiemigracioni, e që në këto zgjedhje kishte qenë e ranguar në vendin e tretë, si dhe për herë të parë kishte arritur të futej në Bundestag (Clarke, 2017). Kur në vitin 2015 gati një

milion emigrantë erdhën në Gjermani për të kërkuar azil, APGj-ja ishte fokusuar tek siguria e brendshme dhe emigracioni, duke u bërë çdoherë e më shumë nacionaliste, populliste dhe raciste. Ekstremizmi i kësaj partie kishte arritur gjër në atë pikë sa që bënte thirrje që Gjermania të rimendojë kulturën e saj kombëtare të shlyerjes dhe përkujtimit të krimeve naziste. Këshilli Qendror i Hebrenjve në Gjermani kishte reaguar ndaj kësaj partie duke pohuar se hyrja e kësaj partie në parlament do të ishte konfirmim i ringjalljes të së djathtës ekstreme. Kjo parti gjithashtu kishte premtuar se do të rriste sigurinë e kufijve gjermanë, do të vazhdonte që të ishte kundër integritit të mëtejshëm në UE dhe do të kundërshtonte përdorimin e parave të taksapaguesve gjermanë për të shpëtuar bankat e huaja. Marrja e afro 6 milionë votave, përfshirë këtu 1,2 milionë vota nga votuesit gjermanë që në zgjedhjet e kaluara nuk kishin votuar fare, argumenton mjaftueshëm se sa çështje shqetësuese është rritja e ndjenjave euroskeptike në Gjermani (Eddy, 2017).

Fakti që në këto zgjedhje të mbajtura në shtetet themeluese të UE-së menjëherë pas referendumit të Brexit-it kishin triumfuar forcat pro-evropiane nuk nënkupton se prezenca e zërave euroskeptikë duhet injoruar. Përkundrazi, shkalla e lartë e euroskepticizmit veçmas në shtetet e lartpërmendura është shumë serioze dhe krijon hapësira për shqetësime të mëdha. Prezenca e partive populliste dhe euroskeptike përbën një sfidë shumë të rëndë ndaj mbrojtjes së vlerave evropiane. Janë dy çështje ku shtetet anëtare dhe institucionet e UE-së duhet të koncentrohen maksimalisht ashtu që të mos rriten frustrimet e evropianëve, menaxhimi i proceseve ekonomike dhe trajtimi i mirëfilltë i çështjes së emigrantëve. Partitë nacionaliste brenda kontinentit evropian dinë të shfrytëzojnë maksimalisht brengat e qytetarëve të vendeve të tyre mbi çështjet e lartpërmendura për të sulmuar UE-në. Pastaj, shqetësues mbetet edhe përdorimi i shtuar i referendumeve për çështje të ndjeshme politike, ku partitë me pikëpamje populliste bëjnë përpjekje të llojllojshme që gjatë fushatave të prekin çështje thumbuese për popullatën. Jo rrallëherë referendumet kanë rezultuar që të jenë përçarëse dhe të paparashikueshme, si dhe mund të kenë pasoja afatgjata në sistemet politike.

III.3.2.2 Efektet negative të Brexit-it në politikat zgjeruese

Programi “Evropa si fuqi” ngjason me federalizmin e hershëm ndërkombëtar, ku në të dy këndvështrimet “bota e jashtme” shihet si e rrezikshme, prandaj integrimet evropiane janë të rëndësishme (Zwolski, 2018, p. 203). Integrimet evropiane paraqesin një proces që influencon jo vetëm politikën dhe ekonominë, por edhe qytetarinë evropiane (Börner & Eigmüller, 2015, p. 3). Një nga përkufizimet e shumta që lidhet me integrimet evropiane është formimi i zakoneve politike dhe institucioneve për të nxitur bashkëpunimin, si dhe të ndikojë në fundin e armiqësive dhe luftës. UE-ja ka qenë gjithnjë duke kaluar nëpër procesin e zgjerimit dhe për herë të parë me rastin e Brexit-it do të përballlet me zvogëlim të numrit të vendeve anëtare (Welfens, 2017, pp. 276-277). Vendet anëtare të UE-së do të duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të vazhduar rrugën e integritit të shteteve të tjera sepse janë ngritur dyshime mbi aftësinë dhe gatishmërinë e UE-së për t’u angazhuar në zgjerimin e mëtejshëm për një periudhë afatmesme pas Brexit-it. Ky i fundit mund të mos ketë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në politikat zgjeruese të UE-së, por nuk mund të themi që nuk do të ketë ndikim indirekt sepse një gjë e tillë është shumë e mundshme. Meqë Brexit-i është një krizë e veçantë ngase është hera e parë që po tërhiqet një vend nga anëtarësia e UE-së, politikanët dhe vendimmarrësit e UE-së duhet të jenë të përqendruar maksimalisht në fazat e negociatave të Brexit-it. Bazuar në këtë gjë, duket sikur çështja e zgjerimit nuk do të jetë pjesë e agjendës së UE-së në një të ardhme të afërt sepse Brexit-i do të shkaktojë shumë lodhje brenda UE-së, me ç’rast mund të ketë mungesë gatishmërie për t’u marrë me çështje të tilla. Pastaj, UE-ja në brendësi është aq e pabashkuar sa që çështja e zgjerimit ka gjithnjë e më pak interes për pjesën më të madhe të vendeve anëtare (Milan Jazbec, interview via email, January 27, 2019).

III.3.2.3 Ndikimi i Brexit-it në procesin integruar të vendeve të Ballkanit Perëndimor në UE

Dalja e MB-së nga UE-ja ka ngritur shqetësime edhe tek vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat tash e sa vite synojnë të integrohen në UE. Pasiguria e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në UE po rritet edhe nga fakti se Britania ka qenë një nga promotorët kryesorë të zgjerimit të UE-së, që do të thotë se vendet e këtij rajoni si pasojë e Brexit-it e kanë humbur mbështetësit kryesorë të rrugëtimit të tyre drejt UE-së.

Në Samitin e Ballkanit më 4 korrik 2016 në Paris, pak ditë pas mbajtjes së referendumit britanik, Gjermania dhe Franca, si zërat më të fuqishëm të UE-së kishin theksuar që Brexit-i nuk do të kishte ndikim në procesin integrues të shteteve të Ballkanit Perëndimor në UE (France Diplomatie, 2016). Mirëpo, besueshmëria rreth një pohimi të tillë është diskutabile. Duke u bazuar në preokupimin e UE-së me tërheqjen e MB-së, integrimi i Ballkanit Perëndimor më nuk do të mund të realizohet pa u finalizuar Brexit-i, gjë që nënkupton se efektet e para të këtij të fundit vihen re në shtyrjen e procedurave integruese të shteteve të këtij rajoni. Pasigurinë e anëtarësimit të këtij rajoni e shton edhe fakti se Britania si një nga promotorët kryesorë të zgjerimit të UE-së cilësohet si partner i vlefshëm i vendeve të Ballkanit Perëndimor sepse vazhdimisht i ka mbështetur ato në procesin e tyre integrues. Megjithëse MB-ja ka pohuar vazhdimisht se mbështetja ndaj integritit evropian të këtij rajoni do të vazhdojë edhe pas Brexit-it, ngjashëm siç veprojnë ShBA-të, është më se e kuptueshme se përkrahja jashtë UE-së nuk ka rezultate të njëjta në krahasim me atë që ofrohet brenda UE-së. Pastaj, tingëllon disi absurde mbështetja e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në UE nga një shtet i cili është tërhequr nga anëtarësia e UE-së.

Megjithatë, edhe Britania si është shteti i parë që është larguar nga UE-ja bazohet në disa pika kur thekson përkrahjen e integritit të pjesës së mbetur të Ballkanit Perëndimor në UE. Vendet e këtij rajoni si Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia karakterizohen nga historia konfliktuozë, përbërja shumë-etnike, qeverisja e dobët dhe niveli i dobët i sundimit të ligjit, ekonomia e pazhvilluar, si dhe synimet për integritime euro-atlantike. Ballkani është një enklavë brenda kufijve të UE-së, fakt ky që nuk mund të neglizhohet për një kohë të gjatë sepse aq sa e ndihmon por edhe e vështirëson sigurinë e UE-së. Parë në perspektivën rajonale dhe më gjerë, integrimi i të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në UE mbetet opsioni i duhur ngase një sërë strategjish të rëndësishme sa i përket përmbushjes së qëllimeve të prosperitetit dhe paqes në Ballkanin Perëndimor mundësohen vetëm nëpërmes integritit evropian. Me përjashtim të Kroacisë që është anëtarësuar në UE në vitin 2013 dhe është edhe shteti i fundit i anëtarësuar në UE, shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor akoma nuk janë bërë pjesë e UE-së dhe kalojnë në faza të ndryshme integruese, me ç'rast integrimi i të gjitha shteteve duket proces pothuajse i pamundur. Gjer më tani Mali i Zi është shteti më i avancuar i Ballkanit Perëndimor sa i përket rrugëtimit në UE. Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim e ka nënshkruar më 15 tetor 2007, e cila ka hyrë në fuqi më 1 maj 2010 dhe më 29 qershor 2012

ka hapur negociatat e anëtarësimit në UE dhe mban statusin e vendit kandidat (European Commission, 2020). Serbia e ka nënshkruar MSA-në më 29 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi më 19 janar 2011 dhe më 21 janar 2014 filloi negociatat e anëtarësimit në UE. Serbia mban statusin e vendit kandidat (European Commission, 2020). Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar MSA-në më 9 prill 2001, e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2004. Kjo ishte marrëveshja e parë në të cilën UE-ja vuri nënshkrimin e saj me ndonjë shtet të Ballkanit Perëndimor. Statusi i saj është vend kandidat, si dhe duhet cekur që në mars 2020 ka hapur negociatat e pranimit në UE (European Commission, 2020). Shqipëria si shteti më i avancuar i Evropës Juglindore marrëdhëniet diplomatike me UE-në i vendosi në vitin 1991. MSA-në e ka nënshkruar më 12 qershor 2006, e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009 dhe në qershor 2014 ka marrë statusin e shtetit kandidat. Po ashtu edhe Shqipëria në mars 2020 ka hapur negociatat e pranimit në UE (European Commission, 2020). Bosnja dhe Hercegovina ka nënshkruar MSA-në më 16 qershor 2008, e cila ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2015 dhe aktualisht ka statusin e kandidatit potencial (European Commission, 2020). Kosova e ka nënshkruar MSA-në më 27 tetor 2015, e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016 dhe ka statusin kandidat (European Commission, 2020). Por, mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtete anëtare të UE-së (Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) krahas plot faktorëve të tjerë, e vështirëson akoma më tepër procesin e saj integruar në UE. Rrjedhshmëria e procesit integruar të këtyre shteteve në UE ndikohet nga një sërë faktorësh, të tillë si: vullneti politik, konsensusi i brendshëm politik, mbështetja e qytetarëve dhe kapaciteti administrativ brenda secilit vend, si dhe marrëdhëniet e tyre fqinjësore. Pastaj, faktorët e tjerë që ndërlidhen me UE-në, si orientimi i saj gjeopolitik, opinioni publik i vendeve anëtare dhe rikonstruimi institucional evropian kanë impakt të madh në këtë proces.

III.3.2.4 Roli i UE-së në arenën ndërkombëtare pa MB-në

Pasojat e plota të Brexit-it do të varen nga finalizimi i negociatave rreth partneritetit të ardhshëm të Britanisë me UE-në. Mirëpo, pavarësisht rezultateve të bisedimeve, pasojat për vendet anëtare, institucionet, kulturën dhe politikën e ardhshme të UE-së në tërësi ka të ngjarë se do të jenë të thella. UE-ja po orientohet drejt bashkimit gjithnjë e më të ngushtë, me hapa federalistë, duke theksuar miratimin e euros, eliminimin e kufijve të brendshëm dhe aspiratat për një ushtri evropiane. MB-ja ka pasur rol të rëndësishëm brenda UE-së sa i

përket politikës së jashtme, duke specifikuar kapacitetin e saj më të madh ushtarak nga të gjitha vendet anëtare të UE-së. Mirëpo, si rrjedhojë e Brexit-it a do të mundet UE-ja të zhvillojë politika më të zakonshme ndaj Ruisë dhe vendeve të tjera në fqinjësinë Lindore të UE-së, që përfshijnë Turqinë, Lindjen e Mesme, Mesdheun dhe Afrikën? Këto marrëdhënie janë thelbësore në luftën kundër terrorizmit dhe problemeve të shkaktuara nga emigracioni, por vendet e UE-së shpeshherë kanë qëndrime të ndryshme rreth këtyre çështjeve. Pastaj shtrohet pyetja, a janë dëmtuar marrëdhëniet e UE-së me ShBA-të gjatë lidershit të Donald Trump? Ky i fundit ka shfaqur pikëpamje më pak favorizuese mbi UE-në se çdo president tjetër amerikan i pasluftës, si dhe nuk e ka mohuar asnjëherë simpatinë e tij rreth vendimit të britanikëve për Brexit dhe dyshimet e tij mbi funksionimin e organizatave ndërkombëtare. Si rrjedhojë e ndikimit të madh në botë të MB-së dhe ShBA-ve, Brexit-i dhe presidenca amerikane e udhëhequr nga Donald Trump kanë pasur ndikime shumë të gjera gjeopolitike (Gilmartin et al., 2018, p. 84). Ndërsa largohet nga UE-ja, Britania përpigëj të shfrytëzonte marrëdhëniet e saj me ShBA-të, duke përfshirë bashkëpunimin e ngushtë ushtarak bilateral. Riinvestimi aktual i MB-së në ushtrinë e saj përputhet mirë me ciklin e planifikuar të armatimit në ShBA. Më e rëndësishmja, Londra ka ndarë historikisht me Uashingtonin kuptimin që fuqia ushtarake të mbetet pjesë e spektrit të plotë të skemave të shtetit dhe se aftësia për të projektuar pushtetin mbetet thelbësore për sigurinë transatlantike (Johnson & Matlary, 2019, p. 66). UE-ja është mjaft e dobësuar politikisht nga Brexit-i, me ç'rast është e detyruar të reflektojë mbi atë se si të arrijë një solidaritet mes numrit të madh të vendeve anëtare dhe të forcojë veprimet e saj të jashtme për ta rritur vazhdimisht ndikimin e saj në skenën globale. UE po humbet një fuqi të madhe ngase dalja e Britanisë e vë në pikëpyetje aftësinë e saj për t'u shndërruar në aktor global me rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare. MB-ja është një fuqi bërthamore, një anëtar i përhershëm i KS-së së OKB-së, e cila gëzon një partneritet të ngushtë me ShBA-të dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në disa korniza globale të qeverisjes si G7 dhe G20. Duke u bazuar në pikat e lartcekura mund të kuptohet se shkëputja e Britanisë prej UE-së rrezikon dobësimin e PPPJSUE-së (Huang & Reilly, 2018, pp. 102-103). UE-ja do të humbasë prestigj nga dalja e njërit prej vendeve anëtare të pakta me fuqi reale diplomatike dhe ushtarake. Pastaj, Brexit-i do të jetë mjaft i dëmshëm për marrëdhëniet transatlantike të UE-së, në të cilat MB-ja ka rol shumë të rëndësishëm ndërmjetësues. Nuk duhet harruar se treshja kryesore evropiane përbëhet nga Gjermania, Franca dhe Britania. Nuk ka politikë evropiane

pa këto tri shtete së bashku. Pastaj, vendet anglofile si Irlanda, Holanda, Suedia dhe Danimarka do të ndihen "të izoluar" si rrjedhojë e daljes së MB-së nga UE-ja.

III.3.2.5 Impakti i Brexit-it në efikasitetin e diplomacisë digjitale të UE-së

Në epokën postmoderne të shpërndarjes së informacionit, shumë gazetarë dhe akademikë pohojnë se fundi i diplomacisë sekrete është afër si rezultat i digjitalizimit (Bjola & Murray, 2016, p. 13). Një mundësi e shkëlqyeshme për të filluar tejkalimin e hendekut "të menaxhimit të ndryshimit" në teorinë diplomatike ofrohet nga përhapja e fundit e iniciativave digjitale në aktivitetet diplomatike, të cilat ndoshta mund të përshkruhen si asgjë më pak se një revolucion në praktikën e diplomacisë (Bjola & Kornprobst, 2015, p. 201) duke sjellë në dritë një formë të veçantë të diplomacisë, atë digjitale. Kjo e fundit është një formë e diplomacisë së re publike, e cila përdor teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit (TIK), Internetin dhe mediet sociale si mjete për forcimin e marrëdhënieve diplomatike mes aktorëve ndërkombëtarë.⁵⁶

Nga një perspektivë diplomatike, UE-ja nga njëra anë përfaqëson një bashkim politik të 27 shteteve anëtare me organe drejtuese, organe legjislative dhe një shërbim të jashtëm që promovon interesat e saj në mbarë botën. Mirëpo, secili vend i UE-së ka qeverinë e tij, organet legjislative, ministrinë e jashtme dhe ambasadat. Rëndësia politike dhe ekonomike, si dhe roli aktiv i UE-së në diplomacinë botërore dëshmohet me përfaqësimin e UE-së nga 140 delegacione në botë. Gjithashtu UE-ja ka afërsisht 164 misione kombëtare të akredituara dhe janë 36 delegacione të organizatave ndërkombëtare në UE (European Commission, 2016). Ashtu si shumica e kombeve dhe organizatave ndërkombëtare, edhe UE-ja e ka miratuar diplomacinë digjitale. Shtetet anëtare, institucionet, agjencitë dhe misionet diplomatike të UE-së e përdorin diplomacinë digjitale dhe janë vazhdimisht të angazhuara me faqet e tyre të Internetit dhe me ndjekësit e medieve sociale, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre, kritikave ose madje duke siguruar informacione me qëllim për të arritur potencialin kryesor të diplomacisë digjitale që është ndërtimi i marrëdhënieve mes kombeve dhe publikut të huaj (Manor, 2014). Prej medieve sociale, Twitter është rrjeti social më i përdorur nga liderët dhe diplomatët e të gjitha vendeve anëtare, institucioneve, agjencive dhe misioneve diplomatike të UE-së, kurse Facebook-u dhe Instagrami janë

⁵⁶ Duhet sqaruar që diplomacia digjitale nuk përdoret vetëm nga shtetet, por edhe nga organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e aktiviteteve diplomatike.

platformat kryesore për institucionet, agjencitë dhe liderët e UE-së. Gjithashtu, nuk duhet anashkaluar edhe përdorimin e YouTube nga institucionet dhe agjencitë e UE-së, ku nëpërmes kanaleve të tyre transmetojnë fjalime në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shfaqin pamje të aktiviteteve të tyre.

Mirëpo, tërheqja e MB-së nga UE-ja do të ketë efekte negative në sukseset e diplomacisë digjitale të UE-së. Britania karakterizohet për një diplomaci digjitale jashtëzakonisht efikase dhe atraktive, me ç'rast edhe renditet ndër vendet e para në botë sa i përket realizimit të suksesshëm të kësaj forme të diplomacisë. Politikanët, diplomatët, institucionet dhe misionet diplomatike të MB-së me përdorimin dhe angazhimin e tyre maksimal në media sociale arrijnë të depërtojnë në çdo cep të botës duke tërhequr audiencat edhe jashtë kontinentit evropian, prandaj jo rastësisht llogaritë e tyre në media të ndryshme sociale karakterizohen nga një ndjekje e jashtëzakonshme. Diplomacia digjitale e UE-së pa MB-në si vend anëtar do ta ketë shumë të vështirë shtrirjen e saj jashtë kufijve të Evropës, si dhe do të jetë e pafuqishme në tërheqjen e audiencave në mbarë globin.

III.3.3 Pasojat politike të Brexit-it në nivel global

III.3.3.1 Kontekstet gjeopolitike të Brexit-it

Po të analizohen detajisht tri fazat e negociatave të Brexit-it, vihet re që secila prej tyre ka qenë më e vështirë se tjetra si rrjedhojë e implikimeve nga më të ndryshmet dhe mospajtueshmërisë mes palëve, ku nuk ka munguar edhe rreziku i përfundimit të bisedimeve pa marrëveshje. Brexit është një fatkeqësi për Evropën, e cila ka shkaktuar një sërë situatash të dëmshme brenda saj. Vendet e tjera anëtare të UE-së duket se janë të vetëdijshme se nuk ka përfitime pozitive nga largimi prej UE-së, prandaj, nuk shihen rreziqe për të inkurajuar shtetet e ndryshme të Evropës që të ndjekin shembullin e MB-së me Brexit (J. D. Groof, interview via email, September 14, 2020).

Brexit po zhvillohet në një kohë kur Evropa po përballlet me rritje sfidash sa i përket sigurisë, si dhe pasiguri rreth pozicionit të saj ekonomik dhe strategjik, duke mos e mohuar këtu edhe ngritjen e nacionalizmit dhe ekstremizmit politik në disa vende të UE-së si Franca, Gjermania, Hungaria, Italia dhe Polonia. Disa shtete të Evropës Lindore, por edhe të asaj Jugore kanë institucione të brishta shtetërore, madje edhe janë në prag të kolapsimit, i cili mund të pasojë me dështim të këtyre shteteve. Këmbëngulja e Rusisë, e shoqëruar me

ndikimin e lajmeve të rreme dhe luftës hibride së bashku me trazirat politike dhe konfliktet në botën arabe dhe në Afrikë përbëjnë sfidat kryesore të sigurisë në kontinentin evropian që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë. Zhvillimet demografike në këto rajone, të shoqëruara me konflikte mbi burimet dhe ndikimin politik, si dhe brishtësinë e përgjithshme të shteteve, kanë pasuar me lëvizje të forta migruese në botë, posaçërisht në UE. Kjo e fundit ka probleme serioze edhe nga marrëdhëniet civilo-ushtarake në Turqi, si dhe paqëndrueshmëria politike e ekonomike e vendeve afrikane, veçmas Afrikës Veriore, si dhe rritja e ndikimit të Kinës në Evropën Jugore dhe atë Juglindore shkaktojnë probleme të panumërta në kontinentin evropian. Aftësia e UE-së për të reaguar në mënyrë adekuate ndaj këtyre sfidave të sigurisë së jashtme, si dhe të politikës së jashtme mund të minohen edhe më tej nga Brexit. Për më tepër, problemet mund të përkeqësohen edhe nga pasiguria që rrethon të ardhmen e NATO-s si rezultat i tërheqjes e MB-së prej UE-së. Udhëheqja e presidencës amerikane nga Donald Trump kishte vënë në pikëpyetje PPPJSUE-në dhe qëndrueshmërinë e aleancës transatlantike të NATO-s. Trump në vazhdimësi kishte shprehur neverinë e tij ndaj UE-së si projekt integruar, duke deklaruar se ishte shumë i dëmshëm për interesat amerikane, por edhe e kishte mbështetur plotësisht vendimin e Britanisë për Brexit, duke mos kursyer në raste të caktuara edhe kritikën e tij ndaj politikanëve britanikë për mosndjekjen e linjave më të ashpra gjatë bisedimeve për Brexit (Zyla, 2020, pp. 73-74). Nëse faza e tretë e negociatave të Brexit-it përfundon pa marrëveshje mbi partneritetin e ardhshëm MB-UE, do të ketë sfida të mëdha në sigurinë evropiane, qoftë në terma politikë, strategjike, operacionale, financiare ose ligjore. Britania nuk do të përfaqësojë askënd tjetër në KS për çështje politike dhe të sigurisë përpos vetes, përderisa Franca do të bëhet përfaqësuese de facto e UE-së në KS. Në të njëjtën kohë, do të jetë e vështirë për UE-në që të arrijë një autonomi strategjike vetëm me potencialin bërthamor dhe detar të Francës. Kalimi i perspektivës institucionale nga UE-ja në NATO, ka shumë të ngjarë që Britania do të bëjë përpjekje maksimale për t'u bërë fuqia kryesore de facto evropiane brenda NATO-s, veçanërisht për të marrë rolin e përfaqësuesit të Evropës Lindore dhe vendeve të tjera që e konsiderojnë Rusinë si një rrezik të veçantë. MB-ja mund të rrisë pjesëmarrjen e saj në NATO në mënyrë që të demonstrojë udhëheqjen mbi politikën ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes (Zyla, 2020, p. 100).

III.3.3.2 Marrëdhëniet diplomatike të ShBA-ve me MB-në dhe UE-në pas zgjedhjeve presidenciale amerikane të vitit 2020

Zgjedhjet presidenciale në ShBA të mbajtura më 3 nëntor 2020 kishin marrë vëmendje të jashtëzakonshme nga e mbarë bota. Gara ishte zhvilluar ndërmjet Donald Trump prej Partisë Republikane dhe Joseph Robinette Biden nga Partia Demokrate. Ky i fundit kishte arritur një fitore të madhe, ku prej 536 votave elektorale kishte fituar 306, ndërsa kundërkandidati i tij, tashmë ish-presidenti amerikan Donald Trump kishte marrë 232 (Stark & Cohen, 2020).

Politika e jashtme amerikane nën udhëheqjen e Trump-it kishte qenë e karakterizuar prej disa kërcënimeve të tërheqjes së ShBA-ve nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Që nga filltet e tij si president, Trump ishte deklaruar se do të fokusohet edhe në rishikimin e disa traktateve ekonomike ndërkombëtare, me ç'rast e kishte vënë si opsion tërheqjen e ShBA-ve nga Organizata Botërore e Tregtisë, pastaj kishte diskutuar për tërheqje të ShBA-ve nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut apo NAFTA (North American Free Trade Agreement), nga G7, por edhe nga NATO. Pastaj, gjatë udhëheqjes së Trump-it, ShBA-të ishin tërhequr nga Marrëveshja e Parisit⁵⁷ dhe nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dhe në vazhdimësi kishte shprehur kërcënimet e tij se do të angazhohej për tërheqjen e ShBA-vë edhe nga shumë marrëveshje të tjera ndërkombëtare (Bump, 2018).

Kurse, disa nga premtimet kryesore të Joe Biden gjatë fushatës së zgjedhjeve presidenciale amerikane të vitit 2020 ishin për maksimalizimin e përpjekjeve për rivendosjen e partneriteteve historike amerikane. Kjo kishte nënkuptuar mbajtjen e mprehtë të aftësive ushtarake të NATO-s, forcimin e bashkëpunimit me partnerë demokratikë përtej Amerikës së Veriut dhe Evropës, duke arritur tek partnerët amerikanë në Azi, Amerikë Latine dhe Afrikë. Ai kishte deklaruar se do të forconte aleancat amerikane me Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë dhe demokracitë e tjera aziatike, duke mbështetur një angazhim të hekurt për sigurinë e Izraelit (Joe Biden, n.d.).

⁵⁷ Marrëveshja e Parisit, e cila është nënshkruar më 22 prill 2015 dhe ka hyrë në fuqi më 4 nëntor 2016, bazohet në Konventë dhe për herë të parë i sjell të gjitha kombet në një kauzë të përbashkët për të ndërmarrë përpjekje ambicioze për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për t'iu përshtatur efekteve të saj, me një mbështetje të shtuar për të ndihmuar vendet në zhvillim ta bëjnë këtë.

Gjatë katër viteve të udhëheqjes prej Donald Trump, UE-ja dhe ShBA-të kishin pasur marrëdhënie të tensionuara. Humbja e tij në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020 ishte mirëpritur në kontinentin evropian, aty ku presidenca e tij kishte shkaktuar zemërim dhe inat. Evropianët kishin pohuar frikën e tyre se një mandat i dytë i Trump-it do të shkaktonte kolapsimin e marrëdhënieve transatlantike, si dhe rrezikimin e prosperitetit dhe stabilitetit evropian. Me ardhjen e Joe Biden në krye të presidencës amerikane, evropianët besonin fuqishëm në interesin e tij për bashkëpunim me UE-në. Madje disa liderë evropianë e shihnin presidencën e Joe Biden-it si një mundësi të artë jo vetëm për të rregulluar aleancën transatlantike, por edhe për ta ripërtërirë dhe ridefinuar atë për dekadat e ardhshme. Por, kishte edhe politikanë evropianë që nuk iu kishin kushtuar edhe aq vëmendje disa elementeve të politikës së jashtme të Biden-it gjatë fushatës presidenciale, përpos që kishin mirëpritur mendimin e tij multilateralist. Duhet theksuar Emmanuel Macron, por edhe disa figura të tjera të UE-së, të cilët kishin argumentuar se Donald Trump ishte një mësim për Evropën, ngase sipas tyre kontinenti duhet të jetë më pak i varur nga Washington-i ekonomikisht, por edhe sa i përket mjedisit dhe sigurisë (Adler, 2020).

Donald Trump e kishte konsideruar UE-në si “armikun” më të madh të ShBA-ve për çështjet tregtare, si dhe asnjëherë nuk i ka fshehur preferencat e tij për Brexit (Birnbau, 2020). Mirëpo, çfarë nënkupton ardhja e Joe Biden në krye të presidencës amerikane për Brexit-in? Gjatë kohës sa kishte qenë Zëvendës-president i ShBA-ve në administratën Obama, Joe Biden kishte shprehur mendimin e tij rreth votimit të britanikëve për Brexit në vitin 2016, duke pohuar se si miq të vjetër të MB-së, ShBA-të do të respektonin vendimin e popullit britanik, megjithëse nuk kishte dashur që të ishte i tillë. Qeveria britanike pothuajse ndryshe nga çdo anëtar tjetër i aleancës perëndimore duket vërtetë ambivalente për atë se cili nga kandidatët për president të ShBA-ve do të ishte më i mirë për të ardhmen e Britanisë. Boris Johnson është karakterizuar për marrëdhënie miqësore me Donald Trump, por në aspektin e politikave britanikët përshtateshin më tepër me Joe Biden. Qëllimet e këtij të fundit për politikën e jashtme amerikane gjenin harmonizim më të madh me ato të Johnson-it sesa që kishin pasur me ato të Trump-it. MB-ja ka qenë partneri kryesor i ShBA-ve brenda UE-së, ndërsa pas Brexit-it ShBA-të do të mund të viheshin në kërkim të ndonjë partneri tjetër që mund të ishte Gjermania, Franca, ose Holanda (Cooper, 2020). Sa i përket asaj se a do të fokusohet administrata Biden më tepër në Paris dhe Berlin, sesa në Londër si rezultat i Brexit-it, zërat afër Joe Biden kishin pohuar se Washington-i dëshironte të kishte

marrëdhënie të mira me të gjithë, përfshirë këtu edhe Brukselin, por që kjo mbetet të shihet në të ardhmen. Johnson nuk e ka adhuruar asnjëherë frazën “marrëdhënie speciale” ndaj marrëdhënieve me ShBA-të sepse këto të fundit i ka konsideruar përherë si aleancën më të rëndësishme të MB-së. Mirëpo, më 2 dhjetor 2020 Joe Biden kishte pohuar se Amerika nuk do të nënshkruante asnjë marrëveshje tregtare me asnjë shtet, gjersa ShBA-të të rregullonin çështjen konkurrencës së tyre. Britania kishte mbyllur një marrëveshje tregtare me administratën e Donald Trump-it, por Biden kishte thënë se ndër prioritetet e tij do të ishte përmirësimi i investimeve në prodhimin amerikan, si dhe mbrojtja e punëtorëve në ShBA. Disa mbështetës të Brexit-it kishin theksuar se një marrëveshje tregtare e MB-së me ShBA-të ishte një nga përfitimet e hershme të Brexit-it, por duket se vlera ekonomike e një marrëveshjeje të tillë ishte vënë në dyshim (Wintour, 2020).

III.3.4 Konkluzionet

Një ditë pas votimit të referendumit të Brexit-it, David Cameron kishte dhënë dorëheqje nga posti i kreut të qeverisë britanike dhe vendin e tij e kishte zënë Theresa May që ishte bërë kryeministrja e dytë femër në Britani. Për të forcuar ndikimin e saj në negociatat e Brexit-it, më 8 qershor 2017 ajo kishte organizuar zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në të cilat PK-ja ishte dashur që të arrinte marrëveshje me PUD-në për të siguruar më shumë se 325 deputetë. Gjersa në zgjedhjet e vitit 2015 UKIP kishte pasur sukses të jashtëzakonshëm, në zgjedhjet e vitit 2017 kishte pasur dështim po aq të jashtëzakonshëm, rënie prej 10,8%. Si rrjedhojë e mospajtimit dhe presioneve të shumta nga politikanët e partive të tjera dhe të partisë së saj, Theresa May kishte dhënë dorëheqje nga posti i kryeministres më 24 maj 2019, si dhe më 13 korrik 2019 vendin e saj e kishte zënë Boris Johnson. Ky i fundit kishte kërkuar prorogim pesëjavor të Parlamentit të MB-së, i cili ishte parë si tendencë e tij për t'i shuar përpjekjet e kundërshtarëve që kishin parandaluar Brexit-in. Për ta lehtësuar finalizimin e Brexit-it, ai më 12 dhjetor kishte organizuar zgjedhjet e parakohshme parlamentare, prej së cilave PK-ja kishte marrë 385 vende në parlament, kurse PL-ja kishte humbur bastionet e saj në pjesën veriore dhe qendrore të Anglisë. Zbehja e partneritetit mes partive Sinn Féin dhe PUD kishte ardhur si rezultat i Brexit-it, gjersa MPM-ja mund të rrezikohej nga moszgjedhja efikase e Kufirit Irlandez, një çështjeje të diskutuar në tri fazat e negociatave të Brexit-it. Pakënaqësitë e

skocezëve për Brexit rrezikojnë shpërbërjen e Britanisë, nëse në të ardhmen në Skoci organizohet referendumi i dytë i pavarësisë. Rreziku i inkurajimit të vendeve të tjera anëtare të UE-së për të ndjekur shembullin e MB-së mund të mohohet nga implikimet e Brexit-it, por gjersa ka nivel të lartë të euroskepticitetit brenda UE-së, ky rrezik mund të ekzistojë. Brexit ka ndikim negativ në politikat zgjeruese të UE-së, veçmas në integrimin e Ballkanit Perëndimor, sepse ato nuk gjenden brenda agjendës së UE-së. Roli i UE-së në arenën ndërkombëtare dhe efikasiteti i diplomacisë digjitale janë dëmtuar shumë nga dalja e Britanisë, ndërsa finalizimi i fazës së tretë të Brexit-it pa marrëveshje mes MB-së dhe UE-së shtrin edhe pasojat politike të Brexit-it përtej Evropës.

KAPITULLI IV

ANALIZA SWOT

IV.1 Pikat e forta

IV.1.1 Pikat e forta për Mbretërinë e Bashkuar

- **Shembull i demokracisë përfaqësuese:** Besimi maksimal i politikanëve të MB-së tek populli britanik për marrjen e vendimeve kryesore shtetërore e bën Britaninë një prej shembujve më të mirë të demokracisë përfaqësuese, jo vetëm brenda kontinentit evropian por edhe në botë;
- **Ruajtja e sovranitetit kombëtar:** Mbështetja e plotë në ligjet e miratuara nga Parlamenti i MB-së dhe vendimet e marra prej GjSMB-së e mbron sovranitetin kombëtar të Britanisë;
- **Kontrolli i emigracionit:** Rritja e mundësive për kontrollin e emigracionit konsiderohet si tërësia e përpjekjeve të MB-së për parandalimin e abuzimit të lëvizjes së lirë dhe sistemit të mirëqenies britanike, duke iu dhënë gjithnjë përparësi studentëve, hulumtuesve, ekspertëve medicinalë dhe personave që mund të kontribuojnë në ekonominë e Britanisë pa rrezikuar sigurinë e saj.

IV.1.2 Pikat e forta për Unionin Evropian

- **Minimi i inkurajimit për aktivizimin e Nenit 50:** Negociatat e Brexit-it në të tri fazat e tyre kanë treguar se aktivizimi i Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës, gjegjësisht vendimi i një shteti për t'u tërhequr prej anëtarësisë së UE-së, përbën një proces të komplikuar dhe me implikime shumë serioze, me ç'rast 27 vendet anëtare të UE-së janë vetëdijesuar për pasojat që burojnë prej largimit nga UE-ja, të cilat hedhin

poshtë përfitimet e daljes dhe në këtë mënyrë minohet inkurajimi i tyre për ta ndjekur shembullin e MB-së;

- **Kontributet financiare britanike pas Brexit-it:** Britania duhet kontribuar në buxhetin e UE-së deri në përfundimin e fazës së tretë të negociatave të Brexit-it njëjtë siç kishte kontribuar kur kishte qenë vend anëtar në UE, ndërsa më pas detyrimet e saj financiare ndaj UE-së do të vazhdojnë gjer në vitin 2064, vlera e së cilave mund të jetë mbi 30 miliardë paund;
- **Forcimi i pozicioneve të qyteteve kryesore evropiane:** Zhvendosja e kompanive evropiane nga Londra do të ketë përfitime të shumta për qytetet ku ato do të vendosen, siç janë: Dublini, Luksemburgu, Parisi, Frankfurti dhe Amsterdami, të cilat në këtë rast mund të forcojnë pozicionet e tyre kundrejt Londrës.

IV.2 Dobësitë

IV.2.1 Dobësitë për Mbretërinë e Bashkuar

- **Tiparet negative të referendumeve:** Referendumet nuk ofrojnë zgjidhje për çdo çështje, me theks të veçantë për marrjen e vendimeve themelore lidhur me drejtimin në të cilin duhet lëvizur vendi. Koha e organizimit, formulimi i pyetjes dhe niveli i pjesëmarrjes janë faktorët kryesorë që ndikojnë në rezultatet e referendumeve;
- **Artikujt e gazetave euroskeptike:** Një pjesë e madhe e gazetave britanike janë euroskeptike dhe karakterizohen prej një qasjeje jashtëzakonisht shumë armiqësore ndaj UE-së, duke keqinterpretuar nëpërmes artikujve të tyre politikat e saj dhe duke cilësuar të dëmshme për MB-në çdo gjë vjen prej Brukselit;
- **Dëmet ekonomike:** Ekonomia britanike ka pësuar shumë goditje si pasojë e Brexit-it, siç janë detyrimet e Britanisë ndaj UE-së, rritja e kostove tregtare prej së cilave ka ulje të eksporteve dhe rritje importesh me UE-në, devaluimi i monedhës paund që shkakton rritje të normës së inflacionit, efektet negative të rënies së IHD-ve dhe zhvendosjes së firmave, si dhe ulja e migrimit neto që vështirëson sigurimin e tregjeve të reja, aftësive dhe forcës së punës me çmime më të ulëta.

IV.2.2 Dobësitë për Unionin Evropian

- **Aktivizimi i Nenit 50 për herë të parë:** UE-ja është përballur për herë të parë me aktivizimin e Nenit 50 të Traktatit të Lisbonës në rastin e Brexit-it. Ndonëse ishte përballur, përballlet dhe do të përballlet me kriza të ndryshme, Brexit për UE-në përbën një krizë të veçantë sepse e sfidon qëllimin e UE-së për të qenë bashkim gjithnjë e më i ngushtë;
- **Humbja e njërit nga tri shtetet kryesore evropiane:** Treshja kryesore e politikës evropiane përbëhet nga Gjermania, Franca dhe MB-ja, si dhe shkëputja e çdonjërit prej këtyre vendeve nga UE-ja paraqet një sërë kërcënimesh të natyrave të ndryshme për UE-në.

IV.3 Mundësitë

IV.3.1 Mundësitë për Mbretërinë e Bashkuar

- **Zbatueshmëria e marrëveshjeve të përziera:** 1/4 e marrëveshjeve ndërkombëtare të UE-së janë marrëveshje të përziera që përpos UE-së, për lidhjen e tyre është marrë edhe pëlqimi i vendeve anëtare të UE-së. Meqë MB-ja ka qenë palë kontraktuese e këtyre marrëveshjeve, zbatueshmëria e tyre nga Britania mund të vazhdojë edhe pas Brexit-it;
- **Liria për lidhjen e marrëveshjeve të reja tregtare:** Liria e Britanisë për të lidhur marrëveshje tregtare me shtete të ndryshme në botë, veçmas me ato që po rangohen në pozicionet e para në botë për zhvillimin e tyre ekonomik, si: India, Kina, Brazili, Australia, Zelanda e Re dhe plot shtete të tjera;
- **Marrëveshja tregtare MB-Japoni:** Arritja e marrëveshjes historike sa i përket tregtisë së lirë ndërmjet MB-së me Japoninë më 11 shtator 2020, me vlerë 15,2 miliardë paund dhe përfitime shtesë për kompanitë britanike përtej marrëveshjes tregtare UE-Japoni;
- **Fuqizimi i ndikimit në NATO:** Britania mund të bëhet fuqia kryesore de facto evropiane brenda NATO-s, me theks të veçantë mund të marrë rolin e përfaqësueses

së Evropës Lindore dhe vendeve të tjera që e konsiderojnë Rusinë si një rrezik të veçantë.

IV.3.2 Mundësitë për Unionin Evropian

- **Rikthimi i partneritetit UE-ShBA:** Presidenca amerikane në krye me Donald Trump ishte karakterizuar prej marrëdhënieve të tensionuara ndërmjet ShBA-ve dhe UE-së, dhe mbështetjes së tij ndaj MB-së për Brexit. Fitorja e Joe Biden në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2020 ishte mirëpritur në Evropë ngase Biden kishte theksuar brenda synimeve të tij për politikën e jashtme amerikane rivendosjen e partneriteteve amerikane, përfshirë këtu UE-në.
- **Tregu më i madh në botë:** UE-ja me 27 vendet e saj anëtare do të vazhdojë të jetë lojtari më i madh i skenës tregtare globale bazuar edhe në faktin se barrën më të madhe të pasojave ekonomike të Brexit-it do ta ketë Britania.

IV.4 Kërcënimet

IV.4.1 Kërcënimet për Mbretërinë e Bashkuar

- **Zëvendësimi i 157 marrëveshjeve ndërkombëtare:** Qeveria e MB-së në vitin 2019 kishte identifikuar 157 marrëveshje ndërkombëtare që duhet zëvendësuar, por që zëvendësimi i tyre përbën një proces të komplikuar dhe të karakterizuar prej negociatave që marrin shumë kohë dhe kanë kosto të larta financiare, si dhe varen nga vullneti i vendeve të treta;
- **Lidhja e marrëveshjeve tregtare me 168 shtete:** Për të parandaluar përçarjen e flukseve tregtare që rezultojnë prej Brexit-it, Britania duhet të arrijë marrëveshje të reja me 168 vende të botës;
- **Dyshimet rreth marrëveshjes tregtare MB-ShBA:** Ndonëse votuesit e Brexit-it ishin mbështetur maksimalisht në përfitimet e hershme të një marrëveshjeje tregtare MB-ShBA, me ardhjen e Joe Biden në krye të presidencës amerikane duket se është vënë në dyshim vlera ekonomike e marrëveshjes në fjalë ngase Biden do të fokusohet në përmirësimin e konkurrueshmërisë brenda ShBA-ve;

- **Rënia e GDP-së britanike:** Përfundimi i fazës së tretë të negociatave të Brexit-it pa marrëveshje të tregtisë së lirë dhe pasojat ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19 rrezikojnë me rënie të jashtëzakonisht serioze të GDP-së së Britanisë;
- **Rreziku i shkëputjes së Skocisë dhe Irlandës Veriore nga MB-ja:** Pakënaqësitë e Skocisë në lidhje me Brexit-in mund të pasojnë me shkëputjen e saj nga MB-ja ngase politikanët skocezë po angazhohen me përkushtim të madh rreth çështjes së organizimit të referendumit të dytë të pavarësisë. Pastaj, premtimi i UE-së ndaj Irlandës Veriore që nëse shkëputet nga Britania dhe bashkohet me Republikën e Irlandës bëhet automatikisht pjesë e UE-së, shton akoma rreziqet e shpërbërjes së MB-së.

IV.4.2 Kërcënimet për Unionin Evropian

- **Dobësimi i ndikimit të UE-së në politikën ndërkombëtare:** Dalja e Britanisë si një nga vendet e pakta anëtare të UE-së me fuqi të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake në botë do t'i dëmtojë marrëdhëniet transatlantike të UE-së, në të cilat Britania ka rol të rëndësishëm ndërmjetësues;
- **Dobësimi i diplomacisë digjitale të UE-së:** Prej vendeve anëtare të UE-së, diplomacia digjitale britanike është shquar për efikasitetin e saj dhe jo më kot platformat digjitale të politikanëve dhe institucioneve të MB-së renditen në vendet e para në botë për tërheqje audiencash. Pa Britaninë, diplomacia digjitale e UE-së do ta ketë të vështirë shtrirjen ndërkombëtare dhe depërtimin tek audiencat globale;
- **Mosarritja e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet UE-së dhe MB-së:** Nëse nuk arrihet një marrëveshje e tregtisë së lirë mes UE-së dhe MB-së do të pasojnë kontrole kufitare dhe taksa për qarkullimin e mallrave të UE-së;
- **Rrezikimi i PPPJSUE-së:** Në qoftë se faza e tretë e negociatave të Brexit-it përfundon pa marrëveshje mbi partneritetin e ardhshëm UE-Britani, krahas pasojave të mëdha ekonomike do të vihet në pikëpyetje edhe PPPJSUE.

KAPITULLI V

PËRFUNDIMI

Tema e disertacionit ndërlidhet me vendimin e MB-së për t'u tërhequr nga anëtarësia e UE-së, i njohur me termin Brexit. Siç është i rëndësishëm elaborimi i anëtarësisë së shtetit në organizata ndërkombëtare, ashtu është edhe përfundimi i saj. Si një nga katër mundësitë e përfundimit të anëtarësisë së shtetit në një organizatë ndërkombëtare është tërheqja, e cila përmendet në statutet e shumicës së organizatave ndërkombëtare. Kryesisht rezistenca e shtetit për bartje të sovranitetit brenda organizatës ndërkombëtare shpie drejt vendimit të tij për t'u tërhequr nga anëtarësia. Rast i veçantë i tërheqjes së shtetit nga anëtarësia e organizatës është Brexit, respektivisht dalja e Britanisë nga UE-ja. Para hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, nëse një shtet do të kishte shprehur vullnetin e tij për t'u tërhequr nga UE-ja, praktikisht do ta kishte të vështirë për shkak të zbrazëtirës juridike rreth kësaj çështjeje. Mirëpo, në Nenin 50 të Traktatit të Lisbonës ishte rregulluar mundësia për tërheqje vullnetare të një vendi anëtar nga UE-ja. Pas arritjes së një marrëveshjeje rinegociuese me UE-në, më 23 qershor 2016 ishte mbajtur referendumi, në të cilin britanikët kishin vendosur për të ardhmen e vendit të tyre. Megjithëse me një rezultat të ngushtë, 51,9% e britanikëve nga ata që kishin dalë në votime kishin votuar për Brexit. Moshat prej 18-44 vjeç kishin votuar kundër daljes, ndërsa ato prej 45 vjeç e tutje për dalje. Me përjashtim të Londrës, në tetë regjione angleze ishte votuar për Brexit, kurse në përgjithësi 53,4% e anglezëve kishin votuar kundër vazhdimin të anëtarësisë në UE. Për Brexit ishte votuar edhe në Uells dhe rezultatet kishin qenë 52,5% në favor të tij. Në Irlandën Veriore ishte votuar kundër daljes së Britanisë nga UE-ja me 55,8%. Ndërsa, Brexit ishte kundërshtuar më së shumti në Skoci sepse 62% e votuesve kishin votuar kundër tij. Meqë Ligji i Unionit Evropian (Njoftimi i Tërheqjes) ishte miratuar nga Parlamenti i MB-së dhe kishte marrë pëlqimin mbretëror në vitin 2017, qeveria britanike më 29 mars 2019 kishte kërkuar aktivizimin e Nenit 50 nga UE-ja. Pas miratimit të UE-së për fillimin e negociatave të Brexit-it, hapja e tyre zyrtare ishte bërë më 19 qershor 2017, për të cilat UE-ja dhe Britania kishin angazhuar si negociatorë ekspertë të shquar dhe personalitete me

eksperiencë të madhe. Këto negociata kishin qenë të ndara në tri faza. Faza e parë e bisedimeve ishte zhvilluar në gjysmën e dytë të vitit 2017 dhe ishte përbërë nga gjashtë raunde, ku ishin diskutuar çështjet kryesore, si të drejtat e qytetarëve britanikë dhe atyre të UE-së, marrëveshjet financiare dhe Kufiri Irlandez. Kjo fazë ishte përmbyllur në fund të vitit 2017, edhe pse me disa mospajtime mes palëve dhe progres jo të madh rreth çështjeve primare. Faza e dytë e negociatave kishte të bënte me dakordimin e MB-së dhe UE-së për arritjen e Marrëveshjes së Tërheqjes. Si pasojë e përplasjeve politike në Britani, kjo marrëveshje nuk ishte ratifikuar më 29 mars 2019, e cila sipas Nenit 50 duhej të ishte “Brexit Day”. Theresa May ishte detyruar që të kërkonte dy herë zgjatje të periudhës së Nenit 50, kurse Boris Johnson një herë. Marrëveshja e Tërheqjes ishte miratuar nga Parlamenti i MB-së dhe kishte marrë pëlqimin mbretëror, ishte nënshkruar nga kryeministri britanik dhe liderët e UE-së, ishte miratuar edhe PE-ja, si dhe kishte hyrë në fuqi më 31 janar 2020. Faza e tretë e negociatave mbi partneritetin e ardhshëm mes UE-së dhe Britanisë duhej të përmbyllej më 31 dhjetor 2020. MB-ja kishte kundërshtuar shtyrje të kësaj date, me ç’rast faktori kohë, problemet e shkaktuara nga pandemia Covid-19, si dhe mospajtimet e shumta mes palëve për arritjen e marrëveshjes së tregtisë së lirë kishin shtuar gjasat mbi përfundimin e kësaj faze pa marrëveshje. Mirëpo, përpjekjet maksimale të palëve rezultuan me Marrëveshjen e Tregtisë dhe Bashkëpunimit UE-Britani më 24 dhjetor 2020, e cila u nënshkrua nga liderët e UE-së dhe MB-së, si dhe u ratifikua nga Parlamenti i Britanisë dhe mori pëlqimin mbretëror më 30 dhjetor 2020. Zbatimi i saj i përkohshëm ka filluar më 1 janar 2021, meqë akoma kjo marrëveshje nuk ka marrë pëlqimin e PE-së, gjë që pritet të ndodh gjatë vitin 2021. Brexit ka rezultuar të jetë një proces edhe më i komplikuar se që është pritur. Por, cilët faktorë i kanë kontribuar Brexit-it? Specifikimi i tyre kërkon një analizë të thellë dhe të mbështetur tërësisht në qasjen teorike realiste. Për nivelin individual të analizës duhet cekur që ka shumë personalitete politike britanike që nga vitit 1974 e gjer në vitin 2016 që në vazhdimësi kanë shprehur përkrahjen e tyre rreth idesë së organizimit të një referendumi, ku populli britanik do të vendoste për të ardhmen e Britanisë, vazhdimin apo përfundimin e anëtarësisë së saj në UE. Harold Wilson, Margaret Thatcher, Michael Foot, James Goldsmith, Gordon Brown, Nick Clegg, Peter Bone, David Nuttall, David Cameron, James Wharton, Nigel Farage, Chris Grayling, Theresa Williers dhe Boris Johnson janë disa nga politikanët britanikë që kanë pasur mospajtime me një sërë politikash të UE-së, si rrjedhojë e së cilave ka ardhur edhe mbështetja e tyre për organizimin e referendumit

të anëtarësisë së MB-së në UE. Rreth referendumit të vitit 2016 kishte pasur reagime edhe prej disa liderëve të shteteve të botës dhe organizatave ndërkombëtare, si: Marc Rutte, François Hollande, Angela Merkel, Erna Solberg, Barack Obama, Justin Trudeau, Xi Jinping, Narendra Modi, Shinzō, Malcolm Turnbull, Jens Stoltenberg dhe Christine Lagarde. Sipas tyre referendumi britanik nuk ishte vetëm çështje e brendshme e MB-së, por një çështje ndërkombëtare duke iu referuar pasojave që mund të rezultojnë nga Brexit-i, prandaj e mbështesnin vazhdimin e anëtarësisë së Britanisë nga UE-ja. Mirëpo, kishte edhe politikanë që iu kishin bërë thirrje britanikëve që ta votonin opsionin e daljes nga UE-ja si Gert Wilders, Marine Le Pen dhe Donald Trump. Niveli shtetëror i analizës hedh në pah atë se votimi për Brexit kishte qenë i ndikuar nga disa faktorë brenda Britanisë. Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2015 kishin qenë befasuese për faktin se UKIP ishte renditur në vendin e tretë pas PK-së dhe PL-së me 12,6% të votave. Kjo parti me pikëpamjet euroskeptike kishte gjetur mbështetje te një pjesë e madhe e britanikëve me brenga rreth emigracionit dhe mospajtimeve rreth funksionimit të UE-së, si dhe po ashtu kishte shfrytëzuar edhe nivelin e ulët të njohurive për politikën dhe institucionet e UE-së për t'i shtyrë votuesit drejt vendimit për Brexit. Në këtë pjesë kishin ndikuar edhe gazetatat britanike me artikujt e tyre, të cilat gjatë referendumit ishin ndarë në dy grupe: pro-UE-së dhe anti-UE-së. Nuk duhet harruar edhe kampanjën e famshme "Vote Leave and Take Control" që vazhdimisht kishte bërë zhurmë mbi arsyet përse duhej votuar për Brexit. Analiza në nivelin sistematik zbulon efektet e disa ngjarjeve dhe proceseve që kishin lidhje edhe me MB-në, por edhe me UE-në. Referendumet mund të cilësohen si mundësi për të zgjedhur çështje të ndryshme, por nuk ofrojnë zgjedhje për secilën çështje. Referendumi i Brexit-it është referendumi i dytë i mbajtur në Britani mbi anëtarësinë e saj në UE sepse i pari ishte mbajtur në vitin 1975. Aspekti ekonomik kishte favorizuar opsionin e mbetjes në vitin 1975, gjersa në vitin 2016 aspekti i sigurisë kishte favorizuar opsionin e daljes. Humbja e sovranitetit shtetëror është shqetësimi kryesor i britanikëve. Rritja e kompetencave të PE-së ka qenë një nga brengat primare të MB-së, kurse anëtarësimi i saj në Zonën Shengen është parë si shkatërrim i sovranitetit. Pastaj, Britania ishte vend anëtar i UE-së, por nuk e ka përdorur euron si monedhë të përbashkët sepse nuk ishte pjesë e eurozonës. Emigracioni ishte faktor kyç që ndikoi në votimin e britanikëve për Brexit. Emigrantët e UE-së, gjegjësisht ata nga Evropa Lindore, në MB shiheshin si një kërcënim i rrezikshëm për mirëqenien e britanikëve. Pastaj kriza e refugjatëve e vitit 2015, ku miliona emigrantë nga Lindja e Mesme kishin ardhur në

Evropë, kishte shkaktuar tensione brenda vendeve anëtare dhe institucioneve të UE-së, me ç'rast pakënaqësitë e britanikëve kundrejt UE-së ishin rritur akoma më tepër. Niveli global i analizës tregon se viti 2016 kishte qenë një vit shumë i trazuar për marrëdhëniet ndërkombëtare, rrjedhshmëria e së cilave ishte ndikuar nga prezenca e popullizmit në vende të ndryshme të botës. Problemet globale, kryesisht të lidhura me terrorizmin, emigracionin dhe ndryshimet klimatike, krijojnë hapësira favorizuese për depërtimin e partive populiste, mbështetja e së cilave në vitin 2016 kishte qenë shumë shqetësuese dhe kishte ngjallur frikë për rrezikimin e efektivitetit të vlerave demokratike. Pastaj, Britania është një shtet me rol të madh politik, ekonomik dhe ushtarak në botë, por që në vitin 2016 nuk ishte në treshen e vendeve më të fuqishme në botë dhe në të ardhmen mund të mos jetë as në pesëshe. Vendimi MB-së për Brexit, një shteti që në shekullin XIX ka qenë fuqi botërore, ishte parë edhe si një mundësi për ta rimarrë "vendin e humbur" në botë. Brexit ka shkaktuar pasoja në aspekte të ndryshme, por ndër më kryesoret janë ato të aspekteve ekonomike dhe politike. Sa iu përket pasojave ekonomike, Brexit ka shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë britanike. MB-ja do të ketë detyrime financiare ndaj UE-së gjer në vitin 2064, kostoja e së cilave mund të arrijë vlerën e mbi 30 miliardë £. Rritja e kostove tregtare paraqet shumë pengesa për realizimin e aktiviteteve tregtare të Britanisë me UE-në dhe që nga viti 2017 kur kishin filluar negociatat e Brexit-it në vazhdimësi kishte pasur ulje të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve britanike në UE. Në përkeqësimin e kushteve të tregtisë mund të ndikojë edhe devaluimi i monedhës që kishte filluar menjëherë pas referendumit të Brexit-it. Rënia e vazhdueshme e IHD-ve të UE-së në Britani dhe zhvendosja e firmave evropiane nga Londra në qytete të tjera si, Dublini, Luksemburgu, Parisi, Frankfurti dhe Amsterdami, do të kenë ndikim negativ për pozicionin e Londrës si një nga qendrat dominuese financiare në Evropë. Ulja e migrimit neto në MB kishte arritur në një nivel brengosës, me ç'rast numri i migrantëve të vendeve anëtare të UE-së që vinin për të punuar në territorin britanik, kryesisht në Londër, po ulet vazhdimisht. GDP-ja britanike ka pësuar goditje të mëdha nga Brexit-i, përfshirë këtu edhe efektet negative ekonomike të pandemisë Covid-19 që do të jenë afatgjata. Ndonëse jo e dëmtuar ekonomikisht në mënyrë të njëjtë sikur MB-ja, as UE-ja nuk është kursyer prej pasojave ekonomike të Brexit-it. Megjithëse detyrimet financiare të Britanisë ndaj UE-së do të vazhdojnë edhe pas Brexit-it, buxheti i saj e ka humbur kontributin e MB-së si vend anëtar, si dhe kontributet e shteteve të tjera anëtare mund të rriten në mënyrë që të ruhet bilanci i buxhetit. Japonia e kishte pasur

Britaninë si portë depërtuese drejt UE-së dhe jo më kot ishte shqetësuar për realizimin e tregtisë së lirë me UE-në pas Brexit-it dhe gjithashtu për të ardhmen e bizneseve japoneze në MB. Hyrja në fuqi e MPE-së ndërmjet UE-së dhe Japonisë në vitin 2019 rezultonte me lehtësim të realizimit të tregtisë mes tyre, por në shtator 2020 ishte arritur një marrëveshje historike e tregtisë së lirë mes Japonisë dhe Britanisë, përfitimet e së cilës shkojnë përtej marrëveshjes tregtare UE-Japoni. UE-ja është palë kontraktuese në 982 marrëveshje ndërkombëtare bilaterale dhe 284 multilaterale. Për lidhjen e 3/4 së këtyre marrëveshjeve ka pasur fuqinë negociuese dhe miratuese vetëm UE-ja, kurse 1/4 e tyre janë marrëveshje të përziera, për lidhjen e së cilave është kërkuar edhe pëlqimi i vendeve të saj anëtare. Këto të fundit mund të zbatohen nga MB-ja pas Brexit-it, por ato që janë lidhur vetëm nga UE-ja do të përfundojnë së zbatuari pas Brexit-it, me ç'rast ato me rëndësi të madhe ekonomike duhet zëvendësuar. Zëvendësimi i tyre dhe lidhja e marrëveshjeve të reja tregtare të Britanisë me 168 vende të botës janë procese që marrin shumë kohë, varen nga vullneti i vendeve të treta, si dhe kanë kosto shumë të larta financiare. Lidhja e marrëveshjeve të tilla nuk janë pasoja ekonomike të Brexit-it vetëm për MB-në dhe UE-në, por efektet e tyre do të shpërndahen në mbarë botën. Në vitin 2016 David Cameron kishte pasur një barrë të madhe mbi supe, organizimin e referendumit mbi anëtarësinë e Britanisë në UE. Ai kishte bërë përpjekje maksimale për arritjen e një marrëveshjeje të kënaqshme për britanikët, duke gjetur zgjedhje për shqetësimet kryesore të MB-së gjatë rinegociimit me UE-në, por rezultatet e referendumit kishin qenë për Brexit dhe menjëherë pas publikimit të tyre ai kishte dhënë dorëheqje nga posti i kreut të qeverisë britanike. Për kryeministrin e ardhshëm britanik, PK-ja kishte pasur pesë pretendentë: Theresa May, Michael Gove, Stephen Crabb, Andrea Leadsom dhe Liam Fox. Prej tyre ishte zgjedhur Theresa May, e cila është edhe kryeministrja e dytë femër britanike, pas Margaret Thatcher. Ajo kishte pasur pikëpamje kundër Brexit-it dhe gjatë fushatës së referendumit kishte pohuar se sa i vështirë do të ishte ky proces për çdokënd që do të vinte në krye të qeverisë britanike në rast të dorëheqjes së Cameron-it. Me synim për të forcuar ndikueshmërinë e saj në bisedimet e Brexit-it, më 8 qershor 2017 kishte organizuar zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në të cilat PK-ja kishte fituar, por nuk i kishte 325 deputetë dhe për këtë arsye ishte arritur një marrëveshje mes Konservatorëve dhe PUD-së, jo koalicion, që së bashku kishin pasur 328 deputetë. Si pasojë e ndikimit të Brexit-it në rezultatet e këtyre zgjedhjeve, UKIP kishte pasur rënie prej 10,8% krahasuar me zgjedhjet e vitit 2015, si dhe diferenca ndërmjet PK-së dhe PL-së ishte

zvogëluar nga ngritja e kësaj të fundit për 9,5%. Gjatë fazës së parë dhe të dytë të negociatave të Brexit-it, propozimi i marrëveshjes për tërheqje të Britanisë nga UE-ja nga Theresa May ishte refuzuar tri herë radhazi. Përpos presioneve dhe kundërshtimeve nga partitë e tjera, ajo nuk kishte mbështetje as nga partia e saj. Të gjitha këto kishin bërë që May të dorëhiqej nga posti i kreut të qeverisë britanike më 24 maj 2019. Kandidatët e PK-së që kishin synuar të zinin vendin e saj kishin qenë: Boris Johnson, Jeremy Hunt, Michael Gove, Sajid Javid, Rory Stewart, Dominic Raab, Matt Hancock, Andrea Leadsom, Mark Harper dhe Esther McVey. Prej tyre kishte fituar Boris Johnson, i cili që nga data 13 korrik 2019 udhëheq qeverinë e MB-së. Johnson kishte vendosur që të prorogonte Parlamentin e Britanisë nga data 9 shtator gjer më 14 tetor 2019, që ishte aprovuar edhe Madhëria e Saj, Mbretëresha Elizabeta II. Mirëpo ky prorogim ishte parë si një tendencë e Johnson-it për të kufizuar kohën e kundërshtarëve të tij dhe si mundësi e shuarjes së përpjekjeve që parandalonin Brexit-in, çështje kjo që kishte përfunduar edhe në GjSMB. Me qëllim të lehtësimit të kalimit të marrëveshjes për Brexit, Johnson më 12 dhjetor 2019 kishte vendosur për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme. Në këto zgjedhje PK-ja kishte fituar 385 vende në Dhomën e Komunave, suksesi më i madh i kësaj partie që prej vitit 1987, ndërsa Laburistët kishin humbur në bastionet e tyre në pjesën veriore dhe qendrore të Anglisë. Pasojat e Brexit-it për Irlandën Veriore kishin filluar me zbehjen e partneritetit të partive Sinn Féin dhe PUD në vitet 2016-2017, pastaj Kufiri Irlandez është diskutuar në të gjitha fazat e negociatave të Brexit-it sepse komplikimet rreth tij mund ta vinin në rrezik MPM-në, por mund të rezultonin edhe me shkëputjen e Irlandës së Veriut nga MB-ja. Irlanda e Veriut kishte marrë një premtim nga UE-ja se nëse do t'i bashkohej Republikës së Irlandës, automatikisht do të bëhej pjesë e UE-së. Rol shumë të madh në referendumin e pavarësisë së Skocisë në vitin 2014 kishte pasur anëtarësia e Britanisë në UE dhe Brexit ka nxjerrë në pah planet e skocezëve për referendumin e dytë në të ardhmen, rezultatet e së cilit mund të jenë në favor të pavarësisë nga MB-ja si pasojë e kundërshtimit të Skocisë për Brexit. Krahas pasojave politike të Brexit-it për Britaninë kurrsesi nuk duhet harruar ato për UE-në. Kjo e fundit vazhdimisht ka pasur, ka dhe do të ketë kriza të njëpasnjëshme që rrisin euroskepticizmin brenda vendeve të saj anëtare. Rreziku i inkurajimit të shteteve anëtare të UE-së për të ndjekur shembullin e MB-së mund të minohet si rrjedhojë e implikimeve të Brexit-it, por nuk mund të mënjanohet. Brexit ka ndikim negativ edhe në politikat zgjeruese të UE-së që si rrjedhojë e tij nuk do të jenë

brenda agjendës së UE-së për një periudhë jo të shkurtër kohore. Prandaj UE-ja duhet të angazhohet për zgjerimin e saj të mëtejshëm për një periudhë afatmesme. Gjithashtu, nuk duhet harruar faktin se rajoni i Ballkanit Perëndimor, shtetet e së cilit janë faza të ndryshme integruese drejt UE-së, e ndihmon në disa raste, por edhe e rrezikon sigurinë e UE-së. Rajoni në fjalë ka humbur një mbështetës të madh për integrimin e tij në UE, siç është Britania. Ndonëse kjo e fundit ka pohuar se do ta mbështesë integrimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në UE, efektet e kësaj mbështetjeje jashtë UE-së nuk janë njëjta me ato brenda UE-së. Brexit e ka dëmtuar rolin e UE-së në arenën ndërkombëtare sepse i mungon një nga vendet e treshes kryesore evropiane. MB-ja ishte prej vendeve anëtare të pakta të UE-së me rol të madh politik, ekonomik dhe ushtarak, duke mos harruar edhe rolin e saj ndërmjetësues në marrëdhëniet transatlantike të UE-së. Brexit e ka dëmtuar edhe diplomacinë digjitale të UE-së, elementit primar për shtrirje globale sepse platformat digjitale të politikanëve dhe institucioneve politike të MB-së renditen ndër vendet e para në botë për tërheqjen e audiencave. Brexit do të ndikojë në bashkëpunimin e Britanisë dhe UE-së edhe në aspekte të tjera, veçmas në atë të sigurisë, duke shkaktuar sfida edhe më të mëdha brenda kontinentit evropian, pasojat e së cilave do të shtrijnë efektet e tyre përtej Evropës. Ardhja e Joe Biden në presidencën amerikane mund të mos përmbushë pritshmëritë e britanikëve sa i përket aleancës së fuqishme MB-ShBA sepse për dallim nga Donald Trump që kishte pasur marrëdhënie të tensionuara me UE-në, Biden kishte pohuar përpjekjet e tij për normalizimin e tyre dhe zgjerimin e bashkëpunimit të ShBA-ve me UE-në. Që nga 31 dhjetori 2020, zyrtarisht MB-ja nuk është më brenda UE-së, si dhe për Britaninë vlejné rregullat e njëjta si për vendet e treta. Shumë implikime të Brexit-it janë parë, akoma më tepër do të shihen gjatë dekadave ardhshme të shekullit XXI. Bazuar në këto fakte mund të konkludohet se tërheqja e Britanisë nga anëtarësia e UE-së do të njihet si rasti më i komplikuar i tërheqjes së shtetit prej organizatës ndërkombëtare.

CHAPTER V

CONCLUSION

The topic of the dissertation is related to the decision of the UK to withdraw from EU membership, known as Brexit. Just as important is the elaboration of the state's membership in international organizations, so is its termination. As one of the four possibilities of termination of the membership of state in an international organization is the withdrawal, which is mentioned in the statutes of most international organizations. Mostly, the state's resistance to the transfer of sovereignty within the international organization leads to its decision to withdraw from membership. A special case of the state withdrawing from the organization's membership is Brexit, respectively Britain's exit from the EU. Before to the entry into force of the Lisbon Treaty, if a country had expressed its willingness to withdraw from the EU, it would have been practically difficult due to the legal gap on the issue. However, Article 50 of the Lisbon Treaty regulated the possibility of voluntary withdrawal of a member state from the EU. Following a renegotiation agreement with the EU in February 2016, a referendum was held on June 23, 2016, in which the British had decided on the future of their country. Although with a narrow result, 51.9% of Britons out of those who had gone to the polls had voted for Brexit. Ages 18-44 years old had voted against leaving, while those aged 45 and over voted for leaving. With the exception of London, in eight English regions was voted for Brexit, while in general 53.4% of the English had voted against the continuation of EU membership. For Brexit was voted also in Wales and the results had been 52.5% in its favor. In Northern Ireland it was voted against Britain's exit from the EU with 55.8%. While, Brexit was most opposed in Scotland because 62% of voters had voted against it. Since the European Union Act (Notification of Withdrawal) was approved by the UK Parliament and received royal assent in 2017, the British government on March 29, 2019 had requested the activation of Article 50 by the EU. Following the EU approval for the start of the Brexit negotiations, their official opening took place on June 19, 2017, for which the EU and Britain had engaged as negotiators prominent experts and highly experienced personalities. These negotiations had been divided into three phases. The first

